

# ANATOMIA E NJERIUT

njohuri baze

BOTIM SPECIAL

Dr. Shk. Nikollaq LEKA

Prof. Sazan GABRANI

Prof Asc. Artur HAFIZI

Prof. Drita OSMANLLI

Prof. Asc. Sofika QAMIRANI

Dr. Shk. Skender TOPI

Abulema

Izdepi

Tirane, 2008

## **PARATHENIE E BOTIMIT TE PARE**

© Të gjitha të drejtat janë të autorit.

Punuar dhe shtypur: Shtypshkronja "MIRGEERALB"

ISBN: 978-99956-22-89-3

Rastesisht apo jo, ne te njejtin vit (1543) Vezaliusi botoi "*De humani corporis fabrica*", ndersa Koperniku "*De revolutionibus orbium coelestium*". Dy librat perfaqesonin vizione te reja te kuptimit te ndertimit te trupit te njeriut dhe te universit.

Libri i Vezaliusit, ne shtate vellime, per here te pare e konsideroi anatomine si shkence mjekesore; ai bazohej ne observime objektive, vizatime te sakta dhe konkluzione logjike. Qe nga ajo kohe, libra anatomike nuk jane reshtur se shkruari dhe me siguri duhet te jene nder me te shumtet midis librave mjekesore.

Peseqind vjet pas Vezaliusit, anatomia vazhdon te jetet ne themel te disiplinave mjekesore (bashke me fiziologjine).

Kendveshtrimet e ndryshme anatomike te strukturave te trupit te njeriut dhe sofistikimi i metodave te studimit e kane bere ate me te zhervjellet.

NA, TA apo ... jane problemi i pazgjidhur ne literaturen tone (shqiptare) anatomike te sotme dhe nje e treta fundore e ketij problemi vazhdon te jetet e pazgjidhur ne kete liber. Kjo me sa duket reflekton ecurine e terminologjise anatomike ne rrafshin nderkombetar.

"*Nomina Anatomica*" (NA), e paraqitur nga IANC (Komiteti Ndërkombëtar i Nomenklaturës Anatomike), u aprovua ne Kongresin e IFAA-s (Federata Nderkombetare e Shoqatave te Anatomeve) ne Paris ne 1955. NA perfshinte rreth 5600 terma anatomike.

"*Terminologia Anatomica*" (TA), e paraqitur nga FCAT (Komiteti Federativ i Terminologjisë Anatomike), u aprovua ne Kongresin e IFAA-s ne Rio de Zhaneiro ne 1998 dhe perdoret ne shumicen e publikimeve anatomike ne kohen e sotme. Barazvlefshmeria sipas saj e termave anatomike latine me ata angleze, eshte konsideruar gjeresisht e pranueshme. TA perfshin rreth 7500 terma anatomike.

Ne publikimet mjekesore ne shqip, meqe ka nje terminologji te unifikuar, perdoren lirisht terma te NA, TA, eponime, perkthime korrekte, jokorrekte apo pershtatje.

Ne kete liber, veç termave te pershtatur ne shqip, jane dhene edhe termat latine te TA (te veçuara ne shkrim italik ne çdo rast).

Fjalet e perkthyera zor se mund te jene edhe besnike edhe te bukura. Per kete aresye, pershtatja e termave latine ne shqip eshte me sa duket, rruga e vërmë, e cila çon keshtu ne formimin e njefare terminologje “alblatine”. Ne kete liber termat e pershtatur jane vetem perzgjedhje personale e termave ne perdonim kolektiv. Megjithate, perzgjedhja ka qene veçanerisht e veshtire ne terminologjine e muskujve, te eneve te gjakut dhe te sistemit nervor periferik, terminologji e cila, duke mos qene gramatikisht korrekte, eshte larg perfekzionit.

Pavaresisht kesaj, eshte synuar maksimalisht qe keta terma, “alblatine” te jene edhe besnike, edhe te bukur.

Shkurtimet e perdonura ne kete liber jane ata gjeresisht te njohur: a. per arterie, lig. per ligament, m. per muskul, n. per nerv, nc. per nukleus, tr. per trakt, r. per ramus dhe v. per vene. Ne rast te perdonimit te njevlershem te dy ose me shume termave latine ata jane ndare me presje. Eponimet nuk permenden ne kete liber.

*Nikollaq Leka*

## ***PERMBAJTJA***

<b>1. HYRJE NE ANATOMINE E NJERIUT</b>	<b>7</b>
<b>2. SISTEMI KOCKOR</b>	<b>17</b>
<b>3. SISTEMI ARTIKULAR</b>	<b>43</b>
<b>4. SISTEMI MUSKULAR</b>	<b>61</b>
<b>5. SISTEMI DIGESTIV</b>	<b>91</b>
<b>6. SISTEMI RESPIRATOR</b>	<b>119</b>
<b>7. SISTEMI URINAR</b>	<b>129</b>
<b>8. SISTEMI GENITAL</b>	<b>133</b>
<b>9. GJENDRAT ENDOKRINE</b>	<b>143</b>
<b>10. SISTEMI KARDIOVASKULAR</b>	<b>147</b>
<b>11. SISTEMI LIMFOID</b>	<b>183</b>
<b>12. SISTEMI NERVOR</b>	<b>187</b>
<b>13. ORGANET E SHQISAVE</b>	<b>231</b>
<b>14. MBULESA E TRUPIT</b>	<b>241</b>

## 1. HYRJE NE ANATOMINE E NJERIUT

### Histori e shkurter

- Veshtrim i per gjithshem
- Variacionet anatomike
- Terminologja anatomike
- Termat e per gjithshem
- Pjeset dhe regionet e trupit
- Planet e linjat anatomike
- Sistemet e trupit

### HISTORI E SHKURTER

Historia e anatomise fillon ne antikitet dhe pastaj vazhdon, paralel me historine e njerezimit, ne mesjetet e kohen moderne, duke patur veçorite dhe emrat e saj te spikatur per gjate gjithe kesa kohe. Informacionet e para anatomike jane marre kryesisht nga kafshet; me pas burim i tyre ka qene diseksoni i kadavrave, dhe se fundi, ne shekullin e 20, perdorimi i teknikave te perparuara mundesoi studime anatomike ne subjekte te gjalle.

Anatomia ne lashtesi lidhet me se pari me pervojen e *egiptianeve*, rreth 1600 vjet paraK, te cilet i hapnin kuformat me qellim balsamosje. Ata kishin njohuri mbi zemren dhe enet e medha qe dalin prej saj dhe e konsideronin ate si pike takimi te vazave qe transportonin te gjithe lengjet e organizmit. **Greket** ne shekujt 5 e 4 paraK, perfaqesohen me fillimisht me *Hipokratin* (babain e mjekesise), qe paraqiti te dhena baze mbi strukturen muskulosoletike. *Aristoteli* perdiroi i pari termin “*anatome*”, qe do te thote “pres e ndaj”. Gjithashtu bazuar ne diseksonin e kafsheve, ai saktosoi mjaft pershkrimet anatomike te meparshme. Pas tyre *Herofili*

perdori per here te pare kadavrat njerezore per studime anatomike dhe beri pershkrimet te kafkes e syve. *Galeni*, ne *Romen* e vjeter, ne shekullin e 2 pasK realizoi diseksione ne kafshe, te shoqeruara me nje koleksion vizatimesh anatomike, duke treguar ngjashmerine e strukturave anatomike te tyre me ato te njeriut.

**Anatomia ne mesjete** njeh pak progres. Ne kete periudhe disekcionet e kadavrave ishin rreptesish te ndalura dhe studimi i trupit te njeriut konsiderohej herezi.

Ne shekullin e 11 pasK, *Avicena*, ne vepren e tij enciklopedike, permblodhi te dhenat e deriatehershme anatomike dhe fiziologjike.

**Anatomia gjate Rilindjes** njoju zhvillimin me te madh te deriatehershem si shkence mjekesore. Ne kete periudhe disekzioni i trupave u kthye ne nje pjese integrale te kurrikulumit mjekesor (dhe grabitja e trupave nga varret nje praktike e shpeshte). Italia u be qender e studimeve anatomike dhe u shtua publikimi i librave anatomike. Me i shquari ne kete periudhe ishte *Vezaliusi*, qe pas disekcioneve ne kadavra, publikoi ne shekullin 16, traktatin e tij “*De humani corporis fabrica*”, ku jepen jo vetem pershkrimet te sakta anatomike te strukturave humane, por edhe vizatime te mrekullueshme te tyre. Me kete vepër Vezaliusi u konsiderua “babai i anatomise” ndersa vete ajo u ngrit ne rangun e nje discipline themelore mjekesore. Ne vazhdim, *Harvey*, zbuloi qarkullimin e gjakut si dhe hodhi bazat e embriologjisë. Gjate Rilindjes studimet anatomike bazoheshin ne observime dhe vizatime, keshtu qe popullariteti i anatomisteve lidhej me aftesine e tyre per te vizatuar. Shume artiste te medhenj, nga Mikelanxhelo tek Rembrandi, nen shembullin e Da Vinçit, ndiqnin disekcionet e kadavrave dhe publikonin vizatimet e tyre anatomike.

Ne **shekullin 19** kontributti me i madh i studiuesve ishte formulimi i teorise qelizore sipas te ciles te gjitha organizmat perbehen nga qeliza te ndryshme. Nderkohe ne mesin e ketij shekulli publikohet nga *Gray* e Carter “*Gray's Anatomy*”, qe perfaqeson finalizimin e nje procesi konsolidimi te anatomise deskriptive; libri u kthye shpejt ne nje “bibel” te mjekeve.

**Anatomia ne shekullin 20** karakterizohet se pari nga unifikimi i nomenklatures anatomike qe u shoqua me simplifikimin e termave dhe shhangjen e eponimeve. Kjo u arrit me konsensusin e shoqatave te shumta anatomike nga gjithe bota dhe coi ne publikimin e “*Nomina Anatomica*” ne 1953 dhe “*Terminologia Anatomica*” ne 1998. Gjate ketij shekulli u kalua nga studimet anatomike te thjeshta ne kadavra, ne studime komplekse ne njerez te gjalle. Kjo u arrit si pasoje e metodave te perparuara te ekzaminimeve, kryesish imazherike (radiologji konvencionale, ekografi, skaner, rezonance magnetike, shintografi etj).

Per kete aresye kufijte e anatomise se njeriut zgjerohen drejt kufijve te disiplinave te tjera klinike (anatomi imazherike, anatomi funksionale etj).

**Aktualisht** progresi ne anatomi inkuadrohet ne progresin e bioteknologjise, e cila kombinon biologjine molekulare dhe gjenetiken me teknologjine inxhinierike.

## VESHTRIM I PERGJITHSHEM

**Anatomia e njeriut** studion formen dhe strukturen e trupit te njeriut. Ky studim behet ne nivel submikroskopik, mikroskopik dhe makroskopik. Ne menyre konvencionale anatomia e njeriut ndahet ne embriologji, citologji, histologji, anatomi makroskopike dhe neuroanatomi. Megjithate me termin anatomi, ne te foluren e perditshme nganjehere nenkuptohet vetem anatomi makroskopike.

Anatomia e njeriut qendron ne themel te praktikes mjekesore. Gjate ekzaminimit te pacientit me mjetet me te thjeshta ose me teknikat imazherike me te sofistikuara, rruga drejt diagnostikimit te semundjes kalon pervesimt anatomin te strukturave te trupit te njeriut. Veç kesaj mjeket, stomatologet, farmacistet, fizioterapeutet e te tjere, te perfshire ne nje menyre apo ne nje tjeter ne vleresimin e shenjave klinike te nje pacienti, mund t'i interpretojne ato sakteisht vetem bazuar ne njohuri te shendosha anatomike.

Po ashtu njohuri specifike anatomike jane te domosdoshme edhe per profesione qe gjenden larg mjekesise (arti, sporti).

Studimi i anatomise kerkon fillimisht nje njohje te **anatomise se per gjithshme** (*anatomia generalis*), qe perfshin termat e per gjithshem, pjeset e regionet e trupit si dhe planet e linjat anatomike.

Pastaj ne varesi te kendveshtrimit, anatomia (makroskopike) mund te jetë sistemeke ose regionale. Kendveshtrime me specifike i takojne anatomise klinike, siperfaqesore, endoskopike, imazherike etj.

**Anatomia sistemike** studion trupin e njeriut sipas sistemeve (sistemi kockor, sistemi artikular, sistemi muskular etj), duke i marre me rradhe ato dhe organet perberes te secilit sistem njeri pas tjetrit.

**Anatomia regionale** (topografike) studion trupin e njeriut sipas pjeseve e regioneve (koka, qafa, trunku, etj dhe regionet perberes te tyre), duke i marre me rradhe ato, shtresat dhe organet perberes te secilit region njeri pas tjetrit.

Secili nga keto kendveshtrime ka te mirat dhe mungesat e tij. Anatomia sistemike mundeson kuptimin e plete (ne vazhdimesi) te nje sistemi, por jo nje orientim te lehte ne kadaver (trup). Anatomia regionale, ne te kundert, mundeson nje

orientim te mire ne kadaver (trup), por veshtireson kuptimin e pote (ne vazhdimesi) te nje sistemi.

Anatomia klinike (e aplikuar) inkorporon perqasjen sistemike e ate regionale ne funksion te spjegimit dhe zgjidhjes se situatave klinike.

Anatomia siperfaqesore studion formen dhe relievin e siperfaqes se trupit, anatomia endoskopike formen dhe relievin e siperfaqeve qe eksplorohen endoskopikisht, anatomia imazherike strukturat anatomike ne imazheri, etj.

## VARIACIONET ANATOMIKE

Eshte gjeresisht e pranuar qe individet e te njejtë specie nuk jane kurre te njejtë. Qofte trupi ne teresi, qofte pjese ose organe te veçante te tij, i nenshtrohen variacioneve ne madhesi, forme, pozicion dhe strukture. Per sa kohe keto variacione nuk prishin funksionin e organit perkates, konsiderohen si “variacione anatomike”. Neqoftese ato e prishin funksionin e tij, konsiderohen si “anomali” ose “keqformime”. Keto keqformime mund te jene te vogla ose te medha deri ne te papajtueshme me jeten.

Njoha e variacioneve anatomike eshte e domosdoshme per te rritur performancen diagnostike dhe mjekuese; ne te kundert mosnjohja e tyre mund te çoje ne trajtime klinike jo adekuate.

## TERMINOLOGJIA ANATOMIKE

**Terminologja anatomike** eshte gjuha e anatomise dhe nje gjuhe themelore e mjekesise. Pershkrimi i sakte i mijera strukturave te trupit nuk mund te jete i mundur pa nje fjalor te gjere dhe shpesh shume te specializuar.

Teminologja e perdorur sot ne publikimet anatomike bazohet ne “Terminologjine Anatomike” (Terminologia Anatomica, FCAT, 1998).

Anatomia nga njera ane eshte nje shkence deskriptive, dhe nga ana tjeter terminologji anatomike bazohet ne termat latine ose greke. Per keto aresye kjo terminologji, e re per fillestaret e fushes, konsiderohet e komplikuar dhe disi e veshtire per ta. Megjithate, meqenese shumica e termave kane nje kuptim fillestar, njoha e tij si dhe e parashtesave e prapashtesave qe perdoren gjeresisht, lehteson shume memorizimin.

## TERMAT E PERGJITHSHEM

**Termat e pergjithshem** (*nomina generalia*) anatomike jane mbiemra, qe pergjithesisht perdoren per lokalizim.

Perdorimi i tyre behet bazuar paraprakisht ne percaktimin e **pozicionit anatomik**, qe me marreveshje eshte konsideruar “*trupi i njeriut te gjalle ne kembe, me shikimin perpara, me gjymtyret e siperme te shtrira pergjate trupit e pellembet e kthyera perpara dhe me kembet e bashkuara*”.

Nga termat me te perdorshem jane:

**vertikal** (*verticalis*), **horizontal** (*horizontalis*), **transversal** (*transversus, transversalis*),  
**koronal** (*coronalis*) ose **frontal** (*frontalis*), qe do te thote ballor ose paralel me ballin,  
**sagital** (*sagittalis*), qe do te thote sipas drejtimit te shigjetes, pra nga perpara prapa.

**superior** (*superior*), qe do te thote i siperri dhe  
**inferior** (*inferior*), qe do te thote i poshtem,  
**anterior** (*anterior*), qe do te thote i perparshem dhe  
**posterior** (*posterior*), qe do te thote i pasem,  
**dekster** (*dexter*), qe do te thote i djathte dhe  
**sinister** (*sinister*), qe do te thote i majte.

**major** (*major*), qe do te thote i madh  
**minor** (*minor*), qe do te thote i vogel dhe  
**i ndermjetem** (*intermedius*).

**median** (*medianus*), qe do te thote ne mes,  
**medial** (*medialis*), qe do te thote me prane mesit se sa  
**lateral** (*lateralis*), qe do te thote me larg mesit.

**central** (*centralis*), qe do te thote qendror dhe  
**periferik** (*periphericus*).

**ekstern** (*externus*), qe do et thote i jashtem dhe  
**intern** (*internus*), qe do te thote i brendshem,  
**superficial** (*superficialis*), qe do te thote siperfaqesor dhe  
**profund** (*profundus*), qe do te thote i thelle.

**Regjone te abdomenit** (*regiones abdominales*) jane regjoni epigastrik (*regio epigastrica*) e regjoni hipokondrik (*regio hypochondriaca*) ne pjesen e siperme te abdomenit, regjoni umbilikal (*regio umbilicalis*) e regjoni lateral (*regio lateralis*) ne pjesen e mesme te abdomenit dhe regjoni hypogastrik ose pubik (*regio pubica*) e regjoni inguinal (*regio inguinalis*) ne pjesen e poshtme te abdomenit.

**Regjone te shpines** (*regiones dorsales*) jane

regjoni vertebral (*regio vertebralis*), regjoni skapular (*regio scapularis*) ose i shpatulles, regjoni lumbar (*regio lumbalis*) ose i mesit, regjoni sakral (*regio sacralis*) ose i kerbishteve etj.

**Regjoni perineal** (*regio perinealis*) me nenregjionet e tij:

regjionin anal (*regio analis*) e regjionin urogenital (*regio urogenitalis*).

**Regjone te gjymtyres se siperme** (*regiones membra superioris*) jane

regjoni i supit ose regjoni deltoid (*regio deltoidea*), regjoni i krahut (*regio brachialis*) me nenregjionet e tij:

regjionin anterior te krahut (*regio brachialis anterior*) dhe regjionin posterior te krahut (*regio brachialis posterior*),

regjoni i brrylit (*regio cubitalis*),

regjoni i parakrahut (*regio antebrachialis*) me nenregjionet e tij:

regjionin anterior te parakrahut (*regio antebrachialis anterior*) e regjionin posterior te parakrahut (*regio antebrachialis posterior*) dhe

regjoni i dores (*regio manus*) me nenregjionet e tij:

regjionin palmar (*regio palmaris*),

regjionin dorsal (*regio dorsalis*),

regjionin karpal (*regio carpalis*),

regjionin metakarpal (*regio metacarpalis*) dhe

gishtat (*digiti manus*), i pari (*digitus primus, pollex*), i dyti (*digitus secundus, index*), i treti (*digitus tertius*), i katerti (*digitus quartus*) e i pesti (*digitus quintus*).

**Regjone te gjymtyres se poshtme** (*regio membra inferioris*) jane

regjoni gluteal (*regio glutealis*) ose regjoni i vitheve,

regjoni femoral (*regio femoris*) ose regjoni i kofshes me nenregjionet e tij:

regjionin femoral anterior (*regio femoris anterior*) e

regjionin femoral posterior (*regio femoris posterior*),

regjoni i gjurit (*regio genus*),

regjoni i kercirit (*regio cruris*) me nenregjionet e tij:

regjionin anterior te kercirit (*regio cruris anterior*) e

regjionin posterior te kercirit (*regio cruris posterior*) dhe

regjoni i kembes (*regio pedis*) me nenregjionet e tij:

regjionin plantar te kembes (*regio plantaris*), regjionin dorsal te kembes (*regio dorsalis pedis*), regjionin tarsal (*regio tarsalis*).

regjionin metatarsal (*regio metatarsalis*) dhe gishtat (*digiti pedis*), i pari (*digitus primus, hallux*), i dyti (*digitus secundus*), i treti (*digitus tertius*), i katerti (*digitus quartus*) e i pesti (*digitus quintus*).

## PLANET DHE LINJAT ANATOMIKE

**Planet** (*plana*) anatomike te trupit jane plane imaginare te aplikuar ne trupin e njeriut ne pozicion anatomik.

Keto plane Jane planet sagitale, planet frontale e planet horizontale.

**Planet sagitale** (*plana sagittalia*) Jane plani median e planet paramediane. Plani median (*planum medianum*) kalon permes trupit dhe e ndan ate ne dy gjysma simetrike. Planet parel me planin median Jane plane paramediane (*plana paramediana*).

**Planet frontale** ose koronale (*plana frontalia, plana coronalia*) Jane perpendikulare me planet sagitale dhe e ndajne trupin ne pjesë anteriore e posteriore.

**Planet horizontale** (*plana horizontalia*) ose transversale (*plana transversalia*) ose aksiale Jane perpendikulare edhe me planet sagitale edhe me planet frontale, dhe e ndajne trupin ne pjesë superiore e pjesë inferiore. Nga planet horizontale vëçohet plani subkostal e plani interspinal. Plani subkostal (*planum subcostale*) kalon ne dy pikat me te poshtme te harkut kostal (brinjor), ndersa plani interspinal (*planum interspinale*) kalon ne dy spinat iliak anteriore superiore.

**Linja** (*lineae*) anatomike te trupit Jane disa:

**linja mediane anteriore** (*linea mediana anterior*) eshte linja gjate te ciles pret siperfaqen anteriore te trupit plani median,

**linja sternale** (*linea sternalis*) eshte linja gjate te ciles pret siperfaqen anteriore te trupit plani sagital qe kalon ne buzen laterale te sternumit,

**linja parasternale** (*linea parasternalis*) eshte linja qe gjendet ne siperfaqen anteriore te trupit midis (ne largesi te barabarte midis) linjes sternale e linjes medioklavikulare,

**linja medioklavikulare** (*linea medioclavicularis*) eshte linja gjate te ciles pret siperfaqen anteriore te trupit plani sagital qe kalon ne mesin e klavikules,

**linja mamilare** (*linea mammillaris*) eshte linja gjate te ciles pret siperfaqen anteriore te trupit plani sagital qe kalon ne papilen mamare (papilen e gjirit),

**linja aksilare anteriore** (*linea axillaris anterior*) eshte linja gjate te ciles pret siperfaqen e trupit plani qe kalon ne buzen anteriore te foses aksilare,  
**linja aksilare e mesme** (*linea axillaris media*) eshte linja gjate te ciles pret siperfaqen e trupit plani (frontal) qe kalon ne mesin e foses aksilare,  
**linja aksilare posteriore** (*linea axillaris posterior*) eshte linja gjate te ciles pret siperfaqen e trupit plani qe kalon ne buzen posteriore te foses aksilare,  
**linja skapulare** (*linea scapularis*) eshte linja gjate te ciles pret siperfaqen posteriore te trupit plani sagital qe kalon ne kenden inferior te skapules,  
**linja paravertebrale** (*linea paravertebralis*) eshte linja gjate te ciles pret siperfaqen posteriore te trupit plani sagital qe kalon ne majat e proceseve transversale te vertebrave dhe  
**linja mediane posteriore** (*linea mediana posterior*) eshte linja gjate te ciles pret siperfaqen posteriore te trupit plani median, etj.

## SISTEMET E TRUPIT

Anatomia sistemike (*anatomia systemica*) e njeriut ben studimin e trupit te tij sipas sistemeve.

Sistemet e trupit te njeriut jane:

Sistemi kockor (*systema skeletale*),  
Sistemi artikular (*systema articulare*),  
Sistemi mëskular (*systema musculare*),  
Sistemi digestiv (*systema digestorum*),  
Sistemi respirator (*systema respiratorium*),  
Sistemi urinar (*systema urinarium*),  
Sistemi genital (*systemata genitalia*),  
Sistemi kardiovaskular (*systema cardiovasculare*),  
Sistemi limfoid (*systema lymphoideum*) dhe  
Sistemi nervor (*systema nervosum*).

Ne anatomine sistemike perfshihen edhe:

Gjendrat endokrine (*glandulae endocrinae*) ose sistemi endokrin,  
Organet e shqisave (*organa sensuum*) dhe  
Mbulesa e trupit (*integumentum commune*) qe ne gjuhen e perditshme konsiderohet lekura.

Po ashtu ne anatomine sistemike studiohen edhe hapesirat e trupit:

Hapesira torakale (*cavitas thoracis*) dhe  
Hapesira abdominale e pelvike (*cavitas abdominis et pelvis*).

## 2. SISTEMI KOCKOR

*Skeleti i kokes*

*Kolona vertebrale*

*Skeleti i toraksit*

*Skeleti i gjymtyres se siperme*

*Skeleti i gjymtyres se poshtme*

**Sistemi kockor** ose sistemi skeletik (*systema skeletale*) perbehet nga teresia e kockave, qe se bashku formojne skeletin. Skeleti i njeriut perbehet nga **206 kocka**, por ky numer nuk eshte gjithnjë i njejtë.

**Skeleti ka disa funksione.** Funksioni *mbeshtetes* siguron fiksimin ose mbeshtetjen ne te, te strukturave te tjera anatomike (muskuj, organe). Funksioni *mbrojtës* siguron mbrojtjen e organeve qe vendosen ne hapesirat e formuara nga kockat. Funksioni *levizes* nenkupton rolin (pasiv) gjate levizjeve. Gjithashu kockat e skeletit sherbejnë si *depo* per mbajtjen e kalciumit e fosforit, ndersa palca e kockave merr pjese ne *hematopoeze* pra ne prodhimin e elementeve te figuruar te gjakut (eritrocite, leukocite, trombocite).

**Skeleti i njeriut ndahet ne skeletin aksial dhe skeletin apendikular.**

**Skeleti aksial** (*skeleton axiale*) perfshin skeletin e kokes, kolonen vertebrale dhe skeletin e toraksit

**Skeleti apendikular** (*skeleton appendiculare*) perfshin skeletin e gjymtyreve te siperme dhe skeletin e gjymtyreve te poshtme.

**Kockat** perbehen nga substanca kompakte (*substancia compacta*) dhe substanca spongioze (*substancia spongiosa*); dallimi midis tyre qendron ne densitetin dhe arkitekturen kockore. Substanca kompakte vendoset ne siperfaqe te

kockave, ndersa substanca spongioze ne brendesi. Kjo e fundit formohet nga plakeza kockore te vendosura sipas linjave te forces, qe ushtrohen ne kocke.

**Kockat klasifikohen** sipas formes ne kocka te gjata, kocka te shkurtra, kocka te sheshta, kocka te çrregullta si dhe kocka pneumatike e kocka sesamoide.

**Kockat e gjata** (*os longum*) gjenden tek gjymtyret dhe jane tubulare. Ato perbehen nga pjesa qendrore ose diafiza (*diaphysis*) dhe dy skajet ose epifizat (*epiphysis*). Diafiza pershkohet ne qender nga hapesira medulare (*cavitas medullaris*) ne forme kanali, ne te cilin vendoset palca e kockave (*medulla ossium*).

**Kockat e shkurtra** (*os breve*) gjenden ne skeletin e dores dhe te kembes; ato jane karpet dhe tarset. Kockat e shkurtra kane formen e kubit ose forme te ngjashme me te.

**Kockat e sheshta** (*os planum*) perbehen nga dy shtresa substance kompakte, midis te cilave gjendet nje shtrese substance spongioze. Shumica e tyre formojne mure per hapesira te trupit (kraniumi, toraksi etj), ku vendosen organe, prandaj jane te perkulura.

**Kockat e çrregullta** (*os irregulare*) nuk kane forme te percaktuar. Te gjitha kockat e kraniomit qe nuk jane te sheshta, jane kocka te çrregullta.

**Kockat pneumatike** (*os pneumaticum*) kane hapesira ajrike ne brendesi te tyre dhe gjenden ne kranium.

**Kockat sesamoide** (*os sesamoideum*) kane formen e berthamave dhe jane te zhytura ne tendine; siperfaqja e lire e tyre vishet me kerc artikular. Kocka me e madhe sesamoide eshte patela, ndersa kocka te vogla sesamoide gjenden ne skeletin e dores dhe kembes.

**Kockat ne siperfaqe** mund te kene elemente morfollogjike, ku kapen, kalojne ose vendosen struktura anatomike. Keto elemente mund te jene:

**te ngritura:** tuber (*tuber*), tuberkulum (*tuberculum*), tuberozitet (*tuberositas*), eminence (*eminentia*), zgjatim ose proces (*processus*), kreshte (*crista*), linje (*linea*), kondil (*condylus*), epikondil (*epicondylus*) ose

**te thelluara:** incizure (*incisura*), sulkus (*sulcus*), gropë ose fose (*fossa*), vrime ose foramen (foramen) dhe kanal (*canalis*).

**Kockat ne brendesi** mund te kene hapesira ajrike, qe quhen sinuse (*sinus*) ose qeliza (*cellula*).

**Kockat gjate zhvillimit osifikohen** dhe rriten.

**Osifikimi** mund te jetë i tipit intramembranoz ose i tipit enkondral. Osifikimi i tipit intramembranoz eshte karakteristik per kockat e kraniomit. Gjate tij ndodh formimi i kockes direkt nga "membrana" e mezenkimes primitive, ku zhvillohen qendrat e osifikimit. Osifikimi i tipit enkondral realizohet ne shumicen e kockave te skeletit. Gjate tij ndodh osifikimi i nje modeli te paraformuar kartilaginoz gjate

te cilit indi kartilaginoz zevendesohet gradualisht me ind kockor. Fillimi i sështë ne diafizen e kockes shfaqet nje qender primare osifikimi. Me pas shfaqen qendrat sekondare te osifikimit ne epifizat e tyre, te cilat sidetofte nuk osifikohen plotesisht. Keshtu ne epifiza nuk osifikohen siperfaqet artikulare (qe mbeten te veshura me kartilago artikulare) dhe zona ku fitare me diafizen (ose kartilagoja epifizare ose e rritjes, ku rritja vazhdon deri ne arritjen e permasave normale te kockes; me pas edhe kjo zone osifikohen).

**Rritja** e kockave eshte nje proces qe shoqerohet me ndryshimin e permasave dhe nganjehere formes e modelimit te tyre. Ajo i nenshtrohet jo vetem efektit hormonal (hormoni i rritjes, hormonet e gjendres tiroide, estrogenet, androgenet), por ndikohet edhe nga balanca e metaboliteve (kalcium, fosfor), vitaminave (A,C,D) dhe po ashtu nga veprimi mekanik i forcave te ndryshme te vazhdueshme te ushtruan mbi to.

### Fakte klinike

#### *Ekzaminimi i kockave me rreze X*

*Ekzaminimi me rreze X* (radiografia, skaneri) eshte metoda me e vjeter dhe me e perhapur per ekzaminimin e demitimeve kockore.

*Shkalla e absorbimit te rrezeve X* varet nga densiteti i indeve neper te cilat ato kalojne. Kjo eshte aresyeja qe ne filmat radiografike kockat dalin te bardha, ari i zi, ndersa indet e buta kane shkalle te ndryshme te ngjyres gri ne varesi te densiteit te tyre.

*Rrezet X* kane edhe efekte negative ne organizem, por perfitim i diagnoza e sakte eshte me i madh. Perdorimi i rrezeve X nuk keshillohet ne grata shtatzena.

#### *Fraktrurat*

*Fraktrurat* kockore janë zakonisht pasoje e traumave fizike. Megjithate ato mund te ndodhin pa ndonje traume te tille edhe ne disa gjendje patologjike si osteoporozë apo disa tipe te tumoreve kockore. Ne praktiken ortopedike fraktrurat konsiderohen te mbyllura ose te hapura dhe te thjeshta ose me fragmente.

*Diagnostimi i sakte i fraktrave* behet me metoda imazherike, ndersa trajtimi synon perfitimin e funksionit maksimal te mundshem pas sherimit. Ai konsiston ne afrimin e fragmenteve kockore dhe imobilizimin e tyre dhe te dy artikulacioneve qfinje. Nganjehere imobilizimi eshte kirurgjikal dhe realizohet me fiksimin me vida te pllakave metalike ne fragmentet kockore.

#### *Osteoporozë*

*Osteoporozë* eshte nje çrregullim metabolik qe shoqerohet me ulje te sasise se kalciumit ne kocke. Ajo ndodh zakonisht tek femrat pas menopauzes dhe tek meshkujt pas moshes 70 vjeç. Faktoret qe ndikojne ne shfaqjen e saj jane predispozicioni gjenetik, niveli i aktivitetit fizik dhe i ushqimit si dhe niveli i estrogenit tek femrat.

Nuk ka shenja specifike klinike te osteoporozes. Pasoje tipike e saj janë fraktrurat patologjike qe me shpesh ndodhin ne trupat vertebrale dhe artikulacionin

koksofemoral. Matja e densitetit kockor (me metoda radiologjike) mund te vleresoje rrezikun e frakturave osteoporotike.

#### Tumoret

Tumoret kockore jane beninje ose malinje; tumoret malinje mund te jene primare ose sekondare.

Ankesa e zakonshme ne tumoret kockore eshte dhimbja, por jo rralle ajo mund te mungoje dhe shenje e vetme te jete nje mase e padhimbshme.

Zakonisht tumoret sekondare metastatike gjenden ne skeletin aksial dhe shoqerojne nje kancer te gjirit, te mushkerise ose te prostates.

Diagnostikimi i tumoreve kockore behet me metoda imazherike. Trajtimi i tyre mund te jete kirurgjikal (psh amputacioni) ose kimioterapia e radioterapia.

## SKELETI I KOKES

**Skeleti i kokes** ka 22 kocka (pa llogaritur kockat e vogla te veshit). Ai perbehet nga kraniumi dhe mandibula. Kraniumi formohet nga kocka qe lidhen me njera tjetren ne menyre te palevizhme me ane te suturave.

E vetmja kocke e levizhme e skeletit te kokes eshte mandibula.

Ne skeletin e kokes studiohet edhe kocka hioide, qe lidhet nepermjet muskujve me kockat e tjera te kokes.

**Kraniumi** (*cranium*) ose kaska perbehet nga kocka (*osse crani*) qe te lidhura me njera tjetren formojne disa hapesira, ne te cilat vendosen (te mbrojtur) disa organe. Hapesira me e madhe eshte hapesira kraniale ku vendoset truri.

Kockat e kraniumit vendosen ose ne linjen mediane dhe jane teke, ose anash saj dhe jane çifte.

Ai ndahet ne **kranumin cerebral** (*neurocranium*) dhe **kranumin facial** ose **visceral** (*viscerocranium*). Kraniumi cerebral perbehet nga kockat: frontale, parietale, oksipitale, temporale, sfenoidale e etmoidale. Kraniumi facial perbehet nga kockat nazale, palatine, lakinale, zigomatike, maksillare, konka nazale inferiore dhe vomeri. Mandibula nuk konsiderohet kocke as e kraniumit cerebral, as e kraniumit facial.

Kraniumi cerebral ka **bazen** e tij dhe **kalvarian** ose kapakun.

Studimi i kraniumit mund te behet ne **disa pamje**, perkatesisht ne pamjen anteriore, pamjen laterale, pamjen posteriore, pamjen superiore dhe pamjen inferiore.

■ **Ne pamjen anteriore** (*norma frontalis*) te kraniumit dallohen kocka qe i takojne kryesish kraniumit facial. Ato jane kocka frontale, kockat nazale, maksila dhe kockat zigomatike. Ne kete pamje skeleti i kokes plotesohet me mandibulen. Kocka frontale ne pamjen anteriore paraqet ne nivelin e vetullave dy harqet superciliare te cilet Jane me te theksuar tek meshkujt. Midis dy harqeve superciliare gjendet glabela ose lulja e ballit.

Ne pamjen anteriore te kraniumit dallohen disa sutura. Ne linjen mediane midis dy kockave nazale gjendet **sutura internazale** (*sutura internasalis*), midis dy maksilave **sutura intermaksilare** (*sutura intermaxillaris*), ndersa ne kocken frontale mund te gjendet **sutura metopike** (*sutura metopica*). Suturat e tjera emertohen sipas kockave qe i formojne ato.

Pika e takimit te sutures internazale me kocken frontale quhet **nazion** (*nasion*).

Ne pamjen anteriore gjithashtu dallohen disa hapesira.

**Orbitat** (*orbita*) jane zgavrati e syve. Plani i hyrjes ne to eshte aditus orbital (*aditus orbitalis*).

**Hapesira e hundes** (*cavitas nasalis ossea*) ka si plan hyrjeje aperturen piriforme (*apertura piriformis*), pra ne forme dardhe.

■ **Ne pamjen laterale** (*norma lateralis*) te kraniumit dallohen shume kocka qe i takojne si kraniumit cerebral ashtu edhe kraniumit facial. Veç kockave qe duken edhe ne pamjen anteriore: kocka frontale, kocka nazale, maksila dhe kocka zigomatike, ne kete pamje dallohen edhe kocka parietale, kocka temporale, kocka sfenoidale dhe kocka oksipitale. Mandibula duket gjithashtu ne kete pamje.

Ne pamjen laterale te kraniumit dallohen disa sutura. Kocka parietale bashkohet me kocken frontale ne **suturen koronare** (*sutura coronalis*), me kocken temporale ne **suturen skuamoze** (*sutura squamosa*) e me kocken oksipitale me **suturen lambdoide** (*sutura lambdoidea*). Suturat e tjera emertohen sipas kockave qe i formojne ato.

Ne kete pamje vendi i bashkimit te kockes frontale, kockes parietale, kockes temporale e kockes sfenoidale quhet **pterion** (*pteron*), ndersa vendi i takimit te sutures skuamoze me suturen lambdoide quhet **asterion** (*asterion*).

Ne pamjen laterale gjithashtu dallohen **fosa pterigopalatine** (*fossa pterygopalatina*) qe gjendet midis maksiles dhe kockes sfenoidale, **fosa temporale** (*fossa temporalis*) qe i takon regjionit temporal dhe **fosa infratemporale** (*fossa infratemporalis*) qe gjendet nen te.

■ **Ne pamjen posteriore** (*norma occipitalis*) dallohet kocka oksipitale dhe dy kockat parietale.

Ne kete pamje duket **sutura lambdoide** ne vendin e bashkimit te kockes oksipitale me kockat parietale.

Ne pamjen posteriore pika me e ngritur e protuberances oksipitale eksterne quhet **inion** (*inion*).

■ **Ne pamjen superiore** (*norma superior*) dallohet kocka frontale, dy kockat parietale dhe kocka oksipitale.

Dy kockat parietale bashkohen me njera tjetren ne **suturen sagitale** (*sutura sagittalis*). Suturat e tjera jane perpara **sutura koronare** dhe prapa **sutura lambdoide**.

Ne kete pamje vendi i bashkimit te sutures sagitale me suturen koronare quhet **bregma** (*bregma*), ndersa me suturen lambdoide **lambda** (*lambda*). Ne femijet e porsalindur ne keto dy vende nuk ka perfunduar ende kockezimi, prandaj ato paraqiten te buta ne shtypje (si top pingpongu) dhe quhen perkatesisht **fontanela anteriore** (*fonticulus anterior*) dhe **fontanela posteriore** (*fonticulus posterior*).

■ **Ne pamjen inferiore** (*norma inferior*), ne te cilen shihet faqja e jashtme e bazes se kraniumit, dallohet ne qender foramen magnum (i takon kockes oksipitale). Kjo faqe mund te ndahet ne tre pjese, pjesen anteriore, pjesen e mesme dhe pjesen posteriore.

**Pjesa anteriore** eshte qielza kockore; ajo formohet nga maksila dhe kocka palatine.

**Pjesa e mesme** gjendet prapa qielzës kockore deri ne buzen anteriore te foramen magnum dhe formohet nga kocka sfenoidale, kocka temporale dhe kocka oksipitale.

**Pjesa posteriore** gjendet pas buzes anteriore te foramen magnum dhe i takon kockes oksipitale.

Ne pamjen inferiore te kraniumit dallohen **sutura palatine mediane** (*sutura palatina mediana*), **sutura palatine transversale** (*sutura palatina transversa*) etj. si dhe bashkimi i kockes sfenoidale me kocken oksipitale, i cili eshte **sinkondroze** (*sfenoeksipitale*) tek femijet dhe **sinostoze** (*sfenoeksipitale*) tek te ritritur.

Ne pamjen inferiore, veç **foramen magnum** (*foramen magnum*), duken gjithashu **foramen lacerum** (*foramen lacerum*), **foramen ovale** (*foramen ovale*), **foramen jugulare** (*foramen jugulare*) etj. si dhe **koanet** (*choanae*), qe formojne hapjen e pasme te hapesires se hundes dhe qe ndahan midis tyra nga vomeri.

**Kockat e skeletit te kokes** mund te studiohen **ne vecanti**, duke u ndalur ne elementet perberes te seciles prej tyre.

■ **Kocka frontale** (*os frontale*) merr pjese ne formimin e murit te perparshem dhe te siperm te hapesires kraniale si dhe ne formimin e hapesirave orbitale. Ajo formohet nga skuama dhe pjeset orbitale. Ne brendesi te kockes frontale gjendet sinusi frontal.

**Skuama** (*squama frontalis*) ka faqen e jashtme, faqen e brendshme dhe faqen temporale. Ne faqen e jashtme (*facies externa*) ajo ka dy te ngriturat e ballit ose tuberat frontale (*tuber frontale*); nen to jane harqet e vetullave ose harqet superciliare (*arcus superciliaris*) dhe midis tyre lulja e ballit ose glabela (*glabella*). Ne kete faqe kufiri midis skuames dhe pjeses orbitale eshte margoja supraorbitale (*margo supraorbitalis*). Ne faqen e brendshme (*facies interna*) skuama ka kreshten frontale (*crista frontalis*) qe vazhdon me nje brazde gjatesore, te quajtur sulkusi i sinusit sagital superior (*sulcus sinus sagittalis superior*). Ne faqen temporale (*facies temporalis*), ne vazhdim te margsos supraorbitale, gjendet procesi zigomatik (*processus zygomaticus*).

**Pjesa orbitale** (*pars orbitalis*) me faqen e poshtme formon tavanin e orbites, ne te cilin lateralish gjendet fosa e gjendres lakinale (*fossa glandulae lacrimalis*), ndersa medialish fovea troklearre (*fovea trochlearis*).

**Sinusi frontal** (*sinus frontalis*) gjendet nen harqet superciliare. Ai ka ne qender nje septum (*septum sinuum frontarium*).

■ **Kocka parietale** (*os parietale*) eshte kocke çifte dhe merr pjese ne formimin e murit te siperm dhe anesor te hapesires kraniale. Ajo ka forme pak a shume katerkendeshe me faqen e jashtme dhe faqen e brendshme. Ne faqen e jashtme (*facies externa*) kocka ka nje te ngritur, tuber parietale (*tuber parietale*) si dhe linjen temporale superiore (*linea temporalis superior*) e linjen temporale inferiore (*linea temporalis inferior*). Ne faqen e brendshme (*facies interna*) gjate linjes mediane secila kocke ka nje brazde, qe se bashku me ate te anes tjeter formon sulkusin e sinusit sagital superior. Gjithashu ne faqen e brendshme gjendet sulkusi i sinusit sigmoid (*sulcus sinus sigmoidei*).

■ **Kocka oksipitale** (*os occipitale*) merr pjese ne formimin e murit te pasem dhe te poshtem te hapesires kraniale. Ajo formohet nga skuama, pjesa basilare dhe pjeset laterale. Midis tyre gjendet foramen magnum.

**Skuama** (*squama occipitalis*) ka nje faqe te jashtme dhe nje faqe te brendshme. Ne faqen e jashtme te saj gjendet nje e ngritur, protuberanca oksipitale eksterne (*protuberantia occipitalis externa*), ndersa ne faqen e brendshme, kundrejt saj gjendet nje e ngritur tjeter, protuberanca oksipitale interne (*protuberantia occipitalis interna*). Mbi te gjendet sulkusi i sinusit sagital superior, ndersa ne secilen ane te saj, sulkusi i sinusit transvers (*sulcus sinus transversi*).

**Pjesa bazilare** (*pars basilaris*) ne faqen e brendshme eshte e lemuar dhe e pjerret dhe quhet klivus (*clivus*).

**Pjeset laterale** (*pars lateralis*) kane ne faqen e jashtme kondilet oksipitale (*condylus occipitalis*).

**Foramen magnum** (*foramen magnum*) eshte vrima, nepermjet te ciles, hapesira kraniale komunikon me kanalin vertebral.

■ **Kocka temporale** (*os temporale*) eshte kocke çifte dhe merr pjese ne formimin e murit anesor dhe te poshtem te hapesires kraniale. Secila kocke formohet nga skuama, pjesa timpanike dhe pjesa petroze.

**Skuama** (*pars squamosa*) ka nje faqe te jashtme dhe nje faqe te brendshme. Ne faqen e jashtme te saj del procesi zigomatik (*processus zygomaticus*), qe shkon perpara, si pjese e harkut zigomatik. Nen vendin e daljes se procesit zigomatik gjendet fosa mandibulare (*fossa mandibularis*), ku futet per te artikuluar kondili mandibular. Faqja e brendshme e skuames temporale ka gjurme nga mbeshtetja e trurit ne te te.

**Pjesa timpanike** (*pars tympanica*) gjendet anash, nen skuamen temporale. Ne kete pjese gjendet porusi akustik ekstern (*porus acusticus externus*), qe vazhdon me kanalin ose meatusin akustik extern (*meatus acusticus externus*). Ne fund te meatusit gjendet membrana timpanike dhe pas saj hapesira timpanike.

**Pjesa petroze** (*pars petrosa*), e forte si “gur”, ka formen e nje piramide me tre faqe dhe maje te drejtuar perpara dhe brenda. Faqja e perparme dhe faqja e pasme e pjeses petroze martir pjesa ne formimin e murit te poshtem te hapesires kraniale. Ne faqen e pasme ndodhet porusi akustik intern (*porus acusticus internus*), qe vazhdon me meatusin akustik intern (*meatus acusticus internus*). Faqja e poshtme e pjeses petroze merr pjese ne formimin e siperfaqes se jashtme te bazes se kafkes. Ne te ka dy zgjatime, procesi stiloide (*processus styloideus*) dhe procesi mastoid (*processus mastoideus*), ndersa midis tyre eshte foramen stilomastoide (*foramen stylomastoideum*). Gjithashtu ne kete faqe gjendet apertura eksterne e kanalit karotik (*apertura externa canalis carotici*), qe vazhdon me kanalin karotik (*canalis caroticus*), i cili hapet ne majen e piramides petroze me aperturen interne te tij (*apertura interna canalis carotici*).

Ne kocken temporale ndodhen hapesira timpanike dhe disa kanale.

**Hapesira timpanike** (*cavitas tympani*) gjendet ne brendesi te pjeses petroze; ne te vendosen kockat e degjimit. Ne murin lateral te hapesires timpanike ndodhet membrana timpanike, qe e ndan nga meatusi akustik ekstern. Gjithashtu ne hapesiren timpanike ndodhet hapja timpanike e tubit auditiv (*ostium tympanicum tubae auditivae*).

**Kanal karotik** fillon ne faqen e poshtme te pjeses petroze te kockes temporale me aperturen eksterne te tij, pastaj ngjitet lart dhe kthehet drejt majes se kesaj

pjese per te perfunduar me aperturen interne. Ne kete kanal kalon arteria karotike interne.

**Kanal i nervit facial** fillon ne fundin e meatusit akustik intern dhe pasi perkulet ne brendesi te pjeses petroze, hapet ne faqen inferiore te saj, ne foramen stilomastoide.

**Kanalikuli vestibular** (*canalculus vestibuli*) dhe **kanalikuli koklear** (*canalculus cochleae*) gjenden gjithashtu ne pjesen petroze te kockes temporale.

■ **Kocka sfenoidale** (*os sphenoidale*) vendoset ne bazen e kraniumit, perpara kockes oksipitale. Ajo ka formen e lakuriqit te nates me trupin, krahet e medha e krahet e vegjel si dhe (kembet) proceset pterigoide.

**Trupi** (*corpus*) ka formen e nje kubi te çrrregullt. Faqja e siperme e tij i ngjan nje shale (*sellula turcica*), ne pjesen e mesme te se ciles gjendet fosa e hipofizes (*fossa hypophysialis*), ku vendoset gjendra me te njejtin emer. Perpara foses gjendet sulkusi kiazmatik (*sulcus prechiasmaticus*), ndersa anash sulkusi karotik (*sulcus caroticus*) ne vazhdim te apertures interne te kanalit karotik; ne te kalon arteria karotike interne. Ne brendesi te trupit gjendet sinusi sfenoidal (*sinus sphenoidalis*).

**Krahet e medha** (*ala major*) vendosen anash trupit; ato kane tre faqe: faqen cerebrale qe sheh siper nga hapesira kraniale, faqen orbitale qe sheh perpara nga hapesira orbitale dhe faqen temporale qe sheh lateralish. Faqja cerebrale (*facies cerebralis*) ka dy vrima, foramen rotundum (*foramen rotundum*) dhe foramen ovale (*foramen ovale*). Faqja orbitale (*facies orbitalis*) formon pjesen me te madhe te murit lateral te orbites. Midis saj dhe kraheve te vegjel gjendet fisura orbitale superiore (*fissura orbitalis superior*), ndersa midis saj dhe maksiles gjendet fisura orbitale inferiore (*fissura orbitalis inferior*). Faqja temporale (*facies temporalis*) bashke me skuamen e kockes temporale formon fosen temporale. Nen faqen temporale gjendet faqja infratemporale (*facies infratemporalis*) qe i takon foses infratemporale.

**Krahet e vegjel** (*ala minor*) vendosen perpara dhe anash trupit te kockes sfenoidale mbi krahet e medha. Secila prej tyre pershkohet nga kanali optik (*canalis opticus*). Midis kraheve te vegjel dhe kraheve te medha, ne secilen ane, formohet fisura orbitale superiore.

**Proseset pterigoide** (*processus pterygoideus*) qe dalin nga trupi, formohen nga dy lamina, nje mediale dhe nje laterale, ndersa midis tyre ndodhet fosa pterigoide (*fossa pterygoidea*). Ne bazen e proceseve pterigoide kalon kanali pterigoid (*canalis pterygoideus*).

■ **Maksila** (*maxilla*) osenofulla e siperme eshte kocke çifte, vendoset ne pjesen e perparme te kafkes dhe merr pjese ne formimin e tre hapesirave:

hapesires orbitale, hapesires se hundes dhe hapesires se gojes. Ajo ka trupin dhe disa procese.

**Trupi** (*corpus maxillae*) ka formen e nje kubi te çrrregullt. Faqja orbitale e tij (*facies orbitalis*) merr pjese ne formimin e murit te poshtem te hapesires orbitale. Ne te fillon kanali infraorbital (*canalis infraorbitalis*), qe hapet ne faqen anteriore me foramen infraorbitale (*foramen infraorbitale*). Faqja anteriore (*facies anterior*) ka ne qender fosen kanine (*fossa canina*). Midis faqes orbitale dhe faqes anteriore gjendet margoja infraorbitale (*margo infraorbitalis*). Faqja nazale (*facies nasalis*) merr pjese ne formimin e murit lateral te hapesires nazale. Ne brendesi te trupit te maksiles gjendet sinusi maksilar (*sinus maxillaris*), qe hapet ne faqen nazale me hiatusin maksilar (*hiatus maxillaris*).

**Procesi frontal** (*processus frontalis*) drejtohet siper dhe merr pjese ne formimin e murit lateral te hapesires nazale.

**Procesi alveolar** (*processus alveolaris*) ka formen e nje harku, ne te cilin gjendet alveolat dentale (*alveoli dentalis*), ku vendosen dhembet.

**Procesi palatin** (*processus palatinus*) ka formen e nje pilake horizontale, qe formon pjesen e perparme te skeletit te qzellzes se forte.

■ **Mandibula** (*mandibula*) osenofulla e poshtme eshte e vjetmja kocke e levizshme e skeletit te kokes. Ajo nuk klasifikohet si kocke e kraniumit. Mandibula formohet nga trupi e dy deget.

**Trupi** (*corpus mandibulae*) ka formen e nje patkoi; ne buzen e siperme te tij gjenden alveolat dentale ku vendosen dhembet. Pas alveoles se fundit gjendet fosa retromolare (*fossa retromolaris*). Ne faqen e jashtme te trupit, perpara, ne secilen ane, gjendet foramen mentale (*foramen mentale*), qe eshte hapja e kanalit mandibular. Ne faqen e brendshme te trupit gjenden spina mentale (*spina mentalis*), fosa digastrike (*fossa digastrica*), linja milohioide (*linea mylohyoidea*) si dhe fovea sublinguale (*fovea sublingualis*) e fovea submandibulare (*fovea submandibularis*).

**Deget mandibulare** (*ramus mandibulae*) fillojne nga trupi me kendet e mandibules (*angulus mandibulae*). Nga jashte kendet gjendet tuberoziteti maseterik (*tuberositas massterica*), ndersa nga brenda tuberoziteti pterygoid (*tuberositas pterygoidea*). Ne faqen e brendshme te ramusit mandibular gjendet foramen mandibulare (*foramen mandibulae*), qe vazhdon me kanalin mandibular (*canalis mandibulae*), i cili hapet ne foramen mentale. Ramusi siper vazhdon me dy procese, nje te perparshem qe eshte procesi koronoid (*processus coronoideus*) dhe nje te pasem qe eshte procesi kondilar (*processus condylaris*). Procesi kondilar perfundon me kondilin (*condylus mandibulae*), nen te cilin eshte qafa e mandibules (*collum mandibulae*).

■ **Kocka etmoidale** (*os ethmoidale*) vendoset midis kockes frontale e kockes sfenoidale dhe merr pjese ne formimin e murit medial te dy hapesirave orbitale dhe murit te siperme te hapesires se hundes. Ajo perbehet nga nje numur i madh celulash etmoidale (*cellulae ethmoidales*).

■ **Kocka palatine** (*os palatinum*) eshte kocke çifte; ajo ka pamjen e shkronjes L. Kocka palatine ka laminen vertikale (*lamina perpendicularis*) dhe laminen horizontale (*lamina horizontalis*). Lamina vertikale merr pjese ne formimin e foses pterigopalatine. Lamina horizontale vendoset prapa procesit palatin te maksiles dhe se bashku me te formon skeletin e qzellzes se forte.

■ **Kocka zigmatike** (*os zygomaticum*) eshte kocke çifte dhe formon mollezen e faqes. Ajo merr pjese ne formimin e murit lateral te orbites. Kocka zigmatike ka procesin temporal (*processus temporalis*), qe bashkohet me procesin zigmatik te kockes temporale per te formuar harkun zigmatik (*arcus zygomaticus*).

■ **Kocka nazale** (*os nasale*) eshte kocke çifte, dy kockat vendosen perpara midis proceseve frontale te maksilave dhe kockes frontale.

■ **Kocka lakrimale** (*os lacrimale*) eshte kocke çifte dhe merr pjese ne formimin e murit medial te hapesires orbitale, duke u vendosur prapa procesit frontal te maksiles.

■ **Vomeri** (*vomer*) eshte kocke teke, qe merrr pjese ne formimin e septumit te hundes.

■ **Kocka hioide** (*os hyoideum*) ka trupin dhe briret. Ajo gjendet ne qafe, nen mandibul dhe lidhet me kockat e tjera mbi te (mandibulen) e nen te nepermjet muskujve.

**Kockat e kraniumit formojne** hapesiren kraniale, hapesiren e hundes, sinuset, orbitat si dhe fosat pterigopalatine, temporale e infratemporale.

■ **Hapesira kraniale** (*cavitas cranii*) eshte hapesira ku vendoset truri me cipat e nervat qe dalin prej tij dhe vazat e gjakut. Kjo hapesire ka çatine e saj, kalvarian dhe dyshemene, bazen e kraniumit. Si kufi midis tyre percaktohet linja qe kalon perpara ne marginon supraorbitale, anash mbi porusin akustik ekstern dhe prapa ne protuberancen oksipitale eksterne.

**Kalvaria** (*calvaria*) ka ne faqen e jashtme pjesen me te dale ose vorteksin (*vortex*) dhe ne faqen e brendshme sulkusin e sinusit sagital superior.

**Baza e kraniumit** ka faqen e jashtme (*basis crani externa*) dhe faqen e brendshme (*basis crani interna*).

Faqja e jashtme e bazes se kraniumit përshtakuhet si faqja inferiore e kafkes. Faqja e brendshme e bazes se kraniumit është dyshemeja e hapesires kraniale, ne te cilen mbeshtetet truri. Ajo ndahet ne fosen kraniale anteriore (*fossa cranii anterior*), fosen kraniale te mesme (*fossa cranii media*) dhe fosen kraniale posteriore (*fossa cranii posterior*). Fosa kraniale anteriore formohet nga pjese te kockave frontale e etmoidale dhe perfundon ne buzen e pasme te kraheve te vegjel te kockes sfenoidale. Nen te jane orbitat dhe hapesira e hundes. Fosa kraniale e mesme formohet nga pjese te kockave sfenoidale dhe temporale. Ajo ka si kufi perpara buzen e pasme te kraheve te vegjel te kockes sfenoidale dhe prapa buzen e siperme te piramides temporale. Kjo fose komunikon me hapesiret orbitale (nepermjet fisures orbitale superiore), me faqen e jashtme te bazes se kraniumit (nepermjet foramen ovale dhe foramen lacerum) dhe me fosen pterigopalatine (nepermjet foramen rotundum). Fosa kraniale posteriore formohet nga pjese te kockave temporale dhe oksipitale. Ajo ka si kufi te perparshem buzen e siperme te piramides temporale. Ne te gjendet foramen magnum (qe është vrima e madhe e kafkes) si dhe foramen jugulare.

■ **Hapesira e hundes** (*cavitas nasalis ossea*) ka pak a shume formen e nje kubi. Hapja e perparme e saj është apertura piriforme, ndersa hapjen e pasme e formojne koanet. Murin e siperme e formon kocka etmoidale dhe trupi i kockes sfenoidale, murin e poshtem procesi palatin i maksiles dhe lamina horizontale e kockes palatine, ndersa murin lateral e formon trupi i maksiles. Ne kete mur gjenden tre flete kockore, konka nazale superiore (*concha nasalis superior*), konka nazale e mesme (*concha nasalis media*) dhe konka nazale inferiore (*concha nasalis inferior*). Midis tyre gjenden meatusi nazal superior (*meatus nasi superior*), meatusi nazal i mesem (*meatus nasi medius*) dhe meatusi nazal inferior (*meatus nasi inferior*). Ne keto meatusin nazal superior e te mesem hapen sinuset e kockave te kraniumit, ndersa ne meatusin nazal inferior hapet duktusii nazolakrimal.

Hapesira e hundes ka ne qender septumin kockor (*septum nasi osseum*) te formuar kryesisht nga vomeri.

■ **Sinuset** janë hapesira ajrike brenda kockave te kraniumit, qe hapen ne hapesiren nazale. Ata janë sinusi frontal, sinusi sfenoidal, sinuset maksilare dhe celulat etmoidale.

**Sinusi frontal** gjendet ne kocken frontale dhe hapet ne meatusin nazal te mesem.

**Sinusi maksilar** gjendet ne trupin e kockes maksilare dhe hapet gjithashtu ne meatusin nazal te mesem.

**Sinusi sfenoidal** gjendet ne trupin e kockes sfenoidale dhe hapet ne meatusin nazal superior.

**Celulat etmoidale** hapen ne meatusin nazal superior e meatusin nazal te mesem.

■ **Orbitat** (*orbita*) kane pamjen e nje piramide me baze katerkendeshe te drejtuar nga perpara, qe quhet aditusi i orbites (*aditus orbitalis*). Buza kockore e aditusit është margoja orbitale (*margo orbitalis*) e perbere nga pjesa ose margoja supraorbitale (*margo supraorbitalis*) dhe pjesa ose margoja infraorbitale (*margo infraorbitalis*). Orbita ka murin e siperme te formuar nga kocka frontale dhe krahut i vogel i kockes sfenoidale, murin lateral te formuar nga kocka zigomatike dhe krahut e medha te kockes sfenoidale, murin e poshtem te formuar nga maksila dhe murin medial te formuar nga kockat lakrimale dhe etmoidale. Ne pjesen laterale te murit te siperme te orbites gjendet fosa e gjendres lakrimale.

Hapesira orbitale (*cavitas orbitalis*) komunikon me hapesira te tjera te kafkes. Me hapesiren kraniale komunikon nepermjet kanalit optik e fisures orbitale superiore, me hapesiren nazale nepermjet kanalit nazolakrimal (*canalis nasolacrimalis*), foramen etmoidale anteriore (*foramen ethmoidale anterius*) e foramen etmoidale posteriore (*foramen ethmoidale posterius*), me fosen pterigopalatine nepermjet fisures orbitale inferiore, ndersa kanali infraorbital hapet ne faqen anteriore te trupit te maksiles.

■ **Fosa pterigopalatine** (*fossa pterygopalatina*) është nje gropë e vogel qe ka perpara trupin e maksiles, prapa procesin pterigoid te kockes sfenoidale dhe medialisht laminen vertikale te kockes palatine. E imagjinuar si kon i permbysur, ajo komunikon perpara me orbiten nepermjet fisures orbitale inferiore, siper me hapesiren kraniale nepermjet foramen rotundum, prapa me faqen e jashtme te bazes se kraniumit nepermjet kanalit pterigoid, poshte me hapesiren e gojes nepermjet kanalit palatin ose pterigoplatin qe hapet ne dy foraminat palatine, medialisht me hapesiren nazale nepermjet foramen sfenopalatine (*foramen sphenopalatinum*) dhe lateralisht me fosen infratemporale nepermjet fisures pterigomaksilare (*fissura pterygomaxillaris*).

■ **Fosa temporale** (*fossa temporalis*) gjendet ne secilen ane e formuar nga skuama e kockes temporale dhe faqja temporale e kraheve te medhenj te kockes sfenoidale.

■ **Fosa infratemporalis** (*fossa infratemporalis*) gjendet ne secilen ane nen fosen temporale dhe formohet nga faqja infratemporale e kraheve te medhenj te kockes sfenoidale. Kjo fose ka medialisht laminen laterale te proceseve pterigoide dhe lateralisht mandibulen.

**Fakte klinike****Radiografia**

Deri para rreth dy dekadave radiografia e kokes ishte metoda standarte e ekzaminimit imazherik te kokes. Aktualisht ato kryhen ne rastet e traumave, por numri i ekzaminimeve te tilla eshte ne renie. Radiografite behen ne pozicion posteroanterior, lateral ose ne pozicione te tjera.

**Skaneri**

Skaneri ose tomografia e kompjuterizuar eshte ekzaminim i zgjedhur ne traumat e kokes, sepse jo vetem demonstron demtimet kockore, por edhe demtimet eventuale te trurit e cipave te tij si dhe pranine e gjakut ne te.

**Rezonanca magnetke**

Rezonanca magnetke eshte superiore ne ekzaminimin e trurit e cipave te tij si dhe lengut cerebrospinal.

**Ekografja**

Ekografja ka gjetur perdonim ne femijet per ekzaminimin e trurit, meqe fontanelat mund te sherbejne si dritare akustike.

**KOLONA VERTEBRALE**

**Kolona vertebrale** (*columna vertebralis*) formohet nga teresia e vertebrave (*vertebrae*) te vendosura njera mbi tjetren; tek njeriu jane rreth 33 vertebra.

**Vertebra tipike** perbehет nga te njejtet elemente ndertimore: trupi, harku dhe proceset.

■ **Trupi vertebral** (*corpus vertebrae*) eshte pjesa me masive e vertebres. Ai ka dy faqe intervertebrale (*facies intervertebralis*) lehtesish konkave, qe shohin nga trupat e vertebrave fqinje. Roli i trupit eshte transmetimi i peshes, prandaj madhesia e tyre vjen ne rritje duke zbritur ne kolone.

■ **Harku vertebral** (*arcus vertebrae*) gjendet prapa trupit dhe fiksohet ne te ne secilen ane. Ai perbehet nga dy lamina (*lamina arcus vertebrae*), qe prapa bashkohen me njera tjetren dhe dy pedikuj (*pediculus arcus vertebrae*) me ane te te cileve harku bashkohet me trupin. Hapesira mbi pedikul (i cili eshte me i ngushte se lamina) eshte incizura vertebrale superiore (*incisura vertebralis inferior*) dhe hapesira nen te eshte incizura vertebrale inferiore (*incisura vertebralis superior*). Incizura superiore dhe incizura inferiore e dy vertebrave te artikuluara formojne foramen intervertebrale (*foramen intervertebrale*).

Midis trupit dhe harkut vertebral formohet foramen vertebrale (*foramen vertebrale*).

■ **Proceset** dalin nga harku vertebral.

Prapa ne vendin e bashkimit te dy laminave fillon procesi spinoz (*processus spinosus*), i cili drejtohet prapa.

Ne vendin e bashkimit te lamines vertebrale me pedikulin e saj dalin procesi transversal (*processus transversus*) dhe proceset artikulare, superiori (*processus articularis superior*) e inferiori (*processus articularis inferior*), te cilet perfundojnë me faqe artikulare.

Pra çdo verteber ka nje proces spinoz, dy procese transversale dhe kater procese artikulare.

**Vertebrat grupohen** ne vertebra cervikale, vertebra torakale, vertebra lumbare, vertebra sakrale dhe vertebra koksigeale; ky grupim bazohet ne pozicionin dhe veçorite morfollogjike te tyre. Sidoqoftë veçori morfollogjike tipike paraqesin vetem vertebrat qe ndodhen ne qender te seciles pjese, ndersa vertebrat e skajeve konsiderohen tranzitore.

■ **Vertebrat cervikale** (*vertebrae cervicales*) jane shtate dhe emertohen C1-C7. Ato kane trup te vogel dhe foramen vertebrale ne forme trekendeshi.

Vertebrat cervikale tipike kane ne secilen ane te trupit procesin uncinat (*processus uncinatus*), gjithashtu kane proces spinoz bifid dhe ne procesin transversal kane foramen transversale (*foramen transversarium*).

Procesi uncinat eshte nje ngritje e buzes se faqes se siperme te trupit ne secilen ane. Ai mbeshtetet ne faqen e poshtme e trupit te vertebres mbi te, ne nje siperfaqe te vogel konkave.

Procesi spinoz eshte i shkurter e bifid per te rritur siperfaqen e atashimit muskular.

Procesi transversal perbehet nga nje pjese anteriore dhe nje pjese posteriore, midis te cilave gjendet foramen transversale. Pjesa anteriore eshte ne fakt rudiment i brinjeve dhe perfundon me tuberkulum anterior (*tuberculum anterius*), ndersa pjesa posteriore eshte procesi i vertete transversal dhe perfundon me tuberkulum posterior (*tuberculum posterius*).

Vertebra cervikale jotipike jane C1, C2 e C7.

**C1 ose atlasi** (*atlasis*) nuk ka trup dhe as proces spinoz. Ai ka harkun anterior (*arcus anterior atlantis*), i cili ne faqen e brendshme ka nje fovea dentis (*fovea dentis*), harkun posterior (*arcus posterior atlantis*) dhe midis tyre dy masa laterale (*massa lateralis atlantis*), te pajisura me faqe artikulare superiore (*facies articularis superior*) e inferiore (*facies articularis inferior*). Harku anterior ka tuberkulum anterior (*tuberculum anterius*) dhe harku posterior tuberkulum

posterior (*tuberculum posterius*), qe eshte rudimenti i procesit spinoz. Mungesa e trupit (qe i ngjitet trupit te C2) dhe e procesit spinoz te atlasit shton amplituden e rrrotullimit te kokes dhe perkuljes prapa te saj.

**C2 ose aksi (axis)** ka dhembin (*dens axis*), qe eshte trupi i C1 (i ngjitur me trupin e C2) rrreth te cilit rrrotullohet C1 dhe koka. Dhembja ka nje faqe artikulare anteriore (*facies articularis anterior*), qe futet ne fovean e tij dhe nje faqe artikulare posteriore (*facies articularis posterior*).

**C7 ose vertebra prominens (vertebra prominens)** ka proces spinoz te gjate qe perfundon me gunge (jo bifid), ndersa foramen transversale mund te mungoje.

■ **Vertebrat torakale (vertebrae thoracicae)** jane dymbedhjete dhe emertohen T1-T12. Ato kane trup me te madh se te vertebrave cervikale dhe foramen vertebruale te vogel e ne forme rrethore. Vertebrat torakale tipike kane proces spinoz te pjerret per te pakesuar levizshmerine e kesaj pjese te kolones vertebruale. Gjithashtu, meqenese me keto vertebra artikulojne brinjet, ato kane si veçori pranine e faqeve perkatese artikulare. Ne trup ato kane fovean kostale superiore (*fovea costalis superior*) dhe fovean kostale inferiore (*fovea costalis inferior*). Dy foveat perballë, te dy vertebrave fqinje, formojne nje gropë te plote ku futet koka e brinjes. Ne procesin transversal vertebrait torakale kane gjithashtu nje fovea kostale (*fovea costalis processus transversi*), ne te cilin perseri artikulon brinja.

Vertebra torakale jotipike jane T11 e T12. Meqenese dy brinjet e fundit artikulojne vetem me kokat e tyre, proceset transversale te T11 e T12 nuk kane fovea kostale.

■ **Vertebrait lumbare (vertebrae lumbales)** jane pese dhe emertohen L1-L5. Ato kane trup me te madh se te tjerat per aresye te peshes qe mbajne, foramen vertebruale ne forme trekendeshe, me te vogel se te vertebrave cervikale, por me te madhe se te atyre torakale. Proseset spinoze te tyre Jane si pllaka katerkendeshe me vendosje vertikale, proceset transversale jane te holle e te gjate, ndersa rudimenti i brinjeve eshte procesi kostal (*processus costalis*).

Trupi i vertebres L5 formon me trupin e vertebres (qe ndodhet nen te) S1 nje kend qe quhet promontorium (*promontorium*).

■ **Vertebrait sakrale (vertebrae sacrales)** jane pese vertebra te bashkuara ne nje kocke, qe quhet sakrum (*os sacrum*). Ky ka formen e nje pyke me baze siper (*basis ossis sacri*) dhe maje poshte (*apex ossis sacri*). Sakrumi ka nje faqe anteriore ose pelvike (*facies pelvica*) dhe nje faqe posteriore ose dorsale (*facies dorsalis*). Anash, midis tyre gjendet faqja aurikulare (*facies auricularis*) dhe prane saj tuberoziteti sakral (*tuberousitas ossis sacri*). Ne faqen pelvike duken linjat transversale (*lineae transversae*) ne kufijte midis trupave vertebruale dhe foraminat sakrale anteriore (*foramina sacralia anteriora*). Ne faqen dorsale duken

foraminat sakrale posteriore (*foramina sacralia posteriora*) si dhe kreshta sakrale mediane (*crista sacralis mediana*) e formuar nga bashkimi i proceseve spinoze, kreshtat sakrale mediale (*crista sacralis medialis*) te formuara nga bashkimi i proceseve artikulare dhe kreshtat sakrale laterale (*crista sacralis lateralis*) te formuara nga bashkimi i proceseve transversale te vertebrave sakrale. Sakrumi pershkohet nga kanali sakral (*canalis sacralis*), qe ne apeks hapet me hiatus (*hiatus sacralis*).

■ **Vertebrait koksigeale (vertebrae coccygea)** jane dy, tre ose kater vertebra te bashkuara ne nje nodus kockor qe quhet koxiks (*coccyx*); ai konsiderohet pjese rudimentare e kolones vertebruale.

**Kolona vertebruale ne teresi** paraqet teresine e vertebrave te artikuluara ne faqet artikulare te proceseve artikulare te tyre. Pare nga perpara kolona vertebruale paraqitet e drejtë, ndersa pare anash ajo paraqet disa perkulje.

**Perkuljet** qe paraqet kolona vertebruale ne pamjen anesore jane kater, dy primare (*curvatura primaria*) dhe dy sekondare (*curvatura secundaria*). Perkuljet primare jane me konkavitet nga perpara dhe pasoje e perkuljes se vrimet me konkavitet perpara tek fetusi; ato Jane **kifoza torakale (kyphosis thoracica)** dhe **kifoza sakrale (kyphosis sacralis)**.

Perkuljet sekondare Jane me konveksitet nga perpara dhe zhvillohen pas lindjes; ato Jane **lordoza cervikale (lordosis cervicis)**, qe formohet kur femija fillon te mbaje koken te ngritur dhe **lordoza lumbale (lordosis lumbalis)**, qe formohet kur femija fillon te ece.

Kifozat e lordozat Jane perkulje normale te kolones vertebruale.

Perkuljet e kolones vertebruale ne pamjen perballë quhen **skolioza (scoliosis)**. Skoliozat Jane perkulje jonormale te kolones vertebruale.

Kolona vertebruale pershkohet nga **kanali vertebral** (*canalis vertebralis*), qe formohet nga teresia e foraminave vertebruale dhe siper nepermjet foramen magnum, komunikon me hapesireni kraniale.

### Fakte klinike

#### Variacionet ne numrin e vertebrave

Variacione ne numer me shipesh paraqesin vertebrait lumbare.

Fuzionimi i vertebres L5 me sakrumin (zakonisht i pjesshem) konsiderohet sakralizim i saj. Ne te kundert, veçimi (zakonisht i pjesshem) i vertebres S1 nga sakrumi konsiderohet lumbalizim i saj.

#### Spina bifida

*Spina bifida* eshte nje çrregullim qe vjen nga mosfuzionimi i dy hargeve vertebrare. Ajo ndodh zakonisht ne nivelin L5-S1 dhe rezulton ne nje kanal vertebral “te hapur”. Mund te jete e dy tipeve. Tipi okuli eshte me i shpeshti dhe nuk shoqerohet me shenja klinike. Tipi i dyte paraqitet me dalje ne nivelin e defektit te cipave te medules spinale duke formuar nje “xhep” qe permban leng cerebrospinal (meningocele) ose dhe pjesa te medules (mielomeningocele) dhe shoqerohet me shenja neurologjike.

#### Skolioza

Eshte perkulja laterale jonormale e kolones vertebrare dhe shoqerohet edhe me rrotullim te vertebrave. Me shpesh eshte pa shkak te njohur, ne kete rast haset sidomos tek vajzat gjate adoleshencës. Qendrimet e gabuara dhe dhimbjet neuromuskulare mund te jene gjithashtu shkak i skoliozave.

## SKELETI I TORAKSIT

**Skeleti i toraksit** (*skeleton thoracis*) formohet nga vertebrat torakale, sternumi dhe brinjet. Ai ka formen e nje cilindri te çrregullt ne te cilin Jane vendosur organe me rendesi jetesore (zemra, mushkerite).

**Vertebrat torakale** vendosen ne pjesen e pasme te toraksit, ne linjen mediane. Ato Jane gjithsej dymbedhjete.

**Sternumi** (*sternum*) eshte nje kocke e sheshte qe vendoset ne pjesen e perparme te toraksit. Ai perbehet nga manubrium ose doreza, trupi dhe procesi ksifoid.

**Manubrium** (*manubrium sterni*) eshte pjesa e siperme e sternumit; ai ka siper incizuren jugulare (*incisura jugularis*) dhe ne secilen ane incizuren klavikulare (*incisura clavicularis*) e incizuren kostale per brinjen e pare. Per brinjen e dyte manubrium ka vetem nje gjysem incizure, gjysmen tjeter e ka trupi i sternumit. **Trupi** (*corpus sterni*) gjendet nen manubrium. Ai formon me te kedin sternal (*angulus sternalis*). Ne pjesen me te siperme, ne secilen ane, trupi ka nje gjysem incizure kostale per brinjen e dyte (gjysmen tjeter e ka manubrium) dhe poshte saj incizurat per brinjet III-VII (*incisurae costales*).

**Procesi ksifoid** (*processus xiphoides*) eshte pjesa e vogel kockore, e vendosur nen trupin e sternumit.

**Brinjet** (*costae*) Jane dymbedhjete çifte; ato prapa bashkohen me vertebrat torakale ndersa perpara me sternumin. Ne fakt vetem shtate brinjet e para kapen direkt ne sternum (nepermjet kerceive te tyre); ato quhen, per kete aresye, edhe brinje te verteta (*costae verae*), ndersa pese brinjet e tjera quhen brinje te rreme (*costae spuriae*). Prej tyre tre te sipermet lidhen indirekt me sternumin (kane

kerce qe bashkohen me ate te brinjes se shtate), ndersa dy te poshtmet nuk lidhen fare me sternumin, por e kane te lire skajin anterior, prandaj quhen edhe brinje fluktuanter (*costae fluctuantes*).

Çdo brinje ka ekstremitetin posterior (me koken, qafen e tuberkulum), trupin dhe ekstremitetin anterior (me kartilagon kostale).

**Koka** (*caput*) e brinjes gjendet ne pjesen e pasme te saj; ajo ka faqe artikulare per te artikular me faqet respektive artikulare (foveat kostale) ne trupat e vertebrave torakale fqinje.

**Qafa** (*collum costae*) eshte pjesa e ngushtuar e brinjes prane kokes se saj.

**Trupi** (*corpus costae*) i brinjes ka forme te sheshte e te perkulur; ne pjesen midis tij e qafes gjendet nje tuberkulum (*tuberculum costae*), me faqe artikulare qe artikulon me fovean kostale ne procesin transversal te vertebrave torakale. Ne buzen e poshtme te trupit ne gjithe gjatesine e tij gjendet sulkusi kostal (*sulcus costae*), ne te cilin vendoset tufa neurovaskulare interkostale.

**Kartilagoja** e brinjes (*cartilago costalis*) qe eshte vazhdim i pjeses se perparme te trupit, futet ne incizuren perkatese kostale te sternumit. Kartilagot kostale i jepin elasticitet e levizshmeri toraksit.

**Hapesira torakale** (*cavitas thoracis*) e formuar nga toraksi kockor ka nje hapje te siperme (*apertura thoracis superior*) te vogel dhe nje hapje te poshtme (*apertura thoracis inferior*) me te madhe. Nen sternum gjendet kendi infrasternal (*angulus infrasternalis*), ndersa midis brinjeve Jane hapesirat interkostale (*spatium intercostale*).

#### Fakte klinike

##### “Pectus excavatum” dhe “pectus carinatum”

“Pectus excavatum” konsiston ne nje gropëzim te sternumit dhe kartilagove kostale, ndersa “pectus carinatum”, ne te kundert, konsiston ne nje protruzion anterior te sternumit. Keto deformime zakonisht Jane te lindura, mund te shoqerohen me deformime te tjera te kolones vertebrare dhe mund te ndikojne ne aktivitetin e zemrës e mushkerive.

##### Brinja cervikale

Brinja cervikale eshte mbizhvillim i pjeses anteriore te procesit transversal te vertebrës C7. Gjatesia e saj eshte variabel; ajo mund te perfundoje me skaj te lire ose te bashkohet me brinjen e pare nepermjet nje bande indi fibroz. Nese eshte e gjate mund te komprimoje pleksin brakial e a. subklavia dhe te shkaktoje “sindromin e apertures se siperme torakale”.

##### Frakturat e brinjeve

Fraktura e vetme e nje brinje zakonisht ka pak pasoja, ndonese ajo eshte shume e dhimbshme. Negofteze trauma eshte e madhe skajet e brinjes ne vendin e fraktureve

ose fragmente te shkeputura te saj mund te zhyten ne brendesi te hapesires torakale dhe te demtojne organet qe gjenden ne te.

#### **Punksioni ne sternum per marrjen e palces kockore**

Megenese sternumi gjendet direkt nen lekure, ai mund te punktohet lehte per te marre dhe ekzaminuar palcen kockore te tij. Punksioni realizohet nepermjet nje ageje, maja e se ciles futet ne hapesiren medullare te sternumit dhe pastaj behet aspirimi i palces. Ekzaminimi i saj ndihmon diagnozen e disa semundjeve te gjakut.

## **SKELETI I GJYMTYRES SE SIPERME**

■ **Skeleti i gjymtyres se siperme** (*osse membra superioris*) ndahet ne rrethin e gjymtyres se siperme ose rrethin pektoral dhe ne pjesen e lire te saj.

**Rrethi i gjymtyres se siperme** (*cingulum membra superioris*) ose rrathi pektoral (*cingulum pectorale*) perbehet nga klavikula dhe skapula.

■ **Klavikula** (*clavicula*) ka trupin (*corpus clavicularae*) si dhe ekstremitetin sternal (*extremitas sternalis*) e ekstremitetin akromial (*extremitas acromialis*). Ekstremiteti sternal ka forme katerkendeshe dhe ka raport me incizuren klavikulare te sternumit, ndersa ekstremiteti akromial eshte me i sheshte dhe ka raport me akromionin e skapules. Klavikula eshte e palpueshme gjate gjithe gjatesise se saj. Pjesa mediale e klavikules eshte konvekse nga perpara, ndersa pjesa laterale e saj konvekse nga prapa. Siperfaqja e siperme e klavikules eshte pak a shume e rrafshet, ndersa ne siperfaqen e poshtme kapen disa ligamente.

■ **Skapula** (*scapula*) ka formen e nje flete ne forme trekendeshi me baze te vendosur siper. Ajo ka faqen anteriore (*facies anterior*), faqen posteriore (*facies posterior*), kordin superior (*angulus superior*), kordin inferior (*angulus inferior*) e kordin lateral (*angulus lateralis*) si dhe margin superiore (*margo superior*), margin laterale (*margo lateralis*) dhe margin mediale (*margo medialis*), qe nri pak a shume vertikalish.

Faqja anteriore eshte konkave dhe formon fosen subskapulare (*fossa subscapularis*).

Faqja posteriore ndahet nga spina skapulare (*spina scapulae*) ne fosen supraspinata (*fossa supraspinata*) dhe fosen infraspinata (*fossa infraspinata*). Spina skapulare vazhdon me nje zgjatim qe quhet akromion (*acromion*), i cili artikulon me ekstremitetin akromial te klavikules.

Margoja superiore e skapules gjithashtu ka nje zgjatim qe quhet procesi korakoid (*processus coracoideus*), ndersa medialisht tij gjendet incizura skapulare (*incisura scapulae*).

Kendi lateral i skapules eshte i trashur dhe ne te gjendet hapesira glenoidale (*cavitas glenoidalis*) mbi e nen te cilien gjenden perkatesisht tuberkulumi supraglenoidal (*tuberculum supraglenoidale*) dhe tuberkulumi infraglenoidal (*tuberculum infraglenoidale*).

**Pjesa e lire** (*pars libera*) e skeletit te gjymtyres se siperme perbehet nga kocka e krahut ose humerusi, kockat e parakrahut qe jane radiusi e ulna dhe kockat e dores qe jane karpet, metakarpet dhe falangjet.

■ **Humerusi** (*humerus*) ka skajin proksimal, skajin distal dhe midis tyre trupin. Ne skajin proksimal ndodhet koka e humerusit (*caput humeri*), qafa anatomike (*collum anatomicum*) si dhe tuberkulumi major (*tuberculum majus*) e tuberkulumi minor (*tuberculum minus*), midis te cileve gjendet sulkusi intertuberklular (*sulcus intertubercularis*). Nen to gjendet qafa kirurgjikale e humerusit (*collum chirurgicum*), qe eshte vendi ku mund te ndodhin fraktura te humerusit. Ne trup (*corpus humeri*) ndodhet lateralisht tuberoziteti deltoid (*tuberositas deltoidea*) dhe prapa sulkusi i nervit radial (*sulcus nervi radialis*). Skaji distal perfaqesohet nga kondili i humerusit (*condylus humeri*), qe ne secilen ane ka epikondilin medial (*epicondylus medialis*) e epikondilin lateral (*epicondylus lateralis*). Ne kete skaj medialisht gjendet troklea (*trochlea humeri*) dhe lateralisht kapitulumi (*capitulum humeri*). Mbi troklea gjendet fosa koronoide (*fossa coronoidea*), mbi capitulum fosa radiale (*fossa radialis*) dhe prapa fosa e olekrani (*fossa olecrani*).

■ **Radiusi** (*radius*) gjendet ne parakrah, lateralisht ulnes. Ai ka skajin proksimal, skajin distal dhe midis tyre trupin. Ne skajin proksimal ndodhet koka e radiusit (*caput radii*), qe ka fovean artikulare (*fovea articularis*), ku futet kapitulumi i humerusit, ndersa rreth kokes gjendet cirkumferanca artikulare (*circumferentia articularis*). Nen koken e radiusit gjendet qafa e tij (*collum radii*). Trupi (*corpus radii*) ka tuberozitetin e radiusit (*tuberositas radii*) dhe margot, anteriore (*margo anterior*), posteriore (*margo posterior*) dhe interosea (*margo interosseus*). Skaji distal ka procesin styloid (*processus styloideus radii*), incizuren per ulnen (*incisura ulnaris*) dhe faqen artikulare per karpet (*facies articularis carpalis*).

■ **Ulna** (*ulna*) vendoset medialisht radiusit. Ajo ka skajin proksimal, skajin distal dhe midis tyre trupin. Ne skajin proksimal ndodhen dy procese, njeri qe drejtohet perpara e quhet procesi koronoid (*processus coronoideus*) dhe tjetri qe drejtohet prapa tij dhe eshte olekrani (*olecranon*). Midis tyre gjendet incizura troklear (incisura trochlearis), ne te cilien futet troklea e humerit, ndersa lateralisht gjendet incizura radiale (incisura radialis) per cirkumferencen artikulare te radiusit. Trupi (*corpus ulnae*) ka tuberozitetin ulnar (*tuberositas ulnae*) dhe margot, anteriore (*margo anterior*), posteriore (*margo posterior*) dhe

interosea (*margo interosseus*). Ne skajin distal ndodhet koka e ulnes (*caput ulnae*), qe ka procesin stloid (*processus styloideus ulnae*) dhe cirkumferencen artikulare (*circumferentia articularis*) per incizuren ulnare te radiusit.

■ **Karpet** (*osso carpi*) vendosen ne dy rreshta. Ne rreshtin proksimal jane kocka skafoide (*os scaphoideum*), kocka lunate (*os lunatum*), kocka triquetrum (*os triquetrum*), dhe kocka piziforme (*os pisiforme*). Ne rreshtin distal jane kocka trapezium (*os trapezium*), kocka trapezoide (*os trapezoideum*), kocka kapitatum (*os capitatum*) dhe kocka hamate (*os hamatum*). Kocka kapitatum eshte me e madhja nga karpet, ndersa kocka piziforme eshte sesamoide. Secili nga karpet ka disa siperfaqe artikulare.

Karpet nuk vendosen ne nje plan te sheshte; ata formojne nje hark me konkavitet nga perpara qe quhet harku karpal.

■ **Metakarpet** (*osso metacarpi*) jane pese; ata artikulojne me karpet ne njeri ane dhe me falangjet ne anen tjeter. Çdo metakarp ka bazen (*basis ossis metacarpi*), trupin (*corpus ossis metacarpi*) e koken (*caput ossis metacarpi*).

■ **Falangjet** (*phalanges*) jane tre per secilin gisht perveç te parit qe ka dy. Ata emertohen falangu proksimal (*phalanx proximalis*), falangu i mesem (*phalanx media*) dhe falangu distal (*phalanx distalis*). Ashtu si dhe metakarpet, çdo falang ka bazen (*basis phalangis*), trupin (*corpus phalangis*) e koken (*caput phalangis*).

#### Fakte klinike

##### Frakturat e klavikules

Frakturat e klavikules shkaktohen zakonisht gjate renieve me shpatull ose dore. Vendi i fraktures eshte ne pjesen e mesme, midis dy harkimeve te saj. Fragmenti lateral nen peshen e krahut ulet; ai gjithashtu mund te zhvendoset medialisht duke u mbivene mbi fragmentin medial, i cili zakonisht peson nje zhvendosje te vogel.

##### Frakturat e humerusit

Frakturat e humerusit jane te shpeshta dhe mund te ndodhin ne çdo nivel. Frakturat ne skajin proksimal zakonisht ndodhin ne qafen kirurgjikale. Frakturat e trupit shkaktohen nga goditje direkte dhe mund te shoqerohen me demtime te nervit radial.

Frakturat ne skajin distal mund te ndodhin nga rrezimi mbi brryl, gjate te cilit olekanni futet si pyke ne kondilin e humerusit; keto fraktura mund te shoqerohen me demtime te nervit ulnar. Tek femijet zakonisht ndodhin fraktura suprakondilare dhe fragmentet mund te demtojne nervin median.

##### Frakturat e radiusit

Frakturat e ekstremitetit distal te radiusit jane frakturat me te shpeshta te parakrahut; ato shkaktohen nga fleksioni i ekzagjeruar dorsal i dores gjate renieve.

Fragmenti distal zakonishi zhvendoset dhe shpesh frakturohet ne pjesë me te vogla, por meqë vaskularizimi i tij eshte i mire, i tille eshte edhe regjenerimi.

##### Frakturat e karpeve

Nga karpet kocka skafoide eshte ajo qe frakturohet me shume dhe kjo ndodh gjate renies mbi dore te flektuar dorsalisht. Fragmentet kockore zakonisht nuk zhvendosen, por jo rralle keto fraktura shoqerohen me nekroze avaskulare te fragmentit proksimal.

##### Frakturat e falangjeve

Nga falangjet me shpesh frakturohet ai distal, meqë eshte me i ekspozuar ndaj traumave. Keto fraktura jane shume te dhimbshme dhe shpesh shoqerohen me hematoma. Per rivendosjen e funksionit normal te gishtave, fragmentet kockore duhet te ripozicionohen me kujdes.

## SKELETI I GJYMTYRES SE POSHTME

**Skeleti i gjymtires se poshtme** (*osso membra inferioris*) ndahet ne rrethin e gjymtires se poshtme ose rrethin pelvik dhe ne pjesen e lire te saj.

**Rrethi i gjymtires se poshtme** (*cingulum membra inferioris*) ose rrathi pelvik (*cingulum pelvicum*) perbehet nga kocka kokse (*os coxae*). Ajo formohet nga bashkimi i tre kockave te tjera, iliumit, iskiumit dhe pubisit.

■ **Ilium** (*ilium*) ose kocka iliake (*os ilium*) ka trupin dhe krahun, qe del prej tij. Trupi (*corpus osis ilii*) merr pjesë ne formimin e acetabulumin. Krahu ose fleta iliake (*ala ossis ilii*) ka nje faqe anteriore, nje faqe posteriore e midis tyre kreshten. Faqja anteriore eshte konkave dhe formon fosen iliake (*fossa iliaca*), kufiri i poshtem i se ciles eshte linja arkuante (*linea arcuata*). Ne faqen posteriore ose gluteale (*facies glutea*) gjenden linjat gluteale (*linea glutea anterior, posterior e inferior*). Kreshta iliake (*crista iliaca*) perfundon perpara me spinen iliake anteriore superiore (*spina iliaca anterior superior*) dhe spinen iliake anteriore inferiore (*spina iliaca anterior inferior*), ndersa prapa me spinen iliake posteriore superiore (*spina iliaca posterior superior*) dhe spinen iliake posteriore inferiore (*spina iliaca posterior inferior*), prane se ciles eshte faqja aurikulare (*facies auricularis*). Mbi faqen aurikulare gjendet tuberoziteti iliak (*tuber osis iliacum*).

■ **Iskium** (*ischium*) ose kocka iskiadike (*os ischii*) ka trupin dhe ramusin (degen) qe del prej tij. Trupi (*corpus osis ischi*) merr pjesë ne formimin e acetabulumin. Ramusi (*ramus osis ischi*) eshte i perkultur dhe bashkohet me ramusin e poshtem pubik. Ne vendin e perkulturës gjendet tuberi iskiadike (*tuber osis ischiadicum*). Ne pjesen e pasme te ramusit gjendet spina iskiadike (*spina*

*ischiadica*), mbi te incizura iskiadike majore (*incisura ischiadica major*) e nen te incizura iskiadike minore (*incisura ischiadica minor*).

■ **Pubis** (*pubis*) ose kocka pubike (*os pubis*) ka trupin si dhe ramusin e siperme e ramusin e poshtem pubike. Trupi (*corpus ossis pubis*) merr pjese ne formimin e acetabulumit. Ramus superior (*ramus superior ossis pubis*) ka eminenca iliopubike (*eminencia iliopubica*), pektenin (*pecten ossis pubis*) dhe tuberkulumin pubik (*tuberculum pubicum*). Ne kufirin e tij me ramusin inferior gjendet faqja simfiziale (*facies symphysialis*), qe bashkohet me faqen e njejtë te anes tjeter duke formuar simfizën pubike. Ramus inferior (*ramus inferior ossis pubis*) bashkohet me ramusin iskiadic duke formuar foramen obturatum (*foramen obturatum*). Ne pjesen e siperme te saj (nen ramusin superior pubik) gjendet gjendet sulkusi obturator (*sulcus obturatorius*).

Tre trupat e bashkuar te kockave te mesiperme formojne **acetabulumin** (*acetabulum*). Ai ka nje grope ne te cilën gjendet faqja lunata (*facies lunata*) e lemuar dhe ne thellesi fosa acetabulare (*fossa acetabuli*). Ne buzen e acetabulumit gjendet incizura acetabulare (*incisura acetabuli*).

Sakrumi e koksiksi bashke me dy kockat kokse formojne **pelvisin**.

**Pelvisi** (*pelvis*) ndahet ne pelvisin major (*pelvis major*) dhe pelvisin minor (*pelvis minor*) nga linja terminale (*linea terminalis*). Kjo fillon ne promontorium dhe vazhdon me linjen arkuate dhe pektenin. Plani i hyrjes ne pelvisin minor quhet apertura pelvike superiore (*apertura pelvis superior*), ndersa plani i daljes prej tij quhet apertura pelvike inferiore (*apertura pelvis inferior*).

Pelvisi ka ndryshime te theksuara midis sekseve, qe jane ndryshime vizuale dhe metrike. Ndryshimet vizuale kane te bejne me formen e tij; keshtu pelvisi femoror eshte me i sheshte, me i ceket dhe me i gjere, ndersa nen simfizën pubike ka harkun pubik (*arcus pubicus*), ndryshe nga meshkujt ku ai emertohet kendi subpubik (*angulus subpubicus*). Ndryshimet metrike kane te bejne me vlerat e diametrave te tij, qe jane me te medha tek femrat. Keto diametra maten ne aperturen superiore e ne aperturen inferiore dhe jane diametra anteroposteriore, transversale e oblike.

**Pjesa e lire** (*pars libera*) e skeletit te gjymtyres se poshtme perbehet nga kockat e kofshes qe jane femuri e patela, kockat e kercirit qe jane tibia e fibula dhe kockat e kembes qe jane tarset, metatarsin e falangjet.

■ **Femuri** (*femur*) ka skajin proksimal, skajin distal dhe midis tyre trupin. Ne skajin proksimal ndodhet koka (*caput femoris*), qe ne qender ka fovean (*fovea capitatis femoris*). Prane kokes eshte qafa e femurit (*collum femoris*) dhe ne

vazhdim trokanteri major (*trochanter major*) e trokanteri minor (*trochanter minor*); midis tyre perpara gjendet linja intertrokanterike (*linea intertrochanterica*) dhe prapa kreshta intertrokanterike (*crista intertrochanterica*). Trupi (*corpus femoris*) ka ne faqen e pasme linjen aspera (*linea aspera*), te perbere nga buza laterale e buza mediale. Siper buza laterale shkon drejt tuberkulumit major e buza mediale drejt tuberkulumit minor. Edhe poshtë dy buzet divergojnë e midis tyre formohet faqja popliteale (*facies poplitea*). Ne skajin distal gjendet dy kondile, njeri medial (*condylus medialis*) dhe tjetri lateral (*condylus lateralis*); pjeset me te dala te tyre janë epikondili medial (*epicondylus medialis*) e epikondili lateral (*epicondylus lateralis*). Midis dy kondileve gjendet perpara faqja patellare (*facies patellaris*) e prapa fosa interkondilare (*fossa intercondylaris*).

■ **Patela** (*patella*) eshte kocke sesamoide dhe ka nje faqe anteriore (*facies anterior*) dhe nje faqe posteriore, qe artikulen me femurin (*facies articularis*).

■ **Tibia** (*tibia*) vendoset medialisht fibules. Ajo ka nje skaj proksimal, nje skaj distal dhe midis tyre trupin. Ne skajin proksimal ndodhen dy kondile, njeri medial (*condylus medialis*) dhe tjetri lateral (*condylus lateralis*); ata marrin pjese ne formimin e faqes artikulare superiore (*facies articularis superior*) te tibias. Ne kete faqe artikulare, midis kondileve, gjendet eminenca interkondilare (*eminencia intercondylaris*). Perpara eminences eshte area interkondilare anteriore (*area intercondylaris anterior*) dhe prapa saj area interkondilare posteriore (*area intercondylaris posterior*). Kondili lateral ka gjithashtu edhe nje faqe artikulare per fibulen (*facies articularis fibularis*). Trupi (*corpus tibiae*) ka tuberozitetin tibial (*tuber os tibiae*) dhe margot, anteriore (*margo anterior*), posteriore (*margo posterior*) dhe interosea (*margo interosseus*). Skaji distal ka maleolusin medial (*malleolus medialis*) me faqen e tij artikulare (*facies articularis malleoli medialis*), incizuren fibulare (*incisura fibularis*) dhe faqen artikulare inferiore (*facies articularis inferior*) per tarset (talusin).

■ **Fibula** (*fibula*) vendoset lateralisht tibias. Ajo ka skajin proksimal, skajin distal dhe midis tyre trupin. Ne skajin proksimal ndodhet koka e fibules (*caput fibulae*) dhe nje faqe artikulare per tibian (*facies articularis capitatis fibulae*). Trupi (*corpus fibulae*) eshte shume i holle dhe ka margot, anteriore (*margo anterior*), posteriore (*margo posterior*) dhe interosea (*margo interosseus*). Skaji distal ka maleolusin lateral (*malleolus lateralis*) me faqen e tij artikulare (*facies articularis malleoli lateralis*).

■ **Tarset** (*ossa tarsi*) ndahen ne grupin posterior dhe grupin anterior. Ne grupin posterior bejne pjese talusi (*talus*) e kalkaneusi (*calcaneus*). Ne grupin anterior bejne pjese kocka kuboide (*os cuboideum*), kocka navikulare (*os naviculare*) dhe bejne pjese kocka kuboide (*os calcaneum*).

tre kockat kuneiforme (*os cuneiforme mediale, intermedium e laterale*). Talusi ka ne pjesen e siperme troklean (*trochlea tali*) qe futet midis maleolusit medial te tibias e maleolusit lateral te fibules. Kalkaneusi eshte me i madhi nga tarset, ne pjesen e pasme ai ka nje te ngritur qe formon thembren (*tuber calcanei*).

Edhe tarset (ashtu si karpet) nuk vendosen ne nje plan te sheshte, por formojne dy harqe me konkavitet nga siper, nje transversal e nje longitudinal. Roli i tyre eshte absorbimi dhe shperndarja e forcave.

■ **Metatarsi** (*ossa metatarsi*) jane pese, ne njerien ane ata artikulojne me tarset dhe ne anen tjeter me falangjet. Çdo metatars ka bazen (*basis ossis metatarsi*), trupin (*corpus ossis metatarsi*) e koken (*caput ossis metatarsi*).

■ **Falangjet** (*phalanges*) jane tre per secilin gisht, perveç te parit qe ka dy. Ata emertoohen **falangu** proksimal (*phalanx proximalis*), falangu i mesem (*phalanx media*) dhe falangu distal (*phalanx distalis*). Ashtu si dhe metatarsi, çdo falang ka bazen (*basis phalangis*), trupin (*corpus phalangis*) e koken (*caput phalangis*).

#### Fakte klinike

##### *Frakturat e pelvisit*

Frakturat e kockave pelvike mund te jene te tipeve te ndryshme. Ato mund te prekin acetabulumin ose jo; po ashtu mund te jene unilaterale ose bilaterale. Gjate tyre nuk duhet negliguar asnjehere mundesia e demtimit te organeve pelvike dhe mundesia e humbjeve te konsiderueshme te gjakut me formim ose jo te hematomave.

##### *Frakturat e femurit*

Ne skajin proksimal te femurit mund te ndodhin frakturna te qafes ose frakturna intertrokanterike.

Frakturat e qafes shpesh shoqerohen me demtime te vazave qe e vaskularizojne ate dhe kjo pasohet nga nekroza te kokes se femurit. Ne keto raste ajo mund te zevendesohet me proteze.

Frakturat intertrokanterike (linja e frakturnes kalon ne dy trokanterat) nuk shoqerohen me nekroze te kokes se femurit dhe imobilizimi i fragmenteve kockore zakonisht behet duke i fiksuar ato me vira ne nje pllake metalike.

## 3. SISTEMI ARTIKULAR

### Lidhjet e skeletit te kokes

#### Lidhjet e kolones vertebrare

#### Lidhjet e skeletit te toraksit

#### Lidhjet e skeletit te gjymtyres se siperme

#### Lidhjet e skeletit te gjymtyres se poshtme

**Sistemi artikular** (*systema articulare*) perfshin **lidhjet midis kockave (juncturae ossium)**; keto lidhje u sigurojne atyre qendrueshmerine ose levizshmerine.

Lidhjet kockore Jane te tipit te sinartrozes ose te lidhjes solide dhe te tipit te diartrozes ose te lidhjes (josolide) sinoviale.

**Sinartroza** (*synarthrosis*) eshte bashkim i panderprera midis kockave, prahapesira midis tyre eshte e mbushur me nje ind bashkues. Ne sinartrozat predominojn qendrueshmeria ndaj levizshmerise. Ne varesi nga indi qe bashkon kockat, ka disa lloje sinartrozash. Kur indi bashkues eshte ind lidhor lidhja quhet fibroze, kur indi eshte kartilaginoz. Lidhja quhet kartilaginoze dhe kur indi eshte kockor lidhja quhet kockore.

■ **Lidhjet fibroze** (*junctura fibrosa*) Jane te tipit te sindesmozes, te sutures dhe te gomfozes.

**Sindesmoza** (*syndesmosis*) Jane lidhjet midis kockave me ane te ligamenteve (*ligamentum*) ose membranave nderkockore (*membrana interossea*). Te tilla Jane perkatesisht lidhjet midis harqeve vertebrare dhe lidhjet midis radiusit e ulnes ne parakrah ose tibias e fibules ne kerci.

**Suturat (sutura)** jane lidhjet midis kockave me ane te indit lidhor. Ato gjenden vetem ne kranium. Ne varesi te formes se buzeve kockore suturat jane te sheshta (*sutura plana*), skuamoze (*sutura squamosa*), serrate (*sutura serrata*) ose dentate (*sutura denticulata*).

**Gomfoza (gomphosis)** ndodh kur njeri kocke futet si ne fole ne kocken tjeter. Shembulli i vetem eshte lidhja e dhembive me alveolat.

■ **Lidhjet kartilaginoze (junctura cartilaginea)** jane te tipit te sinkondrozes ose te simfizës.

*qetësia kësaj lidhje është e fortë që gjithësin shërbehet*  
**Sinkondroza (synchondrosis)** ndodh kur dy qendra osifikimi ne nje kocke ne rritje imbesin te ndara nga nje shtrese indi kartilaginoz. E tille eshte "zona e rritjes" ne kufirin midis skajeve dhe trupit ne kockat e gjata. Me kalimin e kohes mund te ndodhe osifikimi i saj dhe lidhja kthehet ne sinostoze.

**Simfiza (sympysis)** ndodh kur dy kocka te veçanta bashkohen me ind kartilaginoz. Veçori e saj eshte mundesa e kryerjes se levizjeve minimale midis kockave. Topografikisht lidhje te tillë gjenden ne linjen mediane te trupit; shembuj Jane simfiza pubike dhe lidhjet e trupave vertebruale nepermjet disqeve intervertebrale.

■ **Lidhjet kockore (junctura ossea) ose sinostozat (sinostosis)** ndodhin ne vazhdim te nje sinkondroze pas osifikimit te zones se rritjes ose ne vazhdim te nje simfize pas osifikimit te indit kartilaginoz midis kockave, siç ndodh psh. me vertebrat sakrale.

**Diarthroza (diarthrosis)** ose **artikulacioni (articulatio)** ose **lidhja sinoviale (junctura sinovialis)** eshte bashkim i nderprere midis kockave, pra nuk ka ind qe te mbushe hapesirend midis tyre. Ne artikulacionet predomion levizheria ndaj qendrueshmerise.

**Elementet perberes** te nje artikulacioni Jane siperfaqet artikulare, kapsula artikulare, hapesira artikulare dhe ligamentet.

1. ■ **Siperfaqjet artikulare (facies articularis)** Jane pjeset e siperfaqeve qe kockat angazhojne ne artikulacion; ato mund te jene pjesa e foses artikulare (*fossa articularis*), kokes artikulare (*caput articulare*) etj. Siperfaqet artikulare vishen me ind kartilaginoz per te pakesuar forcat e ferkimit gjate levizjes.

Siperfaqet artikulare mund te jene te perputhshme ne madhesi (kongruente), por zakonishet ato Jane jo te perputhshme (inkongruente). Inkongruencia e tyre mund te rregullohet me ane te labrumit, diskut ose meniskut artikular.

Labrumi artikular (*labrum articulare*) eshte brez kartilaginoz qe vendoset rrith foses artikulare duke e thelluar ate.

**Disku artikular (discus articularis)** vendoset midis siperfaqeve artikulare; njera faqe e diskut eshte kongruente me njeri siperfaqe artikulare, ndersa faqja tjeter kongruente me siperfaqen tjeter artikulare.

Menisku (*meniscus articularis*) eshte nje disk jo i plete dhe ka zakonish forme gjysëmhere.

Disku artikular dhe menisku artikular, perveçse irregullojne kongruencen e siperfaqeve artikulare, sherbejnë edhe si amortizues te goditjeve dhe mund te sherbejnë edhe si struktura funksionale ne artikulacion.

2. ■ **Kapsula artikulare (capsula articularis)** zakonishet fiksohet ne buzet e siperfaqeve artikulare. Ajo ka dy shtresa, nje te jashtme fibroze (*stratum fibrose*), qe i jep kapsules qendrueshmerine dhe nje te brendshme sinoviale (*stratum synoviale*) qe eshte shume e vaskularizuar dhe prodhon lengun sinovial (*sinovia*). Shtresa sinoviale, gjithashtu formon ne hapesirend artikulare plikat sinoviale (*plicae synoviales*), si dhe vesh ligamentet intraartikulare. Nganjehere, ajo del pertej shtreses fibroze ne formen e nje qeseje te mbyllur, duke formuar bursa sinoviale (*bursa sinovialis*).

3. ■ **Hapesira artikulare (cavitas articularis)** eshte nje hapesire e mbyllur ne te cilën gjendet nje sasi e paket lengu sinovial. Ne hapesirend artikulare gjithashtu gjendet labrumi, disku ose menisku artikular si dhe ligamentet intraartikulare.

4. ■ **Ligamentet (ligamenta)** Jane element i rendesishem ne funksionin e nje artikulacioni. Ligamentet Jane intrakapsulare (ligg. *intracapsularia*), kapsulare (ligg. *capsularia*) dhe ekstrakapsulare (ligg. *extracapsularia*). Ligamentet kapsulare formohen nga trashja e shtreses fibroze te kapsules, ndersa ligamentet e tjere Jane te veçuar nga kapsula. Ligamentet intrakapsulare gjenden ne hapesirend artikulare, ndersa ligamentet ekstrakapsulare gjenden jashtë saj. Funksioni i ligamenteve eshte te kontrollojne amplituden e levizjeve ne artikulacion duke penguar tejkalimin e tyre. Sa me shume ligamente te kete nje artikulacion, aq me te kontrolluara (kufizuara) Jane levizjet ne te dhe aq me i qendrueshem eshte artikulacioni. Ne te kundert, sa me pak ligamente te kete nje artikulacion, aq me pak te kontrolluara (kufizuara) Jane levizjet ne te dhe aq me pak i qendrueshem eshte artikulacioni.

**Klasifikimi** i artikulacioneve mund te behet sipas kriterieve te ndryshem.

5. ■ **Sipas numrit te siperfaqeve artikulare**, artikulacionet ndahen ne te thjeshte ose te perbere. Nese ne artikulacion marrin pjesë vetem dy siperfaqe artikulare ai eshte i thjeshte (*articulatio simplex*), nese marrin pjesë me teper se dy artikulacioni eshte i perbere (*articulatio composita*). Nese artikulacioni ka disk artikular ose menisk artikular ai konsiderohet i perbere.

**Sipas numrit te boshteve te levizjeve** qe mund te kryhen ne to, artikulacionet ndahen ne artikulacione me nje bosht, me dy boshte dhe me shume boshte. Keto levizje mund te kryhen perkatesisht ne nje plan, ne dy plane dhe ne shume plane.

**Sipas formes** se siperfaqeve artikulare (ky eshte klasifikimi me i zakonshem) artikulacionet mund te jene te sheshta, cilindrike, selare, kondilare, bikondilare ose sferike.

**Artikulacionet e sheshta** (*articulatio plana*) kane siperfaqe artikulare pak a shume te sheshta, dhe levizje shkarese. Te tilla jane artikulacionet intermetatarsale.

**Artikulacionet cilindrike** (*articulatio cylindrica*) kane siperfaqe artikulare cilindrike dhe levizjet qe kryhen ne to janë rrëth nje boshti (boshtit te cilindrit). Keto artikulacione mund te jene te tipit ginglimal (*ginglymus*) ose te tipit trokoid (*articulatio trochoidea*). Artikulacionet ginglimale ose si menteshe zakonisht kane ligamente kolaterale te fuqishem, qe lejojne levizjen vetem ne nje plan. I tille eshte artikulacioni humeroulnar. Artikulacionet trokoide kane nje cilinder kockor dhe nje unaze osteoligamentoze qe shterngohet pas cilindrit. Ne keto artikulacione mund te rrotullohet cilindri kockor ose unaza, siç ndodh perkatesisht ne artikulacionet radioulnare dhe ne artikulacionin atlantoaksial median (midis atlastit dhe dhembit te aksit).

**Artikulacionet selare** (*articulatio sellaris*) kane siperfaqe artikulare me formen e shales, pra konkave ne nje drejtim dhe konvekse ne drejtimin perpendikular me te parin. Levizjet qe kryhen jane ne dy boshte. I tille eshte artikulacioni karpometakarpal i gishtit te pare.

**Artikulacionet kondilare ose elipsoide** (*articulatio ellipsoidea*) kane siperfaqe artikulare ne forme elipsi, pra njera eshte ovale konvekse dhe tjetra ovale konkave. Levizjet qe kryhen jane ne dy boshte. I tille eshte artikulacioni radiokarpal. (Zërejt qe është përfshirë që është grava),

**Artikulacionet bikondilare** (*articulatio bicondylaris*) kane dy kondile me siperfaqe artikulare konvekse qe artikulojnë me dy siperfaqe konkave. Levizjet qe kryhen jane kryesisht ne nje bosht, por edhe nje rotacion i vogel eshte i mundshem.

**Artikulacionet sferike** (*articulatio spheroidea*) kane siperfaqe artikulare ne forme sfere. Levizjet kryhen ne shume boshte. Artikulacioni skapulohumeral dhe artikulacioni koksofemoral jane te tille.

Levizjet ne artikulacion realizohen sipas boshteve.

**Sipas boshtit transversal** kryhen fleksioni (*flexio*) dhe ekstensioni (*extensio*).

**Kes Jane boshtet qe te der hezit nje akt?**

1. Sipas boshtit sagital kryhen adukzioni (*adductio*) dhe abduksioni (*abductio*).

2. Sipas boshtit vertikal kryhen rotacioni intern (*rotatio interna*) dhe rotacioni ekstern (*rotatio externa*).

3. Sipas te tre boshteve njekohesisht kryhet cirkumduksioni (*circumductio*), qe eshte kombinim i levizjeve te mesiperme dhe ndodh kur nje kocke e gjate rrotullohet sipas siperfaques se nje koni.

### Fakte klinike

#### Luksacionet

Luksacioni ndodh kur siperfaqet artikulare ne nje artikulacion zhvendosen duke mos patur me kontakt me njera tjeteren.

Shkaku i luksacioneve eshte tejkalimi i menjehershem i amplitudes normale te levizjeve ne artikulacion duke imposhtur rezistencen e ligamenteve, muskujve e kapsules artikulare. Si pasoje, pothuajse gjithmone ka demtim te ligamenteve gjate nje luksacioni.

Rivendosja e kockave ne pozicionin e tyre normal pas nje luksacioni zakonisht kerkon nje manipulim fizik, qe duhet kryer nga nje specialist.

Artikulacionet ku ndodhin me shpesh luksacione jane artikulacioni skapulohumeral, artikulacioni radiokarpal dhe ato intefalangeale.

#### Artriti

Artriti nenkupton nje gjendje inflamatore ne artikulacion. Ai mund te kete natyre autoimune (artriti reumatoid) ose septike.

Artriti gjithmone shoqerohet me dhimbje; veç saj mund te kete enjtje ne artikulacion. shtim te sasise se lengut sinovial etj.

#### Artroza

Artroza (ose edhe osteoartriti) nenkupton nje gjendje degenerative ne artikulacion, si qe ka ne baze te saj demtimin e indit kartilaginoz qe vesh siperfaqet artikulare; si pasoje siperfaqet kockore nen to janë me pak te mbrojtura dhe i nenshtrohen ndryshimeve jo normale morfollogjike. Meqenese regjenerimi i kartilagove nuk eshte i mundur, nuk ka edhe mjekim specifik per arrozat.

Shenje e nje artroze eshte dhimbja kronike qe redukton levizherine ne artikulacion; dhimbja shpeshi shtohet kur moti eshte me lageshtire.

Me shpesh ndryshimeve artrozike i nenshtrohen artikulacionet ku transmetohen peshat me te medha: artikulacionet intervertebrale ne pjesen lumbar te kolones vertebruale, artikulacioni koksofemoral dhe artikulacioni i gjirit.

#### Bursiti

Bursiti eshte inflamacioni i burses sinoviale. Levizjet e tendineve dhe muskujve mbi bursat e inflamuara e shtojne inflamacionin e tyre.

Bursitet shkaktohen nga levizjet e perseritura per nje kohe te gjate ose traumat.

Dhimbja gjate dhe pas aktivitetit fizik eshte shenja kryesore.

Bursitet me te shpeshta i takojne artikulacionit skapulohumeral, artikulacionit te te brryli dhe atij te gjurit.

#### Radiografia

Radiografia eshte zakonishët ekzaminimi i pare qe kerkohet per vleresimin e gjendjes se nje artikulacioni. Ajo mund te behet ne pozicione te ndryshme te artikulacionit per te bere nje vleresim sa me te plete. Ne radiografi eshte i dukshem indi kockor, ndersa indet e buta jo. Per kete aresye ajo indikohet kryesisht ne rastet e ndryshimeve degenerative ne artikulacion (vleresohen siperfaqet kockore, hapesira artikulare), si dhe ne frakturne, tumore te kockes etj.

#### Artroskopia

Artroskopia nenkupton ekzaminimin fizik te hapesires artikulare dhe formacioneve anatomike qe gjenden ne te. Ajo realizohet nepermjet artroskopit, i cili futet ne hapesireni artikulare pas nje incizioni te vogel ne lekure. Nepermjet artroskopise vleresohet gjendja e siperfaqeve artikulare, disqeve ose menisqeve dhe ligamenteve intraartikulare si dhe mund te realizohen procedura trajtimi.

Artroskopia, duke eliminuar kirurgjine e hapur ne artikulacione dhe duke gene me pak traumatike sea ajo siguron shanse me te medha suksesi dhe kohe sherimi me te shkurter.

#### Rezonanca magnetike

Rezonanca magnetike eshte ekzaminim i shpeshte per diagnostikimin e patologjive artikulare, meqe siguron imazhe te qarta te indeve te buta qe gjenden ne nje artikulacion (kartilago, disk, menisk, ligament dhe kockave). Ajo perdoret gjeresisht ne diagnostikimin e demitimeve traumatike sidomos ne sportistet, por gjithashtu edhe ne patologjite inflamatore ose degenerative artikulare.

## LIDHJET E SKELETIT TE KOKES

**Lidhjet e skeletit te kokes** (*juncturae crani*) jane te tipit te sinartrozave (lidhjeve solide) dhe te tipit te diartrozave (artikulacione, lidhjeve sinoviale).

**Sinartrozat** jane te te tre tipeve, pra te lidhjeve fibroze (pergjithesisht sutura e gomfoza), te lidhjeve kartilaginoze dhe te lidhjeve kockore.

\* **Sutura** jane pjesa me e madhe e lidhjeve midis kockave ne kranium.

Sutura koronale (*sutura coronalis*) gjendet midis kockes frontale dhe dy kockave parietale.

Sutura sagitale (*sutura sagittalis*) gjendet midis dy kockave parietale.

Sutura lambdoidea (*sutura lambdoidea*) gjendet midis kockes oksipitale dhe dy kockave parietale.

Sutura skuamoze (*sutura squamosa*) gjendet midis kockes parietale dhe kockes temporale.

\* **Gomfoza** jane lidhjet midis dhembve dhe alveolave.

\* **Sinkondroze** (e perkohshme) ne kranium eshte sinkondroza sfenooksipitale (*synchondrosis sphenooccipitalis*), midis pjeses bazilare te kockes oksipitale dhe trupit te kockes sfenoidale.

\* **Sinostoze** ne kranium behet sinkondoza e perkohshme sfenooksipitale.

**Diarthroza** ne kranium jane artikulacionet temporomandibulare.

\* **Artikulacioni temporomandibular** (*articulatio temporomandibularis*) realizohet midis kockes temporale qe angazhon si siperfaqe artikulare fosen mandibulare e eminencen artikulare dhe mandibules, kondili i se ciles ka nje siperfaqe artikulare.

Siperfaqet jane inkongruente dhe midis tyre gjendet nje disk artikular.

Kapsula artikulare ka formen e nje hinke.

Hapesira artikulare ndahet nga disku artikular ne nje kat te siperm dhe nje kat te poshtem.

Ligamente kapsulare jane ligamenti medial (*lig. mediale*) dhe ligamenti lateral (*lig. laterale*), qe lidhin ne secilen ane diskun me kapsulen. Ligamente ekstrakapsulare jane ligamenti sfenomandibular (*lig. sphenomandibulare*) dhe ligamenti stiromandibular (*lig. stylomandibulare*).

Artikulacioni eshte i tipit (bi)kondilar dhe levizjet kryhen rrerh tre boshteve.

## LIDHJET E KOLONES VERTEBRALE

**Lidhjet e kolones vertebrale** (*juncturae columnae vertebralis*) realizohen midis te gjithe elementeve perberes te vertebrave, pra midis trupave te tyre, midis harqeve dhe midis proceseve perkates. Veç lidhjeve tipike ne kolone jane edhe lidhjet jotipike kraniovertebrale (kranium – C1 – C2).

\* **Midis trupave vertebrale** gjenden disqet intervertebrale (*discus intervertebralis*), qe realizojne lidhje kartilaginoze te tipit te simfizes (*sympysis intervertebralis*). Gjithashtu midis trupave vertebrale gjenden edhe lig. longitudinal anterior (*lig. longitudinale anterius*) dhe lig. longitudinal posterior (*lig. longitudinale posterius*), qe realizojne lidhje fibroze te tipit te sindesmozes.

**Disku intervertebral** vendoset midis faqeve intervertebrale te trupave vertebrale. Perjashtim bejne atlasi dhe aksi, meqe vertebra e dyte nuk ka trup. Nderkohe ne

vertebrat sakrale ndodh kockezimi i diskut intervertebral dhe lidhja midis trupave te tyre kthehet ne sinostoze.

Disku intervertebral perbehet nga pjesa qendrore, **berthama ose nukleusi pulpoz** (*nucleus pulposus*) dhe pjesa periferike, anulus fibroz (*anulus fibrosus*). Trashesia e diskut intervertebral vjen duke u rritur ne pjeset e poshtme te kolones vertebrale dhe arrin maksimumin midis vertebrave lumbare.

**Lig. longitudinal anterior** fillon ne buzen anteriore te foramen magnum, zbret duke u atashuar ne harkun anterior te atlasit, me poshte vazhdon perpara trupave vertebrale e disqeve intervertebrale deri ne trupat e vertebrave sakrale dhe perfundon ne koksiks.

**Lig. longitudinal posterior** fillon ne siperfaqen e pasme te trupit te aksit dhe zbret prapa trupave vertebrale e disqeve intervertebrale deri ne trupat e vertebrave sakrale dhe perfundon ne koksiks.

■ **Midis harqeve vertebrale** gjenden ligg. flave (*ligg. flava*), qe realizojne lidhje fibroze te tipit te sindesmozes. Ato jane me ngjyre te verdhe dhe shume elastike.

■ **Midis proceseve spinoze** gjenden ligg. interspinale (*ligg. interspinalia*) dhe ligg. supraspinal (*lig. supraspinale*), qe realizojne lidhje fibroze te tipit te sindesmozes.

**Ligg. interspinale** vendosen midis proceseve spinoze fqinje, perpara ato nderthuren me ligg. flave dhe prapa me ligg. supraspinal.

**Lig. supraspinal** kalon mbi majat e proceseve spinoze nga vertebra C7 deri ne sakrum. Vazhdimi i ketij ligamenti mbi vertebren C7 deri ne kranium quhet lig. nukal (*lig. nuchae*); ai ka formen e nje pllake pak a shume trekendeshe me buzen e pasme midis procesit spinoz te C7 dhe protuberances oksipitale eksterne te kockes oksipitale. Perpara lig. nukal kalon mbi majen e proceseve spinoze te vertebrave cervikale, mbi tuberkulum posterior te atlasit, pastaj kalon siper ne buzen posteriore te foramen magnum dhe ne faqen e jashtme te skuames oksipitale deri ne protuberancen oksipitale eksterne.

■ **Midis proceseve transversale** fqinje gjenden ligg. intertransversale (*ligg. intertransversaria*).

**Ligg. intertransversale** realizojne lidhje fibroze te tipit te sindesmozes.

■ **Midis proceseve artikulare** fqinje realizohen artikacionet intervertebrale ose zagapofizeale (*articulationes zagapophyseale*).

**Artikacionet intervertebrale** kane siperfaqe artikulare te vogla dhe pak a shume te sheshta.

Kapsula artikulare fiksohet ne buzet e siperfaqeve artikulare.

Hapesira artikulare eshte e vogel.

Ligamente perforues jane ata te kolones vertebrale, te permendur me siper. Levizjet qe kryhen ne keto artikulacione jane shkarese dhe me amplitude minimale.

**Artikacionet kraniovertebrale** jane artikulacione te vecante ne kolonen vertebrale. Ato perfshijnë lidhjet midis atlasit e aksit dhe lidhjet midis atlasit e kockes oksipitale dhe mund te konsiderohen si nje unitet funksional qe lejon amplituden me te madhe te levizjeve ne te gjithe skeletin aksial.

■ **Artikacionet atlantooaksiale** realizohen midis atlasit dhe aksit. Ata jane tre, nje median dhe dy laterale.

**Artikacioni atlantooaksial median** (*articulatio atlantoaxialis mediana*) realizohet midis dhembit te aksit dhe harkut anterior te atlasit.

Siperfaqet artikulare jane perkatesisht fovea dentis ne faqen posteriore te harkut anterior te atlasit dhe faqja artikulare anteriore e dhembit.

Kapsula artikulare eshte e dobet. Hapesira artikulare eshte e vogel.

Ligamentet qe perforcojne artikacionin jane disa. Lig. apikal (*lig. apicis dentis*) shkon nga maja e dhembit ne buzen e perparme te foramen magnum. Ligg. alare (*ligg. alaria*) shkojne anash lig. apikal, nga dy anet e dhembit ne kocken oksipitale. Lig. transversal (*lig. transversum atlantis*) kapet ne dy masat laterale te atlasit dhe rrrethon dhembin nga prapa. Artikacioni eshte i tipit cilindrik.

**Artikacionet atlantooaksiale laterale** (*articulatio atlantoaxialis lateralis*) realizohen midis faqeve artikulare inferiore te masave laterale te atlasit dhe faqeve artikulare perkatese te aksit.

Kapsula artikulare eshte e dobet. Hapesira artikulare eshte e vogel.

Ligamentet perforues jane ligamenti longitudinal anterior perpara dhe ligamenti flav prapa.

Artikacionet konsiderohen te sheshte.

■ **Artikacionet atlantookspitale** (*articulatio atlantooccipitalis*), ne secilen ane, realizohen midis kockes oksipitale, qe angazhon ne artikulacion kondilin me siperfaqen e tij artikulare dhe atlasit, qe angazhon faqet artikulare superiore te masave laterale.

Kapsula artikulare kapet ne buzet e siperfaqeve artikulare. Hapesira artikulare eshte e vogel.

Rolin e ligamenteve e kryejne membrana atlantookspitale anteriore (*membrana atlantooccipitalis anterior*) e membrana atlantookspitale posteriore (*membrana atlantooccipitalis posterior*). Membrana atlantookspitale anteriore fiksohet siper ne buzen anteriore te foramen magnum dhe poshte ne harkun anterior te atlasit; ajo perforcohet nga lig. longitudinal anterior. Membrana atlantookspitale posteriore fiksohet siper ne buzen posteriore te foramen magnum dhe poshte ne harkun posterior te atlasit; ajo mund te konsiderohet si vazhdim i ligg. flave.

Artikulacioni eshte i tipit (bi)kondilar dhe ne te kryhen levizje rreth dy boshteve.

#### Fakte klinike

##### Herniet diskale

Disku intervertebral formohet nga pjesa qendrore, nukleusi pulpoz, dhe pjesa periferike, anulusi fibroz. Ky i fundit perbehet nga unaza fibroze qe mbajne te shternguar, nen presion, nukleusin pulpoz. Ne rrethana te ndryshme mund te ndodhin çarje ne keto unaza nepermjet te cilave materiali i nukleusit (nen presion) te dale dhe te arrije deri ne kanalin vertebral ose foramen intervertebrale, duke shtypur struktura nervore qe gjenden ne to. Ne varesi te strukturave qe shtypen hernia diskale mund te shoqerohet me dhimbje mesi qe mund te perhapet psh. ne pjesen e pasme te kofshes, kercirit ej.

##### Dhimbja e mesit

Dhimbja e mesit eshte nje ankesa e shpeshte ne praktiken mjekesore. Nqs shkak i saj eshte hernia diskale, trajtimi mund te shkoje deri ne nderhyrje kirurgjikale. Here te tjera shkak mund te jene ndryshimet degenerative ne artikulacionet intervertebrale; ne keto raste trajtimi mund te shkoje deri ne injektimin ne hapesiren artikulare te substancave anestetike e antiinflamatore.

## LIDHJET E SKELETIT TE TORAKSIT

Lidhjet e skeletit te toraksit (*juncturae thoracis*) realizohen midis brinjeve me sternumin nga njera ane dhe me vertebrat nga ana tjeter.

**Lidhja e brinjeve me sternumin** behet nepermjet artikulacioneve sternokostale (*articulationes sternocostales*). Kjo lidhje vlen vetem per brinjet e verteta (1-7) ku kartilagoja kostale futet ne incizuren kostale te sternumit.

\* **Artikulacionet sternokostale** ne fakt nuk jane tipike. Ne to mund te mungoje hapesira artikulare. Kapsula artikulare eshte e holle. Ligamentet perfocues jane intraartikulare dhe ekstraartikulare. Lig. intraartikular eshte lig. sternokostal intraartikular (*lig. sternocostale intraarticulare*), ndersa ekstraartikulare jane ligamentet sternokostale radiate (*ligg. sternocostalia radiata*), qe perhapen si rreze, perpara dhe prapa, nga kartilagoja kostale drejt sternumit.

Levizjet ne keta artikulacione jane shkarese dhe minimale.

Brinjet e rreme 8-10 lidhen me njera tjetren me ane te kartilagove kostale te tyre, ndersa kartilagoja e brinjes 8 lidhet edhe me ate te brinjes 7.

**Lidhja e brinjeve me vertebrat** (*articulationes costovertebrales*) perfshin artikulacionin e kokes se brinjes (*articulatio capitis costae*) dhe artikulacionin kostotransversal (*articulatio costotransversaria*).

\* **Artikulacioni i kokes se brinjes** realizohet midis siperfaqes artikulare te saj dhe foveas kostale superiore e foveas kostale inferiore te trupave te dy vertebrave fqinje, qe se bashku formojne nje grope te plete. Kapsula artikulare fiksohet ne buzet e siperfaqeve artikulare. Ligamentet qe perfocojne artikulacionin jane intraartikulare dhe ekstraartikulare. Lig. intraartikular eshte lig. intraartikular i kokes se brinjes (*lig. capitis capitis costae intraarticulare*), ndersa ekstraartikular eshte lig. radiat i kokes se brinjes (*lig. capitis costae radiatum*), qe perhapet si rreze perpara nga koka e brinjes ne trupat vertebrale.

\* **Artikulacioni kostotransversal** realizohet midis siperfaqes artikulare te tuberkulumit kostal te brinjes dhe foveas kostale te procesit transversal te vertebres. Ky artikulacion mungon ne brinjet flaktuante. Kapsula artikulare fiksohet ne buzet e siperfaqeve artikulare. Ligamentet qe perfocojne artikulacionin lidhin qafen e brinjes me procesin transversal te te njejtit nivel: lig. kostotransversal (*lig. costotransversarium*) ose me procesin transversal nje nivel me siper: lig. kostotransversal superior (*lig. costotransversarium superiorius*).

Levizjet ne artikulacionet e mesiperme jane te vogla; ato lejojne rrullimin e brinjeve rreth boshtit gjatesor te skajit posterior te tyre, qe shoqerohet me uljen ose ngritjen e skajit anterior. Kjo çon ne ulje ose rritje te volumit te hapesires torakale (njekohesish zvogelim ose rritje te kendit infrasternal).

## LIDHJET E SKELETIT TE GJYMTYRES SE SIPERME

**Lidhjet e skeletit te gjymtyres se siperme** (*juncturae membra superioris*) perfshijne lidhjet e rrerit te gjymtyres se siperme ose rrerit pektoral dhe lidhjet e pjeses se lire te gjymtyres.

**Lidhjet e rrerit te gjymtyres se siperme** ose rrerit pektoral (*juncturae cinguli pectoralis*) perfshijne lidhjen e klavikules me sternumin dhe lidhjen e klavikules me akromionin (e skapules). Keto lidhje jane artikulacione.

\* **Artikulacioni sternoklavikular** (*articulatio sternoclavicularis*) realizohet midis ekstremitetit sternal te klavikules dhe incizures klavikulare te sternumit.

Midis faqeve artikulare jo kongruente ka disk artikular. Kapsula artikulare eshte e holle. Ligamentet perforues vendosen perpara, prapa, siper e poshte artikulacionit. Perpara gjendet lig. sternoklavikular anterior (*lig. sternoclaviculare posterior*), prapa lig. sternoklavikular posterior (*lig. sternoclaviculare posterior*), poshte lig. kostoklavikular (*lig. costoclaviculare*) dhe siper lig. interklavikular (*lig. interclaviculare*).

Artikulacioni sternoklavikular eshte i tipit selar dhe levizjet ne te jane minimale.

■ **Artikulacioni akromioklavikular** (*articulatio acromioclavicularis*) realizohet midis ekstermitetit akromial te klavikules dhe akromionit. Midis faqeve artikulare ka disk artikular. Kapsula artikulare eshte e holle. Ligamentet perforues lidhin klavikulen me akromionin dhe klavikulen me procesin korakoid. Midis klavikules dhe akromionit gjendet lig. akromioklavikular (*lig. acromioclaviculare*). Midis klavikules dhe procesit korakoid gjendet lig. korakoklavikular (*lig. coracoclaviculare*), qe perbehet nga dy pjesë, medialisht eshte lig. konoid (*lig. conoideum*) dhe lateralisht lig. trapezoid (*lig. trapezoideum*).

Levizjet ne kete artikulacion janë minimale.

**Lidhjet e pjeses se lire te gjymtyres se siperme** (*juncturae membra superioris liberi*) janë artikulacioni skapulohumeral, artikulacioni i brrylit, artikulacioni radioulnar distal si dhe artikulacionet e dores. Ne kete grup futet edhe lidhja me membrane nderkockore e radiusit me ulnen.

■ **Artikulacioni skapulohumeral** ose artikulacioni glenohumeral (*articulatio glenohumeralis*) realizohet midis kokes se humerusit dhe hapesires glenoidale ne kendin lateral te skapules. Siperfaqet artikulare jane jo kongruente, prandaj thellesia e gropes artikulare rregullohet me ane te labrumit glenoidal (*labrum glenoidale*). Kapsula artikulare kapet ne buzet e siperfaqeve artikulare. Ne hapesiret artikulare gjendet labrumi glenoidal si dhe kalon tendini i kokes se gjate te muskulit biceps brakial. Artikulacioni perforcohet nga lig. korakohumeral dhe ligg. glenohumerale. Lig. korakohumeral (*lig. coracohumeral*) shkon nga procesi korakoid ne humerus. Ligg. glenohumerale (*ligg. glenohumeralia*) janë tre, i siperri, i mesmi dhe i poshtmi; ato kafen ne buzen anteriore te hapesires glenoidale, kalojne perpara artikulacionit e perfundojne ne humerus.

Artikulacioni skapulohumeral eshte i tipit sferik dhe levizjet qe kryhen ne te jane fleksioni e ekstensioni, aduksioni e abduksioni, rotacioni intern e rotacioni ekstern dhe cirkumduksioni.

Ky artikulacion eshte me i paqendrueshmi i trupit te njeriut dhe luksacionet me te shpeshta ne te jane anteriore.

■ **Artikulacioni i brrylit** (*articulatio cubiti*) eshte artikulacion i perbere. Ne te marrin pjese tre kocka dhe perberesit e tij janë artikulacioni humeroradial, artikulacioni humeroulnar dhe artikulacioni radioulnar proksimal.

**Artikulacioni humeroradial** (*articulatio humeroradialis*) realizohet midis siperfaqeve artikulare te kapitulumit te humerusit dhe foveas artikulare te kokes se radiusit. Ai eshte i tipit sferik.

**Artikulacioni humeroulnar** (*articulatio humeroulnaris*) realizohet midis siperfaqeve artikulare te trokleas se humerusit dhe incizures troklaore te ulnes. Ai eshte i tipit cilindrik (ginglim).

**Artikulacioni radioulnar proksimal** (*articulatio radioulnaris proximalis*) realizohet midis cirkumferences artikulare te kokes se radiusit dhe siperfaqes perkatese artikulare ne skajin proksimal te ulnes. Ai eshte i tipit cilindrik.

Kapsula artikulare kapet ne buzet e siperfaqeve artikulare (duke perfshire pjesë te foses koronoide, foses radiale e foses se olekranit).

Ligamentet qe perforcojnë artikulacionin e brrylit janë lig. kolateral radial (*lig. collaterale radiale*) e lig. kolateral ulnar (*lig. collaterale ulnare*), qe perkatesisht lateralisht e medialisht, lidhin humerusin me radiusin e ulnen dhe lig. anular radial (*lig. anulare radii*), qe rrethon dhe shterngon cirkumferencen artikulare te radiusit rreth incizures radiale te ulnes.

Levizjet qe kryhen ne artikulacionin e brrylit janë fleksioni e ekstensioni dhe pronacioni e supinacioni.

■ **Sindesmoza radioulnare** (*syndesmosis radioulnaris*) eshte lidhja me membrane nderkockore (*membrana interossea antebrachii*) e radiusit me ulnen. Membrana fiksohet ne margot perkatese te dy kockave.

■ **Artikulacioni radioulnar distal** (*articulatio radioulnaris distalis*) realizohet midis cirkumferences artikulare te kokes se ulnes dhe incizures ulnare te radiusit. Pjese e artikulacionit eshte disku artikular, i cili ne fakt nuk vendoset ndermjet faqeve artikulare, por nen koken e ulnes duke ndare artikulacionin radioulnar distal nga artikulacioni radiokarpal. Ky disk ka forme trekendeshi me njerin kend ne procesin stiolid te ulnes. Artikulacioni radioulnar distal, si edhe ai proksimal, eshte i tipit cilindrik. Levizjet ne te jane ne sinkron me ato ne artikulacionin radioulnar proksimal dhe perfshijne pronacionin e supinacionin.

■ **Artikulacioni radiokarpal** (*articulatio radiocarpalis*) realizohet proksimalisht nga faqja artikulare per karpet e radiusit dhe nga disku artikular i artikulacionit radioulnar distal dhe distalisht nga karpet e rreshtit proksimal (perveç kockes piziforme). Kapsula artikulare kapet ne buzet e siperfaqeve artikulare.

Ligamentet qe perforcojnë artikulacionin vendosen perpara, prapa, medialisht dhe lateralisht tij. Perpara gjendet lig. radiokarpal palmar (*lig. radiocarpale palmar*)

dhe lig. ulnokarpal palmar (*lig. ulnocarpale palmarum*), prapa lig. radiokarpal dorsal (*lig. radiocarpale dorsale*) dhe lig. ulnokarpal dorsal (*lig. ulnocarpale dorsale*), medialisht lig. kolateral karpal ulnar (*lig. collaterale carpi ulnare*) dhe lateralish lig. kolateral karpal radial (*lig. collaterale carpi radiale*).

Artikulacioni radiokarpal eshte i tipit kondilar. Ne te kryhen fleksioni e ekstensioni si dhe adukzioni e abduksioni.

■ **Artikulacionet interkarpale** (*articulationes intercarpales*) realizohen midis karpeve fqinje.

■ **Artikulacionet karpometakarpale** (*articulationes carpometacarpales*) realizohen midis karpeve te rreshtit distal dhe metakarpeve.

■ **Artikulacionet metakarpofalangeale** (*articulationes metacarpophalangea*) realizohen midis metakarpeve dhe falangjeve proksimale.

■ **Artikulacionet interfalangeale** (*articulationes interphalangeae manus*) realizohen midis falangjeve proksimale e te mesem dhe falangjeve te mesem dhe falangjeve distale.

#### Fakte klinike

##### *Luksacioni i artikulacionit skapulohumeral*

*Luksacioni i artikulacionit skapulohumeral* eshte i shpeshte per shkak te amplitudes se madhe te levizjeve dhe qendrueshmerise se vogel te tij. Ne shumicen e rasteve koka e humerusit zhvendoset poshte perpara tuberkulumit infraglenoidal (*luksacion anterior*) dhe me rralle prapa tij (*luksacion posterior*).

*Luksacioni anterior* shkaktohet nga nje rotacion ekstern e ekstension i ekzagjeruar. Ai shoqerohet me pamundesi per te perdonur krahun (ai zakonisht mbahet me doren tjeter).

##### *Subluksacioni e luksacioni i kokes se radiusit*

*Subluksacioni e luksacioni i kokes se radiusit* ndodhi me shpesh tek femijet parashkollore, kur **femija terhiqet** (ngrihet) papritur nga dora ose parakrah, nderkohe qe ky eshte ne pronacion. Demtimi konsiston ne zhvendosjen distale te kokes se radiusit ndaj ligamentit anular, i cili edhe mund te rupturohet.

Femija refuzon te perdore parakrahun, i cili mbahet i fletkuar dhe ne pronacion.

## LIDHJET E SKELETIT TE GJYMTYRES SE POSHTME

**Lidhjet e skeletit te gjymtires se poshtme** (*juncturae membra inferioris*) perfshijnë lidhjet e rrethit te gjymtires se poshtme ose rrethit pelvik dhe lidhjet e pjeses se lire te gjymtires.

**Lidhjet e rrethit te gjymtires se poshtme** ose rrethit pelvik (*juncturae cinguli pelvici*) perfshijnë lidhjen e dy kockave pubike, qe eshte lidhje kartilaginoze e tipit te simfizes dhe lidhjen e iliumit me sakrumin, qe eshte artikulacion.

■ **Simfiza pubike** (*symphysis pubica*) realizohet midis faqeve simfiziale te dy kockave pubike. Midis tyre gjendet disku interpubik (*discus interpubicus*) dhe perfocimi i simfizes behet me lig. pubik superior (*lig. pubicum superius*) dhe lig. pubik inferior (*lig. pubicum inferius*).

■ **Artikulacioni sakroiliak** (*articulatio sacroiliaca*) realizohet midis faqes aurikulare te sakrumit dhe faqes aurikulare te iliumit.

Siperfaqet artikulare jane te çregullta, ne buzet e tyre kapet kapsula artikulare, ndersa hapesira artikulare mund te zhduket me kalimin e kohes.

Ligamentet perfocues gjenden midis sakrumit nga njera ane dhe iliumit e iskiumit nga ana tjeter.

Midis sakrumit e iliumit ndodhen lig. sakroiliak anterior (*lig. sacroiliacus anterior*), lig. sakroiliak nderkockor (*lig. sacroiliacus interosseum*) dhe lig. sakroiliak posterior (*lig. sacroiliacum posterius*).

Midis sakrumit dhe iliumit gjenden dy ligamente qe indirekt perfocojnë artikulacionin, lig. sakrospinal (*lig. sacrospinale*), qe perfundon ne spinen iskiadike dhe lig. sakrotuberal (*lig. sacrotuberale*), qe perfundon ne tuberin iskiadik. Keto dy ligamente kufizojne foramen iskiadike majore (*foramen ischiadicum majus*) dhe foramen iskiadike minore (*foramen ischiadicum minus*), perkatesisht mbi dhe nen spinen iskiadike.

Ne kete artikulacion behet kalimi i peshes se trupit ne gjymyret e poshtme, prandaj ai eshte artikulacioni me i qendrueshem i trupit.

**Lidhjet e pjeses se lire te gjymtires se poshtme** (*juncturae membra inferioris liberi*) jane artikulacioni koksofemoral, artikulacioni i gjurit, artikulacioni tibiofibular (proksimal) si dhe artikulacionet e kembes. Ne kete grup futet edhe lidhja me membrane e tibias me fibulen.

■ **Artikulacioni koksofemoral** (*articulatio coxofemoralis*) realizohet midis kokes se femurit dhe faqes lunate te acetabulumin. Siperfaqet artikulare jane jo kongruente, prandaj thellesia e gropes artikulare irregullohet me ane te labrumit acetabular (*labrum acetabuli*). Kapsula artikulare perfshin labrumin acetabular ne hapesiren artikulare. Ligamentet jane intrakapsulare, kapsulare dhe ekstrakapsulare.

Ligament intrakapsular eshte lig. i kokes femorale (*lig. capititis femoris*), i cili gjendet midis foveas se kokes femorale dhe foses acetabulare. Brenda tij kalon arteria qe vaskularizon koken e femurit prandaj roli i tij eshte me teper trofik se mekanik.

Si ligament kapsular konsiderohet zona orbikulare (*zona orbicularis*), qe rrrethon qafen e femurit.

Ligamentet ekstrakapsulare lidhin secilen nga kockat kokse me femurin; ata jane lig. iliofemoral (*lig. iliofemorale*), lig. iskiofemoral (*lig. ischiofemorale*) dhe lig. pubofemoral (*lig. pubofemorale*).

Artikulacioni koksofemoral eshte i tipit sferik dhe levizjet qe kryhen ne te jane fleksioni e ekstensioni, adukzioni e abduksioni, rotacioni intern e rotacioni ekstern dhe cirkumduksioni.

\* **Artikulacioni i gjurit** (*articulatio genus*) eshte artikulacioni me i madh i trupit te njeriut. Ai eshte artikulacion i perbere, ne te marrin pjesë tre kocka dhe perberesit e tij Jane artikulacioni patelofemoral dhe artikulacioni tibiofemoral.

**Artikulacioni patelofemoral** realizohet midis faqes posteriore artikulare te pateles dhe pjeses anteriore te faqeve artikulare te kondileve te femurit.

**Artikulacioni tibiofemoral** realizohet midis faqeve artikulare te kondileve te tibias dhe atyre te femurit. Siperfaqet artikulare Jane jo kongruente dhe dy menisqe artikulare irregullojne inkongruencen, menisku lateral (*meniscus lateralis*) dhe menisku medial (*meniscus medialis*).

Ligamentet ne artikulacionin e gjurit Jane intrakapsulare dhe ekstrakapsulare.

Ligamentet intrakapsulare Jane lig. transversal i gjurit dhe dy ligg. kruciate. Lig. transversal i gjurit (*lig. transversum genus*) bashkon nga perpara dy menisqet. Lig. kruciat anterior (*lig. cruciatum anterius*) fillon ne tibia ne arean interkondilare anteriore dhe perfundon ne fosen interkondilare ne femur. Lig. kruciat posterior (*lig. crucianum posterius*) fillon ne tibia ne arean interkondilare posteriore dhe perfundon gjithashtu ne fosen interkondilare ne femur. Dy ligamentet quhen kruciate, sepse kryqezohen ne planin median.

Ligamentet ekstrakapsulare Jane: medialisht lig. kolateral tibial (*lig. collaterale tibiale*), lateralisht lig. kolateral fibular (*lig. collaterale fibulare*), prapa dy ligg. popliteale, njeri oblik (*lig. popliteum obliquum*) e tjeteri arkuat (*lig. popliteum arcuatum*) dhe perpara lig. patellar (*lig. patellae*). Lig. patellar eshte vazhdimi i tendinit te muskulit kuadriceps femoral; ai shkon nga pjesa e poshtme e pateles ne tuberozitetin tibial.

Artikulacioni i gjurit eshte i tipit bikondilar. Levizjet qe kryhen Jane rrreth boshtit transversal, fleksion e ekstension, ndersa kur gjuri eshte gjysem i flektuar mund te behet dhe nje rotacion i lehte (intern e ekstern) rrreth boshtit vertikal.

\* **Artikulacioni tibiofibular** (*articulatio tibiofibularis*) realizohet midis siperfaqeve artikulare te kondilit lateral te tibias dhe te kokes se fibules.

\* **Sindesmoza tibiofibulare** (*syndesmosis tibiofibularis*) eshte lidhja e trupit te tibias me trupin e fibules me membrane nderkockore (*membrana interossea cruris*), qe fiksohet ne margot perkatese te dy kockave dhe e skajt distal te tibias me maleolin lateral te fibules me ligamentin tibiofibular anterior e ate posterior.

\* **Artikulacioni talokrural** (*articulatio talocruralis*) realizohet midis maleolosit medial (te tibias) dhe maleolosit lateral (te fibules), qe se bashku krijojnë një hapesire ku futet troklea e talusit. Kapsula artikulare kapet ne buzet e siperfaqeve artikulare.

Ligamentet qe perforkojne artikulacionin vendosen anash tij. Medialisht gjendet lig. kolateral medial (*lig. collaterale mediale*), qe meqë zgjerohet poshte ne formen e deltes quhet edhe ligamenti deltoid. Nga ai shkeputet një tufë qe vjen perpara si lig. tibiotalar anterior (*lig. tibiotalaris anterior*) dhe një tjeter qe shkon prapa si lig. tibiotalar posterior (*lig. tibiotalaris posterior*).

Lateralisht artikulacionit gjendet lig. kolateral lateral (*lig. collaterale laterale*), nga i cili gjithashtu shkeputen dy tufa, njera vjen perpara si lig. talofibular anterior (*lig. tibiofibulare anterius*) dhe tufa tjeter qe shkon prapa si lig. talofibular posterior (*lig. talofibulare posterius*).

\* **Artikulacionet intertarsale** realizohen midis tarseve fqinje.

\* **Artikulacionet tarsometatarsale** (*articulationes tarsometatarsales*) realizohen midis kockes kuboide e tre kockave kuneiforme dhe metatarseseve.

\* **Artikulacionet metatarsofalangeale** (*articulationes metatarsophalangae*) realizohen midis metatarseseve dhe falangjeve proksimale.

\* **Artikulacionet interfalangeale** (*articulationes interphalangeae pedis*) realizohen midis falangjeve proksimale e te mesem dhe falangjeve te mesem dhe falangjeve distale.

### Fakte klinike

#### Demtimet traumatike te artikulacionit te gjurit

Traumat e artikulacionit te gjurit shoqerohen shpesh me demtime te indeve te buta te tij. Me te shpeshta Jane rupturat e ligamenteve kruciate, rupturat e menisqeve dhe rupturat e ligamenteve kolaterale. Demtime te tillë mund te jene te veçanta, por me shpesh Jane te kombinuara.

*Ekzaminim fizik ne keto raste nenkupton edhe kryerjen e testeve te pagendrueshmerise.*

*Testi i "sirtarit" anterior realizohet duke e mbajtur gjurin te flektuar ne 90° nderkohe qe terhiqet perpara ekstremiteti anterior i tibias. Nqs tibia rrreshqet perpara ka rupture te ligamentit kruciat anterior.*

*Testi i "sirtarit" posterior realizohet ne te njejeten menyre, por duke e shtyre tibian. Nqs ajo rrreshqet prapa ka rupture te ligamentit kruciat posterior.*

*Demitimet degjenerative te artikulacionit te gjurit.*

*Nga artikulacionet e trupit te njeriut gjuri eshte ai qe mban peshen me te madhe, prandaj dhe me shpesh preket nga ndryshimet degjenerative. Ato ndodhin me shpesh tek femrat, me shpesh pas moshes 50 vjeç dhe me shpesh ne dy gjunjte njekohesisht. Gjuri paraqitet i enjtur dhe i dhimbshem, duke e bere te vesh tire ecjen si dhe ngjitjen e zbritjen ne shkalle. Renja ne peshe, ushtrimet fizike dhe mjekimi ndihmues ndihmojne pakesimin e shenjave klinike.*

## 4. SISTEMI MUSKULAR

**Muskujt e kokes**

**Muskujt e qafes**

**Muskujt e shpines**

**Muskujt e toraksit**

**Muskujt e abdomenit**

**Muskujt e gjymtyres se siperme**

**Muskujt e gjymtyres se poshtme**

Sistemi muskular (*systema muscularare*) perfshin muskujt dhe formacionet ndihmese te tyre.

Muskuli (*musculus*) mund te jete i striuar ose i lemuar (sipas pamjes mikroskopike). Muskujt e striuar, me tej, ndahen ne skeletike dhe kardiake.

Muskujt skeletike jane pjese aktive e aparatit lokomotor. Veçori e tyre eshte tkurrja dhe leshimi. Disa here ato konsiderohen si muskuj te vullnetshem, por ky term nuk eshte krejt i sakte, sepse ka muskuj skeletike (psh. diafragma), tkurrja e te cileve nuk eshte e vullnetshme.

Pergjithesisht muskuli fillon me koken (*caput*), pastaj ka pjesen me te madhe qendrore barkun (*venter*) dhe perfundon ose duke u fiksuar direkt ne kocke ose nepermjet formacioneve ndihmese.

Vendi i fillimit te muskulit perben origjinjen e tij, ndersa vendi i perfundimit inserimin e tij (*insertio*).

Muskujt skeletike kapen ne pikën e fillimit, qe eshte nje pike fikse (*punctum fixum*) dhe ne pikën e perfundimit, qe eshte pike e levizshme (*punctum mobile*). Megjithate shpesh keto pika alternohen gjate aktivitetit muskular.

**Muskujt klasifikohen** sipas formes, sipas numrit te kokeve ose sipas veprimit.

**Sipas formes** nje muskul mund te jete i drejte (*m. rectus*), fuziform (*m. fusiformis*), i sheshte (*m. planus*), trekendor (*m. triangularis*), katerkendor (*m. quadratus*) ose orbikular (*m. orbicularis*).

**Sipas numrit te kokeve** nje muskul mund te jete me dy koke (*m. biceps*), me tre koke (*m. triceps*) ose me kater koke (*m. quadriceps*).

**Sipas veprimit** qe kryen nje muskul mund te jete abduktor (*m. abductor*) ose aduktor (*m. adductor*), flektor (*m. flexor*) ose ekstensor (*m. extensor*), pronator (*m. pronator*) ose supinator (*m. supinator*), levator ose depresor dhe sfinkter (*m. sphincter*) ose dilatator (*m. dilatator*).

**Formacionet ndihmese** te muskujve jane tendinet, aponeurozat dhe fasciet. Ato realizojne transferimin e forces se ushtruar nga muskujt skeletike ne kocka.

**Tendinet** (*tendo*) kane formen e kordoneve fibroze, me siperfaqe te lemuar, jane elastike dhe fiksohen fort ne kocke. Siperfaqja e fiksimit varet nga madhesia e muskulit perkates.

Nganjehere kur muskuli eshte i gjate, per te irritur forcen tkurrese, ai ndahet ne pjesë nga nderpreje tendinoze (*intersectiones tendinae*).

Ne rastet kur levizja qe kryhet nga muskuli ka amplitude te madhe, per te pakesuar ferkimin, midis tendinit dhe kockes gjenden bursa sinoviale (*bursa sinovialis*), hapesira e te cilave komunikon me kapesiren artikulare. Disa here bursa e mrethon tendinin si menge dhe kthehet ne vagine sinoviale (*vagina sinovialis*).

**Aponeurozat** (*aponeurosis*) jane flete fibroze, qe zevendesojne tendinet ne muskujt e sheshte.

**Fasciet** (*fascia*) jane flete fibrotike qe veshin jo vetem muskujt (*fascia muscularum*), por edhe organe (*fascia visceralis*). Fascia muskulare mund te veshe nje muskul (*fascia propria musculi*) ose nje grup muskujsh (*fascia investiens*).

#### Fakte klinike

##### *Atrofia muskulare*

*Atrofia muskulare* nenkupton humbjen e mases muskulare dhe fuqise tkurrese te muskulit.

Ka shume semundje qe mund te shkaktojne atrofi muskulare. Megjithate ato shpesht mund te ndodhin edhe pas nje imobilizimi te gjate ose nje qendrimi te gjate ne shtrat. Atrofi te tillë zakonisht jane te rikthyeshme pas ushtrimeve graduale fizike.

##### *Hipertrofia muskulare*

*Hipertrofia muskulare* eshte rritja e mases muskulare. Ajo shoqeron procesin e rritjes, por mund te induktohet edhe nga ushtrimet fizike, suplementet ushqimore dhe substanca steroide (anabolizante).

Ne muskujt e skeletit zakonisht ajo eshte e pelqyeshme, por ne disa organe eshte shenje e gjendjeve patologjike (psh. ne miokard).

##### *Krampet muskulare*

*Krampet muskulare* (ngerçet) shkaktohen nga te ftrohit ose mbiushtrimi i muskujve, qe çojne ne kontraktim te tyre dhe shoqerohen me nje ndjenje tipike te pakendshme ose edhe me dhimbje.

*Krampet muskulare* lehthesohen nga tendosja e muskulit, masazhi dhe kompresat e ngrohta.

##### *Tendinitet*

*Tendinitet* jane inflamacion i tendineve qe kane si shkak çarjet mikroskopike ne to nga mbiperdorimi, ndihmuar kjo edhe nga vaskularizimi i paket i tyre. Shenja kryesore eshte dhimbja gjate e pas aktivitetit fizik.

Demtimi mund te vihet ne dukje nga ekografia dhe rezonanca magnetike. Trajtimi standart eshte qetesia dhe perdonimi i inflamatoreve josteroide.

##### *EMG*

*EMG* ose elektromiografia eshte nje ekzaminim mjekesor qe vlereson veçorite fiziologjike te muskujve ne qtesi dhe kontraktim. Nje elektrode mat aktivitetin elektrik ne qtesi dhe ne fazën te ndryshme te kontraktimit.

## MUSKUJT E KOKES

**Muskujt e kokes** (*musculi capitis*) ndahen ne muskuj faciale dhe muskuj mastikatore. Muskujt e gjuhes, te qijllzes, te syrit dhe te kockave te degjimit, pavaresisht se gjenden ne koke, studiohen me organet perkatese.

**Muskujt e fytyres ose muskujt faciale** (*musculi faciei*) quhen ndryshe edhe muskuj te mimikes, ndonese funksioni i tyre primar eshte ngushtimi ose zgjerimi i orificiumeve ne fytyre.

Ato kane disa veçori.

Pergjithesisht keta muskuj vendosen rrreh orificiumeve te fytyres, duke i ngushtuar ose zgjeruar ato.

Te gjithe kane vetem nje fiksim ne kocke, fiksimi tjeter eshte ne lekure dhe tkurrja e muskulit ndryshon reliefin e lekures.

Gjithashtu ato inervohen nga i njejtii nerv (nervi facial), prandaj gjate demtimit te tij çregullohet funksioni i te gjithe muskujve faciale te njerës ane.

**Muskujt e fytyres klasifikohen** ne grupin orbital, grupin nazal, grupin oral dhe muskujt te tjere.

**Grupi orbital** ose muskujt rrith syut, perfshin muskujt rrith orbites dhe perbehet nga m. orbikular i syrit dhe m. corrugator superciliar.

■ **M. orbikular i syrit** (*m. orbicularis oculi*) ka pamje eliptike dhe vendoset perreth orbites. Ai ka pjesen orbitale, pjesen palpebrale dhe nje pjese te vogel lakrimale.

Pjesa orbitale (*pars orbitalis*) fillon ne lig. palpebral medial, rrethon si elips buzen kockore te orbites dhe perfundon serisht ne lig. palpebral medial. Tkurja e saj mbyll syrin.

Pjesa palpebrale (*pars palpebralis*) fillon ne lig. palpebral medial, shkon nen lekuren e palpebres se siperme e te poshtme dhe perfundon ne lig. palpebral lateral. Tkurja e saj leviz qepallat.

Pjesa lakrimale vendoset thelle, medialisht, rrethon sakusin lakrimal dhe duke ndryshuar presionin brenda tij, shton ose pakeson drenimin e loteve ne te, per te ruajtur sasine optimale te tyre, qe duhet per te mbajtur te lagur kornene.

■ **M. corrugator superciliar** (*m. corrugator supercilii*) fillon ne kocke ne pjesen mediale te harkut superciliar, shkon siper e lateralisht dhe perfundon ne lekuren e vetullave. Tkurja e tij shkakton rrudhjen e vetullave (rrudha vertikale ne balle).

**Grupi nazal** ose muskujt rrith hundes, perbehet nga m. nazal, m. procerus dhe m. depresor i septumit nazal.

■ **M. nazal** (*m. nasalis*) perbehet nga pjesa transversale dhe pjesa alare.

Pjesa transversale (*pars transversa*) fillon ne maksile ne procesin frontal, vazhdon mbi flegren e hundes dhe ne linjen mediane bashkohet me muskulin e anes tjeter. Tkurja e saj ngushton vrimat e hundes.

Pjesa alare (*pars alaris*) gjendet nen pjesen transversale, fillon ne maksile dhe perfundon ne pjesen anesore te flegres se hundes. Tkurja e saj zgjeron vrimat e hundes.

■ **M. procerus** (*m. procerus*) fillon nga kocka nazale dhe ngjitet siper e perfundon ne lekuren e glabeles, duke e ulur ate gjate tkurjes dhe duke formuar rrudha horizontale ne lekuren e saj.

■ **M. depresor i septumit nazal** (*m. depresor septi nasi*) fillon ne maksile dhe ngjitet vertikalish deri ne septumin nazal. Tkurja e tij ul septumin nazal duke ndihmuar ne zgjerimin e vrimave te hundes.

**Grupi oral** ose muskujt rrith gojes, perfshin muskujt rrith gojes dhe perbehet nga m. orbikular i gojes, m. bucinator, muskujt orale te siper: m. risorius, m. levator anguli oris, m. zgomatik major, m. zgomatik minor, m. levator labi superior, m. levator labi superior alekue nazi si dhe dhe muskujt orale te poshtem: m. depresor anguli oris, m. depresor labi inferior e m. mental.

■ **M. orbikular i gojes** (*m. orbicularis oris*) formon masen kryesore te buzeve. Tkurja e fijeve periferike te tij aftron buzet duke i nxjerre perpara, ndersa tkurja e fijeve qendrore aftron buzet duke i puthitur ato.

■ **M. bucinator** (*m. buccinator*) formon masen kryesore te faqeve. Ai fillon prapa ne maksile e ne mandibul ne nivelin e molareve, vjen perpara ne kendin e gojes dhe fijet e tij (pas nje kryqezimi te pjesshem) kalojne ne buzen e siperme e ate te poshtme. M. bucinator shpohet nga duktusi i gjendres parotide dhe sherben si sfinkter per te. Tkurja e muskulit aftron faqen me dhembet duke mos lene ushqim gjate pertypjes ne vestibulum e gojes, gjithashtu ndihmon nxjerrjen me force te ajrit nga goja (psh. gjate fishkellimes).

■ **M. risorius** (*m. risorius*) fillon ne kendin e gojes dhe shkon lateralisht. Tkurja e tij terheq anash e pak siper kendin e gojes duke shkaktuar te qeshuren ironike.

■ **M. levator anguli oris** (*m. levator anguli oris*) fillon ne maksile dhe zbret ne kendin e gojes duke u mbuluar nga muskujt e tjere te ketij grupi. Tkurja e tij ngre lart kendin e gojes.

■ **M. zgomatik major** (*m. zygomaticus major*) fillon ne kocken zgomatike dhe perfundon ne kendin e gojes. Tkurja e tij ngre lart e anash kendin e gojes duke shkaktuar te qeshuren.

■ **M. zgomatik minor** (*m. zygomaticus minor*) vendoset medialisht te parit, fillon ne kocken zgomatike dhe perfundon ne buzen e siperme prane kendit te gojes. Tkurja e tij ngre lart e anash kendin e gojes.

■ **M. levator labi superior** (*m. levator labii superioris*) zbret vertikalish nga mandibula ne buzen e siperme. Tkurja e tij ngre lart buzen e siperme.

■ **M. levator labi superior alekue nazi** (*m. levator labii superioris alaeque nasi*) eshte muskuli me medial i buzes se siperme. Ai fillon ne maksile dhe zbret duke u fiksuar ne flegren e hundes dhe buzen e siperme. Tkurja e tij ngre flegren e hundes dhe buzen e siperme.

■ **M. depresor anguli oris** (*m. depressor anguli oris*) fillon ne mandibul dhe perfundon ne kedin e gojes. Tkurria e tij ul kedin e gojes.

■ **M. depresor labii inferioris** (*m. depressor labii inferioris*) fillon ne mandibul dhe perfundon ne buzen e poshtme. Tkurria e tij ul buzen e poshtme.

■ **M. mentalis** (*m. mentalis*) fillon ne mandibul, fijet zbresin poshte dhe perfundojne ne lekuren e mjekres. Tkurria e tij ngre lart lekuren e mjekres.

**Muskuj te tjere faciale** jane m. epikranial dhe muskujt aurikulare.

■ **M. epikranius** (*m. epicranius*) perbehet nga dy pjese, nga m. oksipitofrontal (*m. occipitofrontalis*) dhe m. temporoparietal (*m. temporoparietalis*).

**M. oksipitofrontal** vendoset mbi kalvarian dhe ka dy barqe, nje oksipital dhe nje frontal. Barku oksipital (*venter occipitalis*) ka fillim te gjere ne kocken oksipitale ne nivelin e protuberances oksipitale eksterne. Ai vjen perpara dhe bashkohet me aponeurozen epikraniale (*aponeurosis epicranialis* ose *galea aponeurotica*), ne buzen e perparme te se ciles fillon barku frontal (*venter frontalis*) i m. epikranial. Ky shkon perpara dhe perfundon ne lekuren e vetullave.

**M. temporoparietal** eshte nje muskul i vogel qe shkon nga barku frontal drejt regjionit temporal.

M. epikranial dhe aponeuroza epikraniale formojne nje flete fibromuskulare qe funksionon si unike.

Tkurria e m. epikranial formon rrudha horizontale ne lekuren e ballit.

■ **Muskujt aurikulare** ose muskujt rrreth veshit, jane tre: ai anterior (*m. auricularis anterior*), ai superior (*m. auricularis superior*) dhe ai posterior (*m. auricularis posterior*). Ata jane muskuj rudimentare.

**Muskujt mastikatore** (*musculi masticatorii*) ose muskujt e pertypjes kane nje fiksim ne kafke dhe fiksimin tjeter ne mandibul, keshtu qe gjate tkurjes se tyre ndodh levizja e mandibules.

■ **M. maseter** (*m. masseter*) ka forme katerkendore; ai siper fiksohet ne harkun zigomatik dhe poshite ne tuberozitetin maseterik ne kedin e mandibules. Muskuli ka nje pjese te siperfaqshme (*pars superficialis*) dhe nje pjese te thelle (*pars profunda*). Tkurria e tij ngre mandibulen lart.

■ **M. temporalis** (*m. temporalis*) ka formen e nje freskoreje; ai fillon siper ne skuamen e kockes temporale, fijet e tij zbresin poshte duke konverguar per te

perfunduar ne procesin koronoid te mandibules. Tkurria e ketij muskuli, gjithashtu ngre mandibulen lart.

■ **M. pterygoideus medialis** (*m. pterygoideus medialis*) fillon ne fosen pterigoide te kockes sfenoidale dhe zurret duke perfunduar ne tuberozitetin pterigoid ne kedin e mandibules. Edhe tkurria e tij e ngre lart mandibulen

■ **M. pterygoideus lateralis** (*m. pterygoideus lateralis*) eshte muskuli me i veçante i ketij grupi. Ai fillon ne faqen laterale te lamines laterale te procesit pterigoid. Fijet e muskultit shkojne pak a shume horizontalisht dhe fiksohen ne diskun artikular te artikacionit temporomandibular dhe nen kondilin e mandibules, ne qafen e saj. Tkurria e dy muskujve njekohesish, e nxjerr mandibulen perpara, ndersa tkurria e vecuar e njerit muskul e con mandibulen nga ana tjeter.

**Fasciet e muskujve mastikatore** jane fascia maseterike (*fascia maseterica*), qe vesh muskulun maseter dhe fascia temporale (*fascia temporalis*), qe vesh m.n temporal. Nderkohe, fascie tjeter ne fytyre eshte fascia parotide (*fascia parotidea*), qe vesh gjendren parotide.

#### Fakte klinike

##### Paraliza faciale

Meqenese te gjithe muskujt faciale iñervohen nga nervi facial, demtimi (zakonisht inflamatori) i tij shoqerohet me çrrregullime ne funksionin e tyre.

Humbja e tonusit te muskultit orbikular te syrit shoqerohet me pamundesi per "shkeljen" e tij si dhe ilje te qepalles se poshtme, qe shoqerohet me "lotim".

Humbja e tonusit te muskultit bucinator dhe muskultit orbikular te gojes shoqerohet me pamundesine per te fishkellyer si dhe me mbetjen e ushqimit ne vestibulumin e gojes; keshtu qe ai mbetet te hiqet me gisht.

Gjithashtu humbja e tonusit te muskujve qe ngrene kedin e gojes ben qe ai te varet dhe kjo mund te çoje ne rrjedhje te peshtimes prej tij. (Te semuret mbajne nje shami per te fishire lotet e peshtymen).

## MUSKUJT E QAFES

**Muskujt e qafes** (*musculi colli*) perfshijnë muskujt qe gjenden ne pjesen e perparme te saj, ndersa muskujt qe gjenden ne pjesen e pasme te qafes pershkruehen ne muskujt e shpines. Disa prej muskujve te qafes sherbejnë si kufij

per percaktimin e trekendeshave te qafes. Muskujt, organet dhe tufat neurovaskulare ne qafe vishen nga fascia e saj.

**Muskujt e qafes** duke filluar nga siperfaqja ne thellesi jane m. platizma, m. sternokleidomastoid, muskujt e kockes hioide dhe muskujt e thelle te qafes.

■ **M. platizma** (*platysma*) eshte nje muskul i holle dhe i gjere, i vendosur menjehere nen lekuren e qafes. Ai nuk ka fillim e mbarim te qarte; fillon nen klavikul ne regionin pektoral e perfundon mbi mandibul ne nivelin e faqes. Tkurrja e tij tendos lekuren e qafes.

■ **M. sternokleidomastoid** (*m. sternocleidomastoideus*) eshte nje muskul i gjate; ai fillon ne pjesen e siperme te sternumit dhe ne ekstremitetin sternal te klavikules dhe perfundon ne procesin mastoid te kockes temporale. Tkurrja e tij perkul koken ne te njejtën ane duke kthyer ftyren nga ana e kundert, ndersa tkurrja e dy muskujve njekohesisht perkul koken prapa.

**Muskujt e kockes hioide** jane muskuj suprahyoidei (*musculi suprahyoidei*) perkatesisht m. stilohioid, m. geniohioid, m. milohioid dhe m. digastric si dhe muskuj infrahyoidei (*musculi infrahyoidei*) perkatesisht m. sternohioid, m. sternotiroid, m. tirohioid dhe m. omohioid.

■ **M. stilohioid** (*m. stylohyoideus*) fillon ne procesin stiloid te kockes temporale dhe perfundon ne kocken hioide. Tkurrja e tij e terheq kocken hioide siper e prapa.

■ **M. geniohioid** (*m. geniohyoideus*) fillon ne spinen mentale te mandibules dhe perfundon ne kocken hioide. Tkurrja e tij ngre kocken hioide ose ul mandibulen, ne varesi te pikes fikse.

■ **M. milohioid** (*m. mylohyoideus*) fillon ne linjen milohioide te mandibules, pastaj shkon horizontalisht per t'u bashkuar me muskulin e anes tjeter ne linjen mediane. Muskuli prapa fiksohet ne kocken hioide. Dy muskujt milohioide formojne dyshemene e gojes.

■ **M. digastric** (*m. digastricus*) ka dy barqe, barkun anterior (*venter anterior*) e barkun posterior (*venter posterior*), qe bashkohen me nje tendin te ndermjetem, i cili fiksohet ne kocken hioide. Barku anterior fillon ne fosen digastrike ne mandibul, ndersa barku posterior prane procesit mastoid ne kocken temporale. Tkurrja e muskulit ngre kocken hioide ose ul mandibulen, ne varesi te pikes fikse.

■ **M. sternohioid** (*m. sternohyoideus*) fillon ne sternum dhe perfundon ne kocken hioide. Tkurrja e tij ul kocken hioide.

■ **M. sternotiroid** (*m. sternothyroideus*) fillon ne sternum dhe perfundon ne kercin tiroid. Tkurrja e tij ul kercin tiroid.

■ **M. tirohioid** (*m. thyrohyoideus*) fillon ne kercin tiroid, pikerisht aty ku perfundon m. sternotiroid dhe perfundon ne kocken hioide. Tkurrja e tij ul kocken hioide ose ngre kercin tiroid ne varesi te pikes fikse.

■ **M. omohioid** (*m. omohyoideus*) ka dy barqe, barkun superior (*venter superior*) e barkun inferior (*venter inferior*), qe bashkohen me nje tendin te ndermjetem. Barku superior fiksohet ne kocken hioide, ndersa barku inferior ne margin superiore te skapules.

**Muskujt e thelle te qafes** jane muskuj skalene dhe muskuj prevertebrale.

■ **Muskujt skalene**, perkatesisht m. skalen anterior (*m. scalenus anterior*), m. skalen i mesem (*m. scalenus medius*) dhe m. skalen posterior (*m. scalenus posterior*), fillojne ne dy brinjet e para dhe ngjiten pjerrtazi si shkalle siper per te perfunduar ne proceset transversale te vertebrave cervikale. Tkurrja e tyre ngre brinjet ose perkul qafen ne varesi te pikes fikse.

■ **Muskujt prevertebrale** (vendosen perpara vertebrave) jane m. longuscoli (*m. longus colli*) dhe m. longus capitis (*m. longus capitis*). Tkurrja e tyre perkul perkatesisht qafen ose koken.

**Trekendeshat e qafes**, te percaktuar per qellim deskriptiv, jane trekendeshi anterior e trekendeshi posterior.

■ **Trekendeshi anterior** i qafes kufizohet nga m. sternokleidomastoid, buza e poshtme e mandibules dhe linja mediane e qafes. Nga dy barjet e m. digastric dhe barku superior i m. omohioid, ai ndahet ne trekendesa me te vegjel.

**Trekendeshi submandibular** (ose digastric) kufizohet nga buza e poshtme e mandibules dhe dy barjet e m. digastric.

**Trekendeshi karotik** (ose omohioid) kufizohet nga m. sternokleidomastoid, barku superior i m. omohioid dhe barku posterior i m. digastric.

**Trekendeshi muskular** (ose omotrakeal) kufizohet nga m. sternokleidomastoid, barku superior i m. omohioid dhe linja mediane e qafes.

■ **Trekendeshi posterior** i qafes kufizohet nga m. sternokleidomastoid, buza e perparme e m. trapezius dhe klavikula. Nga barku inferior i m. omohioid ai ndahet ne trekendesha me te vegjel.

**Trekendeshi supraklavikular** (ose omoklavikular) kufizohet nga m. sternokleidomastoid, barku inferior i m. omohioid dhe klavikula.

**Trekendeshi oksipital** (ose omotrapezoid) kufizohet nga m. sternokleidomastoid, barku inferior i m. omohioid dhe buza e perparme e m. trapezius.

**Fascia e qafes** (*fascia colli*) perbehet nga disa lamina qe veshin muskujt, organet dhe tufen neurovaskulare.

■ **Lamina superficiale** (*lamina superficialis*) ose mbeshtjellese (investuese) rrethon plotesisht qafen. Prapa ajo fillon ne ligamentin nukal, vjen perpara duke mbeshtjelle m. trapezius, pastaj m. sternokleidomastoid dhe muskujt infrahioide dhe ne linjen mediane bashkohet me fascien e anes tjeter. Siper fascia kapet ne trupin e mandibules dhe poshte ne klavikul e ne manubrium sterni. Mbi manubrium sterni ajo ndahet ne nje flete te thelle dhe nje te siperfaqshme, qe duke u kapur ne buzen e pasme dhe te perparme te manubriumit, formojne mbi te hapesireni suprasternale (*spatium suprasternale*).

■ **Lamina pretrakeale** (*lamina pretrachealis*) vesh gjendren tiroide, trakene, ezofagun dhe faringun. Pjesa posteriore e saj, qe vesh nga prapa ezofagun dhe faringun, quhet fascia bukofaringeale (*fascia buccopharyngea*). Lamina pretrakeale siper fillon ne nivelin e kockes hioide, poshte vazhdon ne mediastinum dhe anash bashkohet me laminen superficiale.

■ **Lamina prevertebrale** (*lamina prevertebralis*) ka formen e nje cilindri, ajo vesh kolonen vertebrare dhe muskujt qe e rrrethojne ate (muskujt skalene, muskujt prevertebrale dhe muskujt e thelle te shpines). Prapa ajo fillon pergjate ligamentit nukal, ndersa perpara atashohet ne trupat e vertebrave cervikale. Siper fillon ne bazen e kafkes, ndersa poshte shkrijhet me ligamentin longitudinal anterior.

■ **Vagina karotike** (*vagina carotica*) vesh gjithashtu ne forme cilindri tufen neurovaskulare te qafes te perbere nga arteria karotike interne dhe arteria karotike komune, vena jugulare interne dhe nervi vag. Ne formimin e vagines karotike kontribuojne laminat e tjera te fascies se qafes.

Hapesirat potenciale ne qafe gjenden midis laminave te mesiperme dhe permbajne ind lidhor te shkrifet.

■ **Hapesira pretrakeale** gjendet midis laminec superficiale (prapa muskujve infrahioide) dhe laminec pretrakeale (perpara trakese dhe gjendres tiroide).

■ **Hapesira retrofaringeale** gjendet midis fascies bukofaringeale (prapa faringut) dhe fascies prevertebrale (perpara vertebrave cervikale).

#### Fakte klinike

##### Hapesirat midis laminave te fascies se qafes

Ne kendveshtrim klinik rendesia e hapesirave potenciale midis laminave te fascies se qafes qendron ne mundesine e perhapjes se proceseve inflamatore nepermjet tyre. Psh. nje infekzion ne hapesiren pretrakeale mund te zbrese poshte dhe te arrije ne mediastinin superior bile edhe ne ate inferior, perpara perikardit.

## MUSKUJT E SHPINES

**Muskujt e shpines** (*musculi dorsi*) jane muskuj ekstrinseke dhe muskuj intrinseke. Ata ndahen ne tre grupe, ne grupin siperfaqesor, grupin e ndermjetem dhe grupin e thelle.

Grupi siperfaqesor perbehet nga muskuj qe inserohen ne kockat e rrerhit te gjymtyres se siperme dhe ne humerus, prandaj konsiderohen edhe si grupi apendikular.

Grupi i ndermjetem perbehet nga muskuj qe inserohen ne brinje, prandaj konsiderohen si grupi respirator. Grupi siperfaqesor dhe grupi i mesem perbehen nga muskuj ekstrinseke.

Grupi i thelle perbehet nga muskuj qe fillojnë e mbarojne ne shpine, pra Jane muskuj intrinseke ose te vete shpines (*musculi dorsi proprii*).

Grupi siperfaqesor perfshin m. trapezius, m. latissimus dorsi, mm. romboide major e minor dhe m. levator te skapules.

■ **M. trapezius** (*m. trapezius*) ka formen e nje trekendeshi me baze pergjate kolones vertebrare dhe maje ne skapul. Ai fillon ne protuberancen oksipitale eksterne, ligamentin nukal dhe proceset spinoze te vertebrave C7-T12 e perfundon ne spinen e skapules, akromion e klavikul. Dy muskujt formojne se bashku nje trapezoid. Muskuli ka pjesen zbritese (*pars descendens*), pjesen transversale (*pars transversa*) dhe pjesen ngjiteze (*pars ascendens*).

Tkurrja e pjeses zbritese ngre skapulen, tkurrja e pjeses transversale afro skapulen me kolonen vertebrare dhe tkurrja e pjeses ngjiteze e ul skapulen.

■ **M. latissimus dorsi** (*m. latissimus dorsi*) eshte me i gjeri i shpines; ai ka forme trekendeshi me baze ne kolonen vertebruale duke filluar ne proceset spinoze te vertebrave T6-S4 dhe perfundon ne tuberkulum minor te humerusit. Tkurja e tij ben adukcion dhe rotacion intern te krahut.

■ **M. romboid minor** (*m. rhomboideus minor*) dhe **m. romboid major** (*m. rhomboideus major*) fillojne nga proceset spinoze perkatesisht te dy vertebrave te fundit cervikale dhe kater te parave torakale dhe perfundojne ne margin mediale te skapules.

Tkurja e tyre aftron skapulen me kolonen vertebruale.

■ **M. levator i skapules** (*m. levator scapulae*) fillon ne proceset transversale te vertebrave te siperme cervikale dhe perfundon ne kendin e siperme te skapules.

Tkurja e tij ngre skapulen.

**Grupi i ndermjetem** perfshin perfshin *m. serratus posterior superior* dhe *m. serratus posterior inferior*.

■ **M. serratus posterior superior** (*m. serratus posterior superior*) fillon ne proceset spinoze te kater vertebrave, C6-T2 dhe pasi zbret oblikisht perfundon ne kater brinje, 2-5.

Tkurja e tij i ngre keto brinje lart.

■ **M. serratus posterior inferior** (*m. serratus posterior inferior*) fillon ne proceset spinoze te kater vertebrave, T11-L2 dhe pasi ngjitet oblikisht perfundon ne kater brinjet e fundit, 9-12.

Tkurja e tij i ul keto brinje poshte.

**Grupi i thelle** perfshin *m. erector spinae*, qe fillon ne kisten iliake dhe perfundon ne brinje dhe ne proceset transversale e spinoze te vertebrave lumbare, torakale e cervikale, muskujt spinotransversale (*musculi spinotransversales*), qe fillojne ne proceset spinoze dhe perfundojne ne proceset transversale vertebruale, muskujt transversospinale (*musculi transversospinales*), qe fillojne ne proceset transversale dhe perfundojne ne proceset spinoze vertebruale, muskujt interspinale (*musculi interspinales*), qe lidhin proceset spinoze fqinje dhe muskujt intertransversale (*musculi intertransversarii*), qe lidhin proceset transversale fqinje.

**Fascia e shpines** eshte fascia torakolumbare (*fascia thoracolumbalis*). Ajo eshte vazhdim i lamines superficiale te fascies se qafes.

Ne pjesen e siperme te shpines fascia torakolumbare eshte unike, kapet ne proceset spinoze te vertebrave torakale dhe vendoset midis muskujve te grupit respirator dhe atyre te grupit te thelle.

Ne pjesen e poshtme te shpines fascia torakolumbare perbehet nga tre lamina, lamina superficiale (*lamina superficialis*), lamina e mesme (*lamina media*) dhe lamina profunde (*lamina profunda*). Lamina superficiale kapet ne proceset spinoze, ndersa lamina e mesme dhe lamina profunde ne proceset transversale te vertebrave lumbare. Lamina superficiale dhe lamina e mesme veshin muskujt e thelle te shpines, ndersa lamina e mesme dhe lamina profunde m. kuadrat lumbar. Te tre laminat bashkohen lateralisht dhe marrin pjese ne formimin e fascies transversale te abdomenit, ne faqen e pasme te m. transvers abdominal.

#### Fakte klinike

##### Dhimbja e shpines

Dhimbja e shpines mund te kete origjinën jo vetem nga muskujt, por edhe nga kockat, artikulacione, nervat ose struktura anatomike te tjera ne shpine ose edhe jashtë saj. Ajo eshte nje nga ankesat me te shpeshta te njerezve. Ne shumicen e rasteve ato jane te lokalizuara dhe jo progresive.

Shkaku me i shpeshte i dhimbjeve me origjine muskulare jane prishjet e balances se veprimit muskular ne dy anet e kolones dhe "terheqjet" muskulare; ne keto raste pushimi, te ngrohtat dhe eventualisht trajtimi medikamentoz myftojne per lehtesimin dhe zhdukjen e tyre.

Ne rastet e tjera duhet eksploruar origjina e dhimbjes dhe trajtimi do te varet prej saj.

#### MUSKUJT E TORAKSIT

**Muskujt e toraksit** (*musculi thoracis*) ose te kraherorit jane muskujt ekstrinseke dhe muskujt intrinseke. Muskujt ekstrinseke fillojne ne toraks dhe inserohen ne kockat e rrerhit te gjymtyres se siperme ose ne humerus. Muskujt intrinseke fillojne dhe mbarojne ne toraks.

Nje muskul i veçante i toraksit konsiderohet diafragma.

**Muskujt ekstrinseke** jane *m. pektoral major*, *m. pektoral minor*, *m. subklavius* dhe *m. serratus anterior*.

■ **M. pektoral major** (*m. pectoralis major*) eshte nje muskul i gjere, ne forme trekendeshi qe, ne varesi nga vendi i fillimit, ndahet ne tre pjese. Pjesa klavikulare

(*pars clavicularis*) fillon ne klavikul, pjesa sternokostale (*pars sternocostalis*) fillon ne sternum e ne ekstremitetin sternal te brinjeve dhe pjesa abdominale (*pars abdominalis*) fillon ne vaginen e m. rektus abdominis. Te gjitha fijet konvergojne e fiksohen me anen e nje tendini prane tuberkulumit major te humerusit.

Tkurrja e ketij muskuli afro krahun me toraksin ose ngre lart brinjet ne varesi te pikes fikse.

■ **M. pektoral minor** (*m. pectoralis minor*) eshte nje muskul i vogel, ne forme trekendeshi qe vendoset nen m. pektoral major. Ai fillon ne brinjet e siperme, fijet e tij konvergojne dhe fiksohen ne procesin korakoid te skapules.

Tkurrja e ketij muskuli ul skapulen ose ngre brinjet ne varesi te pikes fikse.

■ **M. subklavius** (*m. subclavius*) eshte nje muskul i vogel qe vendoset nen klavikul, midis saj dhe brinjes se pare.

■ **M. serratus anterior** (*m. serratus anterior*) fillon ne faqen anteriore te brinjeve (sipas nje linje “te dhembzuar”) dhe perfundon ne margin mediale te skapules.

Gjithashtu ne margin mediale te skapules fiksohen dy muskujt romboide qe vijnë nga prapa; se bashku te tre keta muskuj afrojne skapulen me toraksin.

**Muskujt intrinseke** ose te vertete te toraksit jane mm. interkostale eksterne, mm. interkostale interne dhe m. transversal i toraksit.

■ **Mm. interkostale eksterne** (*mm. intercostales externi*) vendosen midis brinjeve fqinje me drejtimin nga lart poshite, nga prapa perpara. Tkurrja e tyre ngre brinjet.

■ **Mm. interkostale interne** (*mm. intercostales interni*) gjithashtu vendosen midis brinjeve fqinje, gjenden nen muskujt interkostale eksterne dhe kane drejtim te kundert me ta.

Tkurrja e tyre ul brinjet.

■ **M. transversal i toraksit** (*m. transversus thoracis*) fillon ne faqen e pasme te sternumit, fijet shkojne oblikisht siper dhe kapen ne secilen ane ne brinjet e siperme.

Tkurrja e muskulit ul brinjet.

**Diafragma** (*diaphragma*) eshte nje muskul tek, i gjere, me drejtim transversal, me forme kubeje me konveksitet nga siper, qe ndan hapesirena torakale nga hapesira abdominale.

Ne periferi diafragma ka pjesen muskulare dhe ne qender pjesen tendinoze.

Pjesa muskulare ne varesi nga vendi i fillimit ndahet ne pjesen sternale (*pars sternalis diaphragmatis*), pjesen lumbare (*pars lumbalis diaphragmatis*) dhe pjesen kostale (*pars costalis diaphragmatis*).

Pjesa sternale fillon ne siperfaqen e pasme te procesit ksifoid.

Pjesa kostale fillon nga faqja e brendshme e brinjeve te poshtme.

Pjesa lumbare fillon nga vertebrat lumbare me dy kruse, nje te djathte (*crus dextrum*) e nje te majte (*crus sinistrum*), qe bashkohen me njeri tjeterin me lig. arkuat median (*lig. arcuatum medianum*). Lateralisht kruseve gjenden lig. arkuat medial (*lig. arcuatum mediale*) dhe lig. arkuat lateral (*lig. arcuatum laterale*). Pas lig. arkuat median (midis tij dhe kruseve) formohet hiatus i aortes (*hiatus aorticus*) ku kalon aorta abdominale. Perpara hiatusit te aortes gjendet hiatusi i ezofagut (*hiatus oesophagus*). Pas lig. arkuat medial kalon m. psoas major dhe pas lig. arkuat lateral kalon m. kuadrat lumbar.

Pjesa tendinoze (*centrum tendineum*) ka djathas vrimen ku kalon vena kava inferiore (*foramen venae cavae*).

Diafragma eshte muskuli kryesor i frymemarries. Gjate tkurrjes ajo ulet poshite, humbet pamjen e kubese, ndersa vellimi i hapesires torakale rritet.

**Fasciet e toraksit** jane fascia pektorale (*fascia pectoralis*), qe vesh m. pektoral major, fascia klavipektorale (*fascia clavipectoralis*), qe vesh m. pektoral minor dhe m. subklavius si dhe fascia torakale (*fascia thoracica*), qe vesh paretin torakal nga jashte mbi mm. interkostale eksterne e fascia endotorakale (*fascia endothoracica*), qe vesh paretin torakal nga brenda mbi mm. interkostale interne.

## MUSKUJT E ABDOMENIT

**Muskujt e abdomenit** (*musculi abdominis*) ndahen ne grupin anterior, grupin lateral dhe grupin posterior. Ne grupin posterior bejne pjese muskuj te abdomenit qe inserohen ne kockat e rrerhit te gjymtyres se poshtme ose ne femur. Muskuj te veçante te abdomenit konsiderohen ata qe formojne diafragmen pelvike.

**Grupi anterior** perbehet nga m. rektus abdominis.

■ **M. rektus i abdomenit** (*m. rectus abdominis*) fillon ne procesin ksifoid te sternumit dhe ne pjesen kartilaginoze te brinjeve te fundit, zbere poshite vertikalishet dhe perfundon ne degen e siperme te kockes pubike, anash simfizes. Ky muskul ka pergjate tij nderprerje tendinoze (*intersectiones tendinae*) per te rritur forcen tkurrese.

**Grupi lateral** perbehet nga tre muskuj te sheshte, m. oblik ekstern, m. oblik intern dhe m. transvers.

■ **M. oblik ekstern** (*m. obliquus externus abdominis*) fillon ne brinjet e poshtme dhe ne kreshten iliak, fijet e tij drejtohen pjerrtazi perpara poshthe dhe pastaj kalojne ne aponeuroze e cila merr pjese ne formimin e vagines se m. rektus abdominis. Buza e poshtme, e lire, e aponeurozes se tij ne intervalin nga spina iliak anteriore superiore deri ne tuberkulum pubik, trashet dhe formon lig. inguinale.

■ **M. oblik intern** (*m. obliquus internus abdominis*) gjendet nen m. oblik ekstern. Ai ka fije qe shkojne ne drejtim te kundert me te. Muskuli fillon ne 2/3 laterale te lig. inguinal, kreshten iliak, fascien torakolumbare dhe brinjet e fundit. Medialisht ai kalon ne aponeuroze, e cila merr pjese ne formimin e vagines se m. rektus abdominis.

■ **M. transversal i abdomenit** (*m. transversus abdominis*) gjendet nen m. oblik intern. Fijet e tij shkojne transversalisht. Ai, si m. oblik intern, fillon ne 2/3 laterale te lig. inguinal, kreshten iliak, fascien torakolumbare dhe brinjet e fundit. Medialisht ai kalon ne aponeuroze, e cila merr pjese ne formimin e vagines se m. rektus abdominis.

Tkurja e te gjithe muskujve abdominale te grupit anterior e te grupit lateral behet njekohesish. Gjate saj rritet presioni ne hapesirena abdominale. Kjo eshte e nevojshme ne aktet fiziologjike te urinimit, defekimit dhe lindjes.

**Grupi posterior** perbehet nga m. kuadrat lumbar dhe nga m. iliopsoas (qe nganjehere konsiderohet si muskul anterior i pelvisit).

■ **M. kuadrat lumbar** (*m. quadratus lumborum*) ka pamje katerkendeshe, ai fillon ne kreshten iliak dhe perfundon ne brinjen e fundit.

■ **M. iliopsoas** (*m. iliopsoas*) perbehet nga m. psoas major, m. psoas minor dhe m. iliak.

M. psoas major (*m. psoas major*) fillon ne trupat e vertebrave lumbare dhe perfundon ne trokanerin minor te femurit.

M. psoas minor (*m. psoas minor*) eshte nje muskul relativisht i vogel, qe edhe mund te mungoje.

M. iliak (*m. iliacus*) fillon ne fosen iliak duke e mbushur ate dhe bashke me m. psoas major perfundon ne trokanerin minor te femurit.

Thuria e m. iliopsoas ben fleksion te kofshes.

**Aponeurozat e muskujve abdominale** te grupit lateral marrin pjese ne formimin e vagines se m. rektus abdominis, te linjes alba dhe te kanalit inguinal.

■ **Vagina e m. rektus te abdomenit** (*vagina musculi recti abdominis*) formohet nga aponeurozat e m. oblik ekstern, m. oblik intern dhe m. transversal te abdomenit, te cilat duke shkuar medialisht arrijne buzen laterale te tij. Ketu ato sillen ne menyre te ndryshme ne 2/3 e siperme te m. rektus, ndaj 1/3 se poshtme te tij.

Ne 2/3 e siperme, aponeuroza e m. oblik ekstern kalon perpara m. rektus, aponeuroza e m. transversal kalon prapa m. rektus, ndersa aponeuroza e m. oblik intern ndahet ne dy flete, nje anteriore dhe nje posteriore qe kalojne perkatesisht perpara dhe prapa m. rektus.

Ne 2/3 e poshtme te tre aponeurozat kalojne perpara m. rektus, keshtu qe faqja e pasme e tij mbeshtetet direkt ne fascien transversale. Ne kete nivel, ne faqen e pasme te muskulit, formohet linja arkuante (*linea arcuata*), qe eshte buza e poshtme e fletes se pasme te vagines se rektusit.

■ **Linja alba** (*linea alba*) gjendet ne linjen mediane midis procesit ksifoid te sternumit dhe simfizes pubike. Tre aponeurozat pasi veshin m. rektus bashkohen ne buzen mediale te tij dhe vazhdojnë drejt linjes mediane (alba) per t'u nderthurur me ato te anes tjeter. Ne nivelin e umbilikosit fijet tendinoze rrallohen duke formuar anulusin umbilikal (*anulus umbilicalis*).

■ **Kanali inguinal** (*canalis inguinalis*) gjendet mbi ligamentin inguinal dhe vendoset paralel me te. Ai ka hapjen e jashtme qe ndodhet poshte medialisht, hapjen e brendshme qe ndodhet siper medialisht dhe muret, midis dy hapjeve.

**Hapja e jashtme** (*anulus inguinalis superficialis*) formohet mbi 1/3 mediale te ligamentit inguinal nga çarja e aponeurozes se m. oblik ekstern. Dy buzet e çarjes jane krusi medial (*crus mediale*) dhe krusi lateral (*crus laterale*); kendi i ngushtë midis tyre rrumbullakoset nga fibrat interkrurale (*fibrae intercrurales*), ndersa perballë tyre anulusi mbyllët nga ligamenti refleks (*lig. reflexum*). Hapja e jashtme e kanalit inguinal projektohet ne fosen inguinale mediale te peritoneumit parietal qe vesh paretin anterior abdominal.

**Hapja e brendshme** e kanalit inguinal (*anulus inguinalis profundus*) korrespondon me fosen inguinale laterale te peritoneumit parietal qe vesh paretin anterior abdominal. Ajo kufizohet poshte e medialisht nga ligamenti inguinal, siper nga fascia transversale dhe medialisht nga ligamenti interfoveolar (*lig. interfoveolare*).

**Muret e kanalit** jane muri anterior, muri posterior, muri superior dhe muri inferior. Muri anterior formohet nga aponeuroza e m. oblik ekstern, muri posterior nga fascia transversale, muri superior nga buza e poshtme e m. oblik intern e m. transversal dhe muri inferior nga vete ligamenti inguinal.

Kanali inguinal eshte **real**; ne te kalon funikuli spermatik (tek meshkujt) ose ligamenti teres uteri (tek femrat). Ne hapjen e jashtme mund te dale edhe permbajtje abdominale, psh. ansa intestinale, duke formuar hernie inguinale.

**Diafragma pelvike** (*diaphragma pelvis*) eshte pjesa muskulare e dyshemese pelvike (dyshemeja pelvike ndan hapesiren pelvike nga perineumi). Diafragma pelvike, ne secilen ane, formohet nga m. levator ani dhe m. koksigeal. Ajo ka formen e nje hinke qe siper fiksohet ne pelvisin kockor.

• **M. levator ani** (*m. levator ani*) perbehet nga tre pjesa: m. iliokoksigeal (*m. iliococcygeus*) qe gjendet lateralisht, m. pubokoksigeal (*m. pubococcygeus*) qe gjendet ne mes dhe m. puborektal (*m. puborectalis*) qe ndodhet medialisht. Dy muskujt levatore ani bashkohen ne linjen mediane, prapa kanalit anal duke formuar lig. anokosigeal (*lig. anococcygeus*). Perpara kanalit anal midis dy muskujve (puborektale) gjendet nje çarje ne forme U qe eshte hiatusi urogenital (*hiatus urogenitalis*), ne te cilin kalon uretra dhe tek femrat edhe vagina.

• **M. koksigeal** (*m. coccygeus*) eshte nje muskul i vogel qe gjendet midis koksiksit dhe spines iskiadike. Ai vendoset lateralisht m. levator ani dhe ploteson diafragmen pelvike.

**Fascia kryesore e abdomenit** eshte fascia transversale (*fascia transversalis*). Ajo eshte vazhdim i fascies torakolumbare te shpines dhe vendoset midis peritoneumit parietal dhe muskulit transversal abdominal e aponeurozes se tij. Siper ajo vazhdon nen diafragme me fascien diafragmatike (*fascia diaphragmatica*), poshte ne pelvis me fascien pelvike dhe mbi diafragmen pelvike me fascien superiore te saj (*fascia superior diaphragma pelvis*).

#### Fakte klinike

##### Incisionet kirurgjikale

Incisionet ne paretin anterior abdominal shoqerojne nderhyrjet kirurgjikale ne abdomen. Tradicionalisht incizioni behet ne dhe rreth vendit me interes kirurgjikal. Anestezia dhe medikamentet muskulorelaksues kane bere qe incisionet te jene gjithnjë e me te vogla.

Ne praktike, ne nderliyjet e medha kirurgjikale, incizioni behet central, nga procesi ksifoid deri ne simfizen pubike, pergjate linjes alba. Kjo nderhyrje quhet laparotomi dhe mundeson eksplorim me te mire te permbajtjes abdominale.

Ne disa lloj patologjish abdominale, realizohen nderhyrje me incizione minimale. Fillimisht nepermjet nje çarje te vogel futet dioksid karboni ne hapesiren abdominale

per te lethesuar proceduren, ndersa nga çarje te tjera futen nje kamera dhe instrumentat kirurgjikale. Ne kete menyre mund te realizohen heqja e kolecistes (kolecistektomia), e apendiksit (apendektomia) etj.

##### Herniet inguinale

Herniet inguinale konsistonje ne pranine e permbajtjes abdominale ne kanalin inguinal. Ato gjenden mbi ligamentin inguinal, ne pjesen mediale te tij.

Herniet inguinale mund te jene indirekte ose direkte.

Herniet inguinale indirekte ose kanalore ndodhin kur permbajtja herniare hyn ne hapjen e brendshme te kanalit inguinal dhe ose qendron ne kanal, ose del ne hapjen e jashtme, ose zurret ne skrotum.

Herniet inguinale direkte ose jokanalore ndodhin kur permbajtja herniare nuk hyn ne hapjen e brendshme te kanalit inguinal, por del direkt ne hapjen e jashtme duke marre me vete murin posterior te kanalit (*fascien transversale*).

Gjithashtu herniet inguinale mund te jene te lindura (jane indirekte) ose te fituara (jane zakonisht direkte). Herniet e fituara zakonisht hasen tek te moshuarit dhe vijne nga dobesimi i paretit abdominal ose rritjet e shpeshta te presionit intraabdominal (psh. nga kolla).

Herniet inguinale jane me te shpeshta tek meshkujt. Ato paraqiten si fryrje ne rreze te kofshes dhe jo gjithmone kerkojne intervent kirurgjikal.

##### Herniet umbilikale

Herniet umbilikale jane te rralla dhe zakonisht pas lindjes, nga mbyllja jo e plote e umbilikusit.

Zakonisht shumica nuk kerkojne nderhyrje kirurgjikale, meqe mbyllen pas viti te pare te jetes.

## MUSKUJT E GJYMTYRES SE SIPERME

Muskujt e gjymtyres se siperme (*musculi membri superiori*) ndahen ne muskujt e supit, muskujt e krahut, muskujt e parakrahut dhe muskujt e dores.

**Muskujt e supit** fillojnë ne kockat e rrëthit te gjymtyres se siperme, skapul e klavikul, dhe perfundojnë ne humerus, prandaj quhen ndryshe edhe muskujt skapulohumerale.

Muskujt e supit jane m. deltoid, m. supraspinat, m. infraspinat, m. subskapular, m. teres major e m. teres minor.

• **M. deltoid** (*m. deltoideus*) ka tre pjesa, pjesen klavikulare (*pars clavicularis*) qe fillon ne klavikul, pjesen akromiale (*pars acromialis*) qe fillon ne akromion dhe pjesen spinale (*pars spinalis*) qe fillon ne spinen skapulare. Muskuli mbulon artikulacionin skapulohumerale dhe perfundon ne tuberozitetin deltoid te humerisit.

Tkurrja e m. deltoid e ngre krahun perpara, anash ose prapa ne varesi te pjeses se tij qe kontraktohet, deri ne pozicion horizontal.

■ **M. supraspinat** (*m. supraspinatus*) mbush fosen supraspinate te skapules dhe perfundon ne tuberkulumin major te humerusit, duke u vendosur nen m. deltoid.

Tkurrja e tij ben abduksion te krahut (ashtu si m. deltoid).

■ **M. infraspinat** (*m. infraspinatus*) mbush fosen infraspinate te skapules dhe perfundon ne tuberkulumin major te humerusit.

Tkurrja e tij ben rotacion ekstern te krahut.

■ **M. teres minor** (*m. teres minor*) fillon ne margin laterale te skapules dhe perfundon ne tuberkulumin major te humerusit.

Tkurrja e tij ben rotacion ekstern te krahut (ashtu si m. infraspinat).

■ **M. subskapular** (*m. subscapularis*) mbush fosen subskapulare dhe fiksohet prane tuberkulumit minor te humerusit.

Tkurrja e tij ben aduksion dhe rotacion intern te krahut.

■ **M. teres major** (*m. teres major*) fillon ne kedin e poshtem te skapules, drejtohet siper e perpara, paralel me m. latissimus dorsi dhe fiksohet poshte tij, prane tuberkulumit minor te humerusit.

Tkurrja e tij ben aduksion dhe rotacion intern te krahut (ashtu si m. subskapular dhe m. latissimus dorsi).

Ne menyre te permblehdhur muskujt e supit kalojne ose mbi artikulacionin skapulohumeral dhe bejne abduksion te krahut (m. deltoid), ose kalojne prapa artikulacionit skapulohumeral dhe bejne abduksion e rotacion ekstern te krahut (m. supraspinat, m. infraspinat dhe m. teres minor), ose kalojne perpara artikulacionit skapulohumeral dhe bejne aduksion e rotacion intern te krahut (m. subskapular e m. teres major; bashke me m. latissimus dorsi, te shpines).

Nga muskujt e supit veçohen m. supraspinat, m. infraspinat, m. subskapular dhe m. teres minor, qe se bashku formojne **grupin rotator** ose **mansheten rotatore**, qe rrëthon artikulacionin skapulohumeral. Keta muskuj mbajne te shternguar koken e humerusit ne fosen glenoidale te skapules duke ndihmuar ne gendrueshmerine e artikulacionit.

**Muskujt e krahut** ndahen ne dy grupe, ne grupin anterior dhe ne grupin posterior.

**Grupi anterior** i muskujve te krahut, qe vendoset ne kompartimentin anterior te tij (*compartimentum brachii anterius*), perfshin m. korakobrakial, m. brakial dhe m. biceps brakial.

■ **M. korakobrakial** (*m. coracobrachialis*) fillon ne procesin korakoid te skapules dhe perfundon ne trupin e humerusit.

Tkurrja e tij ben fleksion te krahut.

■ **M. brakial** (*m. brachialis*) fillon ne trupin e humerusit dhe perfundon ne tuberozitetin ulnar.

Tkurrja e tij ben fleksion te parakrahut.

■ **M. biceps brakial** (*m. biceps brachii*) vendoset mbi dy muskujt e mesiperm. Ai ka koken e gjate (*caput longum*), tendini i se ciles pasi fillon ne tuberkulumin supraglenoidal te skapules, zbret neper hapesire artikulare te artikulacionit skapulohumeral dhe koken e shkurter (*caput breve*), qe fillon ne procesin korakoid. Muskuli perfundon ne tuberozitetin ulnar.

Tkurrja e tij ben fleksion te parakrahut.

**Grupi posterior** i muskujve te krahut, qe vendoset ne kompartimentin posterior te tij (*compartimentum brachii posterius*) perbehet nga m. triceps brakial.

■ **M. triceps brakial** (*m. triceps brachii*) ka tre koke, koken e gjate (*caput longum*), qe fillon ne tuberkulumin infraglenoidal te skapules dhe anash saj koken laterale (*caput laterale*) dhe koken mediale (*caput mediale*), qe fillojne nga humerusi. Muskuli perfundon ne olekranonin e ulnes.

Tkurrja e tij ben ekstension te parakrahut.

**Axila** (*axilla*) eshte zone (reale) e tranzicionit nga qafa ne gjymtyren e siperme. Ne formimin e mureve te saj marrin pjese muskuj te supit dhe muskuj te krahut. Ajo ka formen e nje piramide te çregullt me kater mure. Muri anterior i aksiles formohet nga m. pektoral major e m. pektoral minor. Muri medial formohet nga m. serratus anterior. Muri posterior formohet nga m. subskapular, m. teres major e m. latissimus dorsi; ne kete mur zbret vertikalish tendini i kokes se gjate te m. triceps brakial. Ne kete menyre, midis muskujve te mesiperm formohet nje hapesire triangulare dhe nje hapesire kuadrangulare ku kalojne vaza ose nerva. Neper aksile kalon tufa neurovaskulare e saj.

**Muskujt e parakrahut**, ashtu si edhe muskujt e krahut, ndahen ne dy grupe, ne grupin anterior dhe ne grupin posterior.

**Grupi anterior** i muskujve te parakrahut, qe vendoset ne kompartimentin anterior te tij (*compartimentum antebrachii anterius*), perfshin muskuj qe bejne pronacion, fleksion te pellembes ose fleksion te gishtave. Keto muskuj fillojne ne epikondilin medial te humerusit ose/dhe ne ulne dhe perfundojne ne radius (pronatoret), metakarpe (flektoret e pellembes) dhe falangje (flektoret e gishtave). Vendosja e tyre behet ne tre shtresa: te siperfaqshme, te mesme dhe te thelle.

» **Muskujt pronature** jane m. pronator teres (*m. pronator teres*) ne shtresen e siperfaqshme dhe m. pronator kuadrat (*m. pronator quadratus*) ne shtresen e thelle.

» **Muskujt flektore te pellembes** jane m. fleksor karpi radial (*m. flexor carpi radialis*), m. palmar longus (*m. palmaris longus*) dhe m. fleksor karpi ulnar (*m. flexor carpi ulnaris*), te tre te shtreses se siperfaqshme.

» **Muskujt flektore te gishtave** jane m. fleksor digitorum superficial (*m. flexor digitorum superficialis*) dhe m. fleksor digitorum profund (*m. flexor digitorum profundus*), te dy te shtreses se mesme.

**Grupi posterior** i muskujve te parakrahut, qe vendoset ne kompartimentin posterior te tij (*compartimentum antebrachii posterior*) perfshin muskuj qe bejne supinacion, ekstension te pellembes ose ekstension te gishtave. Keta muskuj fillojne ne epikondilin lateral te humerusit ose/dhe radius e perfundojne ne radius (supinatori), metakarpe (ekstensoret e pellembes) ose ne falangje (ekstensoret e gishtave). Vendosja e tyre behet ne dy shtresa: te siperfaqshme dhe te thelle. Veç tyre ne kete grup gjendet edhe m. brakioradial, i vendosur lateralisht, funksioni i te cilit nuk ka te beje me funksionet e muskujve te mesiperm.

» **M. brakioradial** (*m. brachiradialis*) fillon prane epikondilit lateral te humerusit dhe perfundon ne skajin distal te radiusit.

Tkurrja e tij ben fleksion te parakrahut (ashtu si muskujt anteriore te krahut).

» **M. supinator** (*m. supinator*) i takon shtreses se thelle.

» **Muskujt ekstensore te pellembes** jane m. ekstensor karpi radial longus (*m. extensor carpi radialis longus*) e m. ekstensor karpi radial brevis (*m. extensor carpi radialis brevis*) si dhe m. ekstensor karpi ulnar (*m. extensor carpi ulnaris*), te tre te shtreses se siperfaqshme.

» **Muskujt ekstensore te gishtave** jane m. ekstensor digitorum (*m. extensor digitorum*), i shtreses se siperfaqshme, per gishtat 3-5 dhe muskujt ekstensore pollicis brevis e longus (*m. extensor pollicis brevis* e *m. extensor pollicis longus*)

dhe m. ekstensor indicis (*m. extensor indicis*), te tre te shtreses se thelle, per gishtat 1-2.

**Muskujt e dores** ndahen ne muskujt tenare, muskujt hipotenare dhe muskujt interose. Muskujt tenare vendosen ne anen palmare lateralisht dhe bejne abduksion ose fleksion te gishtit te madh. Muskujt hipotenare vendosen ne anen palmare medialisht dhe bejne abduksion ose fleksion te gishtit te vogel. Muskujt nderkockore vendosen midis metakarpeve.

**Fasciet e gjymtyres se siperme** veshin muskujt e saj.

» **Fascia e krahut** (*fascia brachii*) vesh muskujt e krahut.

» **Fascia e parakrahut** (*fascia antebrachii*) vesh muskujt e parakrahut.

» **Fasciet e dores** jane ne anen dorsale, fascia dorsale (*fascia dorsalis manus*) dhe ne anen palmare, aponeuroza palmare (*aponeurosis palmaris*).

### Fakte klinike

#### Demimet e manshetes rotatore

Demimet e manshetes rotatore jane ose traumatike ose tendinopati.

Muskuli qe demtohet me shpesh eshte m. supraspinat, meje ai kalon ne nje hapesire me dimensione fikse nen akromion. Demimi mund te vije nga abduksioni i sforsuar ose edhe luksacionet ne artikulacionin skapulohumeral dhe zakonisht shoqerohet me dhimbje te forte.

Tendini i muskulit supraspinat eshte pak i vaskularizuar, prandaj traumat e perseritura mund te çojne ne ndryshime degenerative te tij, qe kur shoqerohen me kalcifikime jepin dhimbje shume te forta. Degjenerimi i tendinit mund te çoje edhe ne rupture te pjeshme ose te plete te tij dhe kjo ndodh zakonisht ne pacientet e moshuar. Ruptura e pjeshshme mund te shoqerohet me veshiresi te konsiderueshme ne veprime te theshja si psh. krehja etj. Nese ruptura eshte e plete, gjate aduktimit te krahut te abduktuar mbi 90°, kur ai arrin ne pozicion horizontal, bie menjehere ne menyre te pakontrolluar.

### MUSKUJT E GJYMTYRES SE POSHTME

**Muskujt e gjymtyres se poshtme** (*musculi membri inferioris*) ndahen ne muskujt gluteale, muskujt e kofshes, muskujt e kercirit dhe muskujt e kembes.

**Muskujt gluteale** fillojne ne kockat e rrëthit pelvik, pra kocken kokse (e sakrum), dhe perfundojne ne femur, prandaj quhen edhe muskujt koksofemorale. Ata ndahen ne grupin siperfaqsor dhe ne grupin e thelle. Ne grupin siperfaqsor bejne pjesa m. gluteal maksimus, m. gluteal medius, m. gluteal minimus dhe m. tensor fascie late. Ne grupin e thelle bejne pjesa m. piriform, m. obturator intern, m. gemel superior, m. gemel inferior dhe m. kuadrat femoral, ndersa m. obturator ekstern ndonese ka funksion te ngashem me ta, klasifikohet ne grupin e muskujve mediale te kofshes.

■ **M. gluteal maksimus** (*m. gluteus maximus*) eshte me siperfaqesori i muskujve gluteale, ai fillon ne faqen posteriore te fletes iliake ne linjat gluteale dhe perfundon nen trokanterin major te femurit. Tkurja e tij ben ekstension te kofshes.

■ **M. gluteal i mesem** (*m. gluteus medius*) gjendet nen m. gluteal maksimus; ai gjithashtu fillon ne linjat gluteale te fletes iliake dhe perfundon ne trokanterin major te femurit. Tkurja e tij ben abduksion te kofshes.

■ **M. gluteal minimus** (*m. gluteus minimus*) gjendet nen m. gluteal te mesem; edhe ai fillon ne linjat gluteale te fletes iliake dhe perfundon ne trokanterin major te femurit. Tkurja e tij ben abduksion te kofshes.

■ **M. tensor i fasciae latae** (*m. tensor fasciae latae*) fillon ne spinen iliake anteriore superiore te fletes iliake dhe vazhdon ne traktin iliotibial, i cili zbret lateralish kofshes, perfundon ne skajin proksimal te tibias dhe perforcon artikulacionin e gjurit.

■ **M. piriform** (*m. piriformis*) fillon ne faqen anteriore te pelvisit, del nga hapesira pelvike nepermjet foramen iskiadike major, mbi spinen iskiadike, dhe perfundon ne trokanterin major te femurit. Tkurja e tij ben rotacion ekstern te kofshes.

■ **M. obturator intern** (*m. obturatorius internus*) fillon ne hapesiren pelvike rrëth foramen obturatum te pelvisit, del nga hapesira pelvike nepermjet foramen iskiadike minor, nen spinen iskiadike, dhe perfundon ne trokanterin major te femurit. Tkurja e tij ben rotacion ekstern te kofshes.

■ **M. gemel superior** (*m. gemellus superior*) shoqeron m. obturator intern duke i qendruar siper atij; fillon ne spinen iskiadike dhe perfundon ne trokanterin major te femurit.

Tkurja e tij ben rotacion ekstern te kofshes.

■ **M. gemel inferior** (*m. gemellus inferior*) shoqeron m. obturator intern duke i qendruar poshte atij; fillon ne tuberin iskiadik dhe perfundon ne trokanterin major te femurit.

Tkurja e tij ben rotacion ekstern te kofshes.

■ **M. kuadrat femoral** (*m. quadratus femoris*) fillon ne tuberin iskiadik dhe perfundon nen trokanterin major te femurit.

Tkurja e tij ben rotacion ekstern te kofshes.

■ **M. obturator ekstern** (*m. obturatorius externus*) fillon jashte hapesires pelvike rrëth foramen obturatum te pelvisit dhe perfundon prane trokanterit major te femurit.

Tkurja e tij ben rotacion ekstern te kofshes.

Ne menyre te permblehdur muskujt gluteale te grupit siperfaqesor bejne ekstension ose abduksion te kofshes, ndersa muskujt gluteale te grupit te thelle bejne rotacion ekstern te saj.

**Muskujt e kofshes** ndahen ne grupin anterior, grupin posterior dhe grupin medial.

Grupi anterior i muskujve te kofshes, qe vendoset ne kompartimentin anterior te tij (*compartimentum femoris anterius*), perfshin m. sartorius dhe m. kuadriceps femoral.

■ **M. sartorius** (*m. sartorius*) eshte nje muskul i holle e i gjate qe fillon ne spinen iliake anteriore superiore, zbret ne kofshe duke kaluar nga lateralish medialish dhe perfundon medialish tuberozitetit tibial.

Tkurja e tij flekton kofshen dhe kercirin (ve gjymtyren e poshtme ne pozicionin kembe mbi kembe).

■ **M. kuadriceps femoral** (*m. quadriceps femoris*) ka kater koke qe perbejne muskuj te veçante: m. rektus femoral (*m. rectus femoris*), qe fillon ne spinen iliake anteriore inferiore dhe tre muskuj vastus (*m. vastus lateralis*, *m. vastus intermedius* et *m. vastus medialis*), qe fillojne ne trupin e femurit. Te kater muskujt poshte kalojne ne tendin te perbashket, qe pasi perfshin patelen vazhdon si lig. patellar deri ne tuberozitetin tibial.

Tkurrja e m. quadriceps femoralis shtrin kercirin.

Grupi posterior i muskujve te kofshes, qe vendoset ne kompartimentin posterior te tij (*compartimentum femoris posterius*), perfshin m. biceps femoralis, m. semimembranous dhe m. semitendinosus.

■ **M. biceps femoralis** (*m. biceps femoris*) fillon me njerën koke ne tuberin iskiadik dhe me tjetren ne trupin e femurit. Muskuli zbutet ne kofshe duke kaluar lateralisht dhe perfundon ne skajin proksimal te fibules.

Tkurrja e tij shtrin kofshen dhe flekton kercirin.

■ **M. semimembranous** (*m. semimembranosus*) gjithashtu fillon ne tuberin iskiadik, zbutet ne kofshe duke shkuar medialisht dhe perfundon ne kondilin medial te tibias.

Tkurrja e tij shtrin kofshen dhe flekton kercirin.

■ **M. semitendinosus** (*m. semitendinosus*) po ashtu fillon ne tuberin iskiadik, zbutet ne kofshe duke u vendosur mbi m. semimembranous dhe perfundon ne kondilin medial te tibias.

Tkurrja e tij shtrin kofshen dhe flekton kercirin.

Grupi medial i muskujve te kofshes ose grupi aduktor (sipas funksionit), qe vendoset ne kompartimentin medial te tij (*compartimentum femoris mediale*), perbehet nga m. gracilis, tre muskuj aduktore dhe m. pektin.

■ **M. gracilis** (*m. gracilis*) fillon ne degen e poshtme te kockes pubike, zbutet medialisht ne kofshe dhe perfundon ne kondilin medial te tibias, midis m. sartorius dhe m. biceps femoralis (te tre formojne nje "pes anserinus").

■ **Mm. aduktore**, brevis, longus dhe magnus (*m. adductor brevis*, *m. adductor longus* e *m. adductor magnus*) fillojne nga trupi dhe deget e kockes pubike, shkojnë lateralisht njeri mbi tjetrin dhe perfundojnë ne trupin e femurit.

■ **M. pektin** (*m. pectineus*) fillon ne degen e siperme pubike, vendoset mbi m. aduktor brevis dhe perfundon ne trupin e femurit.

**Muskujt e kercirit** ndahen ne grupin anterior, grupin posterior dhe grupin lateral.

Grupi anterior i muskujve te kercirit, qe vendoset ne kompartimentin anterior te tij (*compartimentum cruris anterius*), perfshin muskuj qe bejne fleksion dorsal te kembes ose ekstension te gishtave. Ata fillojne ne kondilin lateral te tibias ose/dhe fibula dhe perfundojnë ne metatarse ose falangje.

■ **Muskuli fleksor dorsal** i kembes eshte m. tibial anterior (*m. tibialis anterior*).

■ **Muskujt ekstensore te gishtave** jane m. ekstensor digitorum longus (*m. extensor digitorum longus*) dhe m. ekstensor hallucis longus (*m. extensor hallucis longus*).

Grupi posterior i muskujve te kercirit, qe vendoset ne kompartimentin posterior te tij (*compartimentum cruris posterius*), perfshin muskuj qe bejne fleksion plantar te kembes ose fleksion te gishtave. Ata fillojne ne skajin proksimal te tibias e fibules dhe perfundojnë ne tarse (flektoret plantare) ose falangje (flektoret e gishtave). Vendosja e tyre behet ne dy shtresa, te siperfaqshme e te thelle.

■ **Muskujt fleksore plantare** te kembes jane m. triceps surae (*m. triceps surae*) i shtreses se siperfaqshme dhe m. tibial posterior (*m. tibialis posterior*) i shtreses se thelle. M. triceps surae perbehet nga tre muskuj: m. gastrocnemius (*m. gastrocnemius*), m. soleus (*m. soleus*) dhe m. plantaris (*m. plantaris*). Tendini i perbashket i tyre, tendini i (Akilit), kalkaneusit (*tendo calcaneus*) fiksohet ne kalkaneus.

■ **Muskujt fleksore te gishtave** jane m. flexor digitorum longus (*m. flexor digitorum longus*) dhe m. flexor hallucis longus (*m. flexor hallucis longus*), te dy te shtreses se thelle.

Grupi lateral i muskujve te kembes, qe vendoset ne kompartimentin lateral te tij (*compartimentum cruris laterale*), perfshin muskuj qe bejne perkulje nga jashtë te kembes. Ata fillojne ne fibula dhe perfundojnë ne tarse e metatars.

■ **Muskujt fibulare** jane dy, longus dhe brevis (*m. fibularis longus* e *m. fibularis brevis*).

**Muskujt e kembes** vendosen ne anen dorsale te kembes dhe bejne **ekstension** te gishtave, ne anen plantare dhe bejne fleksion te tyre ose Jane muskuj nderkockore.

Fasciet e gjymtyres se poshtme veshin muskujt e saj.

■ **Fascia lata** (*fascia lata*) vesh muskujt e kofshes. Lateralisht ajo trashet dhe formon traktin iliotibial (*tractus iliotibialis*). Septumet e saj e ndajne kofshen ne tre kompartimente, anterior, posterior e medial.

■ **Fascia krurale** (*fascia cruris*) vesh muskujt e kercirit. Ajo jep septume qe ndajne kercirin ne tre kompartimente, anterior, posterior e lateral.

■ **Fasciet e kembes** jane nje ne anen dorsale (*fascia dorsalis pedis*) dhe nje ne anen plantare (*aponeurosis plantaris*).

**Kanali femoral** eshte zone (virtuale) e tranzicionit nga hapesira pelvike ne gjymtyren e siperme. Ne kete zone gjenden disa ligamente qe martin pjese ne formimin e lakunes vazore e lakunes muskulore dhe po ashtu te kanalit femoral.

■ **Lakuna vazore** (*lacuna vasorum*) e **lakuna muskulore** (*lacuna muscularum*) gjenden ne kufirin midis hapesires abdominale dhe kofshes; saktesisht midis ligamentit inguinal dhe buzes kockore te pelvisit. Nga ligamenti inguinal drejt pektenit te kockes pubike shkon ligamenti lakunar (*lig. lacunare*) qe vazhdon mbi pekten si *lig. pektineal* (*lig. pectineum*), ndersa midis ligamentit inguinal dhe eminences iliopektine qjendet harku iliopektin (*arcus iliopectineus*). Ne kete menyre formohet nje hapesire medialishti harkut iliopektin, qe quhet lakuna vazore dhe nje hapesire tjeter lateralisht tij, qe quhet lakuna muskulore. Ne lakuna vazore dhe nje hapesire medialishti harkut iliopektin, qe quhet lakuna muskulore kalon m. iliopsoas dhe n. femoral, ndersa ne lakunen vazore a. dhe v. femorale.

■ **Kanali femoral** (*canalis femoralis*) gjendet prapa dhe nen *lig. inguinal*. Ai eshte kanal potencial, pra normalisht ne te nuk kalon ndonje formacion anatomik. Kanali behet real kur ne te kalon permbajtje abdominale, qe formon hernien. Ajo kalon ne vendin me te dobet te lakunes vazore, midis *lig. lacunar* dhe *v. femorale* (qe mbylltet vetem nga *fascia transversale*) duke formuar hapjen e brendshme te kanalit femoral. Muret e kanalit formohen perpara nga *lig. inguinal*, medialishti nga *lig. lacunar*, prapa nga *lig. pektineal* dhe lateralishti nga *v. femorale*. Hernia del nga kanali ne kofshe, nen *lig. inguinal* ne zonen me te dobet femorale. Hernia del nga kanali ne kofshe, nen *lig. inguinal* ne zonen me te dobet femorale. Hernia del nga kanali ne kofshe, nen *lig. inguinal* ne zonen me te dobet femorale. Hernia del nga kanali ne kofshe, nen *lig. inguinal* ne zonen me te dobet femorale.

#### Fakte klinike

##### Injekzionet intramuskulare

Injekzionet intramuskulare jane nje menyre shume e shpeshte e dhenjes se medikamenteve ne praktiken mijekesore. Ajo nenkupton injektimin e medikamentit direkt ne muskul dhe vendi me tipik per kete eshte regjioni gluteal.

Ky regjion mund te ndahet ne kuadrante nga dy linja imaginare. Njera prej tyre zbere vertikalish qe pika me e siperme e kreshtes iliake drejt tuberit iskiadik, ndersa

tjetra eshte horizontale ne mesin e gjatesise se linjes se pare. Vendimi i sigurte i injekzionit eshte pjesa e perparme e kuadrantit te siperm lateral, meqe ne te nuk kalojne formacione neurovaskulare.

Gjate injekzionit ne kete nivel, gjilpera arrin ne m. gluteal te mesem.

##### Herniet femorale

Herniet femorale ndodhin kur permbajtja abdominale kalon ne kanalin femoral. Ato gjenden nen ligamentin inguinal ne pjesen mediale te tij, megjithate shpesha eshte e veshtere te diferencohen nga herniet inguinale.

Herniet femorale jane me te shpeshta tek femrat, zakonisht te moshuarat. Hernia paraqitet si fryrje ne rreze te kofshes, e shqeruar ose jo me dhimbje. Jo rralle keto hernie inkarcerohen dhe nderhyrja kirurgjikale eshte e pashmangshme.

**Organet ndihmese** jane **gjendrat e peshtymes** qe prodhojne peshtyme, e cila ndihmon mekanikisht formimin e shukut ushqimor dhe kimikisht vepron mbi perberesit e tij, si dhe dy **gjendra te medha**, (hepari e pankreasi), qe prodhojne leng biliar e leng pankreatik, te cilet ndihmojne procesin e tretjes. **Gjendra te tjera te vogla** jane te shperndara ne mukozen e tubit digestiv.

## GOJA

**Goja** (*os*) eshte fillimi i tubit digestiv. Hapesira e gojes (*cavitas oris*) dhe perbehet nga dy pjese: pjesa hyrese, vestibulum (*vestibulum oris*) dhe pjesa tjeter, vete hapesira e gojes (*cavitas oris propria*).

**Vestibulumi** eshte nje hapesire e vogel qe kufizohet nga jashte me buzet (*labia oris*) e faqet (*buccae*) dhe nga brenda me gingivat (*gingivae*) e dhembet (*dentes*). Ai komunikon me ambientin e jashtem nepermjet hapesires midis buzeve ose rimes orale (*rima oris*). Ne vestibulum derdhet sekrecioni i dy gjendrave parotide.

**Vete hapesira e gojes** kufizohet nga perpara dhe anash me gingivat dhe dhembet, poshte ka dyshemene qe formohet nga dy muskujt mylohoide, ndersa siper ka qiellzen (*palatum*), qe ndahet ne qiellzen e forte (*palatum durum*) dhe qiellzen e bute (*palatum molle*). Kjo hapesire prapa komunikon me faringun nepermjet istmusit orofaringeal ose istmus faucium (*isthmus faucium*). Ne te gjendet gjuha (*lingua*) dhe derdhet sekrecioni i gjendres submandibulare dhe i gjendres sublinguale.

■ **Buzet**, e sipermjë dhe e poshtmjë, (*labium superius* e *labium inferius*) rethojne rimen orale, qe ne secilen ane ka kedin e gojes (*angulus oris*). Buzet kane nga jashte nje pjesa te veshur me lekure, nga brenda nje pjesa te veshur me mukoze e midis tyre nje pjesa te ndermjetme me ngjyre te kuqe karakteristike. Siperfaqja e brendshme e seciles buze lidhet me gingiven perkatese ne linjen mediane, me nje pale te mukoze, frenulum (*frenulum*). Anash, buzet bashkohen me njera tjetren me ane te dy komisurave (*commissura labiorum*).

■ **Faqet** (*bucca*) jane vazhdim i buzeve, masen e tyre kryesore e formon m. bucinator. Nga brenda faqet vishen me mukoze, ndersa nga jashte me lekure nen te cilen gjendet nje sasi, tek femijet e konsiderueshme, indi dhjamor (*corpus adiposus buccae*). Ne mukozen e faqeve, ne nivelin e dhembit te dyte molar siper, gjendet papilla e duktusit parotid (*papilla ductus parotidei*).

■ **Gingivat** (*gingiva*) formohen nga ind fibroz te veshur me mukoze, qe rrethon qafat e dhembave.

■ **Dhembet** (*dentes*) tek njeriu dalin dy here. Ne femijeri (nga muaji 6 deri ne muajin 24) dalin dhembet e quimeshtit (*dentes decidui*) te cilet jane te perkohshem. Ata me pas (pas vitiit 6) zevendesohen nga dhembet e perhershem (*dentes permanentes*). Sipas pozicionit dhe formes se tyre dhembet ndahen ne incizive, kanine, premolare dhe molare (*dens incisivus*, *caninus*, *premolaris* e *molaris*). Dhembti molar i trete quhet dhembti i pjekurise (*dens serotinus*). Dhembet e quimeshtit jane 20 dhe formula dentare per to eshte 2.1.0.2 pra dy incizive, nje kanin, (nuk ka premolare) dhe dy molare. Dhembet e perhershem jane 32 dhe formula dentare per to eshte 2.1.2.3 pra dy incizive, nje kanin, dy premolare dhe tre molare.

Çdo dhemb ka rrenjen, qafen dhe kuroren.

**Rrenja** (*radix dentis*) eshte pjesa e dhembit qe futet ne alveole; ajo vishet me periost. Dhembet mund te kene nje rrenje (incizivet, kaninet, premolaret), dy rrenje (molaret e poshtem) ose tre rrenje (molaret e siperem).

**Qafa** (*cervix dentis*) eshte pjesa ndermjetese midis rrenjes dhe kurores; ajo mbulohet nga gingiva.

**Kurora** (*corona dentis*) eshte pjesa e dukshme e dhembit. Ajo ka formen e daltes (incizivet), formen e konit (kaninet) ose formen e prizmit (premolaret, molaret). Kurora ka disa faqe. Faqja e drejtuar nga vestibulumi i gojes quhet faqja vestibulare (*facies vestibularis*), faqja e drejtuar nga gjuha quhet faqja linguale (*facies lingualis*), faqja e drejtuar nga dhembti fqinje quhet faqja e kontaktit, ndersa faqja qe sheh nga dhembet e nofulles tjeter quhet faqja pertypese (*facies occlusalis*); kjo mungon tek incizivet (kthehet ne buze) dhe kaninet (kthehet ne majë), ndersa tek premolaret dhe molaret ka forme katerkendeshe me tuberkula.

**Hapesira e dhembit** (*cavitas dentis*) gjendet ne brendesi te tij; ajo ka pjesen e kurores (*cavitas coronae*) dhe pjesen e rrenjes (*canalis radicis dentis*).

Ne hapesiren e dhembit gjendet pulpa e dhembit (*pulpa dentis*) e perbere nga ene gjaku e fije nervore.

Masen kryesore te dhembit e formon **dentina** (*dentinum*). Ajo vishet ne rrenje nga **cementi** (*cementum*) dhe ne kurore nga **smalti** (*enamelum*).

■ **Qiellza** (*palatum*) formon tavanin e gojes; ajo perbehet nga dy pjese, nga qiellza e forte qe gjendet perpara dhe qiellza e bute qe gjendet pas saj.

**Qiellza e forte** (*palatum durum*) ka skeletin kockor, te formuar nga procesi palatin i maksiles dhe lamina horizontale e kockes palatine, ku aderohet shtresa e mukoze. Gjate linjes mediane ne qiellzen e forte ka nje qepje gjatesore (*raphe palati*), e cila perpara perfundon me papilen incizive (*papilla incisiva*), ku hapet kanali inciziv.

Siperfaqja ne pjesen e perparme te quellzes se forte eshte me plika, ndersa ne pjesen e pasme e lemuar.

**Quellza e bute** (*palatum molle, velum palatinum*) gjendet pas quellzes se forte, ne vazhdim te saj dhe varet si perde midis hapesires se gojes dhe faringut. Buza e poshtme e quellzes se bute ne linjen mediane paraqet nje zgjatje konike te quajtur uvula (*uvula palatina*). Ne secilen ane te saj, quellza e bute formon dy harqe, njerin te perparshem ne drejtim te rrenjes se gjuhes, harkun palatoglos (*arcus palatoglossus*) dhe tjeterin te pasem ne drejtim te faringut, harkun palatofaringeal (*arcus palatopharyngeus*). Midis tyre gjendet fosa tonsilare (*fossa tonsillaris*), ne te cilen vendoset tonsila palatine (*tonsilla palatina*).

Quellza e bute formohet nga nje flete aponeurotike (*aponeurosis palatina*) dhe muskujt qe fiksohen ne te; ata jane pese ne secilen ane.

M. tensor veli palatini (*m. tensor veli palatini*) fillon ne bazen e kafkes, vazhdon me tendin qe kalon ne majen e procesit pterigoid dhe pastaj duke u kthyer medialisht perfundon ne aponeurozen palatine. Tkurrja e ketij muskuli e terheq (tendos) anash quellzen e bute.

M. levator veli palatini (*m. levator veli palatini*) fillon gjithashtu ne bazen e kafkes, zbret drejt quellzes se bute dhe perfundon ne aponeurozen palatine. Tkurrja e tij e ngre lart dhe prapa quellzen e bute.

M. i uvuleve (*m. uvulae*) eshte nje tufe e vogel muskulore qe fillon ne bazen e kafkes, ne linjen mediane plekset me muskulin e anes tjeter dhe dy muskujt formojne zgjatimin me te njejtin emer. Tkurrja e tyre shkurton uvelen.

M. palatoglos (*m. palatoglossus*) fillon nga aponeuroza palatine dhe zbret nen harkun palatoglos, duke perfunduar ne rrenjen e gjuhes. Tkurrja e tij ngushton istmus faucium.

M. palatofaringeal (*m. palatopharyngeus*) gjithashtu fillon nga aponeuroza palatine, zebret nen harkun palatofaringeal dhe perfundon ne murin lateral te faringut. Tkurrja e tij ngre faringun.

• **Istmus faucium** eshte kufiri midis hapesires se gojes dhe hapesires se faringut. Siper ai ka quellzen e bute, poshte rrenjen e gjuhes dhe ne dy anet harqet palatoglose. Harqet palatoglose, harqet palatofaringeale dhe tonsilat palatine quhen edhe gryka (*fauces*).

• **Gjuha** (*lingua*) eshte organi kryesor i shijes si dhe organ i rendesishem i te folurit. Nga ana tjeter ajo ndihmon ne perzjerjen dhe percjelljen e ushqimit.

Gjuha perbehet nga maja (*apex linguae*), qe formon pjesen e perparme te drejtuar kundrejt inciziveve te poshtem, trupi (*corpus linguae*), qe formon pjesen me te madhe dhe rrenja (*radix linguae*), qe formon pjesen e pasme.

Gjuha gjithashtu ka faqen e siperme dhe faqen e poshtme. Faqja e siperme (*dorsum linguae*) ka nje brazde gjatesore (*sulcus medianus linguae*), qe prapa

perfundon me foramen cekum (*foramen caecum linguae*) dhe nje brazde tjeter me formen e shkronjes V te hapur nga perpara me maje ne foramen cekum, te quajtur sulkusi terminal (*sulcus terminalis*).

Sulkusi terminal e ndan faqen e siperme ne nje pjese te perparme me vendosje horizontale, qe ze dy te tretat e gjuhes dhe nje pjese te pasme me vendosje vertikale, qe ze nje te treten e saj.

Ne pjesen e perparme te faqes se siperme te gjuhes gjenden papila te shumta (*papillae linguales*), te cilat sipas pamjes ndahen ne papila filiforme, papila fungiforme, papila valate dhe papila foliate. Ato (perveç papilave filiforme) jane te pajisura me receptore te shijes.

Ne pjesen e pasme te faqes se siperme te gjuhes ka grumbullime te indit limfoid, qe formojne tonsilen linguale (*tonsilla lingualis*).

Faqja e poshtme e gjuhes (*facies inferior linguae*) ka gjate linjes mediane nje plike te mukozeve, frenulum (*frenulum lingue*) dhe anash saj nga nje plike me te vogel, pliken sublinguale (*plica sublingualis*), ne te cilen gjendet papila sublinguale (*caruncula sublingualis*).

Gjuha eshte organ muskular; ne linjen mediane ajo ka nje septum fibroz (*septum linguae*) dhe ne secilen ane muskuj, te cilet jane te brendshem ose te jashtem.

Muskujt e brendshem te gjuhes fillojnë dhe perfundojnë ne gjuhe.

M. longitudinal superior (*m. longitudinalis superior*) gjendet nen mukozen e faqes se siperme dhe shtrihet ne gjithe gjatesine e gjuhes, nga rrenja ne maje.

M. longitudinal inferior (*m. longitudinalis inferior*) gjendet nen mukozen e faqes se poshtme te gjuhes dhe gjithashtu shtrihet nga rrenja ne maje.

M. transversal (*m. transversus linguae*) perbehet nga fije qe fillojnë nga septumi i gjuhes dhe perfundojnë ne anet e saj.

M. vertical (*m. verticalis linguae*) perbehet nga fije qe kalojne nga faqja e siperme e gjuhes ne ate te poshtme.

Veprimi i muskujve te brendshem te gjuhes ndryshon formen e saj, e zgjat ose shkurton ate, e sheshon ose e trash dhe e harkon nga siper ose poshte.

Muskujt e jashtem te gjuhes fillojnë jashtë gjuhes dhe perfundojnë ne te.

M. genioglos (*m. genioglossus*) fillon nga spina mentale dhe perhapet vertikalish si freskore ne gjithe gjatesine e gjuhes nga apeksi ne rrenje. Eshte muskul i rendesishem per funksionin e gjuhes, tkurrja e dy muskujve formon nje ulluk gjatesor ne faqen e siperme te gjuhes (gjate thithjes), ndersa tkurrja e fijeve te pasme terheq perpara rrenjen e gjuhes duke nxjerre jashtë majen e saj (gjate perqeshjes).

M. hioglos (*m. hyoglossus*) fillon nga kocka hioide, ngjitet siper e perpara dhe perfundon ne gjuhe anash m. geniohioid. Tkurrja e tij e terheq gjuhen poshte e prapa.

M. stiloglos (*m. styloglossus*) fillon ne procesin stiloid, zebret perpara poshte dhe perfundon ne gjuhe, anash m. hioglos. Tkurrja e tij e terheq gjuhen prapa e siper.

M. palatoglos (*m.palatoglossus*) fillon nga aponeuroza palatine dhe zbrer nen harkun palatoglos duke perfunduar ne rrenjen e gjuhes. Tkurja e tij ngushton istmus faicum.

■ **Gjendrat e peshtymes** (*glandulae oris*) ne hapesiren e gojes jane te shumta. Gjendra te vogla jane te shperndara kudo ne mukoze, ndersa te medha jane tre çifte, gjendra parotide, gjendra submandibulare dhe gjendra sublinguale.

**Gjendra parotide** (*glandula parotidea*) eshte me e madhja nga gjendrat e peshtymes, ajo vendoset prane veshit te jashtem. Siper ajo arrin ne nivelin e harkut zigomatik, poshte ne nivelin e kendit te mandibules, prapa ne m. sternokleidomastoid dhe perpara mbeshtetet mbi pjesen e pasme te m. maseter. Gjendra ka pjesen siperfaqesore (*pars superficialis*) me te madhe dhe pjesen e thelle (*pars profunda*) me te vogel, qe arrin prane tufes neurovaskulare te qafes. Ne kufirin midis dy pjesave te gjendres kalon n. facial.

Gjendra parotide e mbledh peshtymen ne duktusin parotid (*ductus parotideus*), i cili shkon horizontalisht perpara mbi m. maseter, ne buzen e perparime te tij kthehet medialisht, shpon m. bucinator qe sherben si sfinkter per te dhe hapet ne vestibulum e gojes ne papilen parotide ne nivelin e molarit te dyte siper.

**Gjendra submandibulare** (*glandula submandibularis*) eshte me e vogel se gjendra parotide, vendoset ne trekendeshin submandibular te qafes nen m. milohioid dhe mbeshtetet ne fosen submandibulare te mandibules.

Gjendra submandibulare e mbledh peshtymen ne duktusin submandibular (*ductus submandibularis*), i cili kalon prapa m. milohioid dhe hapet ne dyshemene e hapesires se gojes ne papilen sublinguale.

**Gjendra sublinguale** (*glandula sublingualis*) eshte me e vogla nga gjendrat e medha te peshtymes, ajo vendoset ne dyshemene e hapesires se gojes, nen pliken sublinguale, mbi m. milohioid dhe mbeshtetet ne fosen sublinguale te mandibules. Gjendra sublinguale e mbledh peshtymen ne disa duktuse, disa prej tyre bashkohen duke formuar duktusin sublingual major (*ductus sublingualis major*), qe derdhet bashke me duktusin submandibular ne papilen sublinguale, ndersa te tjeret si duktuse sublinguale minore (*ductus sublinguales minores*) derdhen te veçante per gjate plikes sublinguale.

## FARINGU

**Faringu** (*pharynx*) eshte pjese e tubit digestiv qe vendoset prapa hapesires se hundes, hapesires se gojes dhe laringut. Ai sherben si rruge e perbashket per ushqimin dhe ajrin.

Faringu fillon siper ne bazen e kafkes, poshte arrin ne nivelin e vertebres C6 (dhe kercit krikoid), prapa ka trupat vertebrata cervikale, ndersa lateralisht muret e tij kane kontakt me tufen neurovaskulare te qafes.

Faringu per aresye pershkruese ndahet ne **tre pjesë**, perkatesisht ne pjesen nazale, pjesen orale dhe pjesen laringeale.

**Pjeset e faringut** emertoohen ne baze te raporteve qe ato kane me hapesiren nazale, hapesiren orale dhe laringun.

■ **Pjesa nazale** e faringut (*pars nasalis pharyngis*) ose nazofaringu eshte kati i siperi i faringut mbi nivelin e qellzes se bute. Ai komunikon perpara me hapesiren nazale nepermjet koaneve. Ne murin lateral te nazofaringut gjendet hapja faringeale e tubit auditiv (*ostium pharyngeum tubae auditivae*) e rrethuar nga prapa nga torusi tubar (*torus tubarius*), prane te cilite ka ind limfoid qe formon tonsilen tubare (*tonsilla tubaria*). Hapja faringeale e tubit auditiv ve ne komunikim nazofaringun me hapesiren e veshit te mesem, duke mbajtur te njeje presionin ne dy anet e membranes timpanike per te mundesuar amplituden maksimale te lekundjeve te saj. Ne kufirin midis murit te siperim dhe murit te pasem te nazofaringut gjendet nje grumbullim indi limfoid, me i theksuar ne femieri, qe quhet tonsila faringeale (*tonsilla pharyngealis*).

(Tonsila linguale, dy tonsilat palatine, dy tonsilat tubare dhe tonsila faringeale rrethojne si unaze mbrojtse rrugen e futjes se ajrit dhe ushqimeve ne organizem.)

■ **Pjesa orale** e faringut (*pars oralis pharyngis*) ose orofaringu eshte kati i mesem i faringut nga niveli i qellzes se bute deri ne nivelin e hyrjes ne laring. Ne pjesen e perparime ai komunikon me hapesiren e gojes nepermjet istmus faicum. Kufiri midis orofaringut dhe nazofaringut konsiderohet si istmisi faringeal. Qellza e bute, ndonese eshte pjese e hapesires se gojes, ka lidhje edhe me faringun. Ajo sherben si “valvul”, qe kur ngritet lart mbyll istmusin faringeal duke ndare nazofaringun nga orofaringu, ndersa kur ulet poshte mbyll istmus faicum duke ndare hapesiren e gojes nga orofaringu.

■ **Pjesa laringeale** e faringut (*pars laryngea pharyngis*) ose laringofaringu eshte kati i poshtem i faringut nga niveli i hyrjes ne laring deri ne nivelin e kalimit te faringut ne ezofag. Ne pjesen e perparime ai komunikon me laringun nepermjet aditusit te laringut (*aditus laryngis*), anash te cilite gjenden dy receset piriforme (*recessus piriformis*) neper te cilite kalojne ushqimet per te zbritur ne ezofag.

**Muri i faringut** formohet nga shtresa e mukozes (*tunica mucosa*), shtresa e submukozes (*tela submucosa*) e shtresa muskulare (*tunica muscularis*) dhe perforcohet nga fascia faringeale.

**Shtresa muskulare** perbehet nga muskuj me drejtim cirkular te fijeve, keta jane muskuj konstriktore dhe muskuj me drejtim gjatesor te fijeve.

■ **Muskujt konstriktore** jane tre ne secilen ane dhe emertohen sipas pozicionit te tyre, perkatesisht m. konstriktor superior (*m. constrictor pharyngis superior*), m. konstriktor i mesem (*m. constrictor pharyngis medius*) dhe m. konstriktor inferior (*m. constrictor pharyngis inferior*). Ata fillojne perpara ne kockat ose kercet qe ndodhen ne muret laterale te hapesires se hundes, gojes dhe laringut, ndersa prapa bashkohen me muskujt e anes tjeter ne linjen mediane. Tkurrja e njekohshme e muskujve konstriktore ngushton hapesiren e faringut, ndersa tkurria e njepasnjeshe e tyre nga siper poshte zbret shukun ushqimor drejt ezofagut.

■ **Muskujt gjatesore** jane gjithashtu tre ne secilen ane, m. stiloferingeal, m. salpingofaringeal dhe m. palatofaringeal. M. stiloferingeal (*m. stylopharyngeus*) fillon ne bazen e kafkes ne procesin stiloid dhe zbret duke perfunduar ne murin e faringut. M. salpingofaringeal (*m. salpingopharyngeus*) fillon ne nazofaring prane torusit tubar dhe zbret ne murin lateral te faringut. M. palatofaringeal (*m. palatopharyngeus*), qe eshte edhe muskul i qiellzes se bute, fillon nga aponeuroza palatine, zbret nen harkun palatofaringeal dhe perfundon ne murin lateral te faringut. Tkurrja e muskujve gjatesore te faringut e ngre lart ate.

**Fascia faringeale** perbehet nga dy flete, qe veshin nga brenda dhe jashte muskujt e faringut, duke perfunduar murin e tij.

## EZOFAGU

**Ezofagu** (*oesophagus*) eshte pjesa me e ngushte e tubit digestiv, ai shtrihet nga faringu ne stomak. Ezofagu fillon ne nivelin e vertebres C6 (kercit krikoid), zbret perpara trupave vertebruale ne qafe, toraks e abdomen dhe perfundon ne stomak ne nivelin e vertebres T11. Gjate rruges se tij ai perserit perkuljet e kolones vertebruale dhe kalon ne qafe, toraks e abdomen.

**Pjeset e ezofagut**, ne te cilat ai ndahet per aresye pershkruese. Jane pjesa cervikale, pjesa torakale dhe pjesa abdominale.

■ **Pjesa cervikale e ezofagut** (*pars cervicalis*) eshte e shkurter, ajo prapa ka trupat e dy vertebrave te fundit cervikale, perpara ka trakene dhe anash lobet e gjendres tiroide e tufen neurovaskulare te qafes.

■ **Pjesa torakale e ezofagut** (*pars thoracica*) eshte pjesa me e gjate, ajo kalon ne mediastinin e siperm dhe ne mediastinin e (poshtem te) pasem. Ne mediastinin e siperm ezofagu ka prapa trupat vertebrale, perpara trakene (dhe bifurkacionin e saj) dhe anash dy pulmonet e veshura nga pleura. Ne mediastinin e pasem ezofagu ka prapa trupat vertebrale, perpara atriumin e majte te zemres dhe majtas aorten torakale. Gjithastu ne murin e ezofagut zbresin n. vag i majte dhe n. vag i djathje, te cilet rreth tij formojne pleksin ezofageal. Per te kaluar ne hapesiret abdominale ezofagu shpon diafragmen ne hiatusin ezofageal te saj, ne nivelin e vertebres T10. Ne nivelin e e kryqezimit te ezofagut me bifurkacionin e trakese gjendet ngushtimi i siperm i tij (*constrictio bronchoaortica*), ndersa ne nivelin e kalimit ne diafragme gjendet ngushtimi i poshtem i tij (*constrictio phrenica*).

■ **Pjesa abdominale e ezofagut** (*pars abdominalis*) eshte e shkurter, ajo kalon prapa lobit te majte te heparit dhe perfundon ne stomak.

**Muri i ezofagut** formohet nga shtresa e mukoze (*tunica mucosa*), shtresa e submukoze (*tela submucosa*), shtresa muskulare (*tunica muscularis*) dhe shtresa e adventicias (*tunica adventitia*).

■ **Mukoza** formon pala te shumta gjatesore qe ne prerje i jatin lumenit pamjen e nje ylli. Gjate kalimit te shukut ushqimor ezofagu tendoset dhe keto pala zhduken.

■ **Muskulatura** ka nje shtrese te brendshme cirkulare dhe nje shtrese te jashtme gjatesore. (Tkurrja e kombinuar e shtreses cirkulare dhe asaj gjatesore ne tubin digestiv quhet peristaltike, ajo mundeson percjelljen e shukut ushqimor neper kete tub). Ne nje te treten e siperme te ezofagut muskulatura eshte e striuar, ndersa me poshte e lemuar.

■ **Adventicia**, e perbere nga indi lidhor, eshte shtresa qe vesh nga jashte ezofagun.

Ajo mungon vetem ne pjesen abdominale te tij, e cila vishet nga seroza (*tunica serosa*).

## STOMAKU

**Stomaku** (*gaster*) eshte pjesa me e gjere e tubit digestiv; ai gjendet midis ezofagut e zorres se holle dhe ka pak a shume formen e shkronjes J. Stomaku vendoset ne hapesiren abdominale nen diafragme dhe projektohet ne epigaster dhe ne hipokondrin e majte. Kalimi i ezofagut ne stomak ndodh ne nivelin e vertebres T11, ndersa kalimi nga stomaku ne zorren e holle ne nivelin e vertebres L1.

Ne pamjen e jashtme te stomakut dallohen muret, kurvaturat dhe pjeset e tij.

■ **Muret** e stomakut jane muri anterior (*paries anterior*) e muri posterior (*paries posterior*); midis tyre gjenden **kurvaturat**, kurvatura e vogel (*curvatura minor*) djathtas dhe kurvatura e madhe (*curvatura major*) majtas.

■ **Pjeset** ne te cilat ndahet stomaku, per aresye pershkruese, jane kardia, fundusi, trupi dhe pilori. Kardia (*cardia*) eshte nje zone e vogel e tij rreth vendit ku ezofagu hapet ne stomak; kufiri midis tyre eshte ostium kardial (*ostium cardiacum*). Fundusi (*fundus*) eshte pjesa qe ndodhet mbi nivelin e kardias. Trupi (*corpus*) eshte pjesa me e madhe e stomakut. Pjesa pilorike (*pars pylorica*) eshte pjesa distale e stomakut dhe ndahet ne antrumin pilorik (*antrum pyloricum*) dhe kanalin pilorik (*canalis pyloricus*); kufiri midis kanalit pilorik dhe duodenit eshte ostium pilorik (*ostium pyloricum*).

Midis kardias dhe fundusit te stomakut gjendet incizura kardiale (*incisura cardialis*), ndersa midis trupit dhe pjeses pilorike, ne kurvatura minor, gjendet incizura angular (*incisura angularis*).

**Muri i stomakut** formohet nga shtresa e mukozes (*tunica mucosa*), shtresa e submukozes (*tela submucosa*), shtresa muskulare (*tunica muscularis*) dhe shtresa seroze (*tunica serosa*).

■ **Mukoza** ne stomakun e zbrazur formon plika (*plicae gastricae*) te shumta, te cilat per gjate kurvaturave jane paralel me to, ndersa ne pjesen tjeter te stomakut jane te çregullta. Lengjet (qe nuk kane aresye per te qendruar ne stomakun e zbratz) kalojne tranzit midis plikave gjatesore per gjate kurvatures se vogel per te kaluar ne zorren e holle. Ne stomakun e tendosur plikat zhduken.

Midis plikave te çregullta, ndodhen zona te siperfaqes se mukozes se stomakut (*areae gastricae*) ne te cilat hapen duktuset e gjendrave te tij; keto hapje (*foveolae gastricae*) nuk mund te shihen me sy te lire.

■ **Muskulatura** e stomakut perbehet nga tre shtresa, nje te jashtme gjatesore (*stratum longitudinale*), nje te mesme cirkulare (*stratum circulare*) dhe nje te

brendshme oblike (*fibrae obliquae*). Shtresa gjatesore vjen ne vazhdim te shtreses gjatesore te ezofagut, ajo eshte me e dendur per gjate kurvaturave dhe vazhdon ne zorren e holle. Shtresa cirkulare ndodhet ne gjithe pjeset e stomakut pavec fundusit, ndersa ne nivelin e pilorit ajo eshte shume dense dhe formon m. sfinkter pilorik (*m. sphincter pyloricus*), tkurja e te cilit pengon daljen e ushqimit nga stomaku ne duoden. Nderkohe ne nivelin e kardias nuk ekziston nje sfinkter i ngjashem anatomik qe te pongoje kthimin e ushqimit nga stomaku ne ezofag, por rolin e nje sfinkteri fiziologjik e luan kendi me te cilin ezofagu hapet te stomak (shkaktuar nga incizura kardiale). Fijet oblike te muskulaturese te stomakut kane formen e shkronjes U te permbysur dhe kalojne, mbi fundus, nga njeri mur i stomakut ne tjetrin.

■ **Seroza** eshte shtresa e jashtme e stomakut, qe eshte ne fakt peritoneumi visceral qe vesh stomakun.

■ Kjo veshje eshte pothuajse e plote, prandaj stomaku eshte organ **intraperitoneal**.

**Raportet e stomakut** me organet perreth varen nga shkalla e mbushjes se tij. Siper stomaku ka diafragmen, perpara mbeshtetet ne paretin anterior abdominal, prapa ka pankreasin, djathtas ka raport me faqen viscerale te heparit, majtas ka lienin dhe poshtë kolonin transvers.

**Ligamentet e stomakut** jane pjesa te peritoneumit qe formohen nga kalimi i tij midis stomakut dhe organeve fqinje. Nga kurvatura minor deri ne hepar peritoneumi formon lig. hepatogastric (*lig. hepatogastricum*), qe bashke me lig. hepatoduodenal (*lig. hepatoduodenale*) formojne omentum minus (*omentum minus*). Nga kurvatura major ne diafragme peritoneumi formon lig. gastrofrenik (*lig. gastrophrenicum*), ne lien lig. gastrolienal (*lig. gastrosplenicum*) dhe ne kolonin transvers lig. gastrokolik (*lig. gastrocolicum*); ky i fundit eshte pjesa e omentum majus (*omentum majus*).

### Fakte klinike

#### Hernia hiatale

*Hernia hiatale* ndodhet per aresye te relaksimit te diafragmes ne hiatusin ezofageal. Si pasoje fundusi i stomakut hernion ne mediastinin posterior. Hernia shoqerohet me refluks, qe per aresye te permbarjies acide mund te jape edhe ulceracione e hemoragji.

Trajimi eshte medikamentoz, ndonese nganjehere mund te nevojitet edhe nderhyrje kirurgjikale.

**Kanceri i stomakut**

Kanceri i stomakut eshte nje patologji malinje e shpeshte e traktit digestiv. Shenja te tij jane ndjenja e ngopjes se shpejte, hemoragjia qe çon ne anemi, dhimbja etj. Diagnostikimi behet me endoskopji dhe shoqerohet me marrje materiali per biopsi. Nqs. diagnostikimi eshte i hershem mund te behet rezekcion kirururgjikal kurativ, por zakonisht diagnoza eshte e vone dhe mbijetesha vetem disa muaj.

**ZORRA E HOLLE**

**Zorra e holle** (*intestinum tenuie*) eshte vazhdim i stomakut; ajo fillon ne ostiumin pilorik dhe perfundon ne valvulen ileocekale, ku fillon zorra e trashe. Gjatesia e zorres se holle eshte treth 7 m, ajo formon perkulje te shumta te cilat njihen si ansa (intestinale). Zorra e holle vendoset ne pjesen qendrore te hapesires abdominale, perpara ka paretin anterior abdominal, prapa ka paretin posterior abdominal, anash e siper rrethohet nga zorra e trashe, ndersa poshte ka organet pelvike.

Zorra e holle perbehet nga **tre pjesë**: duodeni, jejunumi dhe ileumi.

**Duodeni** (*duodenum*) eshte vazhdimi i stomakut dhe pjesa e pare, me e shkurter, me e gjere dhe me e fiksuar e zorres se holle.

■ **Ne pamjen e jashtme** forma e duodenit i ngjan nje patkoi; ai ka pjesen e siperme horizontale (*pars superior*) ose D1, pjesen zbritese (*pars descendens*) ose D2, pjesen e poshtme horizontale (*pars inferior*) ose D3 dhe pjesen ngjitese (*pars ascendens*) ose D4.

Pjesa superiore gjendet ne nivelin e vertebres L1, ajo fillon pas pilorit dhe arrin djathetas kolones vertebrale deri ne perkuljen e pare, fleksuren duodenale superiore (*flexura duodeni superior*). Ne kete pjese gjendet bulbi (*bulbus*) i duodenit.

Pjesa zbritese vazhdon deri ne perkuljen e dyte, fleksuren duodenale inferiore (*flexura duodeni inferior*). Ne lumenin e kesaj pjese gjendet papila duodenale major (*papilla duodeni major*) ne te cilen hapen duktusi i koledokut dhe duktusi pankreatik, si dhe papila duodenale minor (*papilla duodeni minor*) ne te cilen hapet duktusi pankreatik akcesor.

Ne vazhdim te saj eshte pjesa inferiore, e cila gjendet ne nivelin e vertebres L3; ajo kalon majtas kolones vertebrale, arrin perpara aortes dhe perfundon me perkuljen e trete.

Pjesa ngjitese eshte me e shkurter se pjeset e tjera, ajo ngjitet majtas aortes deri ne nivelin e vertebres L2 per te vazhduar me fleksuren duodenojejunale (*flexura duodenojejunalis*) dhe pastaj me jejunumin.

■ **Raportet** e duodenit me organet jane si me poshte. Ne anen e tij te brendshme duodeni rrethon koken e pankreasit. Pjesa e siperme ka raport me faqen viscerale te heparit dhe veziken biliare e uktusin e koledokut, pjesa zbritese me veshken e djathje e mezokolonin transvers, pjesa inferiore me vazat e medha, aorten e venen kava inferiore si dhe arterien e venen mesenterike superiore.

■ Duodeni ne raport me peritoneumin eshte organ **ekstraperitoneal** (perveç pjeses superiore dhe pjeses ascendent, pra pjesave me te shkurtra, qe jane intraperitoneale). Midis duodenit e heparit gjendet lig. hepatoduodenal, pjesa e omentum minus.

**Jejunumi** dhe **ileumi** (*jejunum, ileum*) perbejne pjesen tjeter te zorres se holle, pas duodenit; jejunumi konsiderohet te kete dy te pestat dhe ileumi tre te pestat e saj. Ndonesje jejunumi e ileumi nuk kane kufi anatomik ndares midis tyre, ato kane disa karakteristika te veçanta.

■ **Jejunumi** vendoset ne pjesen e siperme te abdomenit, me teper majtas linjes mediane dhe ansat e tij kane drejtim horizontal.

**Ne te kundert, ileumi** vendoset ne pjesen e poshtme te abdomenit, me teper djathetas linjes mediane me ansa ne drejtim vertikal.

Jejunumi eshte me i vaskularizuar, ai ka ngjyre me te kuqe. (Gjithashtu jejunumi ka paret me te trashe, vile me te shumta e me te medha dhe nyje limfatike solitare e aggregate me te pakte se ileumi).

■ Jejunumi dhe ileumi jane organe **intraperitoneale** pra vishen plotesisht prej peritoneumit.

Pjesa e peritoneumit nga zorra e holle ne paretin abdominal formon mezone e zorres se holle, mesenterin, qe eshte dublikature peritoneale ne te cilen kalojnë e gjaku dhe nerva.

**Muri i zorres se holle** ka ndertim pak a shume te ngjashem ne gjithe gjatesine e saj, pavaresisht nga ndarja e mesiperme ne pjesë.

Keshtu ai perbehet nga shtresa e mukozes (*tunica mucosa*), shtresa e submukozes (*tela submucosa*), shtresa muskulare (*tunica muscularis*) dhe shtresa seroze (*tunica serosa*).

■ **Mukoza** eshte me e trashe dhe me e vaskularizuar ne pjesen proksimale te zorres se holle. Ajo formon plika cirkulare (*plicae circulares*) dhe vile intestinale

(*villi intestinales*) qe projektohen ne lumenin e zorres, ndersa ne perberje te saj ka edhe nyje limfatike solitare (*noduli lymphoidei solitarii*) dhe aggregate (*noduli lymphoidei aggregati*) si dhe gjendra (*glandulae intestinales*).

Plikat jane ose jo te plota dhe sherbejne per te rritur siperfaqen e mukozes dhe per te pakesuar shpejtisine e kalimit te ushqimit ne zorre. Ato jane me te shpeshta e me te medha ne pjesen proksimale te zorres se holle, ndersa pakesohen distalisht derisa zhduken ne pjesen fundore te ileumit. Ne ndryshim nga plikat e stomakut, ato persistojne edhe kur zorret e holla distendohen.

Vilet Jane zgjatime te mukozes, shume te vaskularizuara; ato mund te shihen me sy te lire. Ashtu si plikat ato sherbejne per te rritur siperfaqen e mukozes dhe Jane me te shpeshta ne pjesen proksimale te zorres se holle e pakesohen distalisht.

Nyjet limfatike solitare Jane te shperndara ne gjithe mukozen e zorres se holle, por me te shpeshta Jane ne pjesen terminale te ileumit. Nyjet limfatike aggregate perbehen nga grumbullime nyjesh solitare, ato formojne pllaka me diameter disa centimetra dhe gjithashtu Jane me te medha e me te shpeshta ne ileum.

- » **Submukoza** perbehet nga ind i shkrifet lidhor, qe lejon ndryshimin e dimensioneve te zorres gjate peristaltikes.

- » **Muskulatura** e zorres se holle perbehet nga dy shtresa, ajo e jashtme gjatesore dhe ajo e brendshme cirkulare. Edhe muskulatura eshte me e dendur ne pjesen proksimale te zorres se holle.

- » **Seroza** eshte shtresa e jashtme e zorres se holle, e cila perben peritoneumin visceral qe vesh ate. Pjesa me e madhe e zorres se holle eshte intraperitoneale. Perjashtim ben vetem duodeni, i cili eshte ekstraperitoneal.

#### Fakte klinike

##### **Ulçera duodenale**

*Ulcerat duodenale* Jane nga semundjet e shpeshta te traktit digestiv.

Ato ndodhin me shpesh ne bulbin e duodenit. Negofteze ulcera zhvillohet ne paretin anterior te tij, kur perforohen shoqerohen zakonish me peritonit, ndersa negofteze ulcera zhvillohet ne paretin posterior te bulbit te duodenit shoqerohen zakonish me hemoragji.

Trajtimi medikamentoz i ulçerave duodenale konsiston ne dhenien e preparateve qe frenojne sekretimin acid te stomakut. Per shume kohe trajtimi kirurgjikal ka qene nje alternative e shpeshte; nderkohe qe sot injekimi antibakterial (kunder *Helicobacter pylori*) ka reduktuar ndjeshem formimin e ulçerave duodenale dhe trajtimet kirurgjikale te tyre.

## ZORRA E TRASHE

**Zorra e trashe** (*intestinum crassum*) eshte vazhdim i zorres se holle; ajo fillon ne nivelin e valvules ileocecale, perfundon ne anus dhe ndahet ne **kater pjeze** te cilat Jane cekumi, koloni, rektumi dhe kanali anal. Koloni nga ana e tij ka pjesen ascendente, transversale, descendente dhe sigmoide.

**Cekumi** (*caecum*) eshte pjesa e pare e zorres se trashe dhe pjesa me e gjere e saj; ai gjendet nen nivelin e hapjes se ileumit ne cekum. Kjo hapje (*ostium ileale*) ka formen e nje valvule nepermjet te ciles permbytja e zorres kalon nga ileumi ne cekum, por jo ne drejtim te kundert.

Cekumi vendoset zakonish ne fosen iliak te djathte dhe mbeshtetet ne m. iliak. Nganjehere ai mund te gjendet edhe me siper deri prane heparit ose me poshte ne pelvis.

Ne cekum fillon perthithja e ujit dhe elektroliteve (qe realizohet ne zorren e trashe), prandaj forma e tij eshte e pershtatur per mbajtjen e volumeve te medha gjysem te lengshme te permbytjes se zorres.

- » **Ne pamjen e jashtme** ne siperfaqen e cekumit dallohen tre tenie, te cilat fillojnë ne fundin e tij dhe vazhdojnë me tej ne zorren e trashe. Njera gjendet medialisht dhe eshte tenia mezokolike, e dyta vendoset lateralisht dhe eshte tenia omentale, ndersa e treta vendoset midis tyre ne siperfaqen anteriore te cekumit dhe eshte tenia libera. Ne vendin e fillimit te tre tenieve fillon nje zgjatim i holle me formen e krimbit qe quhet apendaksi vermiciform (*appendix vermiciformis*). Ai konsiderohet si organ rudimentar. Apendaksi ka nje gjatesi variabel, mesaterisht 6-7 cm, ndersa pozicioni me i shpeshte eshte ai retrocekal.

Heqja e apendiksit per aresye te inflamacionit te tij eshte nderhyrja me e shpeshte ne urgjencen kirurgjikale.

- » Cekumi dhe apendaksi zakonish Jane **intraperitoneale**.

**Koloni** (*colon*) eshte pjesa ne vazhdim e zorres se trashe; ai ndahet ne kolonin ascendent, kolonin transvers, kolonin descendant dhe kolonin sigmoid. Ne siperfaqen e kolonit dallohen tre teniet e pershkruara me siper.

- » **Koloni ascendent** (*colon ascendens*) fillon ne nivelin e ostiumit ileal dhe ngjitet ne regionin lumbar deri ne hipokondrin e djathte, per te vazhduar me fleksuren kolike te djathte ose fleksuren hepatike (*flexura coli dextra, flexura coli hepatica*). Ai ka perpara dhe lateralisht paretin abdominal, prapa mbeshtetet ne m. kuadrat lumbar dhe veshken e djathte, medialisht ka ansa te zorres se holle.

Koloni ascendent ne **raport me peritoneumin** eshte mezoperitoneal, ai vishet nga peritoneumi pjeserisht, vetem perpara dhe anash. Peritoneumi parietal ne paretin posterior abdominal vjen ne faqen mediale te kolonit ne nivelin e tenies mezokolike dhe pastaj vesh kolonin duke kaluar nga perpara deri ne nivelin e tenies omentale, ku edhe shkeputet prej tij per te vazhduar ne paretin anterior abdominal.

■ **Koloni transvers** (*colon transversum*) eshte pjesa me e gjate e zorres se trashe; ai gjendet pas fleksuren kolike te djathte dhe ka nje vendosje oblike deri ne fleksuren kolike te majte ose fleksuren lienale (*flexura coli sinistra, flexura coli splenica*). Koloni transvers perpara ka paretin abdominal, prapa pjesen zbritese te duodenit dhe pankreasin, djathetas heparin, majtas lienin siper stomakun dhe poshte ansa te zorres se holle.

Koloni transvers eshte **intraperitoneal**, ai vishet plotesisht nga peritoneumi qe vjen nga paretia posterior abdominal ne nivelin e tenies mezokolike te kolonit transvers. Intervali peritoneal nga paretia posterior abdominal ne kolonin transvers eshte dublikature peritoneale qe quhet mezokoloni transvers.

■ **Koloni descendant** (*colon descendens*) shtrihet nga fleksura kolike e majte deri ne planin e hyrjes ne pelvis ne nivelin e kreshtes iliake te majte, ku vazhdon me kolonin sigmoid. Ai, ashtu si koloni ascendent, ka perpara dhe lateralish paretin abdominal, prapa mbeshtetet ne m. kuadrat lumbar dhe veshken e majte, medialish ka ansa te zorres se holle.

Koloni descendant (si edhe koloni ascendent), eshte **mezoperitoneal**, ai vishet nga peritoneumi pjeserisht, vetem perpara dhe anash. Peritoneumi parietal ne paretin posterior abdominal vjen ne faqen mediale te kolonit ne nivelin e tenies mezokolike dhe pastaj vesh kolonin duke kaluar nga perpara deri ne nivelin e tenies omentale ku edhe shkeputet prej tij per te vazhduar ne paretin anterior abdominal.

■ **Koloni sigmoid** (*colon sigmoideum*) eshte vazhdimi i kolonit descendant, ai fillon ne nivelin e kreshtes iliake te majte dhe perfundon duke kaluar ne rektum ne nivelin e bashkimit rektosigmoidien. Ai vendoset ne pelvis, anash ka muret pelvike, prapa ka ureteret, poshte veziken urinare dhe uterusin tek femrat, siper ansa te zorres se holle.

Koloni sigmoid eshte **intraperitoneal**, ai vishet plotesisht nga peritoneumi qe vjen nga paretia posterior abdominal. Intervali peritoneal nga paretia posterior abdominal ne sigme eshte dublikature peritoneale dhe quhet mezosigme.

**Rektumi** eshte vazhdimi i kolonit sigmoid, ai shtrihet nga niveli i bashkimit rektosigmoidien deri ne nivelin e fleksures anorektale (*flexura anorectalis*), ku kalon ne kanalin anal. Rektumi prapa ka sakrumin dhe koksiksin, ndersa perpara tek femrat vaginen dhe tek meshkujt prostaten e vezikulat seminale. Ne pjesen e mesme rektumi ka nje zgjerim qe quhet ampula rektale (*ampulla recti*), mbi te eshte pjesa supraampulare dhe nen te pjesa infraampulare.

Me **peritoneum** vishet nga perpara dhe anash vetem nje e treta e siperme e rektumit.

**Kanali anal** (*canalis analis*) eshte pjesa fundore e tubit digestiv. Ai fillon ne nivelin e fleksures anorektale dhe perfundon ne anus (*anus*). Ne mukozen e kanalit anal vihen re 6-10 plika vertikale qe formojne kolonat anale (*columnae anales*), midis te cilave gjenden sinuset anale (*sinus anales*). Submukoza eshte e pasur me ene gjaku arteriale dhe venoze, keto te fundit formojne pleksin hemoroidal.

**Muri i zorres se trashe** ne menyre te ngjashme me ate te pjeses tjeter te tubit digestiv, perbehet nga shtresa e mukozes (*tunica mucosa*), shtresa e submukozes (*tela submucosa*), shtresa muskulare (*tunica muscularis*) dhe shtresa seroze (*tunica serosa*) ose shtresa e adventicies (*tunica adventitia*).

Karakteristika te veçanta ka ndertimi i murit te rektumit. Krasuar me zorren e holle, zorra e trashe ka diameter me te madh te lumenit, mur me te holle dhe me pak te vaskularizuar.

■ **Mukoza** e zorres se trashe nuk ka plika dhe vile, pra eshte me e lemuar. Gjendrat e saj jane me te shumta dhe me te dendura se ne zorren e holle. Ne rektum mukoza formon disa plika gjatesore dhe transversale. Plikat gjatesore ndodhen kryesisht ne pjesen e poshtme te rektumit dhe zhduken gjate tendosjes se tij. Plikat transversale (*plicae transversae recti*) me pamje semilunare zakonisht jane tre, e sipermjë, e mesmja dhe e poshtmja.

■ **Submukoza** eshte e ngjashme me ate te zorres se holle.

■ **Muskulatura** perbehet nga shtresa e jashtme gjatesore dhe shtresa e brendshme cirkulare. Ne cekum dhe ne kolon fijet gjatesore jane te kondensuara ne tre tenjet gjatesore, po ashtu edhe fijet cirkulare jane te kondensuara ne intervale midis te cilave zorra e trashe eshte me e fryre duke formuar hastrat e saj (*hausta coli*). Ne lumenin e zorres, hastrave u korrespondojnë sakula (qese) midis te cilave ka plika semilunare (*plicae semilunares coli*). Tenjet ne pjesen e fundit te kolonit sigmoid shkrihen duke vazhduar ne murin e rektumit me fije

gjatesore muskulare qe e veshin plotesisht ate. Muskulatura cirkulare e rektumit ne kanalin anal dendesohet dhe formon sfinkterin anal intern (*m. sphincter ani internus*). Rreth saj gjendet shtresa gjatesore e muskulatures dhe me pas sfinkteri anal ekstern (*m. sphincter ani externus*), i cili eshte nje muskul i vecante.

» Seroza eshte peritoneumi visceral qe vesh zorten e trashe. Ne kolon seroza formon zgjatime te vogla te mbushura me ind dhjamor qe quhen apendice epiploike (*appendices epiploicae*).

#### Fakte klinike

##### *Ekzaminim endoskopik i traktit digestiv*

Ezofagogastroduodenoskopja ose shkurt fibrogastroskopia eshte nje procedure diagnostike qe sherben per te ekzaminuar traktin digestiv deri ne duoden. Para futjes se endoskopit behet anestezi lokale e orofaringut me spray lidokaine. Nepermjet endoskopit kqyret mukoza e traktit digestiv dhe mund te merret material per biopsi. Pamjet endoskopike mund te fotografohen ose filmohen.

Kolonoskopia eshte nje procedure e ngjashme qe sherben per te ekzaminuar kolonin. Endoskopi futet nga anusi dhe me ane te tij vizualizohet mukoza dhe lezionet eventuale te saj: ulceracione, polipe etj. Nepermjet endoskopit mund te hiqen polipet e vogla, te merret material per biopsi etj. Edhe pamjet endoskopike gjate kolonoskopise mund te fotografohen ose filmohen.

##### Apendiciti akut

Apendiciti akut ndodhi kur lumeni i apendiksit obstruktohet nga nje fekalit ose nga zmadhim i nyjeve limfoide ne paretin e tij. Ne keto kushte rritet presioni brenda lumenit, veshtiresohet qarkullimi i gjakut ne paret, fillon nekroza e tij dhe rritet sasia e baktereve dhe invazioni bakterial i paretit. Ndryshimet inflamatorie mund te cojne ne perforim dhe peritonit lokal ose te gjeneralizuar.

Shenja e pare eshte nje dhimbje periumbilikale qe me pas lokalizohet ne fosen iliake te djathje dhe mbetet konstante. Shenja te tjera jane temperatura, nauzea, te vjellat etj.

Trajtimi i apendicitit akut zakonisht eshte apendektomia.

##### Kanceri i kolonit e i rektumit

Kanceri i kolonit e i rektumit eshte nje patologji malinje jo e rralle. Shume nga rastet vjne nga malinjizimi i nje polipi beninj.

Per aresye te raporteve topografike te kolonit e rektumit ne hapesireni abdominalpelvike, eshte shume i rendesishem stadiifikimi i sakte i tumorit, psh. ne pelvis duhet vleresuar infiltrimi eventual i vezikes urinare ose uterusit. Ky stadiifikim realizohet me metodat imazherike te ekzaminimit. Ai duhet te vleresoje shkallen e infiltrimit te paretit, perhapjen ne rruget limfatike dhe perhapjen ne distance. Keto te dhena lidhen ngushte me progozen e semundjes.

## HEPARI E RRUGET BILIARE

**Hepari (hepar)** ose melcia eshte organi me i madh abdominal, ai vendoset ne katin e siperm te hapesires abdominale dhe projektohet ne regjionin e hipokondrit te djathje e regjionin epigastrik, por mund te arrije edhe ne regjionin e hipokondrit te majte. Hepari ka shume funksione nga te cilet veçohet depozitimi i glucideve dhe prodhimi i lengut biliar, i cili nepermjet rrugeve biliare shkon dhe derdhet ne duoden.

Ne **pamjen e jashtme** hepari paraqet dy faqe, ate diafragmatike dhe ate viscerale. Midis tyre perpara gjendet nje buze e mprehte, ndersa prapa kufiri eshte i rrumbullakosur pa formuar nje buze te vertete.

» **Faqja diafragmatike** (*facies diafragmatica*) ose faqja anterosuperiore mbeshtetet ne diafragme. Ajo eshte e sheshte dhe ne te dallohet ligamenti falciform qe eshte dublikature peritoneale qe vjen nga pareti abdominal deri ne siperaqen e heparit. Ky ligament e ndan heparin ne lobin e djathje me te madh e lobin e majte me te vogel. Ne vazhdim te buzes se poshtme te lire te lig. falciform, ndodhet lig. teres hepatis (*lig. teres hepatis*). Dy fletet e ligamentit falciform ne pjesen e siperme te tij, largohen nga njera tjetra dhe ne secilen ane marrin pjese ne formimin e lig. koronar duke perbere fleten anteriore te tij. Anash kjo flete bashkohet me fleten posteriore duke formuar lig. triangular te djathje dhe lig. triangular te majte. Siperfaqja e heparit qe gjendet midis dy fleteve (anteriore e posteriore) te lig. koronar nuk vishet nga peritoneumi dhe quhet area nuda (*area nuda*).

» **Faqja viscerale** (*facies visceralis*) ose faqja posteroinferiore e heparit ka gjurmë te organeve qe kane raport me te. Ne te dallohen impresionet qe lene ezofagu (*impressio oesophageale*), stomaku (*impressio gastrica*), duodeni (*impressio duodenalis*), koloni transvers (*impressio colica*) dhe veshka e djathje (*impressio renalis*). Ne te dallohen gjithashtu tre brazda, dy sagitale dhe nje midis tyre; ato kane pamjen e shkronjes H. Brazda e djathje formohet perpara nga fosa e vezikes biliare (*fossa vesicæ biliaris*) dhe prapa nga sulkusi i venes kava inferiore (*sulcus venae cavae*). Brazda e majte formohet perpara nga fisura e lig. teres hepatic (*fissura ligamenti teretis*) dhe prapa nga fisura e lig. venoz (*fissura ligamenti venosi*). Brazda transversale midis tyre quhet porta hepatike (*porta hepatis*) meqe ne te kalojne struktura anatomike qe hyjne ose dalin nga hepari. Vendosja e ketyre strukturave ne porten hepatike eshte e tille: prapa gjendet v. porta, perpara medialisht a. hepatike propria dhe lateralisht duktus hepatici komun.

Brazdat e mesiperme e ndajne faqen viscerale te heparit ne kater lobe, lobin e djathte (*lobus hepatis dexter*), lobin e majte (*lobus hepatis sinister*) si dhe lobin kuadrat (*lobus quadratus*) e lobin kaudat (*lobus caudatus*); dy te fundit perkatesisht mbi e nen porten hepatike.

Midis fases diafragmatike dhe fases viscerale, perpara dhe poshte gjendet buza e poshtme, margoja inferiore (*margo inferior*).

■ Ne praktiken klinike ka rendesi **ndarja e heparit ne segmente**. Çdo segmenti i takon nje treshe vazobiliare e perbere nga dege te v. porta, duktusit biliar e arteries hepatike, ndersa kufijtë midis segmenteve percaktohen nga dege te venave hepatike. Sipas kesaj ndarjeje hepari ndahet ne tete segmente, qe emertohen me numra romake nga I ne VIII.

■ Ne raport me peritoneumin hepari konsiderohet **mezoperitoneal**; pjesa me e madhe e tij eshte e veshur plotesisht nga peritoneumi, perveç zones se quajtur area nuda.

**Rruget biliare** mbledhin dhe dergojne bilen nga hepari ne pjesen zbritese te duodenit. Ato perbehen nga duktuset biliare dhe vezika biliare.

**Duktuset biliare** formojne nje sistem qe fillon ne brendesi te heparit me duktuset biliare interlobulare (*ductus biliferi interlobulares*) ose segmentare, te cilet mbledhin lengun biliar nga kanalikulat biliare. Ato bashkohen ne duktusin hepatik te majte (*ductus hepaticus sinister*) dhe duktusin hepatik te djathte (*ductus hepaticus dexter*). Dy duktuset hepatike me tej bashkohen ne porten hepatike duke formuar duktusin hepatik komun (*ductus hepaticus communis*), i cili kalon midis dy fleteve te omentumit minus bashke me venen porta dhe arterien hepatike. Duktusit hepatik komun i bashkohet ne nje kend te ngushte duktusi cistik (*ductus cisticus*), i cili vjen nga vezika biliare, duke formuar keshtu duktusin e koledokut (*ductus choledochus*). Ky zbret prapa pjeses superiore te duodenit, pastaj ne faqen e pasme te kokes se pankreasit medialisht pjeses descendente te duodenit dhe pasi bashkohet me duktusin pankreatik derdhet ne papilen duodenale majore.

**Vezika biliare** (*vesica biliaris*) ose kolecista eshte rezervuar i biles, ajo vendoset ne fosen e saj ne faqen viscerale te heparit.

■ Ne pamjen e jashtme vezika biliare ka trupin (*corpus vesicae biliaris*), fundusin (*fundus vesicae biliaris*) dhe qafen (*collum vesicae biliaris*). Fundusi gjendet prapa buzes se poshtme te heparit; kur kolecista fryhet ai mbeshtetet ne paretin anterior abdominal dhe mund te palpohet. Trupi gjendet mbi fundusin dhe

mbeshtetet ne faqen viscerale te heparit. Qafa gjendet medialisht trupit, ajo eshte e perkultur dhe vazhdon me duktusin cistik.

■ Vezika biliare ne faqen e lire te saj qe nuk mbeshtetet ne hepar, vishet nga **peritoneumi**.

### Fakte klinike

#### Hepatiti viral

Hepatiti viral eshte inflamacioni i parenkimes hepatike shkaktuar nga viruset. Njihen disa lloje hepatitesh virale.

**Hepatiti A** perhapet me rruge orofekale dhe nuk kronicizohet. Konsiderohet si semundje e vendeve te botes se trete.

**Hepatiti B** perhapet me anen e gjakut te kontaminuar, te shiringave te kontaminuara ose ne rruge seksuale. Ai mund te komplikohet me hepatit kronik, cirroze etj. **Vaksinimi parandalon hepatitis B.**

**Hepatiti C** gjithashtu mund te perhapet me ane te gjakut te kontaminuar ose ne rruge seksuale. Edhe hepatiti C mund te komplikohet me hepatit kronik, cirroze etj.

Shenjat e hepatitit viral jane diskomfort i per gjithshem, dhimbje barku, ikter, temperature etj.

#### Cirroza hepatike

Cirroza eshte nje patologji hepatike qe karakterizohet nga fibroze e shprehur dhe zona regenerimi nodular ne hepar. Ajo zakonisht pason nje demitim paraekzistues ne hepar dhe mund te vije pas nje hepatiti viral, nga perdonim i shtuar i alkolist, nga çrregullime metabolike etj.

Cirroza shoqerohet me pengese ne qarkullimin intrahepatik te gjakut, likid ne hapesireni peritoneale, rritje te rrezikut per hemoragi, ikter etj.

#### Guret ne rruget biliare

Guret mund te gjenden ne çdo segment te rrugeve biliare, por me shpesh ato hasen ne koleciste. Ato jane nje perzierje kolesteroli e pigmenti biliar, por shpesh edhe mund te kalcifikohen. Guret ne koleciste gjenden me teper tek femrat se tek meshkujt dhe me teper ne moshen mbi 40 vjeç.

Per sa kohë guret jane ne koleciste mund te mos kene shenja klinike, por nese ato tentojne te kalojne ne duktusin cistik ose ne koledok dhe ngecin aty, kjo shoqerohet me dhimbje te forta (kolika biliare).

#### Ikteri

Ikteri eshte zverdhja e lekures nga rritja e perqendrimit te pigmentit biliar (bilirubines) ne gjak. Ai mund te vleresohet lehtesishet ne sklera.

Ikteri mund te jetë prehepatik, hepatik ose posthepatik.

Ikteri prehepatik ndodh nga shkaterrimi i shtuar i eritrociteve psh. ne rast transfuzioni te gabuar gjaku.

*Ikteri hepatik ndodh ne rast demtimi te qelizave hepatike psh ne hepatitet, cirroza etj.*

*Ikteri posthepatik ndodh ne rast obstruksioni te rrugeve biliare psh. ne rastin e gureve ne rruget biliare, ne kancerin e kokes se pankreasit etj.*

## PANKREASI

**Pankreasi** (*pancreas*) eshte gjendra tjeter e madhe e sistemit digestiv. Ai prodhon lengun pankreatik, qe derdhet ne duoden dhe insulinen, qe kalon ne gjak.

Pankreasi vendoset pak a shume horizontalisht, ai projektohet ne regjionin epigastrik dhe regjionin e hipokondrit te majte.

» Ne pamjen e jashtme pankreasi ka koken, qafen, trupin dhe bishtin.

**Koka** (*caput pancreatis*) eshte e sheshte, me nje faqe te perparme dhe nje te pasme. Ajo vendoset brenda "patkot" duodenal, duke patur raport me te gjitha pjeset e duodenit. Gjithashtu koka e pankreasit ka rapport te ngushte me duktusin e koledokut.

Ne pjesen e poshtme te kokes gjendet nje zgjatim i pankreasit, qe quhet procesi uncinat (*processus uncinatus*).

**Qafa** (*collum pancreatis*) konsiderohet intervali i vogel i pankreasit i vendosur midis kokes e trupit.

**Trupi** (*corpus pancreatis*) ka forme prizmatike me nje siperfaqe te perparme, nje te pasme dhe nje te poshtme. Siperfaqja e perpame ka kontakt me stomakun, e pasmja me kolonen vertebrale dhe e poshtmja vendoset mbi fleksuren duodenojejunale.

**Bishti** i pankreasit (*cauda pancreatis*) shtrihet majtas dhe arrin deri ne hilusin e lienit.

» **Duktusi pankreatik** (*ductus pancreaticus*) ose duktusi i Wirsungut shtrihet perjate gjithe gjendres, ai fillon ne nivelin e bishtit, vazhdon ne trup, qafe e koke dhe bashke me koledokun derdhet ne pjesen descendente te duodenit, ne papilen duodenale majore. Veç tij ne pankreas gjendet edhe duktusi pankreatik akcesor (*ductus pancreaticus accesorius*), i cili mbledh lengun pankreatik kryesisht nga koka e pankreasit dhe derdhet ne pjesen descendente te duodenit, i pavarur nga duktusi i pare.

» Ne report me peritoneumin pankreasi eshte **ekstraperitoneal**

## Fakte klinike

### Pankreatiti akut

Pankreatiti akut eshte inflamacioni akut i pankreasit. Shkaqet me te shpeshta jane abuzimi me alkool (tek meshkujt) dhe kalkulat e rrugeve biliare "te ngecur" ne fund te koledokut, prane papiles duodenale majore (tek femrat). Shenjet jane dhimbjet abdominale qe perhapen ne shpine, nauzeja, vjellja, temperatura etj. Veç demtive ne parenkimen pankreatike, pankreatiti akut mund te shoqerohet edhe me demtive ne vazat e gjakut rreth pankreasit dhe kjo mund ta rendoje shume ecurine e semundjes.

### Kanceri i pankreasit

Kanceri i pankreasit eshte nje patologji malinje qe zakonishi diagnostikohet vone, meqe shenjet e tij nuk jane specifike. Dhimbja e barkut, humbja e oreksit, renia ne peshe dhe ikteri gjenden edhe ne semundje te tjera. Kanceri i kokes se pankreasit diagnostikohet pas ikterit qe vjen nga infiltrimi i duktusit te koledokut, ndersa kanceri i bishtit ne kohen e diagnostikimit shoqerohet shpesh nga metastaza hepatike.

## PERITONEUMI DHE HAPESIRA PERITONEALE

**Peritoneumi** (*peritoneum*) eshte cipa seroze, e lemuar dhe e lagur, qe vesh paretin e brendshem abdominal dhe organet abdominale.

Pjesa e peritoneumit qe vesh paretin e brendshem abdominal quhet **peritoneumi parietal** (*peritoneum parietale*), pjesa qe vesh organet quhet **peritoneumi visceral** (*peritoneum viscerale*).

Hapesira midis peritoneumit parietal dhe peritoneumit visceral eshte **hapesira peritoneale**.

Pjesa e peritoneumit midis peritoneumit parietal dhe atij visceral qe shkon per te veshur organet quhet **mezó**; keshtu ajo per zorren e holle quhet **mezenterium** (*mesenterium*), per zorren e trashe quhet **mezokolon** (*mesocolon*) etj.

Gjate kalimit te peritoneumit nga nje organ ne tjetrin formohen **ligamentet**, qe mund te jene flete teke ose dublikatura.

» Nese ndjekim peritoneumin parietal nga pardi anterior abdominal dhe ngjitemi siper, verme re se pasi vesh paretin ai vesh faqen e poshtme te diafragmes dhe pastaj kthehet drejt faqes diafragmatike te heparit, dhe vazhdon si peritoneum visceral mbi te. Intervali peritoneal nga diafragma (peritoneum parietal) ne hepar (peritoneum visceral) eshte fleta anteriore e ligamentit koronar (*lig. coronarium*). Kjo fleta ne mesin e saj zbret e dyfishte ne faqen diafragmatike te heparit deri ne buzen e poshtme te tij, duke formuar ligamentin falciform (*lig. falciforme*). Nga ana tjeter fleta anteriore e ligamentit koronar ne secilin ekstrem te saj bashkohet

me fleten posteriore duke formuar ligamentin triangular te majte (*lig. triangulare sinistrum*) dhe ligamentin triangular te djathte (*lig. triangulare dextrum*). Peritoneumi visceral zbret ne faqen diafragmatike te heparit deri ne buzen inferiore, pastaj kthehet ne faqen viscerale te tij dhe arrin ne porten hepatike. Ketu ai bashke me peritoneumin (visceral) qe vjen nga faqja viscerale e heparit prapa portes, formon nje dublikature peritoneale qe shkeputet nga hepari dhe shkon drejt kurvatures minor te stomakut dhe drejt duodenit duke formuar ne kete menyre lig. hepatogastrik (*lig. hepatogastricum*) dhe lig. hepatoduodenal (*lig. hepatoduodenale*). Keto dy ligamente formojne se bashku omentumin minor (*omentum minus*), (meqe pjesa me e madhe e tij arrin ne kurvaturen minor). Dy fletet e omentumit minus serisht hapen pasi arrijne stomakun e pjesen superiore te duodenit per t'i veshur plotesisht ato.

Ne kurvaturen major dy fletet peritoneale ribashkohen dhe formojne nje dublikature tjeter e cila shkon poshte drejt kolonit transvers duke formuar lig. gastrokolik (*lig. gastrocolicum*), majtas drejt lienit duke formuar lig. gastrolienal (*lig. gastrolienale*) dhe siper drejt diafragmes duke formuar lig. gastrofrenik (*lig. gastrophrenicum*). Lig. gastrokolik eshte pjesa fillestare e omentumit major (*omentum majus*), (meqe fillon nga kurvatura major).

Lig. gastrokolik, pasi kalon perpara kolonit transvers, zbret duke arriut ne pjesen e poshtme te paretit anterior abdominal ku kthehet nga brenda dhe ngjitet perseri e lart duke formuar nje dublikature te dyfishte peritoneale (kater flete) deri ne kolonin transvers, e cila gjithashtu eshte pjesa e omentumit major. Dy fletet e dublikatureve se pasme ndahen ne nivelin e tenies omentale te kolonit transvers, e veshin plotesisht ate dhe ribashkohen ne nivelin e tenies mesokolike per te vazhduar se bashku drejt paretit posterior abdominal, si mezokoloni transvers (*mesocolon transversum*). Fleta e siperme e mezokolonit transvers vazhdon si peritoneum parietal ne paretin posterior abdominal duke shkuar siper nen diafragme, pastaj kthehet drejt faqes diafragmatike te heparit. Intervali peritoneal diafragme, pastaj kthehet drejt faqes diafragmatike te heparit. Intervali peritoneal diafragma (peritoneum parietal) ne hepar (peritoneum visceral) eshte fleta e lig. koronar. Dy fletet e lig. koronar kane nje distance midis tyre duke posteriore e lig. koronar. Ne fletet e lig. koronar pasi veshin plotesisht ne peritoneum (area nuda). Peritoneumi visceral pasi vesh faqen viscerale te heparit shkon ne porten hepatike, ku bashkohet me peritoneumin visceral qe vjen nga faqja viscerale e heparit perpara portes dhe formon omentumin minor. Fleta e poshtme e mezokolonit transvers vazhdon si peritoneum parietal ne paretin posterior abdominal deri sa shkeputet prej tij sipas nje linje te pjerret, per te marre pjesë ne formimin e mezenterit (*mesenterium*).

Nese ndjekim perseri peritoneumin parietal nga pareti anterior abdominal dhe zgresim poshte, veme re se ai formon pese plika. qe konvergojne ne umbilikus. Plika umbilikale mediane (*plica umbilicalis mediana*) eshte teke dhe shkon deri ne majen e vezikes urinare, plikat umbilikale mediale (*plica*

*umbilicalis medialis*) anash saj jane dy dhe akoma me anash jane dy plikat umbilikale laterale (*plica umbilicalis lateralis*). Ne secilen ane midis plikes umbilikale mediale dhe asaj laterale gjendet fosa inguinale mediale (*fossa inguinalis medialis*), ne te cilin projektohet hapja e jashtme e kanalit inguinal, ndersa lateralish plikes umbilikale laterale gjendet fosa inguinale laterale (*fossa inguinalis lateralis*), e cila i perket hapjes se Brendshme te kanalit inguinal.

Ne fund te paretit anterior abdominal peritoneumi parietal shkeputet prej tij dhe kalon drejt organeve pelvike. Fillimisht ai arrin ne veziken urinare, ku vesh fundusin dhe faqen posteriore te saj. Me pas raportet jane te ndryshme tek meshkujt dhe tek femrat. Tek meshkujt ai kalon ne siperfaqen e perparme te rektumit duke formuar midis tij dhe vezikes urinare ekskavacionin rektovesikal (*excavatio rectovesicalis*), qe eshte pjesa me e poshtme e hapesires peritoneale. Tek femrat ai arrin ne faqen anteriore te uterusit, pastaj vesh plotesisht ate dhe prapa edhe pjesen e siperme te vagines dhe pastaj shkon ne faqen anteriore te rektumit. Midis vezikes urinare dhe uterusit peritoneumi formon ekskavacionin vezikouterin (*excavatio vesicouterina*) dhe midis uterusit dhe rektumit ekskavacionin rektouterin (*excavatio rectouterina*) ose hapesiren e Douglasit, qe eshte pjesa me e poshtme e hapesires peritoneale.

Peritoneumi visceral qe vesh uterusin, ne dy anet e tij formon nga nje dublikature te quajtur lig. latum (*lig. latum uteri*), i cili siper vesh edhe tubat uterine e ovaret dhe shkon anash ne muret e pelvisit duke kaluar ne peritoneum parietal.

Ne dy sekset peritoneumi vesh pjesen e siperme te rektumit dhe sigmen. Dublikatura peritoneale nga sigma ne paretin abdominal quhet mezosigma (*mesocolon sigmoideum*).

Ne paretin posterior abdominal peritoneumi parietal ngjitet siper dhe me pas shkeputet prej tij sipas nje linje te pjerret duke formuar, bashke me peritoneumin qe vjen nga siper, mesenterin (*mesenterium*) qe eshte dublikature peritoneale qe shkon per te veshur zorren e holle. Linja e kalimit nga peritoneum parietal ne mezenter, e pjerret nga siper majtas ne poshte djathtas, eshte rrenja e mezenterit (*radix mesenterii*).

Nese ndjekim serisht peritoneumin parietal nga pareti anterior abdominal dhe shkojme anash, veme re ndryshime midis raporteve te tij djathtas e majtas. Djathtas peritoneumi parietal vesh plotesisht cekumin dhe apendiksin; mezoja e ketij te fundit quhet mezoappendix (*mesoappendix*). Nderkohe vesh lateralish, perpara e medialish kolonin ascendent, pastaj ne paretin posterior abdominal i kalon nga perpara veshkes dhe ureterit te djathte per te perfunduar ne mezenter si fleta e djathte e tij. Majtas peritoneumi parietal arrin kolonin descendent qe e vesh njelloj si kolonin ascendent, pastaj ne paretin posterior abdominal i kalon nga perpara veshkes dhe ureterit te majte per te perfunduar ne mezenter si fleta e majte e tij.

**Hapesira peritoneale**, qe gjendet midis peritoneumit parietal dhe atij visceral, eshte ne fakt nje hapesire potenciale. Ajo bashke me hapesiren retroperitoneale jane pjese te **hapesires abdominale dhe pelvike** (*cavitas abdominis et pelvis*).

Hapesira peritoneale ndahet ne katin supramesokolik dhe katin inframezokolik. Kufiri midis dy kateve eshte koloni transvers dhe mezoja e tij.

**Kati supramesokolik** (mbi kolonin transvers dhe mezone e tij) perbehet nga disa hapesira qe komunikojne me njera tjetren. Ato jane hapesira subfrenike (nen diafragme), hapesira subhepatike (nen faqen viscerale te heparit), bursa omentale etj. Bursa omentale (*bursa omentalis*) eshte nje hapesire e vogel qe ka perpara peritoneumin qe vesh murin posterior te stomakut dhe lig. gastrokolik, prapa ka peritoneumin qe vesh murin posterior abdominal (para pankreasit), siper ka peritoneumin qe vesh lobin kaudat te heparit, poshte ka kolonin e mezokolonin transvers, majtas ka lig. gastrosplenik, ndersa djathtas ka foramen omentale (*foramen omentale*) ose foramen epiploike. Kjo foramen e cila gjendet prapa buzes se djathte te omentumit minor, eshte vendi i komunikimit te hapesires se vogel peritoneale te burses omentale, me pjesen tjeter (me te madhe) te hapesires peritoneale

**Kati inframezokolik** (nen kolonin transvers e mezone e tij) ndahet nga mezenteri ne hapesiren infrakolike te djathte dhe hapesiren infrakolike te majte. Pjesa me e poshtme e katis inframezokolik nganjehere konsiderohet edhe si kat pelvik, ndonese kjo ndarje nuk percaktohet nga struktura anatomike. Kati pelvik eshte vazhdimi ne pelvis i hapesires infrakolike te majte.

#### Fakte klinike

##### Perhapja peritoneale e semundjeve

Siperfaqja e madhe e peritoneumit dhe hapesires peritoneale lejon perhapje te shpejte e te lehte te semundjeve inflamatore e tumorale ne abdomen.

Peritoniti eshte inflamacioni i peritoneumit. Ai mund te jete i lokalizuar ose i gjeneralizuar dhe perben urgjence kirurgjikale. Shkak i tij zakonisht jane perforacionet e organeve me lumen. Shenjat kryesore te peritonitit jane dhimbja abdominale, mbrojtja abdominale, temperatura etj. Ne ekzaminimin e te semurit vleresohet sidomos simptomi Blumberg; nese shtypet me dore pareti abdominal provokon dhimbje, por heqja e menjehershme e dores shoqerohet me dhimbje akoma me te madhe nga rikthimi i menjehershem i peritoneumit ne pozicionin e meparshem.

Prekja tumorale e peritoneumit (zakonisht sekondare) ndodh nga invazioni i qelizave tumorale (psh. nga kanceri i kolonit ose i ovareve) dhe mund te shoqerohet me formacione me madhesi variabel ne te si dhe likid ne hapesiren peritoneale.

Çlirimi i gazit ne hapesiren peritoneale vjen nga perforimi i paretit te tubit digestiv. Ne keto raste nderhyrja kirurgjikale eshe e domosdoshme.

##### Asciti

Asciti eshte likidi i lire ne hapesiren peritoneale. Shkak mund te jete inflamacioni i peritoneumit, cirroza hepatike etj. Likidi ascitik mund te gjendet ne pjese te ndryshme te hapesires peritoneale. Me shpesht ai haset ne hapesiren subfrenike, subhepatike e pelvike.

## 6. SISTEMI RESPIRATOR

Hunda  
Laringu  
Trakea  
Bronket  
Mushkerite  
Pleura dhe hapesira pleurale  
Mediastini

Sistemi respirator (*systema respiratorium*) perbehet nga **hunda**, **laringu**, **trakea**, **bronket** dhe **mushkerite**. Ne fakt ajri ne rrugen e tij kalon edhe ne faring, por ai studiohet ne sistemin digestiv, meqe eshte edhe pjese e tij.

Sistemi respirator ka funksion te dyfishte. Funksioni kryesor eshte eshte percjellja e ajrit nga mjedisi i jashtem ne mushkeri nepermjet nje rruge te pajisur me skelet kockor ose kercor, qe siguron nje kalueshmeri te vazhdueshme te saj. Funksioni tjeter eshte ai fonator.

### HUNDA

**Hunda** (*nasus*) eshte pjesa fillestare e sistemit respirator, ne te cilen ajri i nenshtrohet pastrimit, ngrohjes dhe lageshtimit. Nga ana tjeter hunda i jep zerit timbrin e tij.

■ **Pjesa e jashtme e hundes** paraqet irrenjen (*radix nasi*), shpinen (*dorsum nasi*), majen (*apex nasi*) dhe flegrat (*ala nasi*). Skeleti i saj eshte pjeserisht kockor (proseset frontale te dy maksilave, kockat nazale) dhe pjeserisht kercet. Kercet marrin pjese ne formimin e flegrave te hundes dhe septumit te saj. Ne secilen ane ata jane kerci alar major (*cartilago alaris major*), kercet alare minore (*cartilagines alares minores*) dhe kerci i septumit nazal (*cartilago septi nasi*).

■ **Hapesira e hundes** (*cavitas nasi*) perbehet nga dy gjysma qe fillojne ne vrimat e hundes (*nares*), perfundojne me koanet (*choanae*) dhe ndahen nga njera tjetra me septumin nazal (*Septum nasi*). Ky septum zakonisht nuk gjendet tjetra me septumin nazal (*Septum nasi*). Ky septum zakonisht nuk gjendet tjetra me septumin nazal (*Septum nasi*). Ky septum zakonisht nuk gjendet tjetra me septumin nazal (*Septum nasi*). Ky septum zakonisht nuk gjendet tjetra me septumin nazal (*Septum nasi*). Ky septum zakonisht nuk gjendet tjetra me septumin nazal (*Septum nasi*).

Hapesira e hundes perbehet nga vestibulumi, pjesa olfaktore dhe pjesa respiratore. **Vestibulumi** (*vestibulum nasi*) gjendet menjehere pas vrimave te hundes dhe vishet me lekure (jo me mukoze si pjesa tjetër e hapesires se hundes).

**Pjesa olfaktore** (*pars olfactoria*), ne te cilën gjenden receptoret e nuhatjes, eshte relativisht e vogel dhe gjendet ne tavanin e hapesires se hundes.

**Pjesa respiratore** (*pars respiratoria*) eshte pjesa me e madhe dhe me e e vaskularizuar e hapesires se hundes.

Ne murin lateral te hapesires se hundes gjinden tre konka nazale, superiorja (*concha nasalis superior*), e mesmja (*concha nasalis media*) dhe inferiorja (*concha nasalis inferior*). Ato risin siperfaqen e kontaktit te ajrit me mukozen e hapesires se hundes. Midis konkave gjinden kanalet ose meatuset nazale. Nen konken e siperme gjendet meatusi nazal superior (*meatus nasi superior*), nen konken e mesme meatusi nazal i mesem (*meatus nasi medius*) dhe nen konken e poshtme meatusi nazal inferior (*meatus nasi inferior*). Ne keto meatuse hapen sinuset paranazale.

■ **Sinuset paranazale** (*sinus paranasales*) paraqiten si zgjerime te hapesires se hundes ne kockat qe rrrethojne kete hapesire. Ata vishen me te njejtën mukoze si hapesira e hundes, emertohen sipas kockave ne te cilat gjinden dhe hapen ne murin lateral te hapesires se hundes.

**Sinusi frontal** (*sinus frontalis*) gjendet ne kocken frontale, nen 1/3 mediale te harkut superciliar dhe hapet ne meatusin nazal te mesem.

**Sinusi maksilar** (*sinus maxillaris*) gjendet ne trupin e maksiles dhe hapet gjithashtu ne meatusin nazal te mesem.

**Sinusi sfenoidal** (*sinus sphenoidalis*) gjendet ne trupin e kockes sfenoidale dhe hapet ne meatusin nazal superior.

**Celulat etmoidale** (*cellulae ethmoidales*) gjinden ne kocken etmoidale dhe hapen ne meatusin nazal superior dhe meatusin nazal te mesem.

### Fakte klinike

#### Sinuziti

Sinuziti eshte inflamacioni i sinuseve paranazale dhe zakonisht shoqerohet me inflamacionin e mukozeve se hundes (rinit).

Pavareresisht nga sinusi i prekur dhimbja e kokes eshte shenja me e shpeshte. Veç saj sinuziti maksilar shoqerohet me dhimbje ne faqe, sinuziti frontal me dhimbje ne vetulla, sinuziti etmoidal me dhimbje midis syve, ndersa dhimbja e kokes nga sinuziti sfenoidal shpesh mund te mbetet pa shkak te njohur.

Sinuziti mund te jetë akut ose kronik. Sinuziti akut i nenshtrohet trajtimit medikamentoz, ndersa ai kronik shpesh ka nevoje per nderhyrje kirurgjikale.

### LARINGU

**Laringu** (*larynx*) fillon ne nivelin e vertebres C4 dhe perfundon ne nivelin e vertebres C6. Ai eshte, perveçse rruge e kalimit te ajrit, edhe organ i prodhimit te tingujeve.

■ **Skeleti i laringut** perbehet nga kerce qe artikulojne me njeri tjetrin. **Kerci krikoid** (*cartilago cricoidea*) eshte tek; ai eshte themeli (i palevizshem) i laringut mbë te cilin vendosen kercet e tjere (te levizshem).

**Kerci tiroid** (*cartilago thyroidea*) gjithashtu eshte tek, ka formen e nje libri te hapur me dy lamina (*lamina dextra* e *lamina sinistra*) dhe prominon ne qafe (*prominentia laryngea*). Ky kerc ka dy brire inferiore (*cornu inferius*), qe artikulojne me kercin krikoid dhe dy brire superiore (*cornu superius*).

**Kercet aritenoide** (*cartilago arytenoidea*) jane çift dhe vendosen mbi kercin krikoid. Ata kane formen e nje piramide me baze poshte. Secili kerc ka procesin vokal (*processus vocalis*) te drejtuar perpara e medialisht dhe procesin muskular (*processus muscularis*) te drejtuar prapa e lateralisht.

**Epiglotisi** (*epiglottis*) ka formen e nje rakete pingpong, bishti i se ciles kapet ne kercin tiroid, ne faqen e brendshme, ne kordin midis dy laminave. Ky kerc nuk kockezohet gjate jetes.

**Kocka hioide**, ndonese nuk eshte pjese e laringut, eshte e lidhur me kercet e tij.

■ **Artikulacionet e laringut** jane artikulacionet krikotiroide dhe artikulacionet krikoaritenoide.

**Artikulacionet krikotiroide** (*articulatio cricothyroidea*) realizohen midis kercit krikoid dhe brirete inferiore te kercit tiroid. Kerci i levizshem eshte ai tiroid, qe rrullohet rrreth nje boshti transversal.

**Artikulacionet krikoaritenoide** (*articulatio cricoarytenoidea*) realizohen midis kercit krikoid dhe kerceve aritenoide. Kerce te levizshem jane ata aritenoide, qe rrotullohen rrreh boshtit vertikal; gjate kesaj levizjeje proceset vokale afrohen ose largohen.

#### ■ Membranat e ligamentet e laringut lidhin midis tyre kercet e tij.

**Membrana fibroelastike** e laringut (*membrana fibroelastica laryngis*) kufizon hapesirene e laringut. Ajo perbehet nga dy pjesa, pjesa e siperme eshte membrana kuadrangulare, ndersa pjesa e poshtme eshte koni elastik.

Membrana kuadrangulare (*membrana quadrangularis*) fillon ne buzen laterale te epiglotisit dhe perfundon ne majen e kercit aritenoide dhe kedin midis dy laminave te kercit tiroid. Ajo ka te lire buzen e siperme dhe buzen e poshtme. Mukoza qe vesh buzen e siperme midis epiglotisit dhe kercit aritenoide formon pliken ariepiglotike (*plica aryepiglottica*). Buza e poshtme midis kercit aritenoide dhe kercit tiroid formon lig. vestibular (*lig. vestibular*) dhe mukoza qe e vesh ate pliken vestibulare (*plica vestibularis*) ose pliken vokale te rrreme. Hapesira midis dy plikave vestibulare eshte rima vestibulare (*rima vestibuli*).

Koni elastik (*conus elasticus*) fillon posht ne kercin krikoid dhe perfundon siper ne procesin vokal te kercit aritenoide dhe ne kedin midis dy laminave te kercit tiroid. Ai ka te lire buzen e siperme, qe midis majes se procesit vokal dhe kercit tiroid formon lig. vokal (*lig. vocalis*), ndersa mukoza qe e vesh ate dhe procesin vokal formon pliken vokale (*plica vocalis*) ose pliken vokale te vertete, e cila eshte paralele me pliken vokale te rrreme dhe nen te. Hapesira midis dy plikave vokale eshte rima vokale (*rima vocalis*).

**Lig. krikotrakeal** (*lig. cricotracheale*) gjendet midis unazes se pare te trakese dhe kercit krikoid.

**Lig. krikotiroid** (*lig. cricothyroideum medianum*) gjendet midis kercit krikoid dhe kercit tiroid.

**Membrana tirohioid** (*membrana thyrohyoidea*) gjendet midis buzes se siperme te kercit tiroid (e breve superiore te tij) dhe kockes hioide.

■ **Muskujt e laringut** realizojne levizjen e kerceve te tij. Ata ndahen ne tre grupe, ne muskuj qe ngushtojne ose zgjerojne rimen vokale, muskuj qe tendosin ose çtendosin ligamentet vokale dhe muskuj qe hapin ose myllin aditusin e laringut.

**Rima vokale** ngushtohet kur proceset vokale te kerceve aritenoide afrohen dhe zgjerohet kur ato largohen.

M. krikoaritenoid lateral (*m. cricarytenoideus lateralis*) fillon ne ne pjesen laterale te kercit krikoid dhe perfundon ne procesin muskular te kercit aritenoide. Tkurja e tij terheq procesin muskular lateralish (e perpara). ndersa procesi vokal shkon medialish (e prapa) duke afrouar plikat vokale dhe ngushtuar rimen vokale.

M. krikoaritenoid posterior (*m. cricoarytenoideus posterior*) fillon ne pjesen e pasme te kercit krikoid dhe perfundon ne procesin muskular te kercit aritenoide. Tkurja e tij terheq procesin muskular medialish (e prapa), ndersa procesi vokal shkon lateralish (e perpara), duke larguar plikat vokale dhe zgjeraur rimen vokale.

**Ligamentet vokale** tendosen ose çtendosen kur kercet aritenoide largohen ose afrohen me kercin tiroid.

M. krikotiroid (*m. cricothyroideus*) fillon tek kerci krikoid, shkon oblikisht siper prapa dhe perfundon ne kercin tiroid. Tkurja e tij e terheq kercin tiroid perpara (e poshtë) duke tendosur ligamentet vokale.

M. vokal (*m. vocalis*) eshte paralel me lig. vokal dhe vendoset midis procesit vokal te kercit aritenoide dhe kercit tiroid. Tkurja e tij çtendos ligamentet vokale.

M. tiroaritenoid (*m. thyroarytenoideus*) fillon ne kercin tiroid dhe perfundon ne kercin aritenoide. Tkurja e tij çtendos ligamentet vokale.

**Aditus i laringut** hapet kur epiglotisi ngrihet dhe mylllet kur epiglotisi ulet.

M. tiroepiglotik (pjesa e siperme e m. tiroaritenoid) fillon ne kercin tiroid dhe perfundon ne buzen laterale te epiglotisit. Tkurja e tij ngre epiglotisin, duke hapur aditusin e laringut.

M. ariepiglotik fillon nga kerci aritenoide dhe perfundon ne anen tjeter ne buzen laterale te epiglotisit. Tkurja e tij ul epiglotisin, duke myllur aditusin e laringut.

■ **Hapesira e laringut** (*cavitas laryngis*) gjendet midis dy membranave fibroelastike te tij. Kjo hapesire ka hapjen e siperme, qe eshte hyrja ne laring ose aditusi i laringut (*aditus laryngis*) midis dy plikave ariepiglotike dhe hapjen e poshtme ne nivelin e kercit krikoid, qe vazhdon me lumenin e trakese. Hapesira e laringut ndahet ne tre kate; kat i siperme eshte vestibulum i laringut, kat i mesem eshte ventrikuli i laringut dhe kat i poshtem eshte hapesira infraglotike.

**Vestibulum i laringut** (*vestibulum laryngis*) ka formen e nje koni te çrrregullt te permbsur, gjendet midis dy membranave kuadranguare, siper fillon ne aditusin e laringut dhe poshtë perfundon ne rimen vestibulare.

**Ventrikuli i laringut** (*ventriculus laryngis*) eshte hapesira e vogel midis rimes vestibulare dhe rimes vokale.

**Hapesira infraglotike** (*cavitas infraglottica*) ka formen e nje koni te çrrregullt me baze poshtë, gjendet midis dy koneve elastike, siper fillon ne rimen vokale dhe poshtë vazhdon me lumenin e trakese.

#### Fakte klinike

##### *Trakeostomia*

*Trakeostomia* konsiston ne hapjen e nje vrime ne trake dhe vendosjen ne te te nje tubi per te mundesuar kalimin e ajrit.

Ne rrethana urgjente trakeostomia mund te kryhet ne rastet e obstrukzionit te laringut (nga nje trup te huaj ose nga edema e shkaktuar nga nje reaksiun anafilaktik). Ne keto raste hapja behet ne lig. krikotiroid.

Ne trakeostomine e planifikuar (zakonisht pas nje nderhyrje per kancer te laringut) hapja behet ne unazen e dyte e te trete trakeale.

Pacientet me trakeostomi nuk mund te flasin, sepse ajri nuk kalon midis plikave vokale te tyre.

#### Kanceri i laringut

Kanceri i laringut zakonisht zhvillohet ne nivelin e rimes vokale (regioni glotik). Duhani eshte faktori me i rendesishem i rrezikut ne kete kancer. Shenja e pare e semundjes eshte ngjirja e zerit; veç saj kolla dhe nje ndjesi e pakendeshme ne gryke jane shenja te tjera.

Trajtimi i kancerit te laringut behet me kirurgji, radioterapi e kimioterapi; keto te kombinuara ose jo.

## TRAKEA

Trakea (*trachea*) ka formen e nje tubi elastik, me gjatesi rreth 10 cm, qe fillon ne nivelin e vertebres C6 dhe perfundon ne nivelin e vertebres T4.

Skeletin e saj e perbejne **kercet trakeale** (*cartilagines tracheales*), me formen e unazave jo te plota, qe ne pjesen e pasme plotesohen me fije muskulare (*m. trachealis*). Kercet e trakese lidhen midis tyre nepermjet **ligamenteve anulare** (*ligg. annularia*). Muri i pasem i trakese eshte membranoz (*paries membranaceus*).

Trakea perfundon me **bifurkacionin** e saj (*bifurcatio tracheae*), ne nivelin e te cilit gjendet karina trakeale (*carina tracheae*).

Gjate gjithe gjatesise se saj trakea ka prapa ezofagun. Ne qafe trakea rrrethohet perpara e anash nga gjendra tiroide, ndersa ne toraks ajo kalon ne mediastinin superior midis dy mushkerive.

## BRONKET

**Bronket** (*bronchi*) ne vazhdim te trakese jane dy, bronku principal i djathte dhe bronku principal i majte, te cilet pasi hyjne ne mushkerine perkatese degezohen duke marre pamjen e nje peme bronkiale (*arbor bronchialis*).

**Bronku principal** i djathte (*bronchus principalis dexter*) dhe bronku principal i majte (*bronchus principalis sinister*) Jane vazhdimi i trakese. Bronku principal i djathte eshte me vertikal, me i gjere dhe me i shkurter se i majti; per kete aresye trupat e huaj gjenden me shpesh djathtas. Ne mushkeri bronket principale degezohen ne bronke lobare.

**Bronket lobare** (*bronchi lobares*) ne mushkerine e djathte jane tre, superiori (*bronchus lobaris superior dexter*), i mesmi (*bronchus lobaris medius*) dhe inferiori (*bronchus lobaris inferior dexter*), ndersa ne mushkerine e majte jane dy, superiori (*bronchus lobaris superior sinister*) dhe inferiori (*bronchus lobaris inferior sinister*). Bronket lobare degezohen ne bronke segmentare.

**Bronket segmentare** (*bronchi segmentales*) Jane dhjete ne mushkerine e djathte dhe tete ne mushkerine e majte. Secili prej tyre degezohet ne **bronke intrasegmentare** (*bronchi intrasegmentales*) dhe keta vazhdojnë te degezohen deri ne **bronkiole** (*bronchioli*).

Muri i pemes **bronkiale** perbehet fillimisht nga unaza kercore dhe pak muskulature; me vazhdimin e degezimit unazat kercore fragmentohen si ishuj gjithnjë e me te vegjel te zhytur ne muskulature, derisa zhduken ne nivelin e bronkiolevë, pareti i te cileve perbehet vetem nga muskulature cirkulare.

## MUSHKERITE

**Mushkerite** (*pulmones*) vendosen ne hapesiren torakale. Ato Jane dy, mushkeria e djathte (*pulmo dexter*) dhe mushkeria e majte (*pulmo sinister*).

■ **Ne pamjen e jashtme** secila mushkeri ka formen e nje koni me bazen (*basis pulmonis*) dhe majen (*apex pulmonis*). Gjithashtu ka faqen kostale (*facies costalis*), faqen diafragmatike (*facies diaphragmatica*) e faqen mediastinale (*facies mediastinalis*) si dhe margon anteriore (*margo anterior*), margon inferiore (*margo inferior*) e margon posteriore, e cila eshte e shume e rrumbullakosur. Ne mushkerine e majte ne faqen mediastinale gjendet impresioni kardiak (*impressio cardiaca*) dhe ne margon anteriore incisura kardiakë (*incisura cardiaca*), nga prania e zemrës, e cila ben qe edhe vellimi i mushkerise se majte te jetë me i vogël. Ne faqen mediastinale te dy mushkerive gjendet hilumi pulmonar (*hilum pulmonis*) ku kalojne bronku, arteria dhe venat pulmonare, te cilat formojnë rrenjen e pulmonit (*radix pulmonis*).

Ne mushkerine e djathte dallohen dy fisura, ajo oblike (*fissura obliqua*) dhe ajo horizontale (*fissura horizontalis*). Ato e ndajne mushkerine e djathte ne lobin superior (*lobus superior*), lobin e mesem (*lobus medius*) dhe lobin inferior (*lobus inferior*). Ne mushkerine e majte dallohet vetem fisura oblike (*fissura obliqua*),

qe e ndan mushkerine ne lobin superior (*lobus superior*) dhe lobin inferior (*lobus inferior*).

Lobet e mushkerise ndahen me tej ne segmente bronkopulmonare.

■ **Segmentet bronkopulmonare** (*segmenta bronchopulmonalia*) jane zonat me te vogla te mushkerise, funksionalisht te pavarura, qe furnizohen nga bronku perkates segmentar. Ky bronk degezohet brenda segmentit deri ne bronkiolle dhe keta me tej deri sa arrihet ne siperfaqen respiratore te alveolave. Mushkeria e djathte ka dhjete segmente (aq sa bronke segmentare), perkatesisht segmentet I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII, IX e X. Mushkeria e majte ka tete segmente (aq sa bronke segmentare), perkatesisht segmentet I-II (nje segment), III, IV, V, VI, VII-VIII ( nje segment), IX e X.

## PLEURA DHE HAPESIRA PLEURALE

**Pleura** (*pleura*) eshte cipa seroze qe vesh mushkerite dhe paretin e hapesires torakale. Pjesa e pleures qe vesh mushkerite quhet pleura viscerale (*pleura visceralis*), ndersa pjesa qe vesh paretin e hapesires torakale quhet pleura parietale (*pleura parietalis*). Pleura viscerale kalon ne pleuren parietale ne hilumin pulmonar, ku vesh formacionet e rrenjes se pulmonit.

Pleura parietale perbehet nga pjesa kostale, pjesa diafragmatike, pjesa mediastinale dhe kupola e pleures.

**Hapesira pleurale** (*cavitas pleuralis*) gjendet midis pleures viscerale dhe pleures parietale; ne te gjendet nje sasi minimale lengu seroz, qe pakeson ferkimin gjate levizjeve respiratore. Midis pjeses kostale dhe pjeses diafragmatike te pleures parietale gjendet recessi kostodiafragmatik (*recessus costodiaphragmaticus*) ne te cilin fillon te grumbullohet likidi pleural ne rastet e inflamacionit te pleures.

## MEDIASTINI

**Mediastini** (*mediastinum*) eshte hapesira midis dy mushkerive, qe perpara ka sternumin, prapa trupat e vertebrave torakale, poshte diafragmen, kurse siper aperturen torakale superiore.

**Mediastini ndahet** ne mediastinin superior dhe mediastinin inferior nga plani qe kalon ne kedin sternal dhe diskun intervertebral midis C4 e C5.

■ **Mediastini superior** (*mediastinum superius*) permban gjendren e timusit, trakene, ezofagun si dhe venat brakiocefalike, venen kava superiore dhe harkun e aortes.

■ **Mediastini inferior** (*mediastinum inferius*) ndahet ne mediastinin anterior, mediastinin e mesem dhe mediastinin posterior.

**Mediastini i mesem** (*mediastinum medium*) permban zemren te veshur nga perikardi dhe fillimin e eneve te medha, qe hyne ose dalin nga zemra.

**Mediastini anterior** (*mediastinum anterius*) gjendet midis perikardit dhe sternumit.

**Mediastini posterior** (*mediastinum posterius*) gjendet midis perikardit dhe trupave vertebrale; ne te gjenden ezofagu, aorta descendente dhe duktusi torakal.

Ne mediastin mund te perhafen procese inflamatore nga hapesirat (potenciale) te qafes.

## Fakte klinike

### Bronkoskopia

Bronkoskopia indikohet per te vleresuar trakene dhe bronket. Bronkoskopi kalohet ne hunde, ne orofaring, larig, trake e bronke. Me ane te tij shihen lezione eventuale ne mukoze dhe mund te merret material per biopsi.

### Bronkiti, pneumonia, bronkopneumonia

Bronkiti eshte Inflamacioni i bronkeve. Ai mund te jetë akut ose kronik. Bronkiti akut shfaqet me kolle e gelbaze qe vazhdojnë deri disa javë, ndersa ne bronkitin kronik shenjat vazhdojnë me muaj.

Pneumonia zhvillohet kur inflamacioni ndodh ne nivelin e alveolave te cilat mbushen me likid, duke pakesuar siperfaqen e shkembimit te gazeve. Shkaktare te saj mund te jene bakteret ose viruset. Shenja tipike jane kolla, veshtiresia ne frysma marrje, temperatura etj. Trajimi eshte medikamentoz dhe varet nga shkaktari.

Bronkopneumonia eshte pneumoni e lokalizuar ne bronkiolle e alveola (inflamacioni kalon nga bronkiolat ne alveolat e aferta), me shpesh ne lobet e poshtme te mushkerive. Shenjat jane pak a shume ato te pneumonise, kolla, gelbaza, veshtiresia ne frysma marrje, temperatura etj. Trajimi eshte medikamentoz dhe varet nga shkaktari.

### Kanceri pulmonar

Kanceri pulmonar zhvillohet kryesisht tek piresit e duhanit. Per shume kohe ai ka dominuar tek meshkujt, por aktualisht edhe numri i femrave te prekura prej tij eshte duke u rritur shpejt; kjo spjegohet me rritjen e numrit te femrave duhanpirese.

Shenja te kancerit pulmonar jane dispnea, hemoptizia, kolla etj. Diagnoza vihet me bronkoskopi ose skaner dhe konfirmohet me biopsi.

Nqs. masa tumorale eshte nje nodul i vogel, ai mund te hiqet me nje nderhyrje kirurgjikale dhe progoza eshte shume e mire. Fatkeqesish shumica e rasteve paraqiten me masa te medha qe infiltrojne strukturat mediastinale ose pleuren dhe i nenshtrohen vetem radioterapise e kimioterapise. Po ashtu lezionet metastatike ne gjendrat suprarenale, hepar ose kocka nuk jane te rralle.

## 7. SISTEMI URINAR

Veshkat  
Ureteret  
Vezika urinare

**Sistemi urinar** (*systema urinarium*) perbehet nga veshkat dhe rruget urinare. Ureteret dhe vezika urinare jane pjesa te rrugeve urinare, te njejtë ne te dy sekset, ndersa uretra jo, bile tek meshkujt ajo eshte edhe pjesa e sistemit genital; per keto aresye studiohet ne sistemin genital.

### VESHKAT

**Veshkat** (*ren*) ekskretojne produktet fundore te metabolizmit dhe ujin e tepert te organizmit, duke kontrolluar dhe mbajtur ne balance perqendrimin e substancave te ndryshme ne lengjet e tij. Gjithashtu veshkat kane funksion endokrin; atjo prodhojne eritropoetine, renine etj.

Veshkat vendosen ne hapesiren retroperitoneale, anash kolones vertebrale dhe rrrethohen me ind dhjamor. "Llozha renale", formohet ne secilen ane nga m. kuadrat lumbar dhe m. psoas major. Veshka e djathte gjendet pak me poshte se e majta, meqe ka heparin mbi te. Aksi i gjate i seciles veshke nuk eshte vertikal; akset e dy veshkave konvergojnë siper.

\* **Ne pamjen e jashtme** veshka ka ngjyre te kuqe ne kafe. Ajo ka formen e fasules, me polin superior (*polus superior*), polin inferior (*polus inferior*), faqen anteriore (*facies anterior*), faqen posteriore (*facies posterior*) dhe marginon laterale (*margo lateralis*) e marginon mediale (*margo medialis*). Ne marginon mediale gjendet hilumi renal (*hilum renale*), ku kalon ureteri, arteria e *vena renale*.

\* **Ne prerje** ne veshke vihet re pjesa parenkimotoze e perbere nga korteksi renal dhe medula renale dhe pjesa fillestare e rruges urinare e perbere nga kalicet dhe pelvisi renal.

**Korteksi renal** (*cortex renalis*) eshte pjesa me periferike, ka ngjyre te kuqe dhe deperton ne brendesi te medules renale, duke formuar kolonat renale (*columnae renales*).

**Medula renale** (*medulla renalis*) eshte me e zbehte; ajo gjendet ne hapesiren midis kolonave renale dhe ka pamjen e piramidave (*pyramides renales*) me baze ne periferi. Maja e piramidave renale, e cila perfundon me arean kriroze (*area cribrosa*), projektohet si papile (*papilla renalis*) ne hapesiren e kaliceve minore.

**Kalicet renale** minore (*calices renales minores*) rrethojne papilat renale; ata jane vendi ku fillimisht vjen urina (nga vrimat e areas kriroze). Keto kalice vazhdojne me dy-tre kalice renale majore (*calices renales majores*), te cilat bashkohen ne pelvisin renal (*pelvis renalis*).

**Pelvisi renal** vazhdon me ureterin pa patur nje kufi anatomik te prerer me te.

\* **Raportet me organet** fqinje nuk jane te njejtë per te dy veshkat.

**Veshka e djathë** ka raport me gjendren suprarenale te djathë, me pjesen descendente te duodenit dhe fleksuren hepatike te kolonit. Gjithashtu ajo ka raport (e ndare nga peritoneumi) me faqen viscerale te heparit dhe zorren e holle.

**Veshka e majte** ka raport me gjendren suprarenale te majte, pankreasin e fleksuren lienale te kolonit. Gjithashtu ajo ka raport (e ndare nga fleta peritoneumi) me lienin, stomakun dhe zorren e holle.

**Fascia renale** (*fascia renalis*) vesh secilen veshkë dhe gjender mbiveshkore me një flete anteriore e një flete posteriore. Dy fletet bashkohen lateralisht dhe atashohen me peritoneumin parietal.

Midis fascies renale dhe siperfaqes se veshkes gjendet indi dhjamor perirenal (*capsula adiposa*), ndersa jashtë fascies renale gjendet indi dhjamor pararenal (*corpus adiposum pararenale*).

## URETERET

**Ureteret** (*ureter*) Jane tuba muskularc qe transportojne urinen nga veshkat ne veziken urinare.

\* **Ureteri ka tre pjesë;** pjesen abdominale, pjesen pelvike dhe pjesen intramurale.

**Pjesa abdominale** (*pars abdominalis*) gjendet ne hapesiren retroperitoneale, anash kolones vertebrale, mbi m. psoas major.

**Pjesa pelvike** (*pars pelvica*) ne nivelin e apertures pelvike superiore kryqezon a. iliake komune. Pastaj ajo harkohet nga brenda dhe perfundon ne veziken urinare.

**Pjesa intramurale** (*pars intramuralis*) eshte e shkurter dhe gjendet brenda trashesise se paretit te vezikes urinare.

\* **Ureteri ka tre ngushtime** gjate rruges se tij. Ngushtimi i pare eshte ne vendin e fillimit te tij pas pelvisit renal, ngushtimi i dyte ne nivelin e kryqezimit me a. iliake komune dhe ngushtimi i trete ne pjesen intramurale. Ky i fundit eshte edhe ngushtimi me i konsiderueshem dhe vend ku mund te ngecin guret e traktit urinar.

\* **Muri i ureterit** perbehet nga shtresa e mukozes (*tunica mucosa*), shtresa e muskulatures (*tunica muscularis*) dhe shtresa e adventicias (*tunica adventitia*).

## VEZIKA URINARE

**Vezika urinare** (*vesica urinaria*) eshte rezervuar i urines dhe madhesia, forma e relacionet e saj me organet e tjera ndryshojne ne varesi te mbushjes. Kur eshte e zbruzur ajo vendoset ne pelvis minor, ndersa kur mbushet kufiri i siperme ngjitet ne hapesiren abdominale.

\* **Ne pamjen e jashtme** vezika e zbruzur ka majen (*apex vesicae*), fundusin (*fundus vesicae*), trupin (*corpus vesicae*) dhe qafen (*cervix vesicae*). Nga apeksi drejt umbilikusit shkon lig. umbilikal median (*lig. umbilicale medianum*), mbi te cilin peritoneumi parietal i paretit anterior abdominal formon pliken umbilikale mediane. Fundusi eshte i drejtuar nga siper dhe vishet me peritoneum bashke me faqen posteriore te trupit. Ne kufirin midis fundusit dhe trupit futen ne vezike dy ureteret. Qafa e vezikes eshte pjesa me e fiksuar e saj dhe ne te hapet uretra. Vezika urinare mbeshtetet ne diafragmen pelvike (mm. levatore ani).

\* **Ne prerje** ne veziken urinare, ne siperfaqjen e brendshme duken ostiumet ku hapen ureteret (*ostium ureteris*) dhe uretra (*ostium uretræ internum*), te cilet kufizojne trekendeshin vezikal (*trigonum vesicae*).

\* **Muri i vezikes urinare** perbehet nga shtresa e mukozes (*tunica mucosa*), shtresa e submukozes (*tela submucosa*), shtresa muskulare (*tunica muscularis*) dhe shtresa seroze (*tunica serosa*) ose shtresa e adventicies (*tunica adventitia*).

Shtresa e mukozes ne veziken e zbrazur formon plika te shumta, perveçse ne trekendeshin vezikal, ku siperfaqja eshte e sheshte.

Shtresa e muskulatures formon mm. e trekendeshit vezikal (*mm. trigoni vesicae*) dhe m. detrusor (*m. detrusor vesicae*).

**Raportet e vezikes urinare** me organet e tjere jane te ndryshme tek meshkujt dhe tek femrat.

**Tek meshkujt** vezika urinare ka perpara simfizen pubike, siper ansa ileale, prapa rektumin dhe poshte prostaten.

**Tek femrat** vezika urinare ka perpara simfizen pubike, siper ansa ileale, prapa uterusin dhe vaginen.

#### Fakte klinike

##### Veshka ne forme patkoi

Veshka ne forme patkoi eshte nje çrregullim i lindur. Gjate tij dy polet e veshkave bashkohen perpara kolones vertebrale. Veshka ne forme patkoi nuk paraqet asnjë simptome te veçante dhe evidentohet vetem rastesisht.

##### Guret ne rruget urinare

Guret ne rruget urinare gjenden me teper tek meshkujt dhe zakonisht shoqerojne jeten sedentare. Guret mund te jene jo obstruktive (psh. te vendosur ne kalice) ose obstruktive (psh. te "ngecur" ne ureter). Ne rastin e dyte ato shoqerohen me dhimbje te forta (kolika renale) ne flank qe perhapen drejt rrezes se kofshes si dhe hematuri. Diagnostikimi i tyre nuk eshte i veshire. Trajtinii eshte litotripsi ose nese ajo deshton nderhyrja kirurgjikale.

## 8. SISTEMI GENITAL

Sistemi genital, ne fakt sistemet genitale, (*systemata genitalia*) jane te veçante per femrat dhe meshkujt; duke u perbere keshtu nga sistemi genital femeror dhe sistemi genital mashkullor.

Ne kete kapitull studiohet edhe uretra e perineumi, perkatesisht tek meshkijt e femrat.

## SISTEMI GENITAL FEMEROR

Ovaret

Tubat uterine

Uterusi

Vagina

Vulva

Uretra femerore

Sistemi genital femeror (*systema genitale femininum*) perbehet nga organet genitale te brendshme dhe organet genitale te jashtme.

Organet genitale te brendshme (*organa genitalia feminina interna*) jane ovaret, tubat uterine, uterusi dhe vagina.

Organet genitale te jashtem (*organa genitalia feminina externa*) perfshijnë vulven dhe perberesit e saj. Ne kete grup studiohet edhe uretra femerore.

## OVARET

**Ovaret (ovarium)** jane prodhuesit e vezeve tek femrat, homologe te testeve. Ata vendosen ne pelvis minor ne dy anet e uterusit. Siperfaqja e tyre eshte e lemuar para pubertetit, ndersa me pas ajo cikatrizohet.

- **Ne pamjen e jashtme** secili ovar ka ekstremitetin uterin (*extremitas uterina*) dhe ekstremitetin tubar (*extremitas tubaria*), faqen mediale (*facies medialis*) dhe faqen laterale (*facies lateralis*), buzen posteriore te lire (*margo liber*) dhe buzen anteriore mezovarike (*margo mesovaricus*).

- **Ne prerje** ovari ka shtresen kortikale (*cortex ovarii*) dhe shtresen medulare (*medulla ovarii*). Ne shtresen kortikale gjenden folikujt ovariale (*folliculi ovarici vesiculosi*) ne fazë te ndryshme te zhvillimit dhe mbeturinat e tyre: trupat e verdhe (*corpus luteum*), qe me vone kthehet ne trupa te bardhe (*corpus albicas*).

- **Ovaret kane rapport me** uterusin, tubat uterine dhe ansa ileale. Ovari i djathte gjithashtu ka rapport me cekumin, ndersa i majti me sigmen.

- **Ovaret jane intraperitoneale.** Peritoneumi qe vesh secilin prej tyre vjen si dublikature (*mesovarium*) nga fleta e pasme e lig. latum ne margin mezovarike i dhe ne siperfaqen e ovarit kthehet ne epitel germinativ. Nga ekstremiteti uterin i ovarit ne uterus peritoneumi formon lig. uteroovarial (*lig. uteroovaricum*) ose lig. ovarial (*lig. ovarii proprium*), ndersa nga ekstremiteti tubar ne murin pelvik lig. suspensor te ovarit (*lig. suspensum ovarii*).

## TUBAT UTERINE

**Tubat uterine** (*tuba uterina, salpinx*) gjenden ne secilen ane te uterusit, ne buzen e siperme te lig. latum.

- **Ne pamjen e jashtme ovaret paraqesin** nje hapje mediale ne kavitetin uterin, ostiumin uterin (*ostium uterinum tubae uterinae*) dhe nje hapje laterale prane ovarit, ne hapesiren peritoneale, ostiumin peritoneal (*ostium abdominale tubae uterinae*).

Secili tub ka pjesen intramurale (*pars uterina*), qe gjendet ne paretin e uterusit, istmusin (*isthmus tubae uterinae*) qe eshte pjesa me e ngushte me diameter qe arrin deri 1 mm, ampulen (*ampulla tubae uterinae*) qe eshte pjesa me e gjere e tubit, ku ndodh fertilizimi, me diameter qe arrin deri 1 cm dhe infundibulin (*infundibulum tubae uterinae*) me formen e nje hinke, qe perfundon me fimbrie

(*fimbriae tubae uterinae*), njera nga te cilat eshte me e gjate, fiksohet ne ekstremitetin tubar te ovarit dhe quhet fimbria ovarike (*fimbria ovarica*).

- **Muri i tubit uterin** perbehet nga shtresa e mukozes (*tunica mucosa*), shtresa e muskulatures (*tunica muscularis*) dhe shtresa e serozes (*tunica serosa*). Mukoza formon plika gjatesore (*plicae tubariae*).

- **Tubat uterine jane intraperitoneale.** Peritoneumi qe vesh secilin prej tyre vjen si dublikature (*mesosalpinx*) nga lig. latum.

## UTERUSI

**Uterusi (uterus)** eshte organ muskular dhe kavitar, qe jasht shtatzanise, vendoset ne pelvis minor.

- **Ne pamjen e jashtme** uterusi ka fundusin (*fundus uteri*), trupin (*corpus uteri*) dhe qafen (*cervix uteri*). Midis trupit e fundusit, vendet ku futen tubat uterine quhen briret e uterusit (*cornu uteri*). Qafa zhytet ne vagine me pjesen vaginalie (*portio vaginalis cervicis*) te saj, mbi te cilin eshte pjesa supravaginale (*portio supravaginalis cervicis*).

Ne brendesi uterusi ka hapesirene e tij (*cavitas uteri*), qe vazhdon ne qafe me kanalin e saj (*canalis cervicis uteri*), i cili hapet poshte ne vagine.

- **Muri i uterusit** ka shtresen e mukozes (*tunica mucosa*) ose endometrin (*endometrium*), shtresen muskulare (*tunica muscularis*) ose miometrin (*myometrium*) dhe shtresen e serozes (*tunica serosa*) ose perimetrin (*perimetrium*).

- **Raportet e uterusit** jane perpara me veziken urinare, prapa me rektumin, siper me ansa ileale e sigmen dhe poshte me vaginen (me te cilin formon nje kend rrith 90 grade). Ne secilen ane te uterusit gjendet lig. latum.

- **Uterusi eshte intraperitoneal.** Peritoneumi nga vezika urinare vjen ne faqen anteriore te uterusit, vesh plotesisht ate, pastaj vesh fundusin, faqen posteriore te uterusit si dhe pjesen e siperme te vagines dhe pastaj shkon ne faqen anteriore te rektumit. Midis vezikes urinare dhe uterusit peritoneumi formon ekskavacionin vezikouterin dhe midis uterusit dhe rektumit ekskavacionin rektouterin ose hapesiren e Douglasit, qe eshte pjesa me e poshtme e hapesires peritoneale.

Peritoneumi visceral qe vesh uterusin ne dy anet e tij formon nga nje dublikature te quajtur lig. latum. Lig. latum perbehet nga mezosalpinski qe shkon per te

veshur tubin uterin, nga mezoovari qe shkon per te veshur ovari dhe mezometri (*mesometrium*) qe shkon per te veshur uterusin, ndersa anash shkon ne murin e pelvisit duke kaluar ne peritoneum parietal.

Mbi lig. latum, ne nivelin e bririt uterin fillon lig. teres uteri (*lig. teres uteri*) qe shkon perpara drejt kanalit inguinal (prapa tij eshte lig. ovarian), ndersa nen lig. latum, ne qafen e uterusit fillon lig. kardinal (*lig. cardinale*).

**Ndryshimet ciklike ne uterus** (ovar e vagine) ndodhin ne periudhen e jetes riprodhuese (perveçse gjate gravidances dhe laktacionit). Çdo cikel zgjat 28 dite dhe ka fazen menstruale dhe fazen proliferative. Gjate fazes menstruale ndodh shkollitja e shtreses (siperfaqesore) funksionale te endometrit qe bashke me gjakun shoqerues eliminohet nepermjet vinges, ndersa gjate fazes proliferative shtresa funksionale e endometrit riformohet nen veprimin e estrogeneve te prodhuar nga ovari.

## VAGINA

**Vagina** (*vagina*) fillon poshte me ostiumin e saj (*ostium vaginae*), i cili mbyllte nga himeni (*hymen*), kalon ne hiatusin urogenital te diafragmes pelvike dhe perfundon siper me fornixin (*fornix vaginae*) ne te cilin zhytet pjesa vaginal e qafes se uterusit.

Vagina ka perpara uretren dhe prapa rektumin.

Pjesa e siperme e murit posterior te vinges vishet nga peritoneumi, i cili pastaj kalon ne rektum.

## VULVA

**Vulva** (*vulva*) ose pudenti (*pudentum femininum*) perfshin organet e jashtme genitale: mons pubis, buzet e medha, buzet e vogla dhe klitorisin.

**Mons pubis** (*mons pubis*) gjendet perpara simfizes pubike dhe formohet nga një mase indi dhjamor subutan.

**Buzet e medha** (*labium majus pudenti*) jane dy pala gjatesore te lekures, prapa mons pubis, qe kufizojne rimen pudentale (*rima pudenti*).

**Buzet e vogla** (*labium minus pudenti*) gjenden nen buzet e medha dhe kufizojne hapesiren e vestibulumit (*vestibulum vaginae*), ne te cilin gjendet ostiumi vaginal dhe hapja e jashtme e uretres.

**Klitorisi** (*clitoris*) gjendet perpara, ne vendin e bashkimit te dy buzeve te vogla dhe eshte homolog i penisit.

## URETRA FEMERORE

**Uretra femerore** (*uretra feminina*) fillon ne veziken urinare me hapjen e brendshme (*ostium urethrae internum*) dhe perfundon ne vestibulumin vaginal me hapjen e jashtme (*ostium urethrae externum*). Ndryshe nga uretra mashkulllore, ajo eshte e shkurter, e drejte, pa kthesa e ngushtime.

### Fakte klinike

#### Kanceri i ovarit

Kanceri i ovarit mund te zhvillohet ne çdo moshe por zakonisht ndodh ne grata e moshuara. Tumori mund te kete permbytje kistik, solide ose te perzier. Perhapja nepermjet gjakut dhe eneve limfatike shoqerohet me metastaza ne hapesirene peritoneale dhe prani likidi ne te. Shume raste diagnostohen ne kete faze te semundjes.

#### Ligatura e tubave uterine

Pas ovulacionit veza kalon ne tubin uterin dhe normalisht fertilizohet ne ampule, pastaj arrin ne hapesiren uterine ku ndodh implantimi ne paretin uterin.

Nje metode efektive per ndalimin e shtatzanive eshte ligatura e tubit uterin qe mund te kryhet gjate laparoskopise ose gjate seksiove cezariene.

#### Kanceri i qafes se uterusit

Kanceri i qafes se uterusit eshte nje semundje jo e rralle tek femrat. Diagnoza vihet me inspeksion, citologji e biopsi, ndersa stadifikimi i semundjes me ekzaminime imazherike. Trajtimi mund te jete rezekzioni lokal, heqja e uterusit (*hysterektomia*) dhe kimioterapija.

#### Barra ekstrauterine

Barra ekstrauterine ndodhi kur veza e fertilizuar nuk implantohet ne uterus, por jashtë tij. Ne 95% te rastev ajo implantohet ne tubin uterin, dhe ne raset e tjera ne ovar ose hapesirene peritoneale. Kjo ndodh zakonisht tek femrat mbi 35 vjeç, pas infeksioneve ne tubat uterine etj. Barrat uterine shoqerohen me dhimbje e hemoragi te brendshme, qe kerkojne underhyrje kirurgjikale te menjehershme.

#### “Sectio cesarea”

“*Sectio cesarea*” eshte lindja e femijes nepermjet nje incizioni te bere ne paretin anterior te abdomenit (*laparotomi*) dhe te uterusit (*histerotomi*). Kjo behet kur lindja ne rruge natyrale (nepermjet vagues) mund te rrezikoje shendetin e nenes ose femijes. Termi vjen nga latinishtja: “*caedere*” – pres. Nderhyrja klasike konsiston ne nje incizion te gjate median, ndersa aktualisht realizohet nje incizion transversal i shkurtër mbi veziken urinare.

Pavaresisht rreziqeve (si çdo nderhyrje kirurgjikale), numri i rasteve kur ajo kryhet per aresye jo mjekesore, eshte i larte.

## SISTEMI GENITAL MASHKULLOR

**Prostata**

**Testi e epididimisi**

**Duktusi deferens e vezikula seminale**

**Funikuli spermatik e skrotumi**

**Penisi**

**Uretra mashkullore**

**Sistemi genital mashkullor** (*systema genitale masculinum*) perbehet nga organet genitale te brendshme dhe organet genitale te jashtme.

**Organet genitale te brendshme** (*organa genitalia masculina interna*) jane testet e epididimiset, funikulat spermatike e duktuset deferente, gjendrat seminale dhe prosta.

**Organet genitale te jashtem** (*organa genitalia masculina externa*) perfshijnë skrotumin dhe penisin. Ne kete grup studiohet edhe uretra mashkullore.

### PROSTATA

**Prostata** (*prostata*) eshte organ tek, vendoset ne pelvis minor, nen veziken urinare dhe rrrethon uretren.

Ajo ka formen e geshtenjes me bazen siper (*basis prostateae*) dhe majen poshte (*apex prostateae*). Prostata ka faqen anteriore (*facies anterior*) e faqen posteriore (*facies posterior*), si dhe lobin e djathte (*lobus dexter*), lobin e majte (*lobus sinister*) dhe lobin e mesem (*lobus medius*).

**Prostata** formohet nga 30-40 gjendra te vecanta, komplekse, qe ne menyre te pavarur ne lumenin e uretres, derdhin lengun prostatik.

**Raportet e prostates** jane perpara me simfizen pubike, prapa me rektumin dhe siper me veziken urinare.

### TESTI E EPIDIDIMISI

**Testet** (*testis*) jane prodhuesit e spermatozoideve tek meshkujt, homologe te ovareve. Ne jeten fetale ata gjenden ne murin posterior te hapesires abdominale, pastaj para lindjes zgresin, kalojne neper kanalin inguinal dhe vendosen ne skrotum, ku testi i djathte zakonisht eshte me lart se i majti. Vendosja e testeve ne skrotum i siguron atyre nje temperaturë rreth 3 grade me te ulet se ajo e trupit; kjo eshte e domosdoshme per prodhimin e spermatozoideve cilesore.

■ **Ne pamjen e jashtme** secili test ka ekstremitetin superior (*extremitas superior*) e ekstremitetin inferior (*extremitas inferior*), faqen mediale (*facies medialis*) e faqen laterale (*facies lateralis*) dhe margin anteriore (*margo anterior*) e margin posteriore (*margo posterior*).

■ **Ne prerje** testi paraqet shtresen vaginal (tunica vaginalis testis), te prejardhur nga peritoneumi parietal dhe shtresen albuginea (tunica albuginea) qe jep septume (*septula testis*) ne brendesi, te cilat e ndajne testin ne lobule (lobuli testis). Ne lobule gjenden tubulat seminifere (tubuli seminiferi contorti e tubuli seminiferi recti), te cilet bashkohen ne rete testis (rete testis). Prej aty nisen duktulet eferente (ductuli efferentes testis) per ne epididimus.

**Epididimisi** (*epididymis*) vendoset prapa testit. Ai ka koken (caput epididymis) te perbere nga vazhdimi i duktuleve eferente te testit, te cilet bashkohen ne trupin e epididimisit (corpus epididymis) ne duktusin e epididimisit (ductus epididymis), qe vazhdon ne bishtin e epididimisit (cauda epididymis) dhe pastaj me duktusin deferens.

## DUKTUSI DEFERENS E VEZIKULAT SEMINALE

**Duktusi deferens** (*ductus deferens*) eshte eshte vazhdim i duktusit te epididimisit pas bishtit te tij. Ai ngjitet siper pergjate margos posteriore te testit, pastaj behet pjese e funikulit spermatik, ne perberje te te cilit kalon kanalin inguinal; pasi hyn ne hapesiren pelvike shkeputet nga funikuli spermatik, kalon midis vezikes urinare dhe seciles vezikul seminale per t'u futur ne prostate, ku bashkohet me duktusin e saj per te formuar duktusin ejakulator.

» **Pjeset e duktusit deferens**, atehere, jane pjesa skrotale (*pars scrotalis*), pjesa funikulare (*pars funicularis*), pjesa inguinale (*pars inguinalis*) dhe pjesa pelvike (*pars pelvica*).

» **Muri i duktusit deferens** perbehet nga shtresa e mukozes (*tunica mucosa*), shtresa e muskulatures (*tunica muscularis*) dhe shtresa e adventicies (*tunica adventitia*).

**Vezikulat seminale** (*vesicula seminalis*) gjenden ne secilen ane midis vezikes urinare dhe prostates. Secila prej tyre konsiderohet aneks i duktusit deferens.

Duktusi ekskretor i vezikules seminale (*ductus excretorius*) hapet ne murin lateral te pjeses fundore te duktusit deferens duke formuar duktusin ejakulator.

**Duktusi ejakulator** (*ductus ejaculatorius*) formohet ne secilen ane, ne bazen e prostates, nga bashkimi i duktusit ekskretor te vezikules seminale me duktusin deferens. Dy duktuset ejakulatore zbresin neper prostate duke konverguar dhe hapen ne pjesen prostatike te uretrës.

## FUNIKULI SPERMATIK E SKROTUMI

**Funikuli spermatik** (*funiculus spermaticus*) formohet kur testi zbret neper kanalin inguinal. Ai merr me vete duktusin deferens, vaza (arterien e venen testikulare) e nerva (pleksin testikular), te veshur nga shtresa te paretit abdominal, te cilet formojne funikulin spermatik. Keshtu aponeuroza e m. oblik ekstern vazhdon ne funikulin spermatik si fascia spermatike eksterne (*fascia spermatica externa*), fije te m. transvers vazhdojne si m. kremaster (*m. cremaster*) dhe fascia transverse vazhdon si fascia spermatike interne (*fascia spermatica interna*).

**Skrotumi** (*scrotum*) ka pamjen e nje qeseje ne te cilen vendosen testet. Ai ndahet ne dy gjysma nga nje rafe (*raphe scroti*). Nen lekure ndodhet fascia superficiale e tij, tunika dartos (*tunica dartos*) dhe m. dartos (*m. dartos*). Nen to, ne vazhdim te shtresave te funikulit spermatik gjenden fascia spermatike eksterne, m. kremaster dhe fascia spermatike interne.

## PENISI

**Penisi** (*penis*) eshte organi mashkullor i kopulimit. Ai ka rrenjen (*radix penis*), trupin (*corpus penis*) dhe glansin (*glans penis*). Mbi glans lekura formon nj epalosje qe quhet prepucium (*preputium penis*). Penisi perbehet nga dy trupa kavernoze (*corpus cavernosus penis*) dhe trupi spongioz (*corpus spongiosum penis*). Trupat kavernoze formojne pjesen me te madhe te penisit; ata kane hapesira te shumta qe gjate erekzionit mbushen me gjak. Trupi spongioz pershkohet nga uretra, e cila hapet ne pjesen e perparme te penisit, ne glans, me ostiumin e saj ekstern.

## URETRA MASHKULLORE

**Uretra mashkullore** (*uretra masculina*) fillon ne veziken urinare me hapjen e brendshme (*ostium urethrae internum*) dhe perfundon ne glans penis me hapjen e jashtme (*ostium urethrae externum*). Ndryshe nga uretra femerore, ajo eshte e gjate, me kthesa dhe ngushtime.

Uretra mashkullore ka pjesen prostatike, pjesen e ndermjetme dhe pjesen spongioze.

**Pjesa prostatike** (*pars prostatica*) pershkon prostaten ne drejtim vertikal. Ne mesin e saj gjendet kolikuli seminal (*colliculus seminalis*) anash te cilit hapen dy duktuset ejakulatore.

**Pjesa e ndermjetme** (*pars intermedia*) ose membranoze (*pars membranacea*) eshte e shkurter dhe gjendet ne nivelin e kalimit te utetres ne hiatusin urogenital te diafragmes pelvike.

**Pjesa spongioze** (*pars spongiosa*) eshte pjesa me e gjate e uretrës, gjendet brenda trupit spongioz te penisit dhe ben nje kend rreth 90 grade me dy pjeset e tjera te saj.

## PERINEUMI

**Perineumi** (*perineum*) eshte regjioni qe gjendet nen dyshemene pelvike, nen muskujt e diafragmes pelvike.

Ai ka formen e nje rombi te formuar midis simfizes pubike, majes se koksiksit dhe dy tuberave iskiadike. Ne vendin e bashkimit te diagonaleve te “rombit” perineal, gjendet trupi perineal (*corpus perineale*). Linja qe kalon midis dy tuberave iskiadike e ndan perineumin ne nje trekendesh posterior ose anal dhe nje trekendesh anterior ose urogenital.

**Trekendeshi anal** ka anusin qe eshte hapja fundore e kanalit anal. Ne secilen ane midis tij dhe tuberave iskiadike gjendet nen lekure fosa iskioanale (*fossa ischioanal*), e mbushur me ind dhjamor.

**Trekendeshi urogenital tek femrat** ka vulven me pjeset e saj (klitoris, buzet e medha, buzet e vogla). Ne vestibulumin vaginal, midis buzeve te vogla, gjenden ostiumi vaginal dhe ostiumi uretral ekstern.

**Trekendeshi urogenital tek meshkujt** ka skrotumin dhe rrrenjen e penisit.

### Fakte klinike

#### Kateterizimi i uretrës

**Kateterizimi i uretrës** konsiston ne futjen e nje kateteri urinar ne ureter dhe vezike urinare, nga ostiumi uretral ekstern. Kjo behet kur pacienti nuk eshte ne gjendje te urinoje vete. Tek femrat futja e nje kateteri te tille eshte e thjeshte, meqë uretra femerore eshte e shkurer dhe e drejte. Tek meshkujt, per aresye te uretrës me te gjate e me kthesa, vendosja e kateterit urinar duhet te behet me shume kujdes.

Ne rast se futja e kateterit urinar deshton (ndushtice e ureterit, zmadhim i prostates), atehere futet nje kateter suprapubik direkt ne veziken urinare.

#### Hipertrofia e prostates

**Hipertrofia e prostates** eshte nje semundje qe prek shumicen e meshkujve te moshuar. Ajo konsiston ne nje zmadhim te pjeses qendrore te prostates qe shtyp ureten dhe veshireshon daljen e urines neper te. Kjo shoqerohet me rritje te urines reziduale te veziken urinare dhe urinim te shpeshte e ne sasi te vogel. Trajtimi eshte medikamentoz e kirurgjikal.

#### Kanceri i prostates

**Kanceri i prostates** eshte i shpeshte tek meshkujt. Tumori zakonisht fillon ne pjesen periferike te prostates dhe eshte per shume kohe asimptomatik. Per kete aresye diagnostikimi eshte per gjithesish i vone.

## 9. GJENDRAT ENDOKRINE

### Hipofiza

Gjendra pineale

Gjendra tiroide

Gjendrat paratiroide

Gjendrat suprarenale

Ishujt e pankreasit

**Gjendrat endokrine** (*glandulae endocrinae*) qe konsiderohen edhe si sistemi endokrin, prodhojnë hormone, veprimi i te cileve se bashku me veprimin e sistemit nervor autonom, rregullon aktivitetin e brendshem te organizmit.

Ato jane hipofiza, gjendra pineale, gjendra tiroide, gjendrat paratiroide dhe gjendrat suprarenale; veçori e tyre eshte se ato nuk kane duktuse, por e hedhin prodhimin e tyre (hormonin) direkt ne gjak.

Veç tyre hormone prodhojnë edhe qeliza te tjera qe jane pjesa e organeve me funksione te tjera: ishujt e pankreasit, organet rrethventrikulare, si dhe qelizat intersticiale testikulare e ovariale.

### HIPOFIZA

**Hipofiza** (*hypophysis*) ose gjendria pituitare gjendet ne hipotalamus, ne vazhdim te infundibulumit. Ajo vendoset ne fosen e hipofizes ne faqen e siperme te trupit te kockes sfenoïdale.

Hipofiza perbehet nga dy pjese, adenohipofiza ose lobi anterior dhe neurohipofiza ose lobi posterior. Dy pjeset kane strukture dhe funksion te ndryshem.

■ **Adenohipofiza** (*adenohypophysis*) prodhon hormone me funksione te ndryshme. Keshtu hormoni i rritjes stimulon rritjen e trupit, prolaktina rritjen e gjendrave te gjirit dhe prodhimin e quimeshit prej tyre, hormoni tireostimulues gjendren tiroide, hormoni adrenokortikotrop korteksin e gjendrave suprarenale, hormoni folikulostimulues prodhimin e estrogeneve dhe spermatogenezen dhe hormoni luteinizues prodhimin e progesteronit dhe testosteronit.

■ **Neurohipofiza** (*neurohypophysis*) prodhon vazopresinen ose hormonin antiidiuretik, qe kontrollon diurezen dhe oksitocinen e cila stimulon tkurtjen e muskulatures uterine gjate lindjes.

## GJENDRA PINEALE

**Gjendra pineale** (*glandula pinealis*) ose epifiza gjendet ne epitalamus, midis dy kolikujve superiore te mezencefalonit, nen trupin kalloz.

Funksioni i saj eshte rregullimi i funksionit te hipofizes, ovareve e testeve deri ne pubertet. Pasoje eshte frenimi i pubertetit. Gjithashtu gjendra pineale prodhon melatonine dhe serotoninine.

Pas dekades se dyte te jetes ajo fillon te atrofizohet dhe kalcifikohet.

## GJENDRA TIROIDE

**Gjendra tiroide** (*glandula thyroidea*) eshte gjendra endokrine me e madhe e trupit; ajo gjendet ne qafe, nen dhe anash kercit tiroid. Perpara ka muskujt infrahioide dhe anash tufen neurovaskulare te qafes.

Gjendra tiroide ka formen e shkronjes H. Ajo perbehet nga dy lobe qe bashkohen ne qender nga istmusi (*isthmus glandulae thyroideae*). Nganjehere nga istmusi ngjitet siper nje zgjatim ne forme piramide (*lobus pyramidalis*), qe mund te jete edhe i shkeputur nga gjendra (*glandula thyroidea accessoriae*).

Gjendra tiroide vishet nga nje kapsul fibroze (*capsula fibrosa*) qe jep septe ne brendesi, te cilat e ndajne gjendren ne lobule. Kapsula fiksohet ne kercin krikoid te laringut dhe trake, prandaj gjate gelltites gjendra leviz.

Gjendra tiroide prodhon hormonin tiroksine, qe merr pjese ne proceset oksiduese qelizore ne gjithe organizmin.

## GJENDRAT PARATIROIDE

**Gjendrat paratiroide** (*glandula parathyroidea*) vendosen ne siperfaqen e pasme te lobeve te gjendres tiroide. Ne secilen ane eshte gjendra paratiroide superiore (*glandula parathyroidea superior*) dhe gjendra paratiroide inferiore (*glandula parathyroidea inferior*).

Hormoni i gjendrave paratiroide, parathormoni, tregullon metabolizimin e kalciumit.

## GJENDRAT SUPRARENALE

**Gjendrat suprarenale** (*glandula suprarenalis*) vendosen ne hapesiret retroperitoneale, mbi polin superior te veshkes perkatese.

Secila gjender ka pamjen e nje piramide me faqen anteriore (*facies anterior*), faqen posteriore (*facies posterior*) dhe faqen renale (*facies renalis*) si dhe margin superiore (*margo superior*) e margin medialle (*margo medialis*). Ne margin medialle gjendet hilumi (*hilum*) ku hyr arteria suprarenale dhe del vena suprarenale.

Ne prerje gjendrat suprarenale perbehesh nga korteksi (*cortex*) qe ze pjesen me te madhe dhe medula (*medulla*).

Korteksi i gjendrave suprarenale prodhon hormone mineralokortikoide (aldosteron), glukokortikoide (kortizol) dhe estrogjene ose androgjene, ndersa medula e saj adrenaline e noradrenaline.

Hormonat e gjendres suprarenale mundesojne pershtatjen e organizmit ne situata te ndryshme stresi.

## ISHUJT E PANKREASIT

**Ishujt e pankreasit** (*insulae pancreaticae*) ose te Langerhansit perbejne pankreasin endokrin. Ata jane mbi nje milion, te shperndare ne gjithe gjendren, por me teper ne bishtin e pankreasit.

Funksioni tyre eshte prodhimi i insulines.

### Fakte klinike

#### Struma

Struma eshte nje nga patologjite me te shpeshita te gjendres tiroide dhe konsiston ne nje rritje te çrrregullt e difuze te saj. Shkaku i zakonshem i saj eshte mungesa e jodit, i cili eshte i domosdoshem per prodhimin e hormoneve te gjendres tiroide. Parandalimi i strumes eshte pasurimi i produkteve ushqimore me jod, ndersa trajtimi nderhyrja kirurgjikale ose terapia radiojodike.

#### Diabeti

Diabeti eshte nje çrrregullim metabolik qe karakterizohet nga hiperglicemja. Mund te jetë i tipit 1 (nga shkaterrimi autoimun i qelizave (beta) insulineproduhuese ne ishujt e pankreasit) ose i tipit 2 (nga rezistenca ndaj insulines); keto tipe kane shenja te ngashme klinike. Roli i insulines eshte te rregulloje marrjen e glukozes nga qelizat, keshtu qe ndodh rritje e perqendrimit te glukozes ne gjak (hiperglicemja) dhe kjo shoqerohet me poliuri (urinim i shtuar), polidipsi (etje e shtuar) dhe polifagi (oreksi i shtuar). Komplikacion akut i semundjes mund te jetë koma diabetike, ndersa komplikacionet kronike mund te prekin zemren, veshkat, retinen e syve etj. Trajtimi i semundjes nenkupton nje diete te kontrolluar, terapi zevendesuese me insuline etj.

## 10. SISTEMI KARDIOVASKULAR

**Sistemi kardiovaskular** (*systema cardiovasculare*) perfaqeson nje sistem qarkullimi te mbyllur, ku transporti realizohet nga indet e lengshme (gjaku dhe limfa). Ai perbehet nga zemra (*cor*), vazat e gjakut (*vas sanguineum*), ne te cilat qarkullon gjaku (*haema, sanguis*) dhe vazat limfatike (*vas lymphaticum*), ne te cilat qarkullon limfa (*lympha*).

Levizja e gjakut brenda ketij sistemi kryhet ne saje te tkurrije ritmike te zemres. Zemra e pompon gjakun ne vazat arteriale: arterie e arteriola (*arteria, arteriola*) te cilat, duke u degezuar gradualisht drejt periferise, e dergojne gjakun ne vazat kapilare (*vas capillare*). Prej ketej, gjaku mblidhet nga vazat venoze: venula e vena (*venula, vena*) te cilat, duke u bashkuar gradualisht drejt qendres, e rikthejne gjakun ne zemer. Nga ky kendveshtrim, vazat e gjakut mund te permblidhen ne nje sistem enesh arteriale (*systema arteriosum*) dhe ne nje sistem enesh venoze (*systema venosum*), te cilet komunikojne midis tyre nepermjet kapilareve. Enet e sistemit arterial kane midis tyre anastomoza duke formuar keshtu nje rrjet apo pleks arterial (*rete arteriosum*); ne menyre te ngashme enet e sistemit venoz formojne rrjetin ose pleksin venoz (*rete venosum*). Nganjehere, ne organe te veçante, ndodh qe arteriolat degezohen ne kapilare, te cilet serisht vazhdojnë me arteriola (ne veshka) ose venulat po ashtu degezohen ne kapilare, te cilet serisht vazhdojnë me venula (ne hepar). Ky rrjet (lemsh) kapilar ne enet e sistemit arterial ose enet e sistemit venoz, quhet rete mirabile (*rete mirabile*). Nderkaq limfa rrjedh nga periferia ne qender neper rruget limfatike, qe mund te konsiderohen si aneks i sistemit venoz.

**Qarkullimi i gjakut**, duke iu referuar nje pershkrimi skematik, kryhet sipas nje rrathi te madh dhe sipas nje rrathi te vogel, te njohur respektivisht si rrathi sistemik dhe rrathi pulmonar i qarkullimit te gjakut.

Kalimi i gjakut nga ventrikuli i majte (me ane te aortes e degeve te saj) ne te gjithe trupin dhe kthimi ne atriumin e djathte (nepermjet dy venave kava) perben rrethin e madh te qarkullimit te gjakut. Rrathi i madh i qarkullimit te gjakut permblehd vazat (arteriet) te cilat e percjellin gjakun ne tere organizmin dhe vazat

(venat) qe, prej ketej, e sjellin gjakun serish ne zemer. Gjate ketij qarkullimi gjaku dergon ne organe  $O_2$  dhe merr  $CO_2$  (ne kapilaret periferike te organeve ndodh pakesimi i  $O_2$  dhe shtimi i  $CO_2$  ne gjak).

Kalimi i gjakut nga ventrikuli i djathte (me ane te trungut pulmonar e degeve te tij) ne mushkeri (pulmone) dhe kthimi ne atriumin e majte (nepermjet kater venave pulmonare) perben rrethin e vogel te qarkullimit te gjakut. Rrethi i vogel i qarkullimit te gjakut perfshin vazat (arteriet) qe e çojne gjakun nga zemra ne pulmone dhe vazat (venat) te cilat, prej mushkerive, e rikthejne ne zemer. Gjate ketij qarkullimi gjaku dergon ne pulmone  $CO_2$  dhe merr  $O_2$  (ne kapilaret alveolare te mushkerive ndodh shtimi i  $O_2$  dhe pakesimi i  $CO_2$  ne gjak).

## ZEMRA

**Zemra** (*cor*) perben organin qendror te qarkullimit te gjakut; ajo vendoset brenda hapesires torakale ne mediastinin e mesem. Zemra i ngjan nje koni ose piramide te rreziuar, me maje te orientuar nga perpara, poshte e majtas.

Ne pamjen e jashtme zemra ka bazen (*basis cordis*), majen (*apex cordis*) si dhe faqen anteriore ose sternokostale (*facies anterior, facies sternocostalis*), faqen posteriore ose diafragmatike (*facies posterior, facies diaphragmatica*) dhe margin e djathte e margin e majte ose faqet pulmonare (*facies pulmonalis dextra/sinistra*).

Gjithashtu ka sulkusin koronar (*sulcus coronarius*), nga i cili zbresin sulkusi interventrikular anterior (*sulcus interventricularis anterior*) ne faqen anteriore e sulkusi interventrikular posterior (*sulcus interventricularis posterior*) ne faqen posteriore.

**Dhomat e zemres** jane atriumi i djathte e ventrikuli i djathte dhe atriumi i majte e ventrikuli i majte.

Dhomat e djaththa te zemres jane te ndara nga dhomat e majta, keshtu qe funksionalisht zemra perbehet nga dy pompa te veçanta, nje e djaththa dhe nje e majte. Pompa e djaththa e dergon gjakun ne mushkeri, ndersa pompa e majte ne gjithe trupin, prandaj eshte me e fuqishme (muret e dhomave te majta jane me te trashe).

\* **Atrium i djaththa** (*atrium dextrum*) eshte dhoma e zemres ne te cilen hapen tre ostiume venoze: ai i v. kava superiore (*ostium venae cavae superioris*), i v. kava inferiore (*ostium venae cavae inferioris*), te cilat sjellin gjak nga gjithe trupi,

si dhe ostium i sinusit koronar (*ostium sinus coronarii*), qe sjell gjak nga vete zemra.

Siperfaqja e brendshme e atriumit te djathte eshte e lemuar, perveçse ne nivelin e aurikules (atriumi primitiv), ku gjenden mm. pektinate (*mm. pectinati*).

Midis atriumit te djathte e atriumit te majte gjendet septumi interatrial (*septum interatriale*) ne te cilin dallohet fosa ovale (*fossa ovalis*) ne vendin e foramen ovale (*foramen ovale cordis*), qe ka ekzistuar ne jeten intrauterine.

Atriumi i djathte e dergon gjakun ne ventrikulin e djathte nepermjet ostiumit atrioventrikular te djathte.

\* **Ventrikuli i djaththa** (*ventriculus dexter*) merr gjakun nga atriumi i djathte nepermjet ostiumit atrioventrikular te djaththa (*ostium atrioventriculare dextrum*), ne te cilin gjendet valvula atrioventrikulare e djathte ose trikuspidale (*valva atrioventricularis dextra, valva tricuspidalis*). Kjo valvul lejon kalimin e gjakut nga atriumi ne ventrikul, por jo anasjelltas. Ajo perbehet nga tri kuspise, kuspis anterior (*cuspis anterior*), kuspis posterior (*cuspis posterior*) dhe kuspis septalis (*cuspis septalis*).

Hapja normale e kuspiseve sigurohet nga tre muskujt papilar: m. papilar anterior (*m. papillaris anterior*), m. papilar posterior (*m. papillaris posterior*) dhe m. papilar septal (*m. papillaris septalis*), te cilet fillojne ne siperfaqen e brendshme te ventrikulit dhe vazhdojne me korda tendinoze (*chordae tendinae*) qe kapen ne buzen e lire te kuspiseve.

Siperfaqja e brendshme e ventrikulit te djathte eshte jo e lemuar nga prania e mm. papilar.

Midis ventrikulit te djaththa dhe ventrikulit te majte gjendet septumi interventrikular (*septum interventricular*), pjesa me e madhe e te cilit eshte muskulare.

Ventrikuli i djaththa e dergon gjakun ne trunkun pulmonar nepermjet ostiumit te trunkut pulmonar (*ostium trunci pulmonalis*), ne te cilin gjendet valvula e trunkut pulmonar (*valva trunci pulmonalis*). Kjo valvul qe lejon kalimin e gjakut nga ventrikuli i djaththa ne trunkun pulmonar, por jo anasjelltas, perbehet nga tre kuspise semilunare.

\* **Atrium i majte** (*atrium sinistrum*) eshte i ngjashem ne ndertim me atriumin e djaththa. Ne te sjellin gjak kater vv. pulmonare, qe hapen ne ostiumet perkatese (*ostia venarum pulmonalium*). Edhe siperfaqja e brendshme e atriumit te majte eshte e lemuar, perveçse ne nivelin e aurikules (atriumi primitiv) ku gjenden mm. pektinate (*mm. pectinati*).

Atriumi e dergon gjakun ne ventrikulin e majte nepermjet ostiumit atrioventrikular te majte.

■ **Ventrikuli i majte** (*ventriculus sinister*) merr gjakun nga atriumi i majte nepermjet ostiumit atrioventrikular te majte (*ostium atrioventricularis sinistrum*), ne te cilin gjendet valvula atrioventrikulare e majte ose bikuspidale ose mitrale (*valva atrioventricularis sinistra, valva mitralis*). Ajo perbehet nga dy kuspise, kuspisi anterior (*cuspis anterior*) dhe kuspisi posterior (*cuspis posterior*). Hapja normale e kuspiseve sigurohet nga dy muskujt papilar, m. papilar anterior (*m. papillaris anterior*) dhe m. papilar posterior (*m. papillaris posterior*), te cilet fillojne ne siperfaqen e brendshme te ventrikulit dhe vazhdojne me korda tendinoze (*chordae tendinae*) qe kafen ne buzen e lire te kuspiseve. Kjo valvul lejon kalimin e gjakut nga atriumi ne ventrikul, por jo anasjelltas. Edhe siperfaqja e brendshme e ventrikulit te djathte eshte jo e lemuar nga prania e mm. papilar.

Ventrikuli i majte e dergon gjakun ne aorte nepermjet ostiumit te saj (*ostium aortae*), ne te cilin gjendet valvula e aortes (*valva aortae*). Kjo valvul, qe lejon kalimin e gjakut nga ventrikuli i majte ne aorte, por jo anasjelltas, perbehet nga tre kuspise semilunare.

**Muri i zemres** perbehet nga tre shtresa, endokardi, miokardi dhe epikardi.

■ **Endokardi** (*endocardium*) eshte shtresa e brendshme e zemres; ai vesh gjithe siperfaqen e atriumeve, ventrikujve e valvulave dhe eshte i ngjashem ne ndertim me cipen qe vesh nga brenda murin e vazave.

■ **Miokardi** (*myocardium*) eshte shtresa e mesme, muskulare, me e trashë e zemres.

Muskulatura e zemres ndonese eshte e striuar, nuk eshte e vullnetshme si ajo skeletike. Ajo fiksohet ne "skeletin" e zemres qe perfaqesohet nga dy unaza fibroze (*anulus fibrosus dexter/sinister*) te vendosura perreth dy ostiumeve atrioventrikulare. Nga keto unaza nisen te veçanta muskulatura e atriumeve dhe muskulatura e ventrikujve.

**Sistemi perçues i zemres** (*systema conduceante cordis*) perbehet nga qeziza te specializuara te miokardit. Ky sistem ka si veçori gjenerimin e impulseve, percjelljen e impulseve dhe respektimin e hierarkise se kateve te tij. Perberesit e tij jane nyja sinuatriale, nyja atrioventrikulare dhe tufa atrioventrikulare me degezimet e saj.

**Nyja sinuatriale** (*nodus sinuatrialis*) gjendet ne atriumin e djathte; ajo prodhon impulse dhe ia percjell ato muskulature se atriumeve dhe nyjes atrioventrikulare. **Nyja atrioventrikulare** (*nodus atrioventricularis*) gjendet ne kufirin atrioventrikular; ajo merr impulse nga nyja sinuatriale dhe i kalon ne tufen atrioventrikulare.

**Tufa atrioventrikulare** (*fasciculus atrioventricularis*) zurret neper septumin interventrikular dhe ndahet ne degen e djathte (*crus dextrum*) dhe degen e majte (*crus sinistrum*). Secila prej tyre vazhdon te degezohet deri ne formimin e nje rjeti (fibrat Purkinje) per muskulaturen e ventrikujve perkates.

■ **Epikardi** (*epicardium*) eshte shtresa e jashtme e zemres, mbi miokard dhe eshte ne fakt fleta e brendshme, lamina viscerale, e perikardit seroz.

**Perikardi** (*pericardium*) eshte cipa seroze, e lemuar dhe e lagur, qe vesh zemren dhe pjesen fillestare te vazave te medha.

Perikardi ka pjesen seroze (*pericardium serosum*), te brendshme, qe vesh direkt zemren, me laminen viscerale (*lamina viscerale, epicardium*) dhe laminen parietale (*lamina parietalis*) dhe ne vazhdim te saj pjesen fibroze (*pericardium fibrosum*), te jashtme.

Midis dy laminave te pjeses seroze gjendet hapesira e perikardit (*cavitas pericardiaca*).

**Vaskularizimi i zemres** realizohet nepermjet nje rrathi te veçante te qarkullimit te gjakut, te perbere nga arteriet koronare dhe venat e zemres.

■ **Arteriet koronare** dalin nga pjesa fillestare e aortes dhe jane dy: a. koronare e djathte dhe a. koronare e majte. Gjaku ne keto arterie nuk hyn gjate sistoles (si ne arteriet e tjera), por gjate diastoles.

**A. koronare e djathte** (*arteria coronaria dextra*) kalon djathtas dhe prapa ne sulkusin koronar, kur arrin ne sulkusin interventrikular posterior jep degen interventrikulare posteriore. Ajo vaskularizon kryesisht gjysmen e djathte te zemres dhe pjesen e pasme te septumit interventrikular.

**A. koronare e majte** (*arteria coronaria sinistra*) kalon majtas ne sulkusin koronar dhe kur arrin ne sulkusin interventrikular anterior ndahet ne degen cirkumflekse dhe degen interventrikulare anteriore. Ajo vaskularizon kryesisht gjysmen e majte te zemres dhe pjesen e perparme te septumit interventrikular.

■ **Venat e zemres** derdhen kryesisht ne sinusin koronar (*sinus coronarius*), ndersa nje grup venash te vogla derdhen direkt ne dhomat e zemres. Venat me te medha qe derdhen ne sinusin koronar jane:

**Vena kardiake e madhe** (*vena cordis magna*) ngjitet ne sulkusin interventrikular anterior, prandaj shpesh quhet vena interventrikulare anteriore (*vena interventricularis anterior*).

**Vena kardiake e mesme** (*vena cordis media*) ngjitet ne sulkusin interventrikular posterior, prandaj quhet edhe vena interventrikulare posteriore (*vena interventricularis posterior*).

**Vena kardiake e vogel** (*vena cordis parva*) gjendet ne sulkusin koronar dhe shoqeron a. koronare te djathte.

### Fakte klinike

#### Sistola e diastola

Sistola eshte kontraktimi i miokardit, ndersa diastola relaksimi i tij. Gjate sistoles gjaku del nga dhomat e zemres, ndersa gjate diastoles hyn ne to.

Sistola atriale nenkupton tkurjen e njekohshme te miokardit te te dy atriumeve; ajo ndodh ne kohen e fundit te diastoles ventrikulare dhe gjate saj gjaku kalon nga atriumet ne ventrikujt. Sistola ventrikulare nenkupton tkurjen e njekohshme te miokardit te te dy ventrikujve; gjate saj gjaku kalon perkatesisht ne trunkun pulmonar e ne aorte.

Diastola e atriuve nenkupton relaksimin e njekohshem te miokardit te dy atriumeve; gjate saj gjaku kalon nga venat (kava e pulmonare) dhe mbush dy atriumet. Diastola ventrikulare nenkupton relaksimin e njekohshem te miokardit te dy ventrikujve; gjate saj gjaku kalon nga atriumet ne ventrikuj.

#### EKG

EKG ose elektrokardiograma konsiston ne regjistrimin e aktivitetit elektrik te zemres. Nepermjet saj vleresohen ritmi i zemres, ndryshimet iskemike ne miokard ose infarkti i tij, biloqet e zemres etj.

#### Semundjet e lindura te zemres

Nga semundjet e lindura te zemres me te shpeshta jane defektet ne septumin interatrial dhe ne septumin interventrikular.

Defekti ne septumin interatrial konsiston ne mosmbyllje te plete te foramen ovale, e cila ne jeten intrauterine lejon kalimin e gjakut nga atriumi i djathte ne te majtin, ndersa pas lindjes mylllet gradualisht. Si pasoje e defektit gjaku i oksigjenuar kalon nga atriumi i djathte ne atriumin e majte per aresye te diferenca se presioneve. Pacienti mund te jete asimptomatik ose mund te kete nevoje per nderhyrje kirurgjikale.

Defekti ne septumin interventrikular eshte relativisht i shpeshte; gjate tij gjaku kalon nga ventrikuli i djathte ne te majtin per aresye te diferenca se presioneve. Trajtimi zakonisht eshte nderhyrja kirurgjikale.

#### Stenoza dhe insuficiencia e valvulave te zemres

Stenoza valvulare konsiston ne pamundesi te valvules per t'u hapur plotesisht. Si pasoje jo gjithe sasia e gjakut kalon neper ostium.

Insuficiencia valvulare konsiston ne prishjen e funksionit te valvules, keshtu qe gjaku kthehet prapsh (regurgiton) neper ostium.

Stenoza dhe insuficiencia e valvulave te zemres cojne ne ndryshime jo normale te presionit ne dhomat e zemres dhe pasoja mund te jete insuficiencia kardiake.

#### Angina dhe infarkti i miokardit

Ngushtimi i nje arterie koronare ose dege te saj con ne pamjaftueshmeri ne oksigenimin e qelizave (iskemi) te miokardit dhe kjo shoqerohet me dhimbje (angina) prapa sternumit qe perhapet ne krahun e majte.

Nese arteria blokohet plotesisht, mosfurnizimi me gjak (oksigen) i zones perkatese te miokardit con ne vdekjen e qelizave te tij (infarkti); dhimbja qe e shoqron eshte infarktin zakonisht eshte shume e forte. Lokalizimi dhe sipërfaqja e zones se infarktit percaktimore edhe gravitetin e tij.

Trajtimi i arterieve te ngushtuara koronare behet nepermjet vendosjes se nje stenti ne vendin e ngushtimit ose te nje segmenti venoz kolateral (bypass).

#### Blloku i zemres

Blloku i zemres nenkupton bllokin e kalimit te impulseve elektrike ne sistemin perçues te zemres. Blloku mund te ndodhe ne nyjen sinuatriale, atrioventrikulare, tufen atrioventrikulare (te Hisit) ose deget e saj. Blloku mund te jete i grades I, i grades II ose i grades III (bllok i plete).

## ARTERIET

### Trunku pulmonar

### Aorta

### Arteriet e kokes dhe qafes

### Arteriet e gjymtyres se siperme

### Arteriet e trunkut

### Arteriet e gjymtyres se poshtme

**Arteriet** (*arteriae*) jane vazat qe e nxjerrin gjakun nga zemra. Gjaku vjen ne to me presion, keshtu qe muret e arterieve jane te trasha dhe kane muskulature te lemuar dhe ind elastik. Indi elastik, qe eshte me i shumte ne murin e aortes (kjo del direkt nga zemra), lejon modifikimin e dimensioneve te lumenit gjate rritjes se presionit. Sasia e indit elastik vjen duke u pakesuar gradualisht deri sa ne murin e arteriolave gjendet vetem muskulature, tkurja e se ciles kontrollon fluksin e gjakut ne organe te ndryshme dhe ruan presionin e tij.

Midis arterieve ka anastomoza (komunikime), te cilat sherbejne si rruge alternative, per rivendosjen e qarkullimit arterial (qarkullim kolateral), ne rast te ngushtimit apo blokimit te kalimit te gjakut ne ndonjeren prej tyre.

## TRUNKU PULMONAR

**Trunku pulmonar** (*truncus pulmonalis*) fillon ne ostiumin e trunkut pulmonar ne ventrikulin e djathte. Pastaj ai ngjitet siper dhe nen harkun e aortes ndahet ne arterien pulmonare te djathje (*arteria pulmonalis dextra*) dhe arterien pulmonare te majte (*arteria pulmonalis sinistra*). Secila prej tyre ndahet ne arterie lobare dhe pastaj ne arterie segmentare sipas lobeve dhe segmenteve ne secilen mushkeri. Degezimi vazhdon deri ne nivelin e plekseve kapilareve alveolare; ne kete nivel realizohet shkembimi i gazeve midis gjakut kapilar dhe ajrit alveolar (*hematoza*), çka rezulton ne pakesimin e perqindjes se  $\text{CO}_2$  dhe shtimin e perqindjes se  $\text{O}_2$  ne gjak.

(Nga mushkerite gjaku kthehet me ane te kater venave pulmonare ne atriumin e majte te zemres).

## AORTA

**Aorta** (*aorta*) eshte arteria me e madhe; ajo fillon ne ventrikulin e majte me aorten ngjitese (ascendente), vazhdon me harkun e aortes dhe perfundon me aorten zbritese (descendente), e cila ndahet ne dy dege terminale (arteriet iliake komune). Pikerisht nga aorta marrin origjine arteriet qe vaskularizojnë zemren, koken, qafen, gjymtyret e siperme, trungun dhe gjymtyret e poshtme.

(Nga pjeset e lartpermendura te trupit gjaku kthehet me ane te dy venave kava ne atriumin e djathte te zemres).

**Aorta ascendente** (*aorta ascendens*) gjendet ne mediastinin e mesem dhe ngjitet nga ostiumi i aortes deri ne fillimin e harkut te aortes. Deget e saj jane dy arteriet koronare (e majta dhe e djathta), qe furnizojnë me gjak zemren.

**Harku i aortes** (*arcus aortae*) vendoset ne mediastinin superior dhe shtrihet ndermjet aortes ngjitese dhe aortes zbritese. Ne muret e harkut te aortes gjenden disa formacione (baroreceptore dhe kimioreceptore), qe monitorojne presionin e gjakut dhe perqindjen e gazeve ne te. Deget e harkut te aortes jane trunku brakiocefalik (qe ndahet ne arterien karotike komune te djathte dhe arterien subklavia te djathte), arteria karotike komune e majte dhe arteria subklavia e

majte, te cilat me degezimet e tyre pajisin me gjak koken, qafen dhe gjymtyret e siperme.

Para lindjes, harku i aortes komunikon me trungun pulmonar nepermjet duktusit arterioz (*ductus arteriosus*), i cili mbyllet pas lindjes dhe kthehet ne lig. arterioz (*lig. arteriosum*).

**Aorta descendente** (*aorta descendens*) pason harkun e aortes dhe ndahet ne nje pjese torakale (e njohur si aorta torakale) dhe ne nje pjese abdominale (e njohur si aorte abdominale). Deget e saj marrin pjese ne vaskularizimin e trungut.

**Aorta torakale** (*aorta thoracica*) ose pjesa torakale e aortes (*pars thoracica aortae*) eshte porcion i pare i aortes descendente, qe fillon pas harkut te aortes, kalon ne mediastinin posterior dhe perfundon ne hiatusin aortal te diafragmes. Deget e saj perqigjen per furnizimin me gjak te mureve dhe organeve torakale (me perjashtim te zemres).

**Aorta abdominale** (*aorta abdominalis*) ose pjesa abdominale e aortes (*pars abdominalis aortae*) perben porcionin e dyte te aortes descendente. Eshte vazhdim i aortes torakale dhe fillon nga hiatusi aortik i diafragmes, zbret ne abdomen (hapesiret retro-peritoneale) dhe perfundon me ndarjen ne dy arteriet iliake komune. Deget e saj anesore (kolaterale) vaskularizojnë muret dhe organet abdominale, ndersa deget fundore (terminale) shkojnë per pajisjen me gjak te pelvisit dhe te gjymtyreve te poshtme.

## ARTERIET E KOKES DHE QAFES

Vaskularizimi i strukturave dhe organeve te kokes e qafes realizohet nga deget e arteries karotike komune dhe disa dege te arteries subklavia.

**A. karotike komune** (*a. carotis communis*) pasi fillon djathtas nga trunku brakiocefalik dhe majtas nga harku i aortes, ngjitet ne qafe dhe ne nivelin e kercit tiroid ndahet (*bifurcatio carotidis*) ne a. karotike eksterne dhe a. karotike interne. A. karotike komune dhe a. karotike interne gjate rruges ne qafe, ne perberje te tufes neurovaskulare te saj, vishen nga vagina karotike.

**Arteria karotike eksterne** (*a. carotis externa*) vaskularizon pjesen e siperme te qafes dhe fytyren. Ajo jep shume dege qe mund te klasifikohen ne te perpame, te pasme dhe te siperme. Deget e perparme te a. karotike eksterne jane a. tiroide superiore, a. linguale dhe a. faciale, deget e pasme jane a. oksipitale dhe a. aurikulare posteriore dhe dege te siperme a. temporale superficiale dhe a. maksilare. Dy deget fundore te a. karotike eksterne.

- **A. tiroide superiore** (*a. thyroidea superior*) jep dege per gjendren tiroide.
- **A. linguale** (*a. lingualis*) jep dege per gjuhen.
- **A. faciale** (*a. facialis*) shkon perpara midis gjendres submandibulare dhe trupit te mandibules, pastaj ngjitet ne faqe perpara m. maseter, kalon anash kendir te gojes, ne sulkusin nazolabial dhe perfundon prane kendir medial te syrit. Dege kryesore te saj jane a. labiale inferiore (*a. labialis inferior*) dhe a. labiale superiore (*a. labialis superior*), ndersa perfundon si a. angulare (*a. angularis*).
- **A. oksipitale** (*a. occipitalis*) jep dege per muskujt dhe lekuren ne regjionin oksipital.
- **A. aurikulare posteriore** (*a. auricularis posterior*) jep dege per aurikulen dhe muskujt e lekuren ne regjionin oksipital.
- **A. temporale superficiale** (*a. temporalis superficialis*) jep dege per aurikulen, gjendren parotide dhe muskujt e lekuren ne regjionin temporal, parietal e frontal.
- **A. maksilare** (*a. maxillaris*) jep shume dege, perkatesisht per mandibulen e dhembet e poshtem, maksilen e dhembet e siperim dhe muskujt mastikatore.
- A. alveolare inferiore** (*a. alveolaris inferior*) zbret drejt foramen mandibule dhe futet ne kanalin alveolar, ku jep dege per dhembet e poshtem (*rr. dentales*).
- A. alveolare superiore posteriore** (*a. alveolaris superior posterior*) futet ne faqen e pasme te trupit te maksiles dhe jep dege (*rr. dentales*) per dhembet molare e premolare te siperim.
- A. infraorbitale** (*a. infraorbitalis*) futet ne hapesiren e orbites nepermjet fisures orbitale inferiore dhe pastaj ne kanalin infraorbital ku jep dege (*rr. dentales*) per dhembet incizive e kanin te siperim.
- A. maseterike** (*a. masseterica*), **aa. temporale** dhe **deget pterigoide** (*rr. pterygoidei*) vaskularizojne muskujt e pertypjes, perkatesisht m. maseter, m. temporal, m. pterigoid medial e m. pterigoid lateral.
- A. karotike interne** (*a. carotis interna*) ngjitet ne qafe pa dhene dege, pastaj futet ne aperturen eksterne te kanalit karotik ne faqen e poshtme te piramides temporale, pershkoni kanalin karotik dhe del ne aperturen interne te tij. Me pas drejtohet perpara, futet ne sinusin kavernozi, mbi sulkusin karotik anash trupit te kockes sfenoidale dhe pasi del nga sinusi kavernozi, ndahet ne dege, ne a. oftalmike, a. koroide, a. cerebrale anteriore, a. cerebrale media dhe a. komunikante posteriore.

- **A. oftalmike** (*a. ophthalmica*) futet ne hapesiren e orbites nepermjet kanalit optik. Ajo jep a. centrale te retines (*a. centralis retinae*), a. lakrimale (*a. lacrimalis*) dhe aa. palpebrale laterale (*aa. palpebrales laterales*), aa. muskulare (*aa. musculares*), aa. palpebrale mediale (*aa. palpebrales medialis*) dhe perfundon si a. dorsale e hundes (*a. dorsalis nasi*), qe anastomozon me a. angulare, dege e a. faciale.
- **A. koroide anteriore** (*a. choroidea anterior*) merr pjese ne formimin e pleksit koroid te sistemit ventrikular te trurit.
- **A. cerebrale anteriore** (*a. cerebri anterior*) shkon e degezohet ne pjesen anteriore te faqes mediale te hemisferes perkatese. Ajo anastomozon me arterien homologe te anes tjeter nepermjet a. komunikante anteriore.
- **A. cerebrale media** (*a. cerebri media*) shkon anash e degezohet ne faqen superolaterale te seciles hemisfere.
- **A. komunikante posteriore** (*a. communicans posterior*) shkon prapa dhe anastomozon me a. cerebri posterior, dege e a. bazilare; kjo formohet nga bashkimi i dy arterieve vertebrale.
- Rrethi arterial i trurit** (*circulus arteriosus cerebri*) formohet ne bazon e trurit nga dy aa. cerebrale anteriore, a. komunikante anteriore (qe bashkon arteriet e mesiperme), dy aa. komunikante posteriore dhe dy aa. cerebrale posteriore (shiko arterien vertebrale). Kjo menyre e vaskularizimit te trurit me anastomoza te konsiderueshme midis arterieve te anes se djathje e asaj te majte, siguron nje furnizim konstant te dy gjysmave te trurit edhe ne rast ulje te fluksit te gjakut ne njerjen ane.
- A. subklavia** (*a. subclavia*) pasi fillon djathtas nga trunku brakiocefalik dhe majtas nga harku i aortes, ndjek nje kurbature (me konveksitet nga siper) mbi pulmonin perkates dhe shkon nen klavikul, midis saj e brinjes se pare. Pasi kalon klavikulen ajo nderron emrin dhe quhet arteria aksilare. A. subklavia jep arterien vertebrale (per trurin), trunkun tireocervikal e trunkun kostocervikal (per qafen) dhe arterien torakale interne (per paretin anterior torakal).
- **A. vertebrale** (*a. vertebralis*) del nga a. subklavia, ngjitet siper, kalon ne foraminat transversale te vertebrave cervikale, futet ne kafke neper foramen magnum dhe bashkohet me arterien e anes tjeter duke formuar a. bazilare. A. vertebrale jep per medulen spinale a. spinale anteriore (*a. spinalis anterior*) e a.

spinalis posteriore (*a. spinalis posterior*) dhe per cerebelumin a. cerebelare inferiore posteriore (*a. inferior posterior cerebelli*). A. bazilare (*a. basilaris*) jep per cerebelumin a. cerebelare inferiore anteriore (*a. inferior anterior cerebelli*) e a. cerebelare superiore (*a. superior cerebelli*) dhe pastaj ndahet ne dy aa. cerebrale posteriore (*a. cerebri posterior*), qe (bashkohen me aa. komunikante posteriore per te formuar rrethin arterioz dhe) degezohen ne lobet oksipitale te hemisferave.

■ **A. torakale interne** (*a. thoracica interna*) dallohet per rrugen e saj zbrtese perjate murit te perparshem te trungut, ne faqet e pasme te kerceve te brinjeve, ku jep deget interkostale anteriore (*rr. intercostales anteriores*) dhe pastaj ndahet ne dy deget fundore, a. musculofrenike (*a. musculophrenica*) per diafragmen dhe a. epigastrike superiore (*a. epigastrica superior*) qe futet ne vaginen e m. rectus abdominis dhe shkon drejt umbilikusit.

■ **Trunku tireocervikal** (*truncus thyreocervicalis*) jep arterien tiroide inferiore (*a. thyroidea inferior*) per gjendren tiroide dhe dege te tjera ne qafe.

■ **Trunku kostocervikal** (*truncus costocervicalis*) jep dege interkostale per hapesirat e siperme interkostale dhe dege te tjera ne qafe.

## ARTERIET E GJYMTYRES SE SIPERME

Arteriet e gjyntyres se siperme (*arteriae membra superioris*) jane dege qe i perkasin arterieve qe pasojne a. subklavia.

**A. aksilare** (*a. axillaris*) eshte vazhdimi i a. subklavia; ajo shtrihet nga brinja e pare deri ne buzen e poshtme te m. teres major, ku perseri nderron emrin ne a. brakiale. A. aksilare kalon ne aksile dhe jep dege per paretin torakal dhe per gjymytren e siperme. Deget e saj jane a. torakale superiore, a. torakale laterale, a. subskapulare, a. cirkumflekse humeri anterior dhe a. cirkumflekse humeri posterior.

■ **A. torakale superiore** (*a. thoracica superior*) dhe **a. torakale laterale** (*a. thoracica lateralis*), bashke me a. torakale dorsale (*a. thoracodorsalis*) dege e a. subskapulare, vaskularizojne paretin torakal.

■ **A. subskapulare** (*a. subscapularis*) vaskularizon muskujt rrith skapules, ndersa dega e saj, a. torakale dorsale, muskujt e pasem te paretit torakal.

■ **A. cirkumfleksa humeri anterior** (*a. circumflexa humeri anterior*) dhe **a. cirkumfleksa humeri posterior** (*a. circumflexa humeri posterior*) rrrethojne perkatesisht nga perpara dhe prapa skajin proksimal te humerusit dhe vaskularizojne muskujt rrith tij.

**A. brakiale** (*a. brachialis*) eshte vazhdim i a. aksilare; ajo fillon ne buzen e poshtme te m. teres major, zbret ne krah medialisht dhe perfundon ne nivelin e artikulacionit te brrylit ku dahet ne dy deget e saj fundore, a. radiale dhe a. ulnare. Deget e tjera te a. brakiale jane a. profunde brakiale dhe dy aa. kolaterale ulnare.

■ **A. profunde brakiale** (*a. profunda brachii*) zbret prapa humerusit dhe ndahet ne a. kolaterale radiale (*a. collateralis radialis*), qe shkon perpara lateralisht artikulacionit te brrylit dhe a. kolaterale te mesme (*a. collateralis media*) qe shkon me medialisht, prapa artikulacionit te mesiperm.

■ **A. kolaterale ulnare superiore** (*a. collateralis ulnaris superior*) zbret medialisht prapa artikulacionit te brrylit dhe poshte saj, **a. kolaterale ulnare inferiore** (*a. collateralis ulnaris inferior*) zbret medialisht perpara tij.

**A. radiale** (*a. radialis*) eshte njera nga deget fundore te a. brakiale; ajo zbret ne parakrah lateralisht dhe perfundon ne pellemben e dores. Dege te saj jane a. rekurente radiale dhe dege te tjera ne pellemben.

■ **A. rekurente radiale** (*a. recurrens radialis*) ngjitet siper e lateralisht dhe anastomozon me a. kolaterale radiale.

■ **Dega karpale palmarie** (*ramus carpalis palmaris*) dhe **dega karpale dorsale** (*ramus carpalis dorsalis*) anastomozojne me deget homologe te a. ulnare per te formuar rrjetin karpal palmar e rrjetin karpal dorsal.

■ **Dega palmare superficiale** (*ramus palmaris superficialis*) anastomozon me fundin e a. ulnare per te formuar harkun palmar superficial.

■ **Fundi i a. radiale** formon harkun palmar profund pasi anastomozon me degen palmare te theille te a. ulnare.

**A. ulnare** (*a. ulnaris*) eshte dega e dyte fundore e a. brakiale; ajo zbret ne parakrah medialisht dhe perfundon ne pellemben e dores. Dege te saj jane a. rekurente ulnare, a. interosea komune dhe dege te tjera ne pellemben.

■ **A. rekurente ulnare** (*a. recurrens ulnaris*) ngjitet siper medialisht dhe jep dy dege, nje anteriore qe anastomozon me a. kolaterale ulnare inferiore dhe nje posteriore qe anastomozon me a. kolaterale ulnare superiore.

■ **A. interosea komune** (*a. interossea communis*) ndahet ne **a. interosea anteriore** (*a. interossea anterior*) dhe **a. interosea posteriore** (*a. interossea posterior*). A. interosea posterior jep **a. interosea rekurente** (*a. interossea recurrens*), qe ngjitet dhe anastomozon prapa artikulacionit te brrylit me a. kolaterale te mesme. A. interosea anteriore e a. interosea posteriore zbresin ne parakrah, perkatesisht perpara dhe prapa membranes interosea drejt pellembes se dores, dhe marrin pjese ne formimin e rrjetit karpal palmar e rrjetit karpal dorsal.

■ **Dega karpale palmare** (*ramus carpalis palmaris*) e **dega karpale dorsale** (*ramus carpalis dorsalis*) anastomozojne me deget homologe te a. radiale per te formuar rrjetin karpal palmar e rrjetin karpal dorsal.

■ **Dega palmare profunde** (*ramus palmaris profundus*) anastomozon me fundin e a. radiale per te formuar harkun palmar profund.

■ **Fundi i a. ulnare** formon harkun palmar superficial, pasi anastomozon me degen palmare superficiale te a. radiale.

Arteriet e gjymtyres se siperme marrin pjese ne formimin e disa **rrjeteve dhe harqeve arteriale**: te rrjetit te artikulacionit te brrylit, rrjetit karpal dorsal e palmar si dhe te harkut palmar superficial e profund.

■ **Rrjeti i artikulacionit te brrylit** (*rete articulare cubiti*) formohet treth artikulacionit nga anastomoza e a. kolaterale radiale (dege e a. profunde brakiale) me a. rekurente radiale (dege e a. radiale), a. kolaterale te mesme (dege e a. profunde brakiale) me a. rekurente te mesme (dege e a. rekurente posteriore), aa. kolaterale ulnare superiore e inferiore (dege te a. brakiale) me deget posteriore e anteriore te a. rekurente ulnare (dege e a. ulnare).

Rrjeti i artikulacionit te brrylit lejon ruajtjen e fluksit te gjakut pavaresisht nga tendosja ose shtypja e vazave gjate levizjeve ne artikulacion.

■ **Rrjeti karpal dorsal** (*rete carpale dorsale*) formohet nga dega karpale dorsale e a. radiale, dega karpale dorsale e a. ulnare dhe dege te a. interosea posteriore. Nga ky rrjet dalin aa. metakarpale dorsale (*aa. metacarpales dorsales*) dhe prej tyre aa. digitale dorsale (*aa. digitales dorsales*).

■ **Rrjeti karpal palmar** formohet nga dega karpale palmare e a. radiale, dega karpale palmare e a. ulnare dhe dege te a. interosea anteriore.

■ **Harku palmar profund** (*arcus palmaris profundus*) formohet nga vazhdimi i a. radiale qe anastomozon me degen palmare profunde te a. ulnare. Nga ky hark dalin aa. metakarpale palmare (*aa. metacarpales palmares*).

■ **Harku palmar superficial** (*arcus palmaris superficialis*) formohet nga vazhdimi i a. ulnare, qe anastomozon me degen palmare superficiale te a. radiale. Ky hark gjendet distalisht harkut palmar profund. Prej tij dalin aa. digitale palmare (*aa. digitales palmares communes*).

Ekzistencia e komunikimeve midis harkut palmar superficial dhe harkut palmar profund mundeson ruajtjen e fluksit te gjakut gjate kompresionit te arterieve ne aktivitetin e perditshem.

## ARTERIET E TRUNKUT

Arteriet e trunkut nenkuptojne deget e aortes zbritese, te cilat vaskularizojne toraksin dhe abdomenin.

**Toraksi** furnizohet me gjak nga arterie qe dalin nga pjesa torakale e aortes zbritese (aorta torakale). Keti bejne pjese dege parietale per muret e toraksit dhe dege viscerale per organet e hapesires torakale.

**Deget parietale** te aortes torakale jane arteriet interkostale posteriore dhe arteriet frenike superiore:

■ **Aa. interkostale posteriore** (*aa. intercostales posteriores*) kalojne ne hapesirat interkostale, ne sulkusin e brinjes (bashke me nervin dhe venen interkostale) dhe anastomozojne me deget interkostale anteriore qe vijnë nga a. torakale interne.

■ **Aa. frenike superiore** (*aa. frenicae superiores*) marrin pjese ne vaskularizimin e diafragmes.

Nga **deget viscerale** te aortes torakale vlejne te permenden deget perikardiale (*rr. pericardiales*), deget ezofageale (*rr. oesophageales*) dhe arteriet bronkiale (*rr. bronchiales*).

**Abdomeni** furnizohet me gjak nga arterie qe marrin origjine nga pjesa abdominale e aortes zbritese (aorta abdominale). Keti perfshihen deget parietale

per muret e abdomenit, deget viscerale per organet e hapesires abdominale si dhe deget fundore per pelvisin.

Ne deget **parietale** te aortes abdominale permblidhen arteriet frenike inferiore dhe arteriet lumbale:

■ **Aa. frenike inferiore** (*aa. frenicae inferiores*) jane homologe te aa. frenike superiore dhe marrin pjesë ne vaskularizimin e diafragmes.

■ **Aa. lumbare** (*aa. lumbales*), kater ne çdo ane, jane homologe te aa. interkostale posteriore dhe vaskularizojne paretin posterior te hapesires abdominale.

Deget **viscerale** te aortes abdominale ndahen ne dege teke (trungu celiak dhe arteriet mezenterike) dhe ne dege çifte (arteriet suprarenale te mesme, arteriet renale dhe arteriet testikulare dhe ovarike):

■ **Trunku celiak** (*truncus coeliacus*) del menjehere nen hiatusin aortik te diafragmes dhe ndahet ne tre dege, a. gastrike sinistra, a. lienale dhe a. hepatike komune.

**A. gastrike sinistra** (*a. gastrica sinistra*) shkon ne kurvaturen minore te stomakut.

**A. lienale** (*a. lienalis*) ne rrugen drejt lienisit kalon mbi pankreas te cilin e vaskularizon, pastaj vaskularizon lienisit dhe shkon ne kurvaturen majore te stomakut si a. gastrooimentale sinistra (*a. gastrooentalis sinistra*).

**A. hepatike komune** (*a. hepatica communis*) jep a. gastrike dextra (*a. gastrica dextra*), qe shkon ne kurvaturen minor te stomakut dhe anastomozon me a. gastrike sinistra, a. hepatike propria (*a. hepatica propria*) qe shkon ne hepar e vaskularizon edhe veziken biliare, si dhe

a. gastroduodenale (*a. gastroduodenalis*) qe jep per stomakun a. gastrooimentale dextra (*a. gastrooentalis dextra*), qe shkon ne kurvaturen majore te tij e anastomozon me a. gastrooimentale sinistra si dhe dege per duodenin.

■ **A. mezenterike superiore** (*a. mesenterica superior*) del nen trunkun celiak dhe jep dege per duodenin, si dhe per jejunumin aa. jejunale (*aa. jejuna*), per ileumin aa. ileale (*aa. ileales*), per cekumin a. ileokolike (*a. ileocolica*), per kolonin ascendent a. kolike dextra (*a. colica dextra*) dhe per kolonin transvers a. kolike media (*a. colica media*).

■ **A. mezenterike inferiore** (*a. mesenterica inferior*) del nen a. mezenterike superiore dhe jep per kolonin descendant a. kolike sinistra (*a. colica sinistra*), per

sigmen aa. sigmoide (*aa. sigmoideae*) dhe per pjesen e siperme te rektumit a. rektale superiore (*a. rectalis superior*).

■ **Aa. suprarenale te mesme** (*a. suprarenalis media*), nga nje per secilen gjender suprarenale, bejne vaskularizimin e tyre (secila gjender vaskularizohet edhe nga a. suprarenale superiore, dege e a. frenike inferiore dhe a. suprarenale inferiore, dege e a. renale).

■ **Aa. renale** (*a. renalis*) shkojnë per secilen veshke; arteria e djathë eshte me e gjate se e majta. Ne brendesi te veshkes ato konsiderohen si arterie intrarenale (*arteriae intrarenales*), qe degezohen ne arterie interlobare (*aa. interlobares*), arterie arkuate (*aa. arcuatae*), arterie interlobulare (*aa. interlobulares*) deri ne arteriola glomerulare aferente (*arteriola glomerularis afferens*). Keto formojne leshin kapilar glomerular (rete mirabilis), nga i cili dalin arteriolat glomerulare eferente (*arteriola glomerularis efferens*), qe degezohen ne plekse kapilare. Vazhdim i tyre Jane venat interlobulare (*vv. interlobulares*), venat arkuate (*vv. arcuatae*), venat interlobare (*vv. interlobares*), te cilat Jane te gjitha vena intrarenale (*venae intrarenales*); keto te fundit vazhdojnë me venat renale (*vv. renales*).

■ **Aa. testikulare** (*a. testicularis*) tek meshkujt dhe **aa. ovarike** (*a. ovarica*) tek femrat dalin nen aa. renale dhe zbresin per tek testet ose ovaret.

**Deget fundore** te aortes abdominale dalin pas bifurkacionit te saj (*bifurcatio aortae*) ne nivelin e vertebres se katert lumbale (L4) dhe Jane dy arteriet iliak komune, te cilat me degezimet e tyre vaskularizojne krahas hapesires pelvike edhe rrerthin e gjymtyres se poshtme.

**A. iliake komune** (*a. iliaca communis*) shkon poshte lateralisht dhe ne nivelin e artikulacionit sakroiliak ndahet ne a. iliake interne dhe a. iliake eksterne.

**A. iliake interne** (*a. iliaca interna*) jep dege parietale dhe dege viscerale. Deget parietale Jane a. gluteale superiore, a. gluteale inferiore dhe a. obturatoria, ndersa deget viscerale (per organet e pelvisit) Jane a. umbilikale, aa. vezikale, a. uterine, a. vaginalle, aa rektale dhe a. pudente interne.

■ **A. gluteale superiore** (*a. glutea superior*) del nga pelvisi neper foramen suprapiriforme (mbi m. piriform) dhe vaskularizon muskujt gluteale.

■ **A. gluteale inferiore** (*a. glutea inferior*) del nga pelvisi neper foramen infrapiriforme (nen m. piriform) dhe vaskularizon muskujt gluteale.

■ **A. obturatore** (*a. obturatoria*) del nga pelvisi neper kanalin obturator dhe vaskularizon artikulacionin koksofemoral dhe muskujt mediale te kofshes.

■ **A. umbilikale** (*a. umbilicalis*) ne pjesen me te madhe te saj obliterohet dhe formon korden e a. umbilikale (*chorda a. umbilicalis*) mbi te cilen peritoneumi parietal i paretit anterior abdominal formon pliken umbilikale mediale.

■ **Aa. vezikale** (*aa. vesicales superiores* e *a. vesicalis inferior*) vaskularizojne veziken urinare.

■ **A. uterine** (*a. uterina*) dhe **a. vaginale** (*a. vaginalis*) vaskularizojne perkatesisht uterusin dhe vaginen tek femrat.

■ **A. rektale e mesme** (*a. rectalis media*) dhe **a. rektale inferiore** (*a. rectalis inferior*) vaskularizojne perkatesisht pjesen e mesme dhe inferiore te rektumit.

■ **A. pudente interne** (*a. pudenda interna*) vaskularizon organet e jashtme genitale dhe perineumin.

**A. iliaka eksterne** (*a. iliaca externa*) pasi jep degen e saj, a. epigastrike inferiore, kalon nen lig. inguinal dhe kalon nepermjet lakunes vazore ne kofshe (ku nderron emrin dhe quhet a. femorale).

■ **A. epigastrike inferiore** (*a. epigastrica inferior*) ngjitet siper, futet ne vaginen e m. rektus abdominal dhe anastomozon me a. epigastrike superiore (nga a. torakale interne). Kur kalon mbi te peritoneumi parietal i paretit anterior abdominal formon pliken umbilikale laterale.

## ARTERIET E GJYMTYRES SE POSHTME

Arteriet e gjymtires se poshtme (*arteriae membrae inferioris*) perfaqesohen nga a. femorale dhe deget e arteriet e tjera ne vazhdim te saj.

**A. femorale** (*a. femoralis*) eshte vazhdimi i a. iliaka eksterne. Ajo fillon ne lakunen vazore, zurret ne kofshe dhe prapa gjurit vazhdon si a. poplitea. Deget e saj jane aa. pudente eksterne, a. profunda femorale dhe a. descendente e gjurit.

■ **Aa. pudente eksterne** (*a. pudenda externa superficialis* e *a. pudenda externa profunda*) vaskularizojne organet e jashtme genitale.

■ **A. profunda femoris** (*a. profunda femoris*) vaskularizon muskujt e kofshes. Ajo jep a. cirkumflekse femorale mediale (*a. circumflexa femoris medialis*), a. cirkumflekse femorale laterale (*a. circumflexa femoris lateralis*) dhe aa. perforante (*aa. perforantes*).

■ **A. descendente e gjurit** (*a. descendens genus*) del nga a. femorale ne pjesen e poshtme te saj dhe zbret ne faqen e perparme te artikulacionit te gjurit duke marre pjese ne formimin e rrjetit arterial e tij.

**A. poplitea** (*a. poplitea*) eshte vazhdimi i a. femorale; ajo jep dege qe marrin pjese ne formimin e rrjetit arterial te artikulacionit te gjurit dhe pastaj ndahet ne a. tibiale anteriore e a. tibiale posteriore.

■ **Aa. superiore te gjurit** (*a. superior lateralis genus* e *a. superior medialis genus*), **a. e mesme e gjurit** (*a. media genus*) dhe **aa. inferiore te gjurit** (*a. inferior lateralis genus* e *a. inferior medialis genus*), dege te a. poplitea, marrin pjese ne formimin e rrjetit arterial te artikulacionit te gjurit.

**A. tibiale anteriore** (*a. tibialis anterior*) zurret midis muskujve anteriore te kercirit, jep dy arterie rekurrente per rrjetin e artikulacionit te gjurit dhe dy arterie maleolare ne pjesen fundore dhe vazhdon ne kembe si a. dorsale e saj.

■ **A. rekurrente tibiale anteriore** (*a. recurrens tibialis anterior*) dhe **a. rekurrente tibiale posteriore** (*a. recurrens tibialis posterior*) ngjiten perkatesisht perpara dhe prapa artikulacionit te gjurit per te marre pjese ne formimin e rrjetit te artikulacionit te tij.

■ **A. maleolare anteriore mediale** (*a. malleolaris anterior medialis*) dhe **a. maleolare anteriore laterale** (*a. malleolaris anterior lateralis*) marrin pjese ne formimin e rrjetave maleolare.

**A. dorsale e kembes** (*a. dorsalis pedis*) jep aa. tarsale mediale (*aa. tarsales mediales*), a. tarsale laterale (*a. tarsalis lateralis*) e a. arkuate (*a. arcuata*) qe anastomozon me a. tarsale laterale si dhe a. plantare profunde (*a. plantaris profunda*). Nga a. arkuate dalin a. metatarsale dorsale (*aa. metatarsales dorsales*) qe vazhdojnë me aa. digitale dorsale (*aa. digitales dorsales*). A. plantare profunde shkon ne tabanin e kembes ku merr pjese ne formimin e harkut plantar.

**A. tibiale posteriore** (*a. tibialis posterior*) jep menjehere degen e saj, a. fibulare (*a. fibularis*); te dyja zbresin midis muskujve posteriore te kercirit dhe ne pjesen e poshtme te kercirit jepin deget perkatese maleolare. Pastaj a. tibiale

posteriore kalon prapa maleolusit medial, arrin ne tabanin e kembes dhe ndahet ne a. plantare mediale dhe a. plantare laterale.

■ **Deget maleolare laterale** (*rr. malleolares laterales*) i jep a. fibulare, ndersa deget maleolare mediale (*rr. malleolares mediales*) a. tibiale posteriore. Ato marrin pjese ne formimin e rrjeteteve maleolare.

■ **A. plantare laterale** (*a. plantaris lateralis*) kthehet medialisht dhe anastomozon me **a. plantare mediale** (*a. plantaris medialis*).

Arteriet e gjymtyres se poshtme marrin pjese ne formimin e rrjetit te artikulacionit te gjurit, si dhe rrjetit maleolar medial, rrjetit maleolar lateral, harkut plantar superficial dhe harkut plantar profund.

■ **Rrjeti i artikulacionit te gjurit** (*rete articulare genus*) formohet rreth artikulacionit nga anastomoza e a. descendente te gjurit (dege e a. femorale), aa. tibiale rekurrente anteriore e posteriore (dege te a. tibialis anterior) dhe aa. superiore, a. se mesme e a. inferiore te gjurit (dege te a. poplitea). Rrjeti i artikulacionit te gjurit lejon ruajtjen e fluksit te gjakut pavaresisht nga tendosja ose shtypja e vazave gjate levizjeve ne kete artikulacion mjaft te vevizshem te trupit.

■ **Rrjeti maleolar medial** (*rete malleolare mediale*) formohet rreth maleolit medial nga anastomoza e a. maleolare anteriore mediale (dege e a. tibiale anteriore) dhe degeve maleolare mediale te a. tibiale posteriore.

■ **Rrjeti maleolar lateral** (*rete malleolare laterale*) formohet rreth maleolit lateral nga anastomoza e a. maleolare anteriore laterale (dege e a. tibiale anteriore) dhe degeve maleolare laterale te a. fibulare.

■ **Harku plantar superficial** (*arcus plantaris superficialis*) formohet ne tabanin e kembes nga anastomoza e a. plantare laterale me a. plantare mediale (te dyja dege te a. tibiale posteriore). Prej tij dalin aa. metatarsale plantare (*aa. metatarsales plantares*), qe vazhdojnë me aa. digitale plantare.

■ **Harku plantar profund** (*arcus plantaris profundus*) formohet ne tabanin e kembes nga anastomoza e a. plantare profunde (dege e a. dorsalis pedis) me harkun plantar superficial, perkatesisht me a. plantare laterale (dege e a. tibiale posteriore). Prania e ketij harku mundeson qarkullimin optimal me gjak edhe kur ndodh komprimim i arterieve nga pesha e ushtruar ne tabanin e kembes.

### Fakte klinike

#### Presioni i gjakut, tensioni arterial

Presioni i gjakut ne kupton forcen qe ushtron gjaku qarkullues ne muret e eneve te gjakut, pra arterieve, arteriolave, kapilareve, venulave e venave. Megjithate termi zakonisht i referohet presionit arterial te gjakut (ne te foluren e perdiushme tensioni arterial – TA), pra presionit te gjakut ne arteriet e medha.

Matja e TA behet me sfigmomanometer dhe shprehet ne milimetra te shytiles se zhives (mmHg). Per te bere matjen e TA mansheta e aparatit futet ne krah dhe fryhet deri sa te ndalohet kalimi i gjakut ne arterien brakiale. Pastaj nxirret gradualisht ajri prej saj nderkohe qe, ose degjohet me stetoskop arteria brakiale ne pjesen e perparme (gropen) e artikulacionit te brryshit, ose palpohet arteria radiale ne pjesen distale te parakrahut. Kur gjaku fillon te hyje ne arterie degjohet zhurma karakteristike ne stetoskop ose ndihet pulsi ne arterien radiale. Vlera e TA ne kete moment i korrespondon TA sistolik. Me pas ajri vazhdon te nxirret nga mansheta deri sa zhurma e mesiperme te zhduket dhe vlera e TA ne kete moment i korrespondon TA diastolik.

Vlerat normale te TA ne qitesi konsiderohen 120 mm per TA sistolik dhe 80 mm per TA diastolik (120/80 mmHg); sidqofte ne realitet keto vlera jane shume individuale. Rritja e TA mbi nje vlore maksimale te pranuar konsiderohet hipertension arterial (HTA), ndersa renia mbi nje vlore minimale te pranuar konsiderohet hipotension arterial.

#### Aneurizma e aortes

Aneurizma e aortes eshte zgjerimi i saj per shkak te dobesimit te paretit; ky dobesim mund te vije nga trauma, infekzioni, etj.

Aneurizma mund te jetet josimptomatike, mund te shoqerohet me dhimbje barku, dhimbje shpine etj. Rreziku i aneurizmes eshte ruptura qe shoqerohet me dhimbje shume te forte, hemoragi masive te brendshme dhe vdekje te shpejte. Diagnoza vihet me ane te ekzaminimeve imazherike.

Trajtimi perfundimtar eshte kirurgjikal dhe konsiston ne vendosjen e protezave sinutike ne pjesen aneurizmatike.

#### Ateroskleroza

Ateroskleroza eshte gjendja qe shoqerohet me trashje te mureve te arterieve. Si pasoje lumeni i enes ngushtohet dhe blokimi i saj mund te ndodhe shpesht qofte si pasoje e spazmes ashtu edhe nga trombe. Prekja e arterieve koronare ndodh shpesht mund te çoje ne infarkt akut te miokardit. Semundja kalon ne disa stade derisa instalohet arterioskleroza.

#### Arterioskleroza

Arterioskleroza konsiston ne demtin e qelizave muskulare dhe elastike te paretit te arterieve dhe depozitim ne to te kriperte te kalciumit. Arteriet humbin elasticitetin dhe kthehen ne tuba rigide. Nje "arterie sklerotike" eshte e pritur te formojе ulceracione ne paret, qe nderlikohen me formim trombi ose te aneurizem; te dy keto situta jane shkak i aksidenteve vaskulare.

**VENAT**

- Venat pulmonare**
- Venat e zemres**
- Vena kava superiore**
- Venat e kokes e qafes**
- Venat e gjymtyres se siperme**
- Vena azigos**
- Vena kava inferiore**
- Vena porta**
- Venat e gjymtyres se poshtme**
- Anastomozat portakavale**

**Venat** (*venae*) jane vazat qe e kthejne gjakun ne zemer. Ato jane ne numer me te shumta se arteriet, kane lumen me te madh dhe mure me te holle (prandaj kolabohen nese zbrazen). Ne brendesi te lumenit venat kane valvula, qe drejtjone rrjedhen e gjakut. Venat dallohen gjithashtu per komunikimet e shumta midis tyre.

**VENAT PULMONARE**

**Vv. pulmonare** (*venae pulmonales*) dergojne gjak te varfer ne CO<sub>2</sub> dhe te pasur ne O<sub>2</sub> nga pulmonet ne atriumin e majte. Gjaku venoz vjen nga plekset kapilare alveolare, pastaj kalon ne ene qe bashkohen gradualisht deri ne vena segmentare e vena lobare. Ne pulmonin e djathte vena e lobit superior bashkohet me venen e lobit te mesem dhe formon venen superiore te pulmonit te djathte

(*vena pulmonalis dextra superior*), ndersa vena e lobit inferior vazhdon si vena inferiore e pulmonit te djathte (*vena pulmonalis dextra inferior*). Ne pulmonin e majte vena e lobit superior vazhdon si vena superiore e pulmonit te majte (*vena pulmonalis sinistra superior*), ndersa vena e lobit inferior si vena inferiore e pulmonit te majte (*vena pulmonalis sinistra inferior*).

Ne perberje te rrrenjes se pulmonit, venat dalin nga pulmoni dhe derdhen ne atriumin e majte.

(Ne mushkeri gjaku vjen nga ventrikuli i djathte me ane te trunkut pulmonar dhe degeve te tij, arterieve pulmonare).

**VENAT E ZEMRES**

**Venat e zemres** (*venae cordis*) derdhen ose ne sinusin koronar (me te medhat) ose direkt ne dhomat e zemres (me te voglat). Venat me te medha qe derdhen ne sinusin koronar jane: vena kardiake e madhe (ose vena interventrikulare anteriore), vena kardiake e mesme (ose vena interventrikulare posteriore) dhe vena kardiake e vogel. Gjaku nga sinusi koronar derdhet ne atriumin e majte nepermjet ostiumit te tij.

**VENA KAVA SUPERIORE**

**V. kava superiore** (*vena cava superior*) mbledh gjakun nga koka, qafa, gjymtyret e siperme dhe toraksi. Ajo formohet nga bashkimi i dy venave braciocefalike prapa artikulacionit te brinjes se pare te djathte me sternumin. Pastaj ajo zbret poshte, merr venen azigos dhe derdhet ne atriumin e djathte. Secila vena braciocefalike (*vena brachiocephalica*) formohet nga bashkimi, ne nivelin e artikulacionit sternoklavicular, i venes jugulare interne qe sjell gjak nga koka e qafa me venen subklavia qe sjell gjak nga gjymtyra e siperme. Ne v. braciocefalike sjellin gjak nga paretia anterior torakal edhe vv. torakale interne (*vv. thoracicae internae*), qe ne paretin anterior abdominal deri ne umbilikus vazhdojnë si vv. epigastrike superiore (*vv. epigastricae superiores*).

**VENAT E KOKES E QAFES**

Gjaku i kokes e qafes mblidhet ne venen jugulare interne, venen jugulare eksterne dhe venen jugulare anteriore. Vena jugulare interne merr gjakun nga

hapesira kraniale (truri etj), vena jugulare eksterne e vena jugulare anteriore marrin gjakun nga pjesa e kokes jashtë hapesires kraniale dhe nga qafa. Te tre venat e mesiperme e dergojne gjakun ne venen brakiocefalike.

Gjaku nga truri mblidhet ne venat encefalike dhe nga orbitat ne venat orbitale; venat e mesiperme derdhen ne sinuset (venoze) durale, te cilet vazhdojnë ne venen jugulare interne.

**Vv. encefalike** (*venae encephalii*) janë venat cerebrale dhe venat cerebelare.

■ **Vv. cerebrale** janë vv. cerebrale superficiale dhe vv. cerebrale profunde.

**Vv. cerebrale superficiale** (*venae superficiales cerebri*) marrin gjakun nga korteksi dhe lenda e bardhe subkortikale dhe e derdhin ne sinusin sagital superior, sinusin transversal dhe sinusin kavernozi.

**Vv. cerebrale profunde** (*venae profundae cerebri*) marrin gjakun nga brendia e trurit dhe e derdhin ne v. magna cerebri (*v. magna cerebri*) dhe sinusin rektus, që eshte vazhdimi i saj.

■ **Vv. cerebelare** janë vv. cerebelare superiore dhe vv. cerebelare inferiore.

**Vv. cerebelare superiore** (*vv. superiores cerebelli*) gjenden ne pjesen e siperme te cerebelumit dhe derdhen ne sinusin rektus.

**Vv. cerebelare inferiore** (*vv. inferiores cerebelli*) gjenden ne pjesen e poshtme te cerebelumit dhe e derdhin gjakun ne sinusin transvers.

**Vv. orbitale** (*vv. orbitalae*) mblidhen ne v. oftalmike superiore dhe v. oftalmike inferiore.

■ **V. oftalmike superiore** (*v. ophthalmica superior*), ne te cilën derdhet edhe v. centrale e retines (*v. centralis retinae*), kalon ne fisuren orbitale superiore dhe derdhet ne sinusin kavernozi.

■ **V. oftalmike inferiore** (*v. ophthalmica inferior*) kalon ne fisuren orbitale inferiore dhe derdhet ne pleksin pterigoid, që gjendet ne pjesen e jashtme te kokes.

**Sinuset durale** (*sinus durae matris*) formohen midis dy shtresave te dura mater (cipe e forte që vesh trurin); ato marrin gjakun nga venat encefalike e venat orbitale dhe e dergojne ne v. jugulare interne. Sinuset durale janë disa.

■ **Sinus sagital superior** (*sinus sagittalis superior*) merr gjak nga vv. cerebrale superficiale dhe e dergon ne konfluencen e sinuseve.

■ **Sinus sagital inferior** (*sinus sagittalis inferior*) eshte me i vogel; ne te derdhen disa vv. cerebrale superficiale. Sinusi sagital inferior bashkohet me v. magna cerebri duke formuar sinusin rektus.

■ **Sinus rektus** (*sinus rectus*) formohet nga bashkimi i sinusit sagital inferior me v. magna cerebri; ne te derdhen edhe vv. cerebelare superiore dhe pastaj ai derdhet ne konfluencen e sinuseve.

■ **Sinus kavernozi** (*sinus cavernosus*) merr gjak nga vv. orbitale (v. oftalmike superiore) dhe e dergon ne sinusin petroz superior dhe sinusin petroz inferior. Dy sinuset kavernoze komunikojnë midis tyre me sinusin interkavernozi anterior (*sinus intercavernosus anterior*) dhe sinusin interkavernozi posterior (*sinus intercavernosus posterior*).

■ **Sinus petroz superior** (*sinus petrosus superior*) derdhet ne sinusin transversal.

■ **Sinus petroz inferior** (*sinus petrosus inferior*) derdhet direkt ne v. jugulare interne.

■ **Konfluenca e sinuseve** (*confluens sinuum*) formohet ne vendin e bashkimit te sinusit sagital superior me sinusin rektus dhe drenon ne dy sinuset transverse.

■ **Sinus transvers** (*sinus transversus*) vazhdon lateralish me sinusin sigmoid.

■ **Sinus sigmoid** (*sinus sigmoideus*) ne nivelin e foramen jugulare vazhdon me v. jugulare interne.

**V. jugulare interne** (*vena jugularis interna*) eshte vazhdim i sinusit sigmoid pas foramen jugulare; ajo zbret ne qafe ne perberje te tufes neurovaskulare te saj dhe pastaj bashkohet me venen subklavia duke formuar venen brakiocefalike. Ne venen jugulare interne derdhen v. tiroide superiore, v. linguale, v. faciale dhe v. retromandibulare.

■ **V. tiroide superiore** (*v. thyroidea superior*) merr dege nga gjendra tiroide. (V. tiroide inferiore derdhet direkt ne v. brakiocefalike).

■ **V. linguale** (*v. lingualis*) merr dege nga gjuha.

■ **V. faciale** (*v. facialis*) formohet nga bashkimi i v. angularis (*v. angularis*), v. labiale superiore (*v. labialis superior*) e v. labiale inferiore (*vv. labiales inferiores*).

■ **V. retromandibulare** (*v. retromandibularis*) formohet nga bashkimi i vv. temporale superficiale (vv. *temporales superficiales*) me vv. maksilare (vv. *maxillares*). Vv. maksilare fillojne me pleksin pterygoideus ne te cilin vjen gjak nga mandibula e dhembet e poshtem, maksila e dhembet e siperim, muskujt mastikatore si dhe vena oftalmike inferiore.

**V. jugulare eksterne** (*vena jugularis externa*) formohet nga bashkimi i v. aurikulare posteriore (v. *auricularis posterior*) me v. oksipitale (v. *occipitalis*) dhe nje dege te v. retromandibulare.

**V. jugulare anteriore** (*vena jugularis anterior*) zurret ne qafe anash linjes mediane dhe derdhet ne v. jugulare eksterne. Dy vv. jugulare anteriore, mbi sternum, anastomozojne me njera tjetren duke formuar harkun venoz jugular (*arcus venosus juguli*).

## VENAT E GJYMTYRES SE SIPERME

**Venat e gjymtires se siperme** (*venae membri superioris*) e derdhin gjakun ne venen aksilare, kjo ne venen subklavia e cila bashkohet me venen jugulare interne per te formuar venen brakiocefalike.

Venat e gjymtires se siperme jane siperfaqesore dhe te thella.

**Venat siperfaqesore** (*venae superficiales membri superioris*) gjenden nen lekure dhe jane te dukshme.

■ **Ne dore**, ne anen dorsale te gishtave, jane vv. digitale dorsale qe vazhdojne me vv. metakarpale dorsale (vv. *metacarpales dorsales*). Prej tyre formohet rrjeti venoz dorsal i dores (*rete venosum dorsale manus*) nga i cili dalin dhe ngjitet ne parakrah v. cephalike (v. *cephalica*) lateralish dhe v. bazilike (v. *basilica*) medialisht, te cilat pastaj kalojne perpara ne parakrah. Ne anen palmare te gishtave te dores jane vv. digitale palmare (vv. *digitales palmares*), qe formojne harkun venoz palmar superficial (*arcus venosus palmaris superficialis*), nga i cili del dhe ngjitet ne parakrah v. mediane antebrakiale (v. *mediana antebrachii*).

■ **Ne parakrah**, anteriorisht, ne kete menyre, ngjiten drejt artikulacionit te brrylit lateralish v. cephalike, ne mes v. mediane antebrakiale dhe medialisht v. bazilike. Perpara artikulacionit te brrylit, nga v. cephalike shkon ne v. bazilike, oblikisht, v. mediane e brrylit (v. *mediana cubiti*), ne te cilin derdhet v. mediane antebrakiale.

■ **Ne krah**, ne kete menyre, medialisht ngjitet v. bazilike qe vazhdon me v. aksilare dhe lateralish v. cephalike, qe derdhet ne v. aksilare.

**Venat e thella** (*venae profundae membra superioris*) zakonisht jane çifte dhe shoqerojne arteriet.

■ **Ne dore**, ne anen palmare, vv. metakarpale palmare (vv. *metacarpales palmares*) formojne harkun venoz palmar profund (*arcus venosus palmaris profundus*) nga i cili dalin vv. radiale (vv. *radiales*) e vv. ulnare (vv. *ulnares*).

■ **Ne parakrah venat radiale** e **venat ulnare** shoqerohen nga vv. interossea anteriore (vv. *interosseae anteriores*) dhe vv. interossea posteriore (vv. *interosseae posteriores*).

■ **Ne krah** venat e mesiperme bashkohen ne vv. brakiale (vv. *brachiales*), qe bashkohen me v. bazilike qe vazhdon me v. aksilare.

**V. aksilare** (v. *axillaris*) merr gjate rruges se saj v. cephalike, v. cirkumflekse humeri anteriore (v. *circumflexa humeri anterior*) dhe v. cirkumflekse humeri posteriore (v. *circumflexa humeri posterior*) si dhe disa vena nga pareti torakal dhe vazhdon si v. subklavia.

**V. subklavia** (v. *subclavia*) bashkohet me v. jugulare interne duke formuar v. brakiocefalike.

## VENA AZIGOS

**V. azigos** (*vena azygos*) dhe v. hemiazigos (*vena hemiazygos*) e marrin fillimin ne paretin posterior te hapesires abdominale. Vv. lumbale (vv. *lumbales*) ne secilen ane anastomozojne me venen lumbare ascendent (v. *lumbalis ascendens*) qe djathetas vazhdon me v. azigos dhe majtas me v. hemazigos, te cilat pasi kalojne diafragmen hyjne ne hapesireni torakale, ne mediastinin posterior. Ne to derdhen vv. ezofageale (vv. *oesophageales*), vena nga organet e tjera mediastinale si dhe vv. frenike superiore (vv. *frenicae superiores*) e vv. interkostale posteriore (vv. *intercostales posteriores*).

V. hemiazigos rrreth nivelit te vertebres T7 kthehet djathetas dhe derdhet ne v. azigos. Para derdhjes ne te derdhet v. hemiazigos akcesore (vv. *hemiazygos accessoria*) qe formohet nga vv. interkostale posteriore te majta mbi nivelin e vertebres T7.

V. azigos pasi merr venen hemiazigos ngjitet deri mbi rrrenjen e pulmonit te djathje, pastaj kthehet mbi te dhe vjen perpara per t'u derdhur ne v. kava superiore.

**Venat e kolones vertebrale** (*venae columnae vertebralis*) formojne pleksin venoz vertebral intern (*plexus venosus vertebralis internus*) dhe pleksin venoz vertebral ekstern (*plexus venosus vertebralis externus*). Prej ketyre plekseve gjaku kalon ne vv. intervertebrale (v. *intervertebralis*), te cilat derdhen ne vv. interkostale posteriore dhe vv. lumbare.

### VENA KAVA INFERIORE

**V. kava inferiore** (*vena cava inferior*) mbledh gjakun nga abdomeni, pelvisi dhe gjymtyret e poshtme. Ajo fillon ne nivelin e vertebres L4 nga bashkimi i dy vv. iliake komune. V. kava inferiore ngjitet ne hapesiren retroperitoneale, djathetas aortes, kalon diafragmen ne hiatusin e saj, futet ne hapesiren torakale dhe perfundon ne atriumin e djathje. Deget qe derdhen ne v. kava inferiore i korrespondojne degeve çifte te aortes abdominale (perveç vv. hepatike).

- ✉ **Vv. lumbare** (vv. *lumbales*), kater ne çdo ane, jane homologe me vv. interkostale posteriore.
- ✉ **V. testikulare** (v. *testicularis*) e djathtë derdhet direkt ne v. kava inferiore, ndersa e majte derdhet ne v. renale te majte (tek meshkujt). Ne te njejtën menyre **v. ovarike** (v. *ovarica*) e djathtë derdhet direkt ne v. kava inferiore, ndersa e majte derdhet ne v. renale te majte (tek femrat).
- ✉ **Vv. renale** (vv. *renales*) marrin gjak nga veshkat. Ne te majten derdhet v. testikulare ose v. ovarike.
- ✉ **Vv. suprarenale** marrin gjak nga gjendrat suprarenale.
- ✉ **Vv. frenike inferiore** (vv. *frenicae inferiores*) jane homologe me vv. frenike superiore.

- ✉ **Vv. hepatike** (vv. *hepaticae*) jane tre, v. hepatike e djathte (v. *hepatica dextra*), v. hepatike e majte (v. *hepatica sinistra*) dhe v. hepatike e ndermjetme (v. *hepatica intermedia*). Venat hepatike nxjerrin nga hepari gjakun qe sjellin ne te a. hepatike propria dhe v. porta.

**V. iliake komune** (*vena iliaca communis*) formohet nga bashkimi i v. iliake interne me v. iliake eksterne. Ky bashkim ndodh ne nivelin e artikulacionit sakroiliak.

**V. iliake interne** (*vena iliaca interna*) merr dege parietale dhe dege viscerale.

✉ **Vv. gluteale superiore** (vv. *gluteales superiore*), **vv. gluteale inferiore** (vv. *gluteales inferiores*) dhe **vv. obturatore** (vv. *obturatoria*) jane dege parietale.

✉ **Pleksi pelvik** formohet nga deget viscerale te v. iliake interne. Ai sherben si nje shunt i rendesishem midis venes kava e inferiore e venes porta kur sistemi i kesaj te dytes blokohet. Perberes te pleksit pelvik jane plekset qe formohen ne organet pelvike.

**Pleksi i vezikes urinare** (*plexus venosus vesicalis*) formohet nga vv. vezikale (vv. *vesicales*). **Pleksi uterin** (*plexus venosus uterinus*) dhe **pleksi vaginal** (*plexus venosus vaginalis*) formohen nga **vv. uterine** (vv. *uterinae*).

**Pleksi rektal** (*plexus venosus rectalis*) ne pjesen e poshtme te tij rreth kanalit anal, ka dy pjesë, nje interne (mbi sfinkterin anal intern) e nje eksterne (mbi sfinkterin anal ekstern). Pleksi rektal drenon me vv. rektale superiore ne sistemin e v. porta dhe me vv. rektale te mesme e inferiore ne sistemin e v. kava inferiore. **Vv. rektale media** (vv. *rectales mediae*) derdhen ne v. iliake interne.

✉ **V. pudente interne** (v. *pudenta interna*), vv. labiale e vv. skrotale jane Jane dege te tjera viscerale te v. iliake interne. Ne v. pudente interne derdhen **vv. iliake inferiore**.

**V. iliake eksterne** (v. *iliaca externa*) eshte vazhdim i v. femorale; ajo merr v. epigastrike inferiore (v. *epigastrica inferior*), qe vjen nga pareti anterior abdominal deri nen umbilikus, dhe pastaj bashkohet me v. iliake interne.

### VENA PORTA

**V. porta** (*vena porta hepatis*) merr gjak nga organet digestive teke te hapesires abdominale dhe e dergon ate ne hepar. Ajo formohet nga bashkimi i v. mezenterike superiore me v. lienale. Direkt ne v. porta e derdhin gjakun v. gastrike dextra (v. *gastrica dextra*) dhe v. gastrike sinistra (v. *gastrica sinistra*) qe vijne nga kurvatura minore e stomakut.

\* **V. mezenterike superiore** (*v. mesenterica superior*) merr gjak nga kurvatura majore e stomakut me *v. gastroomental dextra* (*v. gastroomental dextra*), nga duodenit e pankreasi me *vv. pancreaticoduodenale* (*vv. pancreaticoduodenales*), nga jejunumi me *vv. jejunale* (*vv. jejunales*), nga ileumi me *vv. ileale* (*vv. ileales*), nga cekumi me *v. ileokolike* (*v. ileocolica*), nga koloni ascendent me *v. kolike dextra* (*v. colica dextra*) dhe nga koloni transvers me *v. kolike media* (*v. colica media*).

\* **V. lienale** (*v. lienalis*) pasi merr dege nga lieni dhe *v. gastroomental sinistra* (*v. gastroomental sinistra*) nga kurvatura majore e stomakut, merr edhe *v. mezenterike inferiore* (*v. mesenterica inferior*). Kjo sjell gjak nga koloni descendant me *v. kolike sinistra* (*v. colica sinistra*), nga sigma me *vv. sigmoidiene* (*vv. sigmoideae*) dhe nga pjesa e siperme e rektumit me *v. rektale superiore* (*v. rectalis superior*).

## VENAT E GJYMTYRES SE POSHTME

**Venat e gjymtyres se poshtme** (*venae membri inferioris*) e derdhin gjakun ne venen femorale, qe vazhdon me venen iliake eksterne, e cila bashkohet me venen iliake interne duke formuar venen iliake komune.

Venat e gjymtyres se poshtme jane siperfaqesore dhe te thella.

**Venat siperfaqesore** (*venae superficiales membri inferioris*) gjenden nen lekure dhe jane te dukshme.

\* **Ne kembe**, ne anen dorsale te gishtave, gjenden *vv. digitale dorsale* (*vv. digitales dorsales pedis*), qe vazhdojne me *vv. metatarsale dorsale* (*vv. metatarsales dorsales*) pas te cilave formohet **rrjeti venoz dorsal** (*rete venosum dorsale pedis*). Ne anen plantare gjithashtu gjenden *vv. digitale plantare* (*vv. digitales plantares*) qe vazhdojne me *vv. metatarsale plantare* (*vv. metatarsales plantares*) pas te cilave formohet **rrjeti venoz plantar** (*rete venosum plantare*). Nga rrjeti venoz dorsal e rrjeti venoz plantar formohet medialisht *v. safena magna* (*v. saphena magna*) dhe lateralisht *v. safena parva* (*v. saphena parva*).

\* **Ne kerci** *v. safena magna* ngjitet ne anen mediale te tij, ndersa *v. safena parva*, e cila ngjitet ne anen laterale, prapa artikulacionit te gjurit derdhet ne *v. poplitea*.

\* **Ne kofshe** *v. safena magna* ngjitet medialisht deri (nen lig. inguinal) ne hiatusin safen ku futet dhe derdhet ne **v. femorale**.

**Venat e thella** (*venae profundae membrae inferioris*) zakonisht jane cifte dhe shoqerojne arteriet.

\* **Ne kerci** gjenden *vv. tibiale anteriores* dhe *vv. tibiale posteriores* qe bashkohen ne *v. poplitea* (*v. poplitea*), ne te cilin derdhet edhe *v. safena parva*.

\* **Ne kofshe** *v. poplitea* vazhdon si *v. femorale* (*v. femoralis*). Ne te derdhet *v. profunda femoris* (*v. profunda femoris*), qe merr *vv. circumflexae femoris mediales* dhe *vv. circumflexae femoris laterales* (*vv. circumflexae femoris laterales*).

**V. femorale** (*v. femoralis*) kalon ne lakunen vazore, medialisht a. **femorale** dhe vazhdon si *v. iliaka eksterne*.

## ANASTOMOZAT PORTAKAVALE

**Anastomozat portakavale** realizohen midis venave te qarkullimit portal dhe venave te qarkullimit sistemik. Keto anastomoza ekzistojne ne sistemin digestiv ne ezofag dhe ne rektum, gjithashtu ekzistojne ne paretin anterior dhe ne paretin posterior abdominal.

\* **Ne ezofag** anastomoza realizohet midis **venes gastrike sinistra** (pastaj *v. porta*) te qarkullimit portal dhe **venave ezofageale** (pastaj *v. azigos e v. hemiazigos* dhe *v. kava superiore*) te qarkullimit sistemik.

\* **Ne rektum** anastomoza realizohet midis **venes rektale superiore** (pastaj *v. lienale, v. mezenterike inferiore* e *v. porta*) te qarkullimit portal dhe **venes rektale te mesme e venes rektale inferiore** (pastaj *v. iliaka interne* e *v. kava inferiore*) te qarkullimit sistemik.

\* **Ne paretin anterior abdominal** anastomoza realizohet midis **venave paraumbilikale** (qe shkojnë pergjate lig. teres hepatic ne *v. porta*) te qarkullimit portal dhe **venes epigastrike inferiore** (pastaj *v. iliaka eksterne, v. iliaka komune* e *v. kava inferiore*) te qarkullimit sistemik.

\* **Ne paretin posterior abdominal** anastomoza realizohet midis **venave kolike** te djathte, te mesme e te majte (pastaj perkatesisht *v. mesenterike*

superiore e v. mesenterike inferiore dhe v. porta) te qarkullimit portal dhe **venave renale e venave suprarenale** (pastaj v. kava inferiore) te qarkullimit sistemik.

### Fakte klinike

#### Terapia intravenoze

Medikamentet e ndryshme mund te administrohen ne rruge lokale (psh. nepermjet lekures-pomadat), rruge enterale (nepermjet traktit digestiv) ose rruge parenterale (injekzionet: intravenoze, subkutane, intramuskulare etj.).

**Terapia intravenoze** aplikohet zakonisht ne rastet e injeksioneve se urgjencese dhe kujdesit intensiv, meqe kjo eshte rruga me e shpejtë e shperndarjes se medikamenteve ne organizem. Ne rruge intravenoze gjithashu mund te merret gjak per ekzaminime te ndryshme, behet transfuzioni i gjakut etj.

Terapia intravenoze ka rreziqet e veta, prandaj duhet kryer gjithnjë nen supervizim mjekesor. Ekstravazimi (injekzioni jashtë venes), flebiti (inflamacioni i venes), mbingarkesa ne lengje, embolizmi janë disa rreziqet e terapise intravenoze.

#### Trombi, emboli dhe trombembolia

Trombi (koaguli) eshte produkti final i procesit te koagulimit te gjakut. Ai normalisht formohet ne rastet e denitimeve te mureve te vazave per te ndaluar hemoragine. Tromboza eshte formimi brenda nje vase gjaku i nje trombi qe obstrukton kete vase. Ajo mund te ndodhe ne rastet e demtimit (traumatik, infeksioz) te mureve te vazave, te uljes se shpejtësise se qarkullimit te gjakut ose ne çrrregullime te koagulimit. Tromboza mund te jete arteriale (psh. ne arteriet koronare ku shkakton infarkt te miokardit) ose venoze (psh. ne venen porta).

Emboli eshte prania dhe qarkullimi ne gjak i nje "materiali" jo te tretshem ne te. Shkeputja e nje trombi dhe qarkullimi ne gjak e kthen ate ne embol. (Embol mund te jete gjithashu gazor, yndyror etj.). Embolizmi eshte blokimi i nje vase gjaku nga nje embol.

Trombembolia nenkupton nje tromboze qe komplikohet me embolizem. Nje tromb i formuar ne sistemin venoz sistemik mund te shkoje ne gjysmen e djathte te zemres dhe te perfundoje ne arteriet pulmonare ose deget e tyre (trombemboli pulmonare). Nje tromb i formuar ne gjysmen e majte te zemres (psh. nga fibrilacioni atrial) mund te shkoje ne çdo pjese te trupit te njeriut; ngs shkon ne triu shkakton infarkt trunor.

#### Tromboflebiti

Tromboflebiti eshte prania e nje trombi ne vene, shoqueruar me inflamacion te saj (flebit). Shenjat jane ato te inflamacionit: dhimbje skuqje e enjte lokale. Trajtimi eshte medikamentoz (antibiotike, antikoagulanje, analgezike). Komplikacioni me i shpeshte eshte shkeputja e trombit (trombembolia).

#### Hipertensioni portal

Hipertensioni portal eshte rritje e presionit te gjakut ne venen porta dhe deget e saj. Shkaku me i shpeshte eshte cirroza e heparit.

Si pasoje ndodh zgjerimi i venave te sistemit portal shoqueruar me zgjerim te anastomozave portakavale, me ascit (prani e likidit te lire ne hapesirene peritoneale) dhe me splenomegali (zmadhim te lienit).

Zgjerimi i anastomozave portakavale mund te shprehet me pranine e variceve te ezofagut, te hemorroideve ose te "caput medusae".

Varicet e ezofagut zhvillohen me teper ne pjesen fundore te tij; ato zakonisht diagnostikohen me endoskopji. Shpesh komplikohen me hemoragi. Trajtimi eshte ligatura e variceve ose skleroterapia.

Hemorroidet jane zgjerime varikoze te venave ne rektum e anus; ato mund te inflamohen, trombozohen etj. Perveç shkaqeve te tjera (predisposicioni gjenetik, qendrimet e gjata ulur, seksi anal etj), hemorroidet mund te vijnë edhe nga hipertensioni portal. Hemorroidet mund te jene te brendshme (lokalizohen ne rektum) ose te jashtme (lokalizohen ne kanalin anal). Trajtimi permbledh mjekimin lokal, rregullime ne diete dhe nderhyrje kirurgjikale.

"Caput medusae" nenkupton zgjerimin e venave umbilikale te cilat perhafen si rreze nga umbilikusi per te drenuar ne venat sistemike (duke dhene pamjen e kokes se meduzes). Zakonisht zhvillohet ne fazat e perparuara te hipertensionit portal.

## VAZAT LIMFATIKE

### Duktusi torakal

### Duktusi limfatik i djathte

Rruget limfatike perbehën nga rrjeti i kapilareve limfatike, qe mbledhin limfen nga organet dhe indet e organizmit, nga vazat limfatike qe marrin limfen nga kapilaret dhe e dergojne ne venat e medha te qafes dhe nga nyjet limfatike te shperndara ne sistemin e vazave limfatike. Limfa formohet nga lengu nderqelizor, i cili eshte derivat i plazmes se gjakut (ka te njejtën perberje, por eshte me e holluar se ajo). Nepermjet vazave limfatike ajo rikthehet serish ne sistemin venoz, prandaj vazat limfatike konsiderohen si pjese e sistemit te qarkullimit te gjakut dhe aneks i sistemit venoz.

**Kapilaret limfatike** jane tuba me njerin fund te mbyllur, te zhytur ne lengun indor nderqelizor, qe vjen nga plazma e gjakut. Ata kane diameter dhe peshkueshmeri me te madhe se te kapilareve te gjakut.

**Vazat limfatike** kane paret te holle te tejdukshem, keshtu qe rrjedhja e limfes mund te duket permes tij. Brenda lumenit ato kane valvula qe vendosen ne intervale me te vegjel se valvulat e venave. Vazat limfatike te zorreve te holla, gjate procesit te tretjes, mbushen me nje leng si qumesht, qe quhet "kilus". Dy Jane vazat me te medha limfatike, duktusi torakal dhe duktusi limfatik i djathte.

**Nyjet limfatike** ose noduset limfatike ose limfonoduset ndodhen ne rrugen e vazave limfatike. Ata kane forme zakonisht ovale dhe funksioni tyre eshte te filtrojne limfen dhe ta pasurojne ate me limfocite. Ne nyjet limfatike fillon gjithashtu per gjigja imunitare. Per kete aresye, ndonese anatomikisht ato lidhen me vazat limfatike, funksionalisht i takojne sistemit limfoid, ne te cilin edhe studiohen.

## DUKTUSI TORAKAL

**Duktusi torakal** (*ductus thoracicus*) formohet nga bashkimi i dy trungjeve lumbare (*truncus lumbalis*) te djathte e te majte, qe sjellin limfe nga gjysma e poshtme e trupit. Pjesa fillestare e duktusit torakal, ne te cilin derdhen trunkuset intestinale (*trunci intestinales*) qe sjellin kilus, eshte e zgjerauar dhe quhet cisterna kili (*cysterna chyli*).

Duktusi torakal ngjitet siper, kalon diafragmen ne hiatusin aortik dhe ne toraks merr edhe limfen qe sjell nga gjysma e majte e toraksit trunku bronkomediastinal i majte (*truncus bronchomediastinalis*), nga gjymtyra e siperme e majte trunku subklavius i majte (*truncus subclavius*) dhe nga ana e majte e kokes e qafes trunku jugular i majte (*truncus jugularis*). Pastaj duktusi torakal derdhet ne kedin midis venes subklavia te majte dhe v. jugulare te majte.

## DUKTUSI LIMFATIK I DJATHTE

**Duktusi limfatik i djathte** (*ductus lymphaticus dexter*) formohet nga bashkimi i trunkut bronkomediastinal te djathte, qe sjell limfe nga gjysma e djathte e toraksit, trunkut subklavius te djathte qe sjell limfe nga gjymtyra e

siperme e djathte dhe trunku jugular i djathte qe sjell limfe nga gjysma e djathte e kokes e qafes.

Duktusi limfatik i djathte derdhet ne kedin midis venes subklavie te djathte dhe v. jugulare te djathte.

## 11. SISTEMI LIMFOID

**Organet limfoide primare**

**Organet limfoide sekondare**

**Sistemi limfoid** (*systema lymphoideum*) perbehет nga organet limfoide, ne te cilat ka nje perqendrim te madh te limfociteve. Keto jane organet limfoide primare, ne te cilat ndodh diferencimi (prodhimi) i limfociteve dhe organet limfoide sekondare, ne te cilat limfocitet marrin pjese ne perqigjet imunitare. Qarkullimi i limfociteve ne organizem behet nepermjet gjakut e limfes.

### ORGANET LIMFOIDE PRIMARE

**Organet limfoide primare** (*organa lymphoidea primaria*) ose qendrore jane palca e kockave dhe timusi.

**Palca e kockave** (*medulla ossium*) gjendet kryesisht ne hapesirene medulare me forme kanali, ne kockat e gjata. Ajo eshte vendi i prodhimit te eritociteve, leukociteve (perfshire limfocitet) dhe trombociteve.

**Timusi** (*thymus*) vendoset ne mediastinin superior prapa manubriumit te sternumit. Ai zhvillohet mjaft gjate femijerise, ndersa fillon te atrofizohet pas pubertetit duke u zevendesuar gradualisht me ind dhjarmor.

Timusi perbehet nga dy lobe asimetrike te ndare ne lobule (*lobuli thymi*). Ne timus, limfocitet e prodhuara nga palca e kockave maturohen, hidhen ne gjak dhe nepermjet tij qarkullojnë ne gjithe organizmin.

## ORGANET LIMFOIDE SEKONDARE

**Organet limfoide sekondare** (*organa lymphoidea secundaria*) ose periferike jane lieni, unaza limfoide e faringut dhe nyjet limfatike.

**Lieni** (*lien, splen*) ose shpretka vendoset ne katin e siperme te hapesires abdominale dhe projektohet ne regionin e hipokondrit te majte. Madhesia e tij eshte shume variabile. Funksioni kryesor i tij eshte shkaterrimi i eritrociteve. Gjithashtu ne lien ndodh filtrimi i “trupezave” te huaj qe qarkullojne ne gjak.

Lieni ka faqen diafragmatike (*facies diaphragmatica*) dhe faqen viscerale (*facies visceralis*), e cila ka kontakt me stomakun, fleksuren kolike te majte, pankreasin dhe veshken e majte. Ne kufirin midis fases gastrike dhe fases renale gjendet hilumi lienal (*hilum lienale*) ne te cilin kalojne vazat e gjakut.

Lieni eshte organ intraperitoneal. Peritoneumi midis lienit dhe stomakut formon lig. gastrolienal (*lig. gastrolienale*), midis lienit e kolonit lig. splenokolik (*lig. splenocolicum*), midis lienit e pankreasit lig. pankreatikolienal (*lig. pancreaticosplenicum*), midis lienit e veshkes lig. splenorenal (*lig. splenorenale*). Lieni rrrethohet nga nje kapsul fibroze (*capsula*), e cila vazhdon ne brendesi me trabekulat (*trabeculae splenicae*), te cilat jane te shumta, te degezuara dhe formojne nje skelet fibroz per parenkimen e lienit. Kjo parenkime formohet nga pulpa e bardhe dhe pulpa e kuqe (sipas ngjyres ne lienin e fresket). Pulpa e bardhe (*pulpa alba*) formohet nga ind limloid ne te cilin limfocitet proliferojne nen veprimin e stimujve antigenike. Pulpa e kuqe (*pulpa rubra*) sherben si nje filter i veçante per gjakun kur ky kalon neper lien. Ajo perbehet nga nje numer i madh sinusesh venoze (*sinus lienalis*).

**Unaza limfoide e faringut** (*anulus lymphoideus pharyngis*) perbehet nga tonsila palatine (*tonsilla palatina*), tonsila linguale (*tonsilla lingualis*), tonsila faringeale (*tonsilla pharyngea*) dhe tonsilat tubare (*tonsilla tubaria*). Ato rrrethojne hyrjen ne rrugen respiratore e digestive dhe jane vendet ku organizmi perballat me mikroorganizmat qe vijnë ne keto rruge, prandaj konsiderohen si linja e pare e mbrojtjes kunder “agresoreve” te jashtem.

**Nyjet limfatike** (*nodus lymphoideus, nodus lymphaticus, lymphonodus*), pavaresisht mendimeve kundershtuese, konsiderohen si perberes te sistemit limfoid, te vendosura ne rrugen e vazave limfatike. Gabimisht nganjehere quhen limfoglandula (nuk jane gjendra, nuk sekretojne). Nyjet limfatike sherbejne si filtra, ne te cilat limfocitetet kapin dhe shkaterrojnë bakteret e virusët. Ne rast infektioni numri i limfocitetit rritet dhe po ashtu madhesia e nyjeve limfatike.

Nyjet limfatike rrrethohen nga nje kapsul fibroze (*capsula*) e cila vazhdon ne brendesi me trabekulat (*trabeculae*). Ne prerje ne to dallohet korteksi (*cortex*) dhe medula (*medulla*). Ne hilumin (*hilum*) e nyjes limfatike hyjne disa vaza limfatike aferente dhe del nje vaze limfatike eferente.

Nyjet limfatike gjenden ne disa pjese te paretit te tubit digestiv dhe ne rrugen e vazave limfatike.

Ne jejunum dhe ileum gjenden nyjet limfatike solitare e aggregate (*noduli lymphoidei solitarii e noduli lymphoidei aggregati*).

Ne rrugen e vazave limfatike gjendet pjesa me e madhe e nyjeve limfatike, te organizuara ne nyje limfatike regionale.

Nyjet limfatike regionale (*nodi lymphoidei regionales*) jane te kokes e qafes, te gjymtyres se siperme, te toraksit, te abdomenit e pelvisit dhe te gjymtyres se poshtme. Ne praktike disa prej tyre jane me te ekzaminueshme.

■ **Nyjet limfatike te kokes e qafes** (*nodi lymphoidei capititis et colli*) perfshijne nyjet limfatike submandibulare (*nodi submandibulares*), nyjet limfatike cervikale anteriore e laterale (*nodi cervicales anteriores e nodi cervicales laterales*), nyjet limfatike supraklavikulare (*nodi supraclavicularis*) etj.

■ **Nyjet limfatike te gjymtyres se siperme** (*nodi lymphoidei membri superioris*) perfshijne nyjet limfatike aksilare (*nodi lymphoidei axillares*) etj.

■ **Nyjet limfatike te toraksit** (*nodi lymphoidei thoracis*) perfshijne nyjet limfatike paratrakeale (*nodi paratracheales*), nyjet limfatike trakeobronkiale (*nodi tracheobronchiales*) etj.

■ **Nyjet limfatike te abdomenit** (*nodi lymphoidei abdominis*) perfshijne nyjet limfatike aortale e nyjet limfatike kavale (*noduli lumbales sinistri, intermediae, dextri*), nyjet limfatike celiake (*nodi coeliacii*), nyjet limfatike mezenterike superiore (*nodi mesenterici superiores*), nyjet limfatike mezenterike inferiore (*nodi mesenterici inferiores*) etj.

**Nyjet limfatike te pelvisit** (*nodi lymphoidei pelvis*) perfshijne nyjet limfatike iliaka komune (*nodi iliaci communes*), nyjet limfatike iliaka interne (*nodi iliaci interni*), nyjet limfatike iliaka eksterne (*nodi iliaci externi*) etj.

■ **Nyjet limfatike te gjymtyres se poshtme** (*nodi lymphoidei membri inferioris*) perfshijne nyjet limfatike inguinale (*noduli lymphoidei inguinales*), nyjet limfatike popliteale (*nodi poplitei*) etj.

## Fakte klinike

### Tonsiliti akut

Tonsiliti akut eshte inflamacioni akut i tonsilave palatine. Shkaku mund te jetë bakterial (streptokoku) ose viral. Shenjat klinike jane dhimbja ne gryke, veshtiresia ne gelltitje, temperatura etj. Komplikacione mund te jene abscesi peritonsilar, rheumatizmi artikular akut etj. Trajtimi eshte medikamentoz; ne rastet kronike mund te behet heqja e tonsilave (tonsilektomia).

### Splenomegalia

Splenomegalia eshte zmadhimi i lienit. Ajo mund te vije nga hiperfunkzioni i lienit (shkatterrim i shtuar i eritrociteve), hipertensioni portal, semundjet infektive, infiltrimet malinje (leucemia, limfoma) etj. Veç shenjave te semundjes primare, splenomegalia shoqerohet edhe me dhimbje renduese abdominale.

### Limfadenopatia

Limfadenopatia eshte zmadhimi i nyjeve limfatike. Zakonisht ky zmadhim eshte reaktiv ose tumoral. Zmadhimi reaktiv i nyjeve limfatike ndodh ne infekzionet akute ose kronike. Zmadhimi tumoral eshte ose primar (ne limfomat) ose sekondar (metastatik).

Limfadenopatia mund te jetë e gjeneralizuar ose regionale.

Limfadenopatia e gjeneralizuar prek njekohesisht nyje limfatike ne pjesë te ndryshme te trupit. Ajo mund te vije per shkaqe infeksioze (zakonisht virale), tumorale (leucemia) etj.

Limfadenopatia regionale prek nje ose disa nyje limfatike te nje grupi. Ajo mund te jetë limfadenopati cervikale (zakonisht infeksioze), mediastinale (zakonisht tumorale), aksilare (shpesh ne tumoret e gjendres se gjirit), abdominale (infeksioze, tumorale), inguinale (zakonisht infeksioze) etj.

## 12. SISTEMI NERVOR

**Sistemi nervor** (*systema nervosum*) eshte sistemi me i nderlikuar i organizmit te njeriut. Qeliza baze e tij eshte neuroni dhe shkak i kompleksitetit te sistemit nervor eshte fakti qe nje neuron i veçante mund te beje lidhje sinaptike me dhjetra, me qindra e bile me mijera neurone te tjere dhe impulset qe arrijne te, nga kaq shume drejtime, i nenshtrohen efektit shumues ne kohe dhe ne hapesire.

Sistemi nervor ka pjesen e tij qendrore ose sistemin nervor qendor dhe pjesen periferike ose sistemin nervor periferik.

**Sistemi nervor qendor** (SNQ) perbehet nga truri dhe medula spinale.

**Sistemi nervor periferik** (SNP) perbehet nga nervat kraniale (qe dalin nga truri) dhe nervat spinale (qe dalin nga medula spinale).

Sistemi nervor gjithashtu mund te ndahet ne sistemin nervor somatik dhe sistemin nervor autonom. Anatomikisht te dy keta perberes kane elemente si ne sistemin nervor qendor ashtu edhe ne sistemin nervor periferik. **Sistemi nervor somatik** perfaqeson komponentin somatik te sistemit nervor, qe realizon lidhjen me mjedisin e jashtem.

**Sistemi nervor autonom** (SNA) perfaqeson komponenetin visceral te sistemit nervor, qe realizon kontrollin mbi mjedisin e brendshem te organizmit. Ai perbehet nga pjesa simpatike, pjesa parasimpatike dhe pjesa enterike.

Sistemi nervor perbehet nga **tre tipe neuronesh**: neurone aferente (ose sensore), neurone eferente (ose motore) dhe neurone te ndermjetem (interneurone).

Neuronet aferente kane mbaresa sensore, qe marrin ngacmimë te per gjithshme ose speciale nga mjedisit i jashtem osc i brendshem i trupit.

Neuronet eferente, nepermjet mbaresave te tyre motore, dergojne impulsset motore drejt organeve efektore (muskujt).

Neuronet e ndermjetem gjenden ne sistemin nervor qendor, jane me te shumtet ne numer dhe nuk kane as mbaresa sensore, as mbaresa motore.

## SISTEMI NERVOR QENDROR

- Medula spinale
- Trunku i trurit
- Cerebelumi
- Diencefaloni
- Telencefaloni
- Sistemi limbik
- Rruget e ndjeshmerise
- Rruget motore
- Meningjet
- Sistemi ventrikular

**Sistemi nervor qendror** (*systema nervosum centrale*) perbehet nga truri (*encephalon*), qe vendoset ne hapesiren kraniale dhe medula spinale, qe vendoset ne kanalin vertebral.

### MEDULA SPINALE

**Medula spinale** (*medulla spinalis*) vendoset ne kanalin vertebral. Ajo shtrihet ne dy te tretat e siperme te tij, nga niveli i foramen magnum deri ne nivelin e diskut intervertebral midis vertebrave L1-L2; kjo ndodh per aresye te maturimit me te shpejte te saj ne report me kanalin vertebral.

**Ne pamjen e jashtme** medula spinale ka forme pak a shume cilindrike, ndersa pjesa fundore e saj ngushtohet si kon (*conus medullaris*). Koni medular vazhdon me poshte me filumin terminal (*filum terminale*), i cili fiksohet ne koksiks.

\* Medula spinale nuk eshte uniforme ne diameter gjate gjithe gjatesise se saj; ajo paraqet nje trashje cervikale, **intumeshencen cervikale** (*intumescensia cervicalis*), dhe nje trashje tjeter lumbosakrale, **intumeshencen lumbosakrale** (*intumescensia lumbosacralis*). Ne keto zona dalin nervat qe inervojne respektivisht gjymtyret e siperme dhe gjymtyret e poshtme.

Medula spinale ka ne pjesen e perparme fisuren mediane anteriore (*fissura mediana anterior*) dhe ne pjesen e pasme sulkusin median posterior (*sulcus medianus posterior*), qe vazhdon ne brendesi me septumin median posterior (*septum medianus posterius*). Anash medula spinale ka sulkusin lateral anterior (*sulcus anterolateralis*) dhe sulkusin lateral posterior (*sulcus posterolateralis*). Nga medula spinale dalin dy rrenjet e cdo nervi spinal (*nervus spinalis*), **rrenja anteriore** (*radix anterior*) dhe **rrenja posteriore** (*radix posterior*), perkatesisht nga sulkusi lateral anterior dhe nga sulkusi lateralposterior. Dy rrenjet bashkohen ne foramen intervertebrale duke formuar **nervin spinal**. Ne pjesen e poshtme te medules spinale rrenjet zbresin vertikalish duke formuar se bashku me filumin terminal, **kauden ekuina** (*cauda equina*) me pamjen e bishtit te kalit.

\* Njesia anatomofunksionale e medules spinale quhet **segment**, ai perfshin dy rrenjet e nervave spinale ne secilen ane si dhe pjesen perkatese te substances gri.

**Medula spinale** perbehet nga substanca gri dhe substanca e bardhe.

\* **Substanca gri** (*substancia grisea*) gjendet ne qender ne formen e nje kolone vertikale gjate gjithe gjatesise se medules. Ajo pershkohet ne qender nga **kanali central** (*canalis centralis*), i cili eshte i mbushur me leng cerebrospinal.

Ne prerje substanca gri ka formen e gernes H, me **bririn anterior** (*cornu anterius*), **bririn posterior** (*cornu posterius*) dhe **bririn lateral** (*cornu laterale*). Ne bririn anterior gjenden dy berthama mediale dhe dy berthama laterale. Berthamat mediale jane **nc. anteromedial** (*nucleus anteromedialis*) per inervimin e muskujve te perparme te trunkut dhe **nc. posteromedial** (*nucleus posteromedialis*) per inervimin e muskujve te pasem te trunkut. Berthamat laterale jane **nc. anterolateral** (*nucleus anterolateralis*) per inervimin e muskujve fleksore te gjymtyreve dhe **nc. posterolateral** (*nucleus posterolateralis*) per inervimin e muskujve ekstensore te gjymtyreve. Berthamat e bririt anterior i perkasin rrugeve motore qe percjellin impulset nga qendra ne periferi prandaj ky bri quhet edhe bri motor. Impulset prej tij dalin nepermjet fijeve qe formojne rrenjet e perparme ose motore te nervave spinale.

Ne bririn posterior gjenden keto grumbullime te qelizave nervore: **nc. proprius** (*nucleus proprius*) dhe **nc. dorsal** (*nucleus dorsalis*). Berthamat e bririt posterior i perkasin rrugeve sensore qe percjellin impulset nga periferia ne qender, prandaj ai quhet edhe bri sensor. Impulset ne kete bri vijne prej fijeve qe formojne rrenjet e pasme ose sensore te nervave spinale.

Ne bririn lateral, qe gjendet ne pjesen torakale te medules, gjendet **nc. intermediolateral** (*nucleus intermediolateralis*), i cili eshte berthame autonome, prandaj edhe ky bri quhet bri autonom.

Pershkrimi i mesiperm i substances gri aktualisht konsiderohet i vjeteruar dhe ne vend te tij preferohet ndarja e saj ne dhjete zona apo lamina sipas **Rexed**, te cilat emertoohen nga prapa perpara me shifrat nga I deri X.

■ **Substanca e bardhe** (*sustantia alba*) rrrethon substancen gri. Ajo ndahet ne tre funikuj: **funikulin anterior** (*funiculus anterior*), **funikulin lateral** (*funiculus lateralis*) dhe **funikulin posterior** (*funiculus posterior*). Ne çdo funikul kalojne trakte, te cilat perbehen nga fije nervore qe kane fillim e mbarim te njeje. Pergjithesishet ne funikulin anterior (prane bririt motor) gjenden traktet motore, ne funikulin posterior (prane bririt sensor) traktet sensore, ndersa ne funikulin lateral gjenden edhe trakte motore edhe sensore.

Keshtu ne funikulin anterior zbresin tr. tektospinal (*tractus tectospinalis*), tr. kortikospinal anterior (*tractus corticospinalis anterior*), tr. vestibulospinal (*tractus vestibulospinalis*), tr. olivospinal (*fibrae olivospinales*) dhe ngjitet tr. spinotalamik anterior (*tractus spinothalamicus anterior*).

Ne funikulin lateral zbresin tr. kortikospinal lateral (*tractus corticospinalis lateralis*) dhe tr. rubrospinal (*tractus rubrospinalis*), ndersa ngjiten tr. spinothalamic lateral (*tractus spinothalamicus lateralis*), tr. spinocerebelar anterior (*tractus spinocerebellaris anterior*) dhe tr. spinocerebelar posterior (*tractus spinocerebellaris posterior*).

Ne funikulin posterior ngjiten fascikuli gracilis (*fasciculus gracilis*) dhe fascikuli kuneat (*fasciculus cuneatus*).

## TRUNKU I TRURIT

**Trunku i trurit** (*truncus encephali*) vendoset mbi medulen spinale dhe perbehet nga medula oblongata, ponsi dhe mezencefaloni, te cilet kane ndertim te ngjashem.

## MEDULA OBLONGATA

**Medula oblongata** (*medulla oblongata*) eshte vazhdim i medules spinale. Ajo perben katin e poshtem te trunkut te trurit.

Ne pamjen e jashtme medula oblongata ka sulkuse e fisura qe jane ne vazhdim te strukturave homologe te medules spinale. Keshtu ajo ka **fisuren mediane anteriore** (*fissura mediana anterior*), **sulkusin lateral anterior**, (*sulcus anterolateralis*), **sulkusin lateral posterior** (*sulcus posterolateralis*) dhe **sulkusin median posterior** (*sulcus medianus posterior*). Midis sulkusit median anterior dhe sulkusit lateral anterior gjendet nje ngritje me formen e nje piramide te permbysur, **piramida** (*pyramis*), e vazhdon poshte me funikulin anterior te medules spinale. Nga secila piramide nisen fije qe kalojne ne anen tjeter pergjate fisures mediane anteriore dhe kryqezohen duke formuar **kryqezimin piramidal** (*deccusatio pyramidum*). Midis sulkusit lateral anterior dhe sulkusit lateral posterior, mbi funikulin lateral te medules spinale, gjendet nje ngritje tjeter, ne forme ulliri, **oliva** (*oliva bulbaris*). Midis sulkusit lateral posterior dhe sulkusit median posterior gjenden **tuberkulum gracilis** (*tuberculum gracile*) dhe **tuberkulum kuneat** (*tuberculum cuneatum*), ku perfundojnë perkatesisht fascikuli gracilis dhe fascikuli kuneat.

Faqja posteriore e medules oblongata formon trekendeshin bulbar te foses romboide.

Medula oblongata lidhet me cerebelumin (qe gjendet prapa trunkut te trurit) nepermjet **pedunkujve cerebelare inferiore** (PCI), qe formojne brinjet laterale te trekendeshit bulbar.

**Medula oblongata** perbehet nga substanca gri dhe substanca e bardhe.

■ **Substanca gri** nuk eshte unike si ne medulen spinale, por e fragmentuar ne berthama.

Ato Jane berthama te nervave kraniale dhe berthama te tjera te vete medules oblongata. **Berthamat e nervave kraniale** formohen nga fragmentimi si me poshte. Nga briri anterior formohen berthamat motore: nc. n. hypoglos (*nucleus nervi hypoglossi*) dhe nc. ambiguus (*nucleus ambiguus*), nga briri lateral berthama autonome nc. dorsal n. vag (*nucleus dorsalis nervi vagi*) dhe nga briri posterior berthamat sensore nc. i traktit solitar (*nucleus tracti solitarii*) dhe nc. spinal i n. trigemin (*nucleus spinalis nervi trigemini*).

**Berthama te vete medules oblongata** Jane nc. gracilis (*nucleus gracilis*), nc. kuneat (*nucleus cuneatus*) dhe nc. olivar inferior (*nuclei olivares inferiores*).

■ **Substanca e bardhe** perbehet nga fibrat arkuate dhe traktet.

**Fibrat arkuate** kane drejtim transversal, ato nisen nga nc. olivar inferior e perfundojne ne cerebelum.

Traktet qe gjenden ne medulen oblongata Jane tr. tektospinal, tr. piramidal (*tractus pyramidalis*) i perbere nga tr. kortikobulbar (*fibrae corticobulbares*) e tr. kortikospinal (*fibrae corticospinales*), tr. rubrospinal, tr. vestibulospinal, tr. spinothalamic dhe tr. spinocerebelar anterior, ndersa tr. spinocerebelar posterior

shkon ne cerebelum nepermjet PCI. Nderkohe ne nc. olivar inferior vjen tr. rubroolivar dhe niset drejt medules spinale tr. olivospinal (*tractus olivospinalis*) dhe drejt cerebelumit tr. olivocerebelar (*tractus olivocerebellaris*), ndersa nga nc. gracilis dhe nc. kuneat ngjitet drejt talamusit tr. bulbotalamik ose lemnisku medial (LM).

## PONSI

**Ponsi (pons)** gjendet mbi medulen oblongata dhe perben katin e mesem te trunkut te trurit. Kufiri me medulen oblongata eshte sulkusi bulbopontin (*sulcus bulbopontinus*).

Ne pamjen e jashtme ponsi ka vetem faqen anteriore dhe faqen posteriore. Ne faqen anteriore dallohen **sulkusi bazilar** (*sulcus basilaris*) dhe anash tij dy **eminencat piramidale**. Faqja posteriore e ponsit formon trekendeshin pontin te foses romboide, brinjet laterale te te cilit i formojne pedunkujt cerebelare superiore (PCS). Ponsi anash vazhdon me krahet e tij (ures) ose **pedunkujt cerebelare te mesem** (PCM), qe e lidhin me cerebelumin.

**Ponsi perbehet** nga substanca gri dhe substanca e bardhe.

Substanca gri perbehet nga berthama te nervave kraniale dhe berthama te tjera te vete ponsit.

**Berthamat e nervave kraniale**, te ardhura nga fragmentimi i substances gri ashtu si ne medulen oblongata, jane berthama motore: nc. n. abducens (*nucleus nervi abducens*), nc. i n. facial (*nucleus nervi facialis*) dhe nc. motor i n. trigemin (*nucleus motorius nervi trigemini*) ose nc. mastikator, berthama autonome: nc. salivator superior (*nucleus salivatorius superior*) dhe nc. salivator inferior (*nucleus salivatorius inferior*) dhe berthama sensore: nc. principal i n. trigemin (*nucleus principalis nervi trigemini*) e nc. mesencefalik i n. trigemin (*nucleus mesencephalicus nervi trigemini*), nc. kokleare (*nuclei cochlearis*), perkatesisht anterior (*nucleus cochlearis anterior*) e posterior (*nucleus cochlearis posterior*) dhe nc. vestibulare (*nuclei vestibulares*), perkatesisht superior (*nucleus vestibularis superior*), inferior (*nucleus vestibularis inferior*), medial (*nucleus vestibularis medialis*) e lateral (*nucleus vestibularis lateralis*).

**Berthama te vete ponsit** jane nc. olivar superior (*nuclei olivares superiores*) dhe nc. pontine (*nuclei pontis*).

Substanca e bardhe perbehet nga fijet transversale dhe traktet.

Fijet transversale nisen nga nc. pontine e nc. kokleare. Nga nc. pontine nisen fijet pontocerebelare qe pasi kryqezohen ne linjen mediane arrijne ne cerebelum

nepermjet PCM. Nga ncc. kokleare te seciles ane dalin striet akustike qe pasi nderpriten ne ncc. olivare superiore, formojne midis ketyre nukleuseve trupin trapezoid dhe pastaj vazhdojne si lemnisk lateral (*lemniscus lateralis*) ose LL. **Traktet** qe gjenden ne pons kane pak a shume te njejtën vendosje si ne medulen oblongata. Ata jane tr. tektospinal, tr. piramidal (i fijezuar midis ncc. pontine), tr. rubrospinal, tr. spinothalamic. LM dhe tr. spinocerebelar anterior. Nderkohe ne ncc. pontine zbet tr. kortikopontin e niset tr. pontocerebelar, ndersa ne ncc. vestibulare vjen tr. cerebelovestibular dhe nisen tr. vestibulocerebelar e tr. vestibulospinal.

## MEZENCEFALONI

**Mezencefaloni** (*mesencephalon*) ose truri i mesem gjendet mbi ponsin dhe eshte kati i siperm i trunkut te trurit. Kufiri me ponsin eshte sulkusi prepontin. Mezencefaloni lidhet me cerebelumin nepermjet pedunkujve cerebelare superiore (PCS). Neper mezencefalon kalon akueduktusi cerebral (*aqueductus cerebri*), qe lidh ventrikulin III me ventrikulin IV.

Ne pamjen e jashtme mezencefaloni ka faqen anteriore, faqen posteriore dhe dy faqe anesore. Ne faqen anteriore te tij gjenden dy **pedunkujt cerebrale** (*pedunculus cerebri*) ose PC e midis tyre fosa interpedunkulare (*fossa interpeduncularis*).

Ne faqen posteriore gjenden **kater kolikuj**, qe jane te ngritura ne forme kodrash: dy kolikula inferiore (*colliculus inferior*) dhe dy kolikula superiore (*colliculus superior*), te cilet se bashku formojne laminen kuadrigemina (*lamina quadrigemina*). Anash kolikulat vazhdojne me **krahet** e tyre, çdo kolikul i poshtem ka brakumin e kolikulit inferior (*brachium colliculi inferioris*), qe duke u ngjitur, vazhdon ne diencefalon me trupin genikulat medial dhe çdo kolikul i siperm ka brakumin e kolikulit superior (*brachium colliculi superioris*), qe duke u ngjitur, vazhdon ne diencefalon me trupin genikulat lateral. Krahet e kolikulave formojne faqet laterale te mesencefalonit.

**Mezencefaloni perbehet** nga substanca gri dhe substanca e bardhe.

Substanca gri perbehet nga berthama te nervave kraniale, berthama te tjera te vete mesencefalonit dhe substanca nigra.

**Berthamat e nervave kraniale** jane vazhdim i rreshtave te berthamave te ponsit dhe medules oblongata. Berthama motore jane nc. i n. trochlear (*nucleus nervi trochlearis*) ne nivelin e kolikulit inferior dhe nc. i n. okolomotor (*nucleus nervi oculomotorii*) ne nivelin e kolikulit superior. Berthame sensore eshte nc.

mesencefalik i n. trigemin (nucleus mesencephalicus nervi trigemini), qe ngjitet nga ponsi deri ne nivelin e kolikulit te siperm.

**Berthama te vete mezencefalonit** jane nc. i kolikulit inferior, nc. i kolikulit superior dhe nc. ruber (nucleus ruber), qe gjendet ne nivelin e kolikulit superior.

**Substanca nigra** (*substantia nigra*) dhe substanca gri periakueduktale (*substantia grisea centralis*) gjenden gjithashtu ne mesencefalon.

■ **Substanca e bardhe** perbehet nga **trakte** nervore. Ne PC zbresin tr. piramidal dhe tr. kortikopontin. Tr. tektospinal fillon ne nivelin e kolikulit superior dhe zurret per ne medulen spinale. Ne nc. ruber vijnë nga cerebelumi fije cerebelorubrale, ndersa niset tr. rubrospinal qe zurret per ne medulen spinale. LL qe vjen nga ponsi perfundon ne nivelin e kolikulit inferior. Tr. spinotalamic dhe LM ngjiten per ne diencefalon. Tr. spinocerebelar anterior nepermjet PCS shkon ne cerebelum.

**Mezencefaloni eshte vendi i kater kryqezimeve te fijeve nervore, dy kryqezime Jane ne nivelin e kolikulit te poshtem e dy te tjera ne ne nivelin e kolikulit te siperm.**

Ne nivelin e kolikulit te poshtem kryqezohen dorsalisht dy nn. troklaare dhe ventralisht dy traktet cerebelorubrale. Ne nivelin e kolikulit te siperm kryqezohen dorsalisht dy traktet tektospinale dhe ventralisht dy traktet rubrospinale.

## FORMACIONI RETIKULAR

**Formacioni retikular** (FR) eshte nje matriks heterogen neuronesh qe mbush hapesirene midis berthamave te nervave kraniale dhe berthamave te tjera te trunkut te trurit duke zene gati gjysmen e vellimit te tij.

Fijet nervore ne FR formojne komponentin zbrtes (fije qe zbresin ne medulen spinale) dhe komponentin ngjites (fije qe ngjiten ne talamus dhe korteks).

FR ka lidhje me funksionet motore somatike, funksionet motore viscerale dhe vigjilencen (atensionin, gjendjen e ndergjegjshme dhe ate gjumit).

## FOSA ROMBOIDE

**Fosa romboide** (*fossa rhomboidea*) formohet nga faqja e pasme e medules oblongata ose trekendeshi bulbar dhe faqja e pasme e ponsit ose trekendeshi pontin dhe perben dyshemene e ventrikulit IV. Ajo ka fomen e rombit, brinjet e te cilit formohen poshte nga dy PCI dhe siper nga dy PCS.

Ne fosen romboide projektohet pjesa me e madhe e berthamave te nervave kraniale: nc. i n. hypoglos, nc. dorsal i n. vag, nc. ambig, nc. i traktit solitar, nc. spinal i n. trigemin, nc. principal i n. trigemin, nc. mezencefalik i n. trigemin, nc. motor i n. trigemin, nc. salivator superior, nc. salivator inferior, ncc. kokleare, ncc. vestibulare, nc. i n. abducens dhe nc. i n. facial.

## CEREBELUMI

**Cerebelumi** (*cerebellum*) ose truri i vogel vendoset prapa trunkut te trurit dhe lidhet me medulen oblongata nepermjet PCI, me ponsin nepermjet PCM e me mezencefalonin nepermjet PCS.

**Ne pamjen e jashtme** cerebelumi perbehet nga pjesa qendrore ose vermis (*vermis cerebelli*) dhe anash tij dy pjeset me te medha, hemisferat cerebelare (*hemispherium cerebelli*).

Siperfaqeja e cerebelumit nuk eshte e sheshte, por me brazda ose fisura (*fissurae cerebelli*), qe kalojne nga njera hemisfer ne tjetren nepermjet vermisit. Prej tyre veçohen dy fisura qe e ndajne cerebelumin ne tre lobe: fisura primare (*fissura prima*), qe ndan lobin anterior nga lobi posterior dhe fisura posterolaterale (*fissura posterolateralis*), qe ndan lobin posterior nga lobi flokulonodular.

Secili lob ndahet anatomikisht ne njesi me te vogla, lobule, por kjo ndarje nuk ka rendesi funksionale.

Ne mesin e faqes anteriore te cerebelumit dalin velumi medular superior (VMS) dhe velumi medular inferior (VMI), qe marrin pjese ne formimin e ventrikulit te IV. Midis tyre gjendet kulmi i çatise se ventrikulit te IV ose fastigiumi.

**Cerebelumi** perbehet nga substanca gri dhe substanca e bardhe.

■ **Substanca gri** vendoset ne periferi, **korteks** dhe ne brendesi ne berthamat e zhytura ne substancen e bardhe.

**Berthamat** qe gjenden ne cerebelum duke filluar medialisht jane: nc. fastigi (*nucleus fastigii*), berthamat e ndermjetme: nc. globoz (*nucleus globosus*) e nc. emboliform (*nucleus emboliformis*), dhe nc. dentat (*nucleus dentatus*).

■ **Substanca e bardhe** nga pjesa qendrore shkon e laminuar drejt korteksit me pamjen qe njihet si "arbor vitae" (*arbor vitae*).

**Pedunkujt cerebelare** lidhin cerebelumin me pjese te tjera te sistemit nervor kendor. Nepermjet tyre vijnë fije aferente ne korteksin cerebelar. Fijet eferente

nisen nga kortexi cerebelar drejt berthamave cerebelare dhe pastaj prej tyre dalin nag cerebelumi ne perberje te pedunkujve cerebelare.

■ **Pedunkujt cerebelare inferiore** kane ne perberje te tyre tr. spinocerebelar posterior, tr. olivocerebelar, tr. vestibulocerebelar dhe tr. cerebelovestibular.

■ **Pedunkujt cerebelare te mesem** perbehen nga tr. pontocerebelar.

■ **Pedunkujt cerebelare superiore** kane ne perberje te tyre tr. spinocerebelar anterior, tr. cerebelorubral dhe tr. cerebelotalamik.

**Sipas funksionit** cerebelumi ndahet ne tre pjesë: vestibulocerebelum, spinocerebelum dhe pontocerebelum.

■ **Vestibulocerebelumi** (*vestibulocerebellum*) eshte perqejges per ruajtjen e ekuilibrit. Ai perfaqesohet nga lobi flokulanodular dhe nc. fastigi.

Ne kortexin flokulanodular vjen tr. vestibulocerebelar me informacion mbi pozicionin e trupit. Qe aty nisen impulse per ne nc. fastigi qe vazhdojnë pastaj neper tr. cerebelovestibular per ne berthamat vestibulare nga ku niset tr. vestibulospinal (pjesë e sistemit ekstrapiramidal), me impulse motore drejt medules spinale per **ruajtjen e ekuilibrit gjate ecjes** ose nderimit te pozicionit.

■ **Spinocerebelumi** (*spinocerebellum*) eshte perqejges per rregullimin e tonusit muskular. Ai perfaqesohet nga vermisi dhe berthamat e ndermjetme.

Ne kortexin e cerebelumit arrijne impulse proprioceptive (sensore te pavetedijshme nga muskujt, tendinet e artikulacionet) me informacion mbi tonusin muskular, nepermjet tr. spinocerebelar anterior dhe tr. spinocerebelar posterior. Qe aty nisen fije per ne berthamat e ndermjetme, qe vazhdojnë pastaj neper tr. cerebelorubral per ne nc. ruber, nga ku niset tr. rubrospinal (pjesë e sistemit ekstrapiramidal), drejt medules spinale, me impulse motore per **rregullimin e tonusit muskular**.

■ **Pontocerebelumi** (*pontocerebellum*) eshte perqejges per koordinimin e levizjeve fine. Ai perfaqesohet nga hemisferat dhe nc. dentat.

Ne kortexin e hemisferave vijnë dy lloj impulsesh.

**Se pari** nga kortexi cerebral, i cili njekohesht me nisjen e nje sinjali motor drejt medules spinale ose nervave kraniale, nepermjet tr. kortikospinal e tr. kortikobulbar, i jep informacion mbi kete levizje te paramenduar edhe cerebelumit nepermjet tr. kortikopontocerebelar. **Se dyti** ne kohe reale informacion mbi levizjen e vullnetshme qe eshte duke u kryer percjell ne kortexin e pontocerebelumit tr. spinocerebelar dorsal e tr. spinocerebelar ventral.

Pra ne kortexin e pontocerebelumit vjen njekohesht informacion per levizjen qe duhet te kryhet dhe per levizjen qe po kryhet. Cerebelumi ben krahasimin e dy informacioneve dhe **nderhyn** duke bere koordinimin automatik per te bere nje levizje fine te sakte. Ai dergon impulsset e nevojshme ne nc. dentatus, nga ku niset tr. cerebelorubrotalamokortikal, i cili i perfundon fijet ne qendren kortikale te motorikes se vullnetshme, ku ben frenimin e levizjeve parazitare (duke lene te kryhet vetem levizja fine, nepermjet tr. piramidal). Ne kete menyre cerebelumi ben **rregullimin automatik te levizjeve**.

## DIENCEFALONI

**Diencefalon** (*diencephalon*) ose truri i ndermjetem, vendoset mbi mezencefalon, ndermjet dy hemisferave cerebrale. Perbehet nga talamus, epitalamus, metatalamus, hypotalamus dhe subtalamus.

**Talamusi** (*thalamus*) perben pjesen me te madhe te diencefalonit.

Ai ka formen e vezes me polin anterior (*polus anterior*) e pulvinarin (*pulvinar thalami*) si dhe faqen mediale, faqen superiore, faqen laterale e faqen inferiore. Dy faqet mediale formojne muret laterale te ventrikulit III. Midis tyre zakonisht gjendet adezioni intertalamik (*adhesio interthalamicæ*). Faqja superiore formon dyshemene e ventrikulit lateral. Faqja laterale nuk eshte e lire; ajo vazhdon me kapsulen interne. Edhe faqja inferiore nuk eshte e lire; ajo vazhdon me hypotalamusin dhe subtalamusin.

Talamusi perbehet nga **substanca gri**, qe perben pjesen me te madhe dhe formon berthamat (anteriore, mediale, laterale) dhe nga substanca e bardhe, qe ka pamjen e laminave ne periferi e midis berthamave.

Berthamat anteriore kane funksion kryesht olfaktor. Berthamat mediale luajne rol ne shume funksione te organizmit, ku veçohet integrimi i aktivitetave somatoviscerale. Berthamat laterale ndahen ne berthamen ventrale dhe berthamen dorsale. Berthama ventrale eshte stacion i rrugeve te ndjeshmerise (ne te perfundojne LM, LL, dhe tr. spinotalamik ose leminsku spinal, LS), qe pastaj ngjiten ne fushen sensoriale te kortexit, ndersa ne berthamen dorsale vjen nje pjesë e fijeve te tr. optik. te cilat pastaj si radiacion optik ngjiten ne fushen optike te kortexit.

**Epitalamus** (*epithalamus*) ka strukture kryesore **gjendren pineale** me pamje si boçe pishe (*glandula pinealis*) ose epifizen. Ajo vendoset ne linjen e mesit mbi kolikulat e siperme te mezencefalonit. Funksioni i gjendres pineale eshte te frenoje pubertetin; ne dekaden e dyte te jetes ajo fillon te kalcifikohet.

**Metatalamusi** (*metathalamus*) perbehet nga trupi genikulat medial e trupi genikulat lateral.

**Trupi genikulat medial** (*corpus geniculatum mediale*) gjendet ne vazhdim te brakiumit te kolikulit inferior. Kolikuli inferior, brakumi i tij dhe trupi genikulat medial i takojne sistemit auditiv; ne to vijne fije nga lemnisku lateral (akustik). Nga trupi genikulat medial nisen fije qe si radiacion akustik shkojne ne fushen akustike te korteksit.

**Trupi genikulat lateral** (*corpus geniculatum laterale*) gjendet ne vazhdim te brakiumit te kolikulit superior. Kolikuli superior, brakumi i tij trupi genikulat lateral i takojne sistemit optik. Ne to vijne fije nga trakti optik. Nga trupi genikulat lateral nisen fije qe si radiacion optik arrijne ne fushen optike te korteksit.

**Hypotalamus** (*hypothalamus*) ndodhet nen talamus dhe merr pjesë ne formimin e dyshemese se ventrikulit III. Ai perbehet nga pjesa anteriore (optike), pjesa e mesme (tuberale) dhe pjesa posteriore (olfaktore).

**Pjesa anteriore** ose optike formohet nga kiazma optike

**Pjesa e mesme** ose tuberale formohet nga tuber cinereum (*tuber cinereum*), **Pjesa posteriore** ose olfaktore formohet nga trupat mamilare.

Funksioni i hipotalamusit ka lidhje te ngushte me aktivitetin e sistemit nervor autonom dhe te sistemit endokrin, duke ndikuar ne organizem nepermjet dy rrugave, asaj nervore dhe asaj hormonale. Rruja nervore realizohet nepermjet rrugave te hipotalamusit me pjesë te tjera te sistemit nervor, ndersa rruja hormonale nepermjet hormoneve qe prodhon gjendra e hipofizes (ACTH, TSH, STH, FSH, LH, MSH si dhe vazopresine e oksitocine)

**Subtalami** (*subthalamus*) eshte zone kalimtare midis mesencefalosit dhe talamusit.

## TELENCEFALONI

**Telencefalon** (*telencephalon*) ose truri i madh perben pjesen me te madhe te sistemit nervor qendror. Ai perbehet nga dy hemisfera (*hemispherium cerebri*), e majta dhe e djathta te lidhura ne pjesen qendrore midis tyre. Hemisferat kane lobin frontal, lobin parietal, lobin oksipital, lobin temporal, lobin limbik dhe insulen. Ne siperfaqen e hemisferave gjenden shume sulkuse disa prej te cilave jane konsistente dhe te tjere me pak. Ato kufizojne midis tyre lobet, gyruset ose lobulet. Ky konfigurim mundeson rritje te siperfaqes cerebrale pa sakrifikuar ne volum. Ne brendesi te seciles hemisfera ka nga nje ventrikul, qe emertohet ventrikuli lateral.

Secila hemisfer ka faqen superolaterale, faqen mediale dhe faqen inferiore. Midis faqeve gjenden margoja superiore, margoja inferomediale dhe margoja inferolaterale.

\* **Faqja superolaterale** (*facies superolateralis*) ka forme konvekse te perputhshme me konkavitetin kranial. Ne te vihen re dy sulkuse kryesore, **sulkusi central** (*sulcus centralis*) dhe **sulkusi lateral** (*sulcus lateralis*). Sulkusi central ndan lobin frontal nga lobi parietal. Sulkusi lateral ndan lobin temporal nga lobi frontal dhe lobi parietal. Ne thellesi te sulkusit lateral gjendet lobi i insules (*lobus insularis, insula*) i rrethuar nga **sulkusi cirkular** (*sulcus circularis*). Ne faqen superolaterale nuk ka nje kufi anatomik midis lobit oksipital dhe lobit parietal. Vec sulkuseve te mesiperm ne faqen superolaterale gjenden edhe sulkuse te tjere qe i ndajne lobet e hemisferave ne gyruse.

Ne **lobin frontal** sulkusi precentral (*sulcus precentralis*) zbret paralel me sulkusin central dhe midis tyre gjendet gyrusi precentral (*gyrus precentralis*). Nga sulkusi precentral nisen sulkusi frontal superior (*sulcus frontalis superior*) dhe sulkusi frontal inferior (*sulcus frontalis inferior*) qe kufizojne midis tyre gyrusin frontal superior (*gyrus frontalis superior*), gyrusin frontal te mesem (*gyrus frontalis medius*) dhe gyrusin frontal inferior (*gyrus frontalis inferior*).

Ne **lobin parietal** sulkusi postcentral (*sulcus postcentralis*) zbret paralelisht me sulkusin central dhe midis tyre gjendet gyrusi postcentral (*gyrus postcentralis*). Nga sulkusi postcentral niset sulkusi intraparietal (*sulcus intraparietalis*), qe ndan lobulin parietal superior (*lobulus parietalis superior*) dhe lobulin parietal inferior (*lobulus parietalis inferior*).

Ne **lobin temporal** gjenden sulkusi temporal superior (*sulcus temporalis superior*), me poshte sulkusi temporal i mesem (*sulcus temporalis medius*) dhe ne faqen inferiore te hemisferave sulkusi temporal inferior (*sulcus temporalis inferior*). Mbi sulkusin temporal superior gjendet gyrusi temporal superior (*gyrus temporalis superior*) ne te cilin dallohen gyret temporale transverse (*gyrus temporalis transversi*). Midis sulkusit temporal superior e sulkusit temporal te mesem gjendet gyrusi temporal i mesem (*gyrus temporalis medius*). Nen sulkusin temporal te mesem gjendet gyrusi temporal inferior (*gyrus temporalis inferior*), i cili vazhdon ne siperfaqen inferiore deri ne sulkusin temporal inferior.

Ne **lobin oksipital** ndarja ne gyruse behet nga sulkusi oksipital transvers (*sulcus occipitalis transversus*) dhe nga sulkusi lunat (*sulcus lunatus*).

Ne lobin e insules gjendet vertikalish sulkusi central (*sulcus centralis*).

\* **Faqja mediale** e hemisferave eshte e sheshte dhe vertikale. Ajo ndahet nga **sulkus cinguli** (*sulcus cinguli*) ne nje pjese qendore dhe nje pjese periferike.

**Pjesa qendore** formon **lobin limbik** (*lobus limbicus*), qe rrethon si kufi (limbus) trunkun e trurit. Ai formohet nga komponente me prejardhje nga lobi frontal, lobi parietal e lobi temporal dhe perbehet nga gyrus cinguli (*gyrus cinguli*), gyrusi parahipokampal (*gyrus parahypocampalis*) e gyrusi dentat. Gyrus cinguli gjendet nen sulkus cinguli dhe ne pjesen posteroinferiore te tij vazhdon me gyrusin parahipokampal, i cili ne pjesen me anteriore ka unkusin (*uncus*). Gyrus parahipokampal ndahet nga sulkusi hipokampal me gyrusin dentat, ndersa nga sulkusi kolateral me gyrusin oksipitotemporal medial.

**Pjesa periferike** e faqes mediale formohet nga lobi frontal, lobi parietal, lobi oksipital dhe lobi temporal. Ne kete faqe sulkusi parietooksipital (*sulcus parietooksipitalis*) ndan lobin parietal nga lobi oksipital.

Ne pjesen e pasme te lobit oksipital fillojne sulkusi kalkarin (*sulcus calcarius*) dhe me poshtë paralel me te sulkusi kolateral (*sulcus collateralis*). Midis sulkusit parietooksipital dhe sulkusit kalkarin gjendet kuneusi (*cuneus*), midis sulkusit kalkarin dhe sulkusit kolateral gjendet gyrusi lingual (*gyrus lingualis*) perpara te cilit gjendet ne lobin temporal gyrusi parahipokampal.

**Faqja inferiore** e hemisferave eshte e çrrgullt. Ajo formohet nga lobi frontal, lobi temporal dhe lobi oksipital. Ne pjesen e pasme te kesaj faqeje, te formuar nga lobi oksipital dhe lobi temporal, sulkusi oksipitotemporal (*sulcus oksipitotemporalis*) kalon paralel me sulkusin kolateral (*sulcus collateralis*) dhe ndan gyrusin oksipitotemporal medial (*gyrus oksipitotemporalis medialis*) me gyrusin oksipitotemporal lateral (*gyrus oksipitotemporalis lateralis*). Ne pjesen e perparme te kesaj faqeje, te formuar nga lobi frontal, dallohet sulkusi olfaktor (*sulcus olfactorius*), medialisht te cilit gjendet gyrusi rektus (*gyrus rectus*).

**Telencefaloni perbehet** nga substance gri dhe substance e bardhe.

**Substanca gri** gjendet ne berthama qe gjenden ne brendesi (jo sakteisht quhen ganglionet bazale) dhe ne siperfaqe (korteksi).

**Ganglionet bazale** (*nuclei basales*) vendosen ne pjesen e poshtme te hemisferave, lateralisht talamusit. Ata formojne se bashku trupin striat (*corpus striatum*). Ganglionet bazale jane nc. kaudat (*nucleus caudatus*), putameni (*putamen*) dhe globi palidus (*globus pallidus*). Nc. kaudat dhe putameni kane vazhdimesi anatomike me njeri tjeterin dhe konsiderohen si nje njesi morfolunksionale.

Ganglionet bazale jane pjese e sistemit motor ekstrapiramidal ashtu si edhe cerebelumi. Qellimi i tyre eshte te realizojne “**pergatitjen**” e levizjes se vullnetshme qe inicijon korteksi motor, duke frenuar fillimin e levizjeve te tjera. I ngashem eshte edhe funksioni i cerebelumit, por ai vepron gjate kohes qe levizja kryhet, duke bere “**korigjinin**” e saj. Ne kete menyre ganglionet bazale dhe cerebelumi konsiderohen si komplemente te njeri tjetrit ne veprimin e tyre (frenues) ndaj korteksil motor (ganglionet bazale sigurojn konteksin e levizjes, cerebelumi siguron statusin e saj). Nga ana tjeter perseritja shpesh e te njejtit veprim “trajnon” ganglionet bazale duke i bere ato (bashke me cerebelumin) te mundesojne “**mesimin e levizjeve**” dhe kryerjen e “**levizjeve te mesuara**” (qe ndodh psh. me mesimin e biçikletes).

**Korteksi cerebral** (*cortex cerebri*) eshte lenda gri ne siperfaqen e hemisferave. Ai ka nje trashesi rrith 3 mm.

Ne praktike rendesi ka ndarja funksionale e korteksit ne fushat motorike e sensore, te cilat perbejne rrith 10% te siperfaqes se tij, ndersa pjesa tjeter e korteksit perbehet nga fushat asociative, ku behet asocijimi, pra integrimi i informacioneve.

**Fusha motorike** gjendet ne lobin frontal, perkatesisht ne gyrusin precentral. Funksioni i kesaj fushe eshte te nise impulse per kryerjen e levizjeve te vullnetshme te muskulatures. Ne pjesen e poshtme te gyrusit jane neuronet qe inervojne muskulaturen e kokes e qafes, ne pjesen e mesme neuronet qe inervojne muskujt e rrithit te krahut e gjymtyres se siperme, ne pjesen e siperme neuronet qe inervojne muskujt e trupit, muskujt e rrithit te gjymtyres se poshtme, muskujt e kofshes, te kercirit e kembes. Vendosja me koke poshtë e ketyre zonave jep konfigurimin qe eshte quajtur “homunculus inversus”.

**Fusha sensore** gjendet ne lobin parietal, perkatesisht ne gyrusin postcentral. Edhe ketu vendosja e neuroneve eshte e njejte si ne fushen motorike, pra me pamjen e “homunculus inversus”.

**Fusha akustike** gjendet ne lobin temporal, ne gyruset temporale transverse.

**Fusha optike** gjendet ne lobin oksipital, ne sulkusin kalkarin.

**Fusha olfaktore** gjendet ne lobin temporal ne unkus.

**Fusha gustative** gjendet ne lobin parietal, ne pjesen e poshtme te fushes sensore, para zones se fytyres.

**Substanca e bardhe** formohet nga fije qe lidhin pjesen e korteksit te te njejtes hemisferë (fije asociative), pjesen te korteksit te dy hemisferave (fije komisurale) si dhe pjesen te korteksit me katet poshtë tij (fije projektive).

**Fijet asociative** lidhin gyruse fjinje ose gyruse te largjet te korteksit te te njejtes hemisferë.

**Fijet komisurale** lidhin pjesen e homologe te korteksit te dy hemisferave. Pjesen me te madhe te tyre e formon trupi kalloz (*corpus callosum*). Ai ka pjesen qendore, te lire, që gjendet midis hemisferave dhe pjeset laterale që zhyten ne hemisfera ose radiacionin. Pjesa e lire ka formen e germes C te permbysur. Radiacioni formon ne pjesen e mesme tapetin (*tapetum*), qe lidh korteksin e lobeve parietale, ne pjesen e perparme forcepsin frontal ose minor (*forceps minor, forceps frontalis*), qe lidh korteksin e lobeve frontale dhe ne pjesen e pasme forcepsin oksipital ose major (*forceps major, forceps occipitalis*), qe lidh korteksin e lobeve oksipitale e temporale.

Fije te tjera komisurale jane komisura anteriore, komisura posteriore dhe komisura e forniksits qe lidhin pjesen e korteksit, qe nuk lidhen nga trupi kalloz.

**Fijet projektive** lidhin korteksin me katet e meposhtem te sistemin nervor qendror. Te gjitha fijet projektive formojne (kalojne ne) kapsulen interne (*capsula interna*). Kapsula interne ka formen e germes V te hapur lateralisht. Ajo ka krusin anterior (*crus anterior*) e krusin posterior (*crus posterior*) dhe midis tyre gjurin (*genu*). Ne kapsulen interne fijet motore (tr. piramidal, tr. kortikopontin), ndersa ngjiten fijet sensore (rruget e ndjeshmerise se per gjithshime, optike, akustike etj). Nen kapsulen interne fijet projektive kalojne ne pedunkujt cerebrale te mezencefalonit.

Dy hemisferat cerebrale nuk jane identike as ne forme, as ne funksion.

**Asimetria** nenkupton ndryshimet anatomike midis tyre, me e shprehur kjo ne lobet tempora.

**Lateralizimi** nenkupton ndryshimet funksionale midis tyre, e shprehur kjo ne dominimin e disa funksioneve ne njeri nga hemisferat. Keshtu hemisfera e majte eshte dominante per aftesite verbale, matematike dhe mendimin analistik, ndersa hemisfera e djathte eshte dominante per aftesite joverbale dhe vleresimin emocional te informacionit vizual dhe akustik.

## SISTEMI LIMBIK

**Sistemi limbik** ka lidhje anatomike dhe funksionale me sistemin olfaktor dhe vazhdimesht eshte menduar se funksioni i tij eshte vetem olfaktor. Ne fakt vetem pak struktura te tij kane kete funksion, pjesa tjeter luani roli ne aktivitetin visceral, ne sjelljen emocionale dhe ne kujtese. Ne literatoren anatomike terminologja e strukturave perberese te sistemit limbik vazhdon te jete konfuze.

Ne baze te konceptit anatomik te sistemit limbik qendron nje sistem lidhjesh qe fillojne e mbarojne ne hipotalamus.

Strukturat e sistemit limbik jane kortikale, subkortikale dhe fije lidhese.

**Strukturat kortikale** i takojne lobit limbik dhe Jane gyrus cinguli, gyrusi parahypokampal me unkusin dhe gyrusi dentat.

**Strukturat subkortikale** jane berthamat e sistemit limbik, perkatesisht ncc. amigdaloide.

**Strukture lidhese** eshte forniksi qe lidh strukturat kortikale te sistemit limbik me berthama jashte tij: ncc. anteriore talamike dhe ncc. mamilare.

## RRUGET E NDJESHMERISE

**Rruget e ndjeshmerise** perbehen nga fije ngjitese qe percjellin ndjeshmerine e per gjithshme dhe ate speciale. Ndjeshmeria e per gjithshme (somatike) nenkupton ate te prekjes, temperature, dhimbjes, presionit, vibracionit e proprioceptionit. Ndjeshmeria speciale nenkupton ate te lidhur me shqisat, nuhatjen, shikimin, shijimin, degjimin dhe ekuilibrin.

**Rruget e ndjeshmerise se per gjithshme** perbehen nga tre neuroni i pare gjendet ne ganglionet spinale dhe ganglionin e n. trigeminal. Zgjatimi periferik perfundon ne receptoret qe gjenden ne lekure, muskuj e artikulacione, ndersa zgjatimi qendor nepermjet trenjes posteriore hyr ne bririn posterior te medules spinale per te arritur ne neuronin e dyte. Neuroni i dyte gjendet ne bririn posterior ose nc. gracilis e nc. kuneat. Ai i dergon impulset ne talamus, ne berthamen ventrale posteriore te tij, qe perben edhe neuronin e trete. Ky neuron i dergon impulset ne fushen sensoriale te korteksit, ne gyrusin postcentral. Rruget e ndjeshmerise se per gjithshme perfajesohen nga **tre sisteme kryesore**: sistemi i trakteve spinotalamike, sistemi i tr. bulbotalamik dhe sistemi i trakteve spinocerebelare.

• **Sistemi i trakteve spinotalamike** percjell ndjeshmerine e vetedijshme te dhimbjes, te temperatureve dhe te prekjes ne fushen sensore ne korteksin cerebral, duke kaluar neper talamus.

• **Sistemi i tr. bulbotalamik** percjell ndjeshmerine e thelle te vetedishme, perkatesisht te pozicionit (statik e dinamik) e vibracionit ne fushen sensore ne korteksin cerebral, duke kaluar neper talamus.

• **Sistemi i trakteve spinocerebelare** percjell ndjeshmerine e thelle te pavetedijshme ne cerebelum.

**Rruget e ndjeshmerise speciale** perfshijnë sistemin olfaktor, sistemin optik, sistemin gustativ, sistemin auditiv dhe sistemin vestibular. Impulset perkates merren nga receptore shume te specializuar dhe percillen ne tru nepermjet

nervave kraniale. Gjate trajektit te tyre keto rruge kane te gjitha nje stacion ne talamus, perveç rruges olfaktore e cila anashkalon talamusin dhe perfundon direkt ne korteksin cerebral.

**Sistemi olfaktor** eshte me i hershmi nga sistemet e shqisave. Qelizat receptore gjenden ne mukozen olfaktore ne tavanin e hapesires se hundes. Prej tyre dalin fije olfaktore qe pasi kalojne neper kocken etmoidale hyjne ne fosen kraniale anteriore dhe perfundojn ne bulbin olfaktori. Ai vazhdon me traktin olfaktori, i cili ndahet ne tre strie olfaktore, nje mediale, nje laterale dhe midis tyre nje me te vogel, rudimentare, te ndermjetme. Stria laterale eshte me e rendesishmja, ajo perfundon ne korteksin olfaktor dhe siguron percepionin e nuhatjes. Stria mediale lidhet me sistemin limbik dhe realizon perggjigen emocionale ndaj stimujve olfaktore.

**Sistemi optik** eshte me i rendesishmi nga sistemet e shqisave. Qelizat receptore jane shkopinjtë dhe konet (ne retine). Nga syri del n. optik i cili pasi hyn ne hapesireni kraniale ben nje kryqezim te pjesshem (vetem te fijeve mediale) me nervin e anes tjeter. Pas kryqezimit vazhdojne traktet optike qe perfundojn ne nc. e kolikulit superior dhe trupin genikulat lateral (qendra subkortikale optike), nga ku niset radiacioni optik per ne korteksin optik.

**Sistemi gustativ** percjell ndjeshmerine e shijes, e cila merret nga receptoret e vendosur ne gjuhe dhe epiglotis nepermjet tre nervave kraniale. N. intermedius merr ndjeshmerine ne 2/3 anteriore te gjuhes, n. glosofaringeal merr ndjeshmerine nga 1/3 posteriore e gjuhes dhe n. vag merr ndjeshmerine nga epiglotisi. Keto nerva i dergojne impulsset ne trunkun e trurit, ne nc. solitar dhe qe aty fije te tjera i atashohen tr. bulbotalamik dhe arrijne bashke me te ne talamus, ne berthamen ventrale laterale. Pastaj zgjatimet qendrore te saj i dergojne impulsset ne korteksin gustativ.

**Sistemi auditiv** fillon ne receptoret periferike qe gjenden ne veshin e brendshem, ne vazhdim te tyre formohet komponenti auditiv, akustik ose koklear i n. vestibulokoklear. Nervi futet ne trunkun e trurit dhe fijet kokleare perfundojne ne ncc. kokleare. Prej tyre dalin striet akustike qe nderpriten ne nc. olivar superior duke formuar bashke me ato te anes tjeter trupin trapezoid dhe pastaj vazhdojne si LL. Ky i perfundon fijet ne nc. kolikulit inferior, qe andej nepermjet brakiumit te kolikulit inferior ato shkojne ne trupin genikulat lateral (qendra subkortikale akustike), prej ku niset radiacioni akustik per ne korteksin akustik.

**Sistemi vestibular** fillon ne receptoret periferike qe gjenden ne veshin e brendshem, ne vazhdim te tyre formohet komponenti vestibular i n. vestibulokoklear. Nervi futet ne trunkun e trurit dhe fijet vestibulare perfundojne

ne ncc. vestibulare. Prej tyre niset tr. vestibulospinal, fijet vestibulocerebelare dhe fije te tjera drejt talamusit qe percillen ne korteks. Fusha kortikale vestibulare nuk e perkaktuar.

## RRUGET MOTORE

**Rruget motore** (zbritese) perfaqehen nga sistemi piramidal dhe nga sistemi ekstrapiramidal. Sistemi piramidal siguron aktivitetin motor te vullnetshem te muskulature se striuar, ndersa sistemi ekstrapiramidal siguron aktivitetin motor te pavullnetshem te saj. Qofte rruget motore piramide, qofte rruget motore ekstrapiramidale, pavaresisht nga trajktoret ku kalojne, mbarojne ne neuronet e bririt anterior ne medules spinale ose ne berthamat motore te nervave kraniale ne trunkun e trurit.

**Sistemi piramidal** perfaqehen nga fije zbritese motorike, te cilat shkojne ne perberje te tr. piramidal, i cili perbehet nga tr. kortikospinal (fibra kortikospinale) dhe tr. kortikobulbar (fibra kortikobulbare). Tr. piramidal fillon ne korteksin motorik, gyrusi precentral, pastaj neper kapsulen interne (krusin posterior). Ne mesencefalon kalon neper PC, ndersa fijet kortikonukleare shkeputen gjate rruges per te perfunduar ne berthamat motore te nervave kraniale ne trunkun e trurit. Ne pons trakti fije zohet (midis ncc. pontine) dhe riformohet ne medulen oblongata, ku formon piramidat. Ne kufirin e poshtem te medulen oblongata behet kryqezimi i pjesshem i dy trakteve (kryqezimi piramidal) dhe ne medulen spinale kemi tr. kortikospinal anterior, te pakryqezuar (me rreth 10% te fijeve) qe kalon ne funikulin anterior dhe tr. kortikospinal lateral, te kryqezuar (me rreth 90%) te fijeve qe kalon ne funikulin lateral. Dy traktet perfundojne ne berthamat motore te bririt anterior te medulen spinale.

**Sistemi ekstrapiramidal** perfaqehen nga te gjitha fijet zbritese motorike, qe nuk bejne pjese ne sistemin piramidal. Ndryshe nga rruget motore piramide, te cilat zbresin direkt ne berthamat motore ne trunkun e trurit e medulen spinale, rruget motore ekstrapiramidale zbresin duke u nderprere ne stacione dhe duke formuar rrjete komplekse midis tyre.

Funksioni i rrugeve motore ekstrapiramidale eshte kontrolli automatik i levizjeve te vullnetshme (realizimi i levizjeve fine), rregullimi i tonusit muskular dhe realizimi i levizjeve automatike te pavullnetshme.

Fijet ne perberje te sistemit motorik ekstrapiramidal ose formojne rrathe nervore ose jane zbritese.

**Rrathet nervore** formohen nga lidhjet me dy stacionet kryesore te rrugeve ekstrapiramidale: ganglionet bazale dhe cerebelumin. Ato jane rrathi korteksi-striatum-korteks dhe rrathi korteks-cerebelum-korteks.

**Fijet zbritese** organizohen ne disa trakte. me kryesoret jane tr. tektospinal, tr. rubrospinal, tr. vestibulospinal, FLM etj.

## MENINGJET

**Meningjet** (*meninges*) jane cipa qe veshin medulen spinale dhe trurin. Ato Jane tre dhe emertohen dura, araknoidea dhe pia.

**Dura** (*dura mater*) eshte cipa e jashtme dhe me e forte qe vesh medulen spinale dhe trurin. Ajo qendron ne faqen e brendshme te kanalit vertebral dhe te hapesires kraniale. Hapesira midis dures dhe paretit kockor quhet hapesira epidurale (*spacium epidurale*).

» **Dura spinale** (*dura mater spinalis*) vesh medulen spinale dhe shtrihet nga foramen magnum deri ne nivelin vertebral S2. Pjesa fundore e saj, ku gjendet kauda ekuina ka formen e nje sakusi. Nen kete nivel ajo vesh filumin terminal. Ne kanalin vertebral dura vesh me kellefe te perbashket rrenjet anteriore dhe rrenjet posteriore te medulen spinale.

» **Dura kraniale** (*dura mater cranialis*) vesh trurin dhe perbehet nga dy shtresa, nje e jashtme dhe nje e brendshme. Shtresa e brendshme e dures ben disa zgjatime (palosje) drejt kavitetit kranial duke e ndare ate ne pjese ku vendosen pjese te trurit. Ne disa nivele dy shtresat ndahen nga njera tjetra duke formuar sinuset venoze qe sherbejne per drenimin e gjakut nga truri.

**Zgjatimet kryesore** te dures kraniale jane falksi cerebral, tentorium cerebelar dhe falksi cerebelar.

**Falksi cerebral** (*falx cerebri*) vendoset ne drejtim sagital duke u futur midis dy hemisferave. Buza e siperme e falksit formon sinusin sagital superior ndersa buza e poshtme eshte e lire dhe formon sinusin sagital inferior.

**Tentorium cerebelar** (*tentorium cerebelli*) ka formen e nje tende te vendosur mbi cerebelum, nen lobet oksipitale. Buza e pasme e tij formon sinusin transversal, ndersa buza e lire e perparme eshte konkave dhe ka perpara mezencefalonis.

**Falksi cerebelar** (*falx cerebelli*) vendoset ne drejtim sagital dhe futet midis hemisferave te trurit te vogel. Buza e siperme e tij vazhdon ne siperfaqen e

poshtme te tentoriumit cerebelar. Buza e pasme formon sinusin oksipital dhe perfundon ne buzen e foramen magnum.

**Sinuset venoze** te dures jane sinusi sagital superior, sinusi sagital inferior, sinusi rektus, sinusi transversal, sinusi sigmoid, sinusi oksipital dhe sinus i kavernoze.

**Sinus sagital superior** gjendet ne buzen e siperme te falksit cerebral, ai shtrihet nga kocka frontale deri ne protuberancen oksipitale interne. Ne pjesen fundore ai zgjerohet dhe formon konfluencen e sinuseve.

**Sinus sagital inferior** gjendet ne buzen e poshtme te lire te falksit cerebrali, ai perfundon prapa ne sinusin rektus.

**Sinus rektus** paraqitet si vazhdim i sinusit sagital inferior dhe gjendet ne nivelin e bashkimit te falksit cerebral me tentoriumin cerebelar. Prapa ai vazhdon ne konfluencen e sinuseve.

**Sinuset transversale** gjenden ne buzen e pasme te tentoriumit cerebelar. Medialisht ata dbashkohen ne konfluencen e sinuseve, ndersa lateralisht vazhdojnë me sinuset sigmoide.

**Sinus sigmoid** derdhet ne venen jugulare interne.

**Sinus oksipital** eshte sinus me i vogel, ai gjendet ne buzen e pasme te falksit cerebelar dhe derdhet ne konfluencen e sinuseve.

**Sinus kavernoze** gjendet anash trupit te kockes sfenoidale. Ne brendesi te tij kalojne a. karotike interne, n. okulomotor, n. troklear e n. abduces si dhe n. ofthalmik e n. maksilar (dege te n. trigeminal). Midis dy sinuseve kavernoze gjenden sinus i interkavernoze anterior dhe sinus i interkavernoze posterior duke formuar keshtu nje sinus venoz rrethor.

**Araknoidea** (*arachnoidea mater*) eshte cipa e mesme qe vesh medulen spinale dhe trurin. Ajo eshte e holle dhe e ngjeshur pas dures. Hapesira midis dures dhe araknoideas quhet hapesira subdurale (*spacium subdurale*); ne fakt ajo eshte nje hapesire potenciale. Hapesira midis araknoideas dhe pias quhet hapesira subaraknoidale (*spacium subarachnoidale*). Ajo eshte e mbushur me lengun cerebrospinal, i cili e preson araknoidean ndaj dures. Vendet e zgjeruara te hapesires subaraknoidale quhen cisterna subaraknoidale (*cisternae subarachnoidae*).

» **Araknoidea spinale** (*arachnoidea mater spinalis*) vesh medulen spinale duke imituar duren gjate gjithe shtrirjes se saj. Zgjerimi i hapesires subaraknoidale ne nivelin e sakusit dural quhet cisterna lumbare (*cisterna lumbalis*). Ne kete nivel, pikerisht ne intervalin vertebral L4-L5 ose L3-L4, behet punktioni lumbar.

• **Araknoidea kraniale** (*arachnoidea mater cranialis*) vesh trurin pa u futur ne sulkuset e siperfaqes se tij. Hapesira subaraknoidale ne hapesiren kraniale formon disa cisterna.

**Cisterna magna** (*cisterna magna*) ose cisterna cerebelomedulare formohet midis cerebelumit dhe medules oblongata. Ajo komunikon me hapesiren e ventrikulit IV nepermjet apertures mediane te tij.

**Cisterna pontocerebelare** (*cisterna pontocerebellaris*) gjendet perpara ponsit.

**Cisterna interpedunkulare** (*cisterna interpeduncularis*) gjendet ne fosen interpedunkulare.

**Pia** (*pia mater*) eshte cipa me e brendshme qe vesh medulen spinale dhe trurin. Ajo eshte nje membrane kryesisht vaskulare, mjaft delikate, qe ngjitet ngushte me siperfaqen dhe shoqeron ate ne te gjitha brazdat e saj.

• **Pia spinale** (*pia mater spinalis*) vesh medulen spinale dhe nen konin medular vazhdon si filum terminal. Nderkohe ne secilen ane te medules spinale fije gjatesore te pias formojne ligamentin dentikulat (*lig. denticulatum*). Çdo ligament eshte nje flete e holle, qe medialisht fillon midis trenjeve anteriore e posteriore te nervave spinale, ndersa lateralisht ne buzen e lire ka disa zgjatime trekendeshe ne formen e dhembave, te cilat shpojne araknoidean dhe fiksohen ne dure. Keto ligamente, bashke me filumin terminal, e mbajne medulen spinale “te ankoruar”. Pia gjithashtu vesh edhe trenjet e nervave spinale pertej mantelit dural.

• **Pia kraniale** (*pia mater cranialis*) vesh trurin. Ne ventrikulin III e ne ventrikulin IV, mbeshtetet ne ependime dhe formon stromen per pleksin koroid.

## SISTEMI VENTRIKULAR

**Sistemi ventrikular** perbehet nga disa hapesira ne brendesi te trurit, te veshura me epitel ependimtar, te cilat komunikojne me njera tjetren. Ne secilen hemisferje cerebrale ndodhet nje ventrikul lateral. Ne diencefalon gjendet ventrikuli i trete, qe komunikon me secilin ventrikul lateral. Ventrikuli i trete vazhdon me akueduktusin cerebral qe pershkron mezencefalonin dhe hapet ne ventrikulin e katert, i cili ndodhet midis trunkut te trurit dhe cerebelumit. Ventrikuli IV vazhdon me kanalin central te medules spinale qe konsiderohet rudiment. Sistemi ventrikular komunikon me hapesiren subaraknoidale.

**Ventrikujt laterale** (*ventriculus lateralis*) gjenden ne brendesi te hemisferave dhe ne pamje laterale kane formen e germes C te permbysur me nje bisht ne

drejtimin okspital. Ventrikuli lateral ka nje pjese centrale (*pars centralis*), bririn anterior (*cornu anterius*) qe shtrihet ne lobin frontal, bririn posterior (*cornu posterior*) qe shtrihet ne lobin okspital dhe bririn inferior (*cornu inferius*) qe shtrihet ne lobin temporal. Midis pjeses centrale dhe bririt anterior gjendet foramen interventrikulare (*foramen interventriculare*) me ane te se ciles ventrikuli lateral komunikon me ventrikulin III.

Ne ventrikulin lateral pleksi koroid vendoset ne fisuren koroide (*fissura choroidea*), e cila fillon ne nivelin e foramen interventrikulare, kalon ne pjesen centrale dhe perfundon ne bririn inferior.

**Ventrikuli i trete** (*ventriculus tertius*) eshte hapesira e ngushte midis dy talamuseve e hipotalamusit. Ne tavanin e tij gjendet pleksi koroid, qe nepermjet dy foraminave interventrikulare kalon ne dy ventrikujt laterale.

Ne pjesen e pasme te ventrikulit te trete hapet akueduktusi cerebral qe e lidh ate me ventrikulin e katert.

**Ventrikuli i katert** (*ventriculus quartus*) gjendet midis medules oblongata e ponsit dhe cerebelumit. Dyshemene e tij e formon fosa romboide (*fossa rhomboidea*) e perbere nga trekendeshi bulbar dhe trekendeshi pontin. Tavanin e ventrikulit te katert (*tegmen ventriculi quarti*) e formojne velumi medular superior (*vellum medullare superior*) dhe velumi medular inferior (*vellum medullare inferior*). Ne nje pjese te tavanit mbi trekendeshin bulbar gjendet pleksi koroid. Ne kendet anesore te ventrikulit te katert formohen receset laterale (*recessus lateralis*) te tij.

Ventrikuli i katert komunikon me hapesiren subaraknoidale nepermjet tre aperturave qe gjenden ne tavanin e tij, apertures mediane (*apertura mediana*) dhe dy aperturave laterale (*apertura lateralis*). Poshte ventrikuli i katert vazhdon me kanalin central te medules spinale.

**Kanali central** (*canalis centralis*) i medules spinale gjendet gjate gjithe gjatesise se saj; ai zgjerohet ne nivelin e konusit medular duke formuar ventrikulin terminal qe mbyllte me kalimin e moshes.

**LCS** (lengu cerebrospinal) eshte nje leng pa ngyre qe sekretohet nga plekset koroide dhe me pak nga ependima e sistemit ventrikular. Ai mbush sistemin ventrikular dhe hapesiren subaraknoidale ne tru dhe medulen spinale. LCS kalon nga ventrikujt laterale ne ventrikulin III nepermjet foramen interventrikulare, pastaj nepermjet akueduktusit cerebral ne ventrikulin IV dhe qe aty nepermjet apertures mediane dhe aperturave laterale kalon ne hapesiren subaraknoidale. LCS absorbohet ne kete hapesire nga vilet araknoidale per te kaluar ne sistemin venoz (sinusin sagital superior).

Funksioni i LCS eshte te sherbeje se pari si nje bufer (amortizues) fizik midis trurit dhe kafkes dhe se dyti si nje bufer kimik midis gjakut dhe trurit.

**Organet rrethventrikulare** gjenden perreth sistemit ventrikular. Ne zona te caktuara te ependimes se tij mungon bariera gjak-tru (ose bariera hematoencefalike, qe nenkupton permeabilitet selektiv te kapilareve). Keto zona, ku mund te behet nje shkembim lirisht i substancave te ndryshme neurokimike, formojne organet rrethventrikulare.

Organet rrethventrikulare vendosene ne muret e sistemit ventrikular, ne linjen mediane dhe perfshirje neurohipofizen, epifizen, organin vaskular (ne laminen terminale), arean postrema (ne medulen oblongate), etj.

**Pleksi koroid** gjendet ne disa pjese te siperfaqes se sistemit ventrikular (tavani i ventrikulit te katert, ventrikulit te trete dhe muri medial i ventrikujve laterale), ku shtresa ependimale eshte ne kontakt direkt me pian. Midis tyre gjendet nje kompleksi kapilaresh qe “zhyten” bashke me ependimen si vile ne hapesiren e sistemit ventrikular duke formuar pleksin koroid.

#### Fakte klinike

##### Punksioni lumbar

Punksioni lumbar zakonisht kryhet per te marre dhe ekzaminuar nje sasi LCS. Ai behet nen nivelin e fundit te medules spinale, pra nen nivelin e vertebres L2. Gjate punksionit kalohet nje age ne linjen mediane midis proceseve spinoze. Kur maja e saj hyn ne hapesiren subaraknoidale ne anen tjeter filton e rrjedh LCS.

Gjate injekzionit mund te injektohen lokalisht edhe lende anestetike. Zakonisht injektimi behet ne hapesiren epidurale. Kjo anestezi aplikohet ne nderhyrjet kirurgjikale ne pelvis ose ne kembe duke shmhangu anestezine e per gjithshime.

##### Traumet e medules spinale

Traumat e medules spinale shoqerohen me prishje te funksionit te saj. Ai mund te jete i tipit motor (paralize) ose i tipit ndjesor (parestezi). Nga ana tjeter prerja transversale e medules spinale shkakton humbje te plete te funksionit motor e ndjesor nen nivelin e demtimit.

Nese demtini shkakton humbje te funksionit te gjymtyreve te poshtme gjendja quhet paraplegji, ndersa nese humb funksioni edhe i gjymtyreve te siperme gjendja quhet tetraplegji.

Hemiplegja e cila eshte paraliza e njerëz gjysem te trupit, shkaktohet kryesisht nga demtimi cerebrale.

##### Aneurizmat cerebrale

Aneurizmat jane fryrje te arterieve si pasoje e defekteve ne paretin e tyre. Ato hasen me shpesh cirkulusin arterial te trurit, prane vendeve ku vazat bashkohen. Duke komprimuar strukturat kufitare, aneurizma mund te kompromontoje funksionin e tyre.

##### Infarkti trunor

Bllokimi i nje arterie nga pllaka aterosklerotike ose nga nje tromb çon ne infarkt trunor. Shenjat varen nga madhesia e deges arteriale te bllokuar dhe nga territori i furnizimit te saj.

##### Hemoragjite intrakraniane

Hemoragjia epidurale zakonisht ka shkak traumatik dhe vjen nga demtimi i vazave arteriale. Gradualisht formohet hematoma epidurale e cila komprimon gjithnjë e me shume trurin. Pacienti mund te kaloje ne kome dhe nderhyrja kirurgjikale eshte e domosdoshme.

Hemoragjia subdurale gjithashtu ka zakonisht shkak traumatik dhe vjen nga demtimi i vazave venoze. Ne kete rast gjaku grumbullohet ne hapesiren potenciale midis dures dhe araknoideas.

Hemoragjia subaraknoidale vjen zakonisht nga çarja e nje aneurizme dhe merralle nga trauma. Gjate saj gjaku grumbullohet ne hapesiren subaraknoidale.

##### Hidrocefalia

Hidrocefalia vjen nga bllokimi i rrugeve te qarkullimit te LCS. Ne kete menyre shtohet sasia e tij dhe komprimimi i mases trunore. vendet me te mundshme ku mund te ndodhe obstruksioni jane vrimat e hapjet ne sistemin ventrikular: foraminat interventrikulare, akueduktusi cerebral, aperturat e ventrikulit IV.

## SISTEMI NERVOR PERIFERIK

### Nervat kraniale

### Nervat spinale

### Harku reflektor somatik

Sistemi nervor periferik, (*systema nervosum periphericum*) nenkupton bashkësinë e nervave (*nervus*), të cilët përbëhen nga aksonet dhe të **ganglioneve** (*ganglion*), që formohen nga trupat e neuroneve.

Nervat dalin nga sistemi nervor qendror, perkatesisht nga truri dhe nga medula spinale. Nervat qe dalin nga truri quhen **nerv a kraniale**, ndersa nervat qe dalin nga medula spinale quhen **nerv a kraniale**.

Morfologjikisht, krahas tyre, ne sistemin nervor periferik përfshihen edhe **nervat simpatike**, të cilët bëjnë pjesë në sistemin nervor autonom.

## NERVAT KRANIALE

**Nervat kraniale** (*nervi craniales*) Jane dymbedhjete çifte qe emertoohen me emra ose me numra (romake) duke zbritur nga siper poshte.

Berthamat e tyre gjenden ne trunkun e trurit (perveç çiftit I dhe II qe nuk kane berthame).

Nervat kraniale mund te jene sensore (*n. sensorius*), motore (*n. motorius*) ose te perzier (*n. mixtus*). Nervat sensore mund te jene sensore te per gjithshem ose sensore speciale (te shqisave).

Nervat kraniale jane n. olfaktor, n. optik, n. okulomotor, n. troklear, n. trigeminal, n. abducens, n. facial, n. vestibuloklear, n. glosofaringeal, n. vag, n. akcesor dhe n. hipoglos.

**N. olfaktor** (*nervus olfactorius*) eshte nerv sensor special. Ai percjell ndjeshmerine e nuhatjes. N. olfaktor nuk ka berthame dhe rruga olfaktore nuk kalon neper talamus (ndryshe nga gjithe nervat e tjere kraniale sensore speciale). Ne pjesen olfaktore te hapesires se hundes gjenden qeliza, zgjatimet qendrore te te cilave formojne nje rrjet nga ku dalin rreth njezet fije olfaktore (*fila olfactoria*), te cilat pasi kalojne neper kocken etmoidale hyjne ne fosa krani anterior dhe perfundojne ne bulbin olfaktor. Teresia e ketyre fijave olfaktore perben ne te vertete nervin olfaktor.

Ne vazhdim te bulbit olfaktor jane trakti olfaktor, trekendeshi olfaktor dhe striet olfaktore qe perfundojne ne korteksin olfaktor.

Strukturat e mesiperme formojne sistemin olfaktor.

**N. optik** (*nervus opticus*) eshte me i rendesishmi nga nervat sensore speciale. Edhe ai nuk ka berthame.

Nervi fillon ne retine, ku ndodhen qelizat receptore, shkopinjte e konet. Pastaj kalon shtresat e bulbit okular (pjesa intrabulbare), vazhdon ne hapesiren e orbites (pjesa intraorbitale), ne kanalin optik (pjesa intrakanalore) dhe me pas hyn ne hapesiren e kafkes (pjesa intrakraniale). Keti nervi ben kiazmen optike ku ndodh nje kryqezim i pjesshem (vetem i fijave mediale) me nervin e anes tjeter. Pas kryqezimit vazhdojne traktet optike qe perfundojne ne qendrat subkortikale optike, nga ku niset radiacioni optik per ne korteksin optik.

Strukturat e mesiperme formojne sistemin optik.

**N. okulomotor** (*nervus oculomotorius*) eshte nerv motor, ai ka edhe fije motore somatike edhe fije motore (autonome) parasimpatike.

Berthamat e tij ndodhen ne mezencefalon, ne nivelin e kolikujve superiore. Nervi ka nje berthame centrale, teke ne linjen mediane (nc. Perlia), dy berthama anash saj, mediale (ncc. Edinger-Westfal) dhe dy berthama te tjera, laterale. Berthamat laterale jane somatomotore, te tjerat autonome, parasimpatike. Berthama mediane, teke eshte e perbashket per dy nervat, pra jep fije per nervat e te dy aneve, berthamat e tjera jepin fije per nervat e anes perkatese.

Nervat dalin nga truri medialisht pedunkujve cerebrale, shkojne perpara dhe futen ne sinusin kavernozi, (ku kalojne dhe n. troklear e n. abducens).

Perpara hyrjes ne fisuren orbitale superiore nervi ndahet ne dy dege, nje te siperme me te vogel dhe nje te poshtme me te madhe. Dega e siperme inervon m. levator palpebre superior dhe m. rektus okuli superior. Dega e poshtme jep nje dege per m. rektus okuli medial, nje dege per m. rektus okuli inferior dhe degen e fundit me te gjate per m. oblik inferior. Nga kjo dege shkëputen fijet parasimpatike qe shkojne ne ganglionin ciliar si rrenja parasimpatike e tij. Keto fije dalin nga ganglioni ne perberje te nn. ciliare breve dhe shkojne ne m. sfinkter pupile dhe m. ciliar.

Fijet parasimpatike te n. okulomotor janë pjesë e sistemit optik dhe luajne rol ne realizimin e refleksit pupilar dhe refleksit te akomodimit e konvergjencës.

**N. troklear** (*nervus trochlearis*) eshte nerv motor, ai ka fije motore somatike. Berthama e tij, nc. n. troklear, gjendet ne mezencefalon, ne nivelin e kolikujit inferior.

Nervat pasi nisen nga berthamat shkojne prapa, kryqezohen dhe dalin ne faqen e pasme te mezencefalosit, rrrotullohen rreth tij dhe dalin perpara, lateralisht pedunkujve cerebrale. Pastaj secili nerv futet sinusin kavernozi (ku kalojne edhe n. okulomotor e n. abduces). Nervi hyn ne fisuren orbitale superiore dhe inervon m. oblik superior.

**N. trigemin** (*nervus trigeminus*) eshte nerv i perzier, ai ka fije sensore te per gjithshme dhe fije motore somatike, ndërkohe qe rruges i atashohen fije motore (autonome) parasimpatike.

Fijet sensore arrijne ne berthamat sensore, te cilat janë nc. spinal i n. trigemin, nc. principal i n. trigemin dhe nc. mezencefalik i n. trigemin.

Fijet motore somatike nisen nga nc. motor (ose mastikator) i n. trigemin dhe inervojne muskujt e pertypjes.

Fijet nga te gjitha berthamat e nervit konvergojnë dhe dalin ne faqen e perparme te ponsit me rrenjen sensore (*radix sensoria*) dhe rrenjen motore (*radix motoria*). Pastaj drejtohen perpara mbi faqen e siperme te piramides temporale. Aty fijet

sensore formojne ganglionin trigemin (ganglion trigeminale), ndersa fijet motore kalojne tranzit nen ganglion. Pas ganglionit trigemin fijet sensore ndahen ne tre dege: n. oftalmik, n. maksilar dhe n. mandibular te cilit i bashkohen edhe fijet motore.

**N. oftalmik** (*nervus ophthalmicus*) me fije vetem sensore drejtohet perpara, futet ne sinusin kavernozi dhe duke u futur ne fisuren orbitale superiore ndahet ne tre dege: n. lakkimal qe shkon lateralish, n. nazociliar qe shkon medialish dhe n. frontal qe shkon midis tyre.

N. lakkimal (*n. lacrimalis*) merr rruges degen komunikante me nervin zigomatik (*r. communicans cum nervo zygomatico*) qe ka fije (autonome) parasimpatike e simpatike, te cilat shkojne per gjendren lakkimale. Pasi kalon gjendren lakkimale n. lakkimal inervon konjunktiven dhe lekuren e palpebrane ne kedin lateral te syrit.

N. frontal (*n. frontalis*) kalon nen tavanin e orbites dhe ndahet ne dy dege: n. supraorbital (*n. supraorbitalis*) dhe n. supratroklear (*n. supratrochlearis*), te cilet inervojne palpebren e siperme dhe lekuren e kokes ne balle.

N. nazociliar (*n. nasociliaris*) jep degen per ganglionin ciliar ose rrenjen sensore te ganglionit, nn. ciliare longe, n. etmoidal posterior, n. etmoidal anterior dhe n. infratroklear. Rrenja sensore e ganglionit (*radix sensoria ganglia ciliaris*) permban fije qe pasi kalojne ne ganglion, dalin prej tij ne perberje te nn. ciliare breve dhe shkojne ne bulb per te bere inervimin sensor te skleres e kornese (bashke me nn. ciliare longe). Nn. ciliare longe (*nn. ciliares longi*) shkojne per te inervuar (bashke me fijet sensore qe kalojne ne perberje te nn. ciliare breve) skleren dhe kornene. N. etmoidal posterior (*n. ethmoidalis posterior*) futet ne foramen etmoidale posterior dhe inervon mukozen e celulave ethmoidale posteriore dhe te sinusit sfenoidal. N. etmoidal anterior (*n. ethmoidalis anterior*) futet ne foramen etmoidale anterior dhe inervon mukozen e celulave ethmoidale anteriore dhe te sinusit frontal. N. infratroklear (*n. infratrochlearis*) inervon konjunktiven dhe lekuren e palpebrane ne kedin medial te syrit.

**N. maksilar** (*nervus maxillaris*) me fije vetem sensore shkon perpara dhe zbret neper foramen rotundum ne fosen pterigopalatine. Keti gjendet gangioni pterigopalatin, nga i cili dalin fije (autonome) simpatike e parasimpatike si dy nn. pterigopalatine; keto fije i atashohen n. maksilar. Pastaj n. maksilar ndahet ne tre dege: n. zigomatik, nn. alveolare superiore dhe n. infraorbital.

N. zigomatik (*n. zygomaticus*) merr me vete nga n. maksilar fijet autonome qe ky i fundit mori me nn. pterigopalatine, pastaj ai futet ne orbite nepermjet fisuren orbitale inferiore, dhe ia jep keto fije n. lakkimal (ky i çon ne gjendren lakkimale). Me pas n. zigomatik shkon drejt foramen zigomatikoorbitale, ndahet ne degen zigomatikotemporale (*r. zygomaticotemporalis*) dhe degen zigomatiokofaciale (*r.*

*zygomaticofacialis*), qe nepermjet kanaleve perkatese shkojne dhe bejne inervimin e lekures ne zonat perkatese.

Nn. alveolare superiore (*nn. alveolares superiores*) zakonisht dy, ndahen ne dege qe futen maksile dhe marrin pjese ne formimin e pleksit dental superior (plexus dentalis superior) per inervimin e dhembive te siperme dhe mukozes se gingivave perkatese.

N. infraorbital (*n. infraorbitalis*) hyn ne fisuren orbitale inferiore, kalon ne kanalin infraorbital dhe del ne foramen infraorbitale per te inervuar lekuren e palpebres se poshtme, buzes se siperme dhe te hundes.

**N. mandibular** (*nervus mandibularis*) vec fijeve sensore merr edhe te gjitha fijet motore te n. trigemin dhe neper foramen ovale del nga kaska. Pastaj ai jep nerva motore dhe nerva sensore.

Nn. temporale, n. maseterik (*n. massetericus*), n. pterigoid lateral (*n. pterygoideus lateralis*) n. pterigoid medial (*n. pterygoideus medialis*) inervojne muskujt perkates te pertypjes.

N. bukal (*n. buccalis*) inervon lekuren dhe mukozen e faqeve.

N. lingual (*n. lingualis*) ben inervim sensor te mukozes se 2/3 anteriore te gjuhes. Gjate rruges atij i atashohet n. korda tympani me fije sensore speciale (gustative) dhe motore (autonome) parasimpatike. Fijet gustative shkojne bashke me n. lingual ne 2/3 anteriore te gjuhes nga ku marrin ndjeshmerine e shijes. Fijet (autonome) parasimpatike shkeputen nga n. lingual per ganglionin submandibular kur nervi kalon prane tij.

N. alveolar inferior (*n. alveolaris inferior*) kalon ne kanalin mandibular ku merr pjese ne formimin e pleksit dental inferior (plexus dentalis inferior) per inervimin e dhembive te poshtem e gingivave perkatese. N. alveolar inferior del ne foramen mentale si n. mental (*n. mentalis*) dhe inervon lekuren e mjekres dhe buzes se poshtme.

N. aurikulotemporal (*n. auriculotemporalis*) fillon me dy rrenje nga n. mandibular; rrenjes se siperme i atashohen fije motore (autonome) parasimpatike qe dalin nga gangioni otik, te cilat shkeputen per gjendren parotide kur nervi kalon prane saj. Nervi inervon lekuren e aurikules dhe regionit temporal.

**N. abducens** (*nervus abducens*) eshte nerv motor, ai ka fije motore somatike.

Berthama eshte nc. i n. abducens dhe gjendet ne pons.

Nervi del nga truri ne ne sulkusin bulbopontin, pastaj shkon perpara, futet ne sinusin kavernozi (ku kalon edhe n. okulomotor e n. troklear), pastaj ne fisuren orbitale superiore dhe perfundon duke inervuar m. rektus okuli lateral. Tkurrja e tij e "abduktion" bulbin (per te pare anash).

**N. facial** (*nervus facialis*) konsiderohet si nerv i perzier. Ai perbehet nga dy komponente: komponenti i pare me fije motore somatike dhe komponenti i dyte

me fije motore (autonome) parasimpatike e fije sensore speciale. Komponenti i dyte, meqe paraqitet i ndare nga pjesa tjeter, njihet edhe si n. intermedius. Berthama e n. facial eshte nc. i n. facial, ndersa berthamat e n. intermedius jane, nc. salivatorius superior (berthame motore parasimpatike) dhe nc. tr. solitar (berthame sensore speciale - gustative).

Nervi facial del ne sulkusin bulbopontin me dy komponentet e tij, pastaj futet ne porusin e meatusin akustik intern (bashke me n. vestibulokoklear) dhe pastaj ne kanalin facial. Ne kthesen e pare te kanalit nga n. facial shkeputet n. intermedius.

**N. facial** me fije vetem motore somatike vazhdon rrugen ne kanal dhe pasi ben kthesen e dyte del ne foramen stylomastoideum. Pastaj shkon drejt gjendres parotide, ne brendesi te se ciles ndahet ne (5) dege temporale, zigmatike, bukale, mandibulare dhe cervikale, te cilat pasi anastomozojne me njera tjetren shperndahan per te inervuar muskujt e mimikes.

**N. intermedius** (*nervus intermedius*) ka ne perberje te tij fije motore parasimpatike (nga nc. salivatorius superior) dhe fije sensore speciale (nga nc. tr. solitaris). Menjehere pas shkeputjes fijet gustative formojne ganglionin genikular (*ganglion geniculi*). Pastaj nervi ndahet ne dy dege, n. petrosus major (me fije motore parasimpatike) dhe n. korda tympani (me fije motore parasimpatike dhe fije sensore gustative).

N. petrosus major (*n. petrosus major*) del nga piramida temporale, shkon drejt foramen lacerum, zbret ne te dhe bashkohet me n. petrosus profund qe sjell fije motore simpatike nga pleksi i a. karotike interne. Nervi i formuar eshte n. i kanalit pterigoid qe pasi kalon neper kanal arrin ne fosen pterigopalatine dhe i perfundon fijet parasimpatike dhe simpatike ne ganglionin pterigopalatin.

N. korda tympani (*chorda tympani*) vazhdon rrugen ne kanalin facial bashke me n. facial, pastaj shkeputet prej tij dhe del ne faqen e jashtme te bazez se kraniumit. Pastaj i atashohet n. lingual, duke udhetuar me te. Prane ganglioninit submandibular n. korda tympani i leshon atij fijet motore parasimpatike, ndersa fijet gustative vazhdojne rrugen bashke me nervin lingual dhe perfundojne ne mukozen e 2/3 anteriore te gjuhes duke bere inervim gustativ.

**N. vestibulokoklear** (*nervus vestibulocochlearis*) perbehet nga n. vestibular dhe n. koklear. Te dy nervat kane nje pjesë te rruges te perbashket.

**N. koklear** (*nervus cochlearis*) eshte nerv sensor special. Formohet nga zgjatimet qendrore te qelizave te ganglionit koklear (*ganglion cochleare*) te vendosur ne veshin e brendshem. Zgjatimet periferike te tyre perfundojne ne qelizat receptore. Nervi pasi kalon neper meatusin akustik intern (bashke me n. vestibular e n. facial) del nga porusin akustik intern, futet ne pons dhe i perfundon fijet ne nc. koklear posterior dhe nc. koklear anterior. Nga keto berthama nisen fijet akustike

qe vazhdojne ne lemniskun lateral dhe shkojne ne qendrat subkortikale akustike nga ku niset radiacioni akustik drejt korteksit akustik. Strukturat e mesiperme formojne sistemin auditiv.

**N. vestibular** (*nervus vestibularis*) eshte nerv sensor special. Formohet nga zgjatimet qendrore te ganglionit vestibular (*ganglion vestibulare*) te vendosura ne fund te meatusit akustik intern. Zgjatimet periferike te tyre perfundojne ne qelizat receptore. Nervi pasi kalon neper meatusin e porusin akustik intern (bashke me n. koklear e n. facial) futet ne pons dhe i perfundon fijet ne kater berthamat vestibulare, perkatesisht ne nc. vestibular inferior, nc. vestibular lateral, nc. vestibular superior dhe nc. vestibular medial. Nga keto berthama nisen fije ne disa drejtime, drejt medules spinale, cerebelumit, talamusit e korteksit dhe ne perberje te FLM. Strukturat e mesiperme formojne sistemin vestibular.

**Nervi glosofaryngeus** (*nervus glossopharyngeus*) eshte çifti i nente i nervave kraniale. Ai eshte nerv i perzier dhe ka disa lloje te fijeve. Fije motore somatike, qe e kane origjinën ne nc. ambiguus (1/2 superiore). Fije motore viscerale (parasimpatike), qe e kane origjinën ne nc. salivator inferior. Fije sensore somatike, qe perfundojne ne nc. tr. spinalis n. trigemin. Fije sensore viscerale, qe perfundojne ne nc. tr. solitar.

Nervi del nga truri ne sulkusin lateral posterior te medules oblongata, pastaj futet ne foramen jugulare (bashke me n. vag, n. akcesor dhe v. jugulare interne) dhe del jashte kafkes. Ne foramen jugulare fijet sensore somatike formojne ganglionin superior dhe fijet sensore viscerale formojne ganglionin inferior.

Fijet motore somatike inervojne mm. konstriktore te faringut dhe m. stylofaryngeus.

Fijet motore viscerale parasimpatike shkeputen nga nervi glosofaringeal si n. tympanik; ky futet ne kanalikulin tympanik ne piramiden temporale. Ne kavitetin tympanik ai degezohet e formon pleksin tympanik, nga ribashkimi i degeve te te cilin formohet n. petroz minor, i cili pasi del nga piramida, kalon ne foramen ovale dhe i perfundon fijet (parasimpatike) ne ganglionin otik. Ky me pas ia kalon n. aurikulotemporal, i cili i dergon ne gjendren parotis.

Fijet sensore somatike (qe vijnë nga ganglioni superior) inervojne mukozen e gjuhes (1/3 posteriore), faringut dhe meatusit akustik ekstern.

Fijet sensore viscerale (qe vijnë nga ganglioni inferior) Jane te dy llojeve, gustative dhe baroreceptore. Fijet gustative (sensore speciale) marrin ndjeshmerine e shijes nga 1/3 posteriore e gjuhes dhe i perfundojne ne pjesen gustative te nc. tr. solitar. Fijet baroreceptore (sensore te pergjithshme) fillojnë nga baroreceptoret e sinusit karotik (te vendosur mbi bifurcationin e a. karotike komune) si nervi i sinusit karotik dhe perfundojne ne pjesen kardiorespiratore te

nc. tr. solitar (perkatesisht ne pjesen baroreceptore te tij), e cila ka lidhje direkte me nc. dorsal te n. vag, gje qe mundeson modifikimin e punes se zemres dhe ventilimit pulmonar ne varesi te vlerave te presionit te gjakut.

**N. vagus** (*nervus vagus*) eshte çifti i dhjete i nervave kraniale. Ai eshte nerv i perzier dhe ashtu si n. glosofaringeal, ka disa lloje te fijeve.

Fijet motore somatike, qe e kane origjinen ne nc. ambiguus (1/2 inferiore).

Fijet motore viscerale (parasimpatike), qe e kane origjinen ne nc. dorsalis n. vag.

Fijet sensore somatike, qe perfundojne ne nc. tr. spinalis n. trigemin.

Fijet sensore viscerale, qe perfundojne ne nc. tr. solitar.

Nervi del nga truri ne sulkusin lateral posterior te medules oblongata, nen n. glosofaringeus. Pastaj futet ne foramen jugulare (bashke me n. glosofaringeus, n. akcesor dhe v. jugulare interne) dhe del jashtë kafkes. Nen foramen jugulare fijet sensore somatike formojne ganglionin superior dhe fijet sensore viscerale formojne ganglionin inferior. Pastaj nervi zbret ne qafe (ne perberje te tufes neurovaskulare bashke me a. karotike interne dhe v. jugulare interne), ne toraks dhe ne abdomen. Kalimi (endja; vagus do te thote endacak) ne qafe, toraks e abdomen e bejne vagusin nervin me te gjate kranial.

Ne qafe n. vag, qe zbret ne perberje te tufes neurovaskulare jep degen faringeale, n. laringeus superior, n. laringeus rekurens dhe deget kardiale. Dega faringeale (*r. pharyngeus*) merr pjese ne formimin e pleksit faringeal (*plexus pharyngeus*). N. laringeus superior (*n. laryngeus superior*) inervon mukozen e laringut dhe pjesen e jashtme te tij. N. laringeus rekurens (*n. laryngeus recurrens*) inervon muskujt e laringut. Deget kardiak (cervikale) shkojne ne zemer.

Ne toraks n. vag i djathet ka raporte te ndryshme me te majtin. Djathetas nervi kalon prapa v. brakiocefalike te djathet, pastaj prapa v. kava superior, prapa rrenjes se mushkerise dhe vazhdon ne ezofag. Majtas nervi kalon prapa v. brakiocefalike te majte, kryqezon nga perpara harkun e aortes, zbret prapa rrenjes se mushkerise te majte dhe vazhdon ne ezofag.

Deget qe jep vagusi ne toraks jane dege kardiak, dege bronkiale e dege ezofageale.

Deget kardiak (torakale) formojne pleksin kardiak.

Deget bronkiale (*rr. bronchiales*) marrin pjese ne formimin e pleksit pulmonar (*plexus pulmonalis*).

Deget ezofageale marrin pjese ne formimin e pleksit ezofageal (*plexus oesophagus*) anterior (nga nervi vagus i majte) e pleksit ezofageal posterior (nga nervi vagus i djathte).

Ne abdomen nga plekset e mesiperme formohen trunku vagal anterior (*truncus vagalis anterior*) dhe trunku vagal posterior (*truncus vagalis posterior*) qe jepin kryesisht dege gastrike dhe hepatike.

Fijet motore somatike te nervit vagus inervojne muskujt e laringut.

Fijet motore viscerale parasimpatike inervojne muskulaturen e organeve torakale dhe shumices se atyre abdominale duke ulur rrashjet e zemres, shtuar peristaltiken dhe sekrecionin e gjendrave te organeve te ndryshme.

Fijet sensore somatike (qe vijnë nga ganglioni superior) inervojne lekuren e regionit retroaurikular dhe meatusit akustik ekstern.

Fijet sensore viscerale (qe vijnë nga ganglioni inferior) janë te dy llojeve, gustative dhe kimioreceptore. Fijet gustative (sensore speciale) marrin ndjeshmerine e shijes nga epiglotisi dhe i perfundojnë ne pjesen gustative te nc. tr. solitar. Fijet kimioreceptore (sensore te perqitshme) fillojne nga kimioreceptoret e trupit karotik (te vendosur mbi bifurkacionin e a. karotike komune) dhe perfundojnë ne pjesen kardiorespiratore te nc. tr. solitar (perkatesisht ne pjesen kimioreceptore te tij), e cila ka lidhje direkte me nc. dorsal te n. vag, gje qe mundeson modifikimin e punes se zemres dhe ventilimit pulmonar ne varesi te vlerave te perqindjes se gazeve ne gjak.

(Nc. tr. solitar funksionalisht ka: pjesen gustative dhe pjesen kardiorespiratore.

Pjesa gustative gjendet ne pjesen e siperme te nc. tr. solitar. Ne te sjellin shijen n. intermedius (nga 2/3 anteriore te gjuhes), n. glosofaringeus (nga 1/3 posteriore e gjuhes) dhe n. vagus (nga epiglotisi).

Pjesa kardiorespiratore ka pjesen baroreceptore dhe ate kimioreceptore ose respiratore. Ne pjesen baroreceptore vjen informacion mbi presionin e gjakut nga n. glosofaringeus dhe n. vagus. Ne pjesen kimioreceptore vjen informacion mbi informacion mbi perqindjen e O<sub>2</sub> dhe CO<sub>2</sub> ne gjak nga n. glosofaringeus dhe n. vag.

**N. akcesor** (*nervus accessorius*) eshte nerv motor, ai ka fije motore somatike.

Berthama e tij eshte nc. i n. akcesor dhe gjendet ne fakt ne medulen spinale, ne bririn anterior ne segmentet e siperme te saj dhe arrin ne pjesen kaudale te medules oblongata.

Nervi del me rrenjet e tij ne siperfaqen laterale te medules spinale midis rrenjeve anteriore e posteriore te saj, pastaj futet ne foramen magnum dhe ridel nga kraniumi ne foramen jugulare (bashke me n. glosofaringeal, n. vag dhe v. jugulare interne).

Nervi inervon m. sternokleidomastoid dhe m. trapezius.

**N. hypoglos** (*nervus hypoglossus*) eshte nerv motor, ai ka fije motore somatike.

Berthama e tij eshte nc. i n. hypoglos dhe gjendet ne medulen oblongata.

Nervi del me rrenjet e tij ne sulkusin anterolateral te medules oblongata dhe pastaj nga kafka nepermjet kanalit te n. hypoglos.

Pasi zbret ne qafe ai perfundimisht ndahet ne dege per te inervuar muskujt e gjuhes.

## NERVAT SPINALE

**Nervat spinale** (*nervi spinales*) dalin nga medula spinale me dy rrenje, ate anteriore ose motore (*radix anterior, radix motoria*) dhe ate posteriore ose sensore (*radix posterior, radix sensoria*). Secila rrenje formohet nga bashkimi i fijeve radikulare (*fila radicularia*) qe dalin per rrenjen anteriore nga sulkusi anaterolateral, ndersa per rrenjen posteriore nga sulkusi posterolateral. Rrenja posteriore formon ganglionin spinal (*ganglion sensorium nervi spinalis*) dhe menjehere pas kesaj dy rrenjet bashkohen duke formuar nervin spinal, qe del neper foramen intervertebrale. Pas kesaj n. spinal ndahet ne degen anteriore e degen posteriore; secila prej tyre ka fije nga te dy rrenjet e nervit.

Ka gjithesej 31 çifte te nervave spinale, qe ndahen ne 8 cervikale, 12 torakale, 5 lumbare, 5 sakrake dhe 1 koksigeal.

**Deget posteriore** (*rami posteriores*) jane me te holla se ato anteriore, ndahen ne dege mediale e laterale dhe inervojne muskujt dhe lekuren e qafes e shpines. Nga deget posteriore te nervave cervikale, torakale, lumbare, sakrale e koksigeal veçohen deget posteriore te tre nervave te siperim cervikale.

Dega posteriore e n. C1 eshte e madhe dhe formon n. subokcipital (*n. suboccipitalis*), dega posteriore e n. C2 gjithashu eshte e madhe dhe formon n. okcipital major (*n. occipitalis major*), ndersa dega posteriore e n. C3 formon n. okcipital te trete (*n. occipitalis tertius*).

**Deget anteriore** (*rami anteriores*) bashkohen dhe formojne pleksen, perveçse ne nervat torakale, ku ato formojne nn. interkostale. Plekset anastomozojne me njeritjetrin.

\* **Pleksi cervikal** (*plexus cervicalis*) formohet nga deget anteriore te nervave C1-C4, qe kane ansa komunikante midis tyre. Pleksi jep dege siperfaqesore dhe te thella.

**Deget siperfaqesore** te pleksit cervikal jane n. okcipital minor, n. aurikular magnus, n. transvers cervikal dhe nn. supraklavikulare. N. okcipital minor (*n. occipitalis minor*) ka dege komunikante me nervat e tjere okspitale dhe inervon lekuren ne regjionin mastoid. N. aurikular magnus (*n. auricularis magnus*) inervon lekuren perpara e prapa aurikules.

N. cervical transvers (*n. transversus cervicalis*) inervon lekuren ne pjesen e perparme te qafes. Nn. supraklavikulare (*nn. supractaviculares*) zbresin perpara klavikules dhe inervojne lekuren ne pjesen e siperme te toraksit.

**Deget e thella** te pleksit cervikal jane dege muskulare (per muskujt e qafes) si dhe ansa cervikale e n. frenik.

Ansa cervikale (*ansa cervicalis*) ka rrenjen e siperme (*radix superior*) qe i atashohet n. hipoglos dhe rrenjen e poshtme (*radix inferior*). Deget e anses inervojne muskujt infrahioide.

N. frenik (*n. phrenicus*) pasi zbret ne qafe, hyn ne hapesireni torakale ku kalon perpara rrenjes se pulmonit, pastaj midis perikardit dhe pleures mediastinale te cilat i inervon, (dy nervat kane gjatesi dhe raporte te ndryshme), dhe perfundon ne diafragme duke bere inervimin motor te saj.

\* **Pleksi brakial** (*plexus brachialis*) formohet nga deget anteriore te nervave C5-T1, qe kane ansa komunikante midis tyre. Prej tyre formohet trunku superior (*truncus superior*), trunku i mesem (*truncus medius*) dhe trunku inferior (*truncus inferior*). Trunkuset ndahen ne dege (*divisiones anteriores, divisiones posteriores*) qe ribashkohen ne fascikulin medial (*fasciculus medialis*), fascikulin lateral (*fasciculus lateralis*) e fascikulin posterior (*fasciculus posterior*).

Pleksi brakial jep dege per inervimin e muskujve dhe lekures se rrëthit pektoral dhe te gjymtyres se siperme.

**Deget per rrëthin pektoral** jane n. pektoral medial, n. pektoral lateral, n. subskapular, n. supraskapular, n. dorsal skapular, n. torakal longus e n. torakodorsal.

N. pektoral medial (*n. pectoralis medialis*) e n. pektoral lateral (*n. pectoralis lateralis*) inervojne muskujt pektorale.

N. subskapular (*n. subscapularis*) dhe n. supraskapular (*n. suprascapularis*) inervojne muskujt perpara e prapa skapules.

N. skapular dorsal (*m. dorsalis scapulae*), m. torakal long (*m. thoracicus longus*) dhe m. torakodorsal (*m. thoracodorsalis*) inervojne muskujt e shpines qe kapen ne skapul e brinje.

**Deget per gjymtyren e siperme** jane n. aksilar, n. muskulosutan, n. kutan brakial medial, n. kutan antebrazial medial dhe n. median, n. ulnar dhe n. radial.

**N. aksilar** (*n. axillaris*) inervon m. deltoid dhe jep n. kutan brakial lateral per lekuren ne pjesen laterale te krahut.

**N. muskulokutan** (*n. musculocutaneus*) inervon muskujt e parparshem te krahut dhe jep n. kutan antebakial lateral (*n. cutaneus antebrachii lateralis*) per lekuren ne pjesen laterale te parakrahut.

**N. kutan brakial medial** (*n. cutaneus brachii medialis*) inervon lekuren ne pjesen mediale te krahut.

**N. kutan antebakial medial** (*n. cutaneus antebrachi medialis*) inervon lekuren ne pjesen mediale te parakrahut.

**N. median** (*n. medianus*) fillon nga fascikuli medial dhe ai lateral i pleksit brakial, ne krah nuk jep dege, ne parakrah jep dege muskulare per muskujt e perparshem te tij dhe ne dore, ne anen palmare, veç degeve muskulare, jep edhe nn. digitale palmare per lekuren e gishtit te pare, te dyte, te trete e pjeserisht te katert.

**N. ulnar** (*n. ulnaris*) fillon nga fascikuli medial i pleksit brakial, ne krah e parakrah nuk jep dege, ndersa ne dore jep dege muskulare si dhe nn. digitale palmare e nn. digitale dorsale per lekuren e gishtit te peste e pjeserisht te katert ne anen palmare e dorsale.

**N. radial** (*n. radialis*) fillon nga fascikuli posterior i pleksit brakial dhe eshte nervi me i madhi i pleksit. Ne krah inervon muskujt e pasem te tij si dhe jep n. kutan brakial posterior (*n. cutaneus brachii posterior*). Ne parakrah inervon muskujt e pasem te tij dhe jep n. kutan antebakial posterior (*n. cutaneus antebrachii posterior*). Ne dore, ne anen dorsale, veç degeve muskulare, jep edhe nn. digitale dorsale per lekuren e gishtit te pare, te dyte, te trete e pjeserisht te katert.

**Nervat interkostale** (*nn. intercostales*) kalojne ne hapesirat interkostale, ne sulkusin e brinjes (bashke me arterien dhe venen interkostale) dhe jepin dege muskulare e kutane.

■ **Pleksi lumbar** (*plexus lumbalis*) formohet nga deget anteriore te nervave L1-L4, qe kane ansa komunikante midis tyre, ne vazhdim te te cilave (ndryshe nga pleksi brakial) dalin deget e pleksit.

Deget e pleksit lumbar jane n. iliohipogastrik, n. ilioinguinal, n. genitofemoral, n. kutan femoral lateral, n. obturator dhe n. femoral.

**N. iliohipogastrik** (*n. iliohypogastricus*) inervon muskujt e barkut si dhe lekuren ne regjionin gluteal (me degen laterale) dhe ne regjionin hipogastrik (me degen mediale).

**N. ilioinguinal** (*n. ilioinguinalis*) shkon paralel dhe nen n. ilioinguinal dhe inervon lekuren e organeve genitale te jashtme.

**N. genitofemoral** (*n. genitofemoralis*) ka degen genitale (*r. genitalis*) qe kalon neper kanalin inguinal dhe inervon lekuren e organeve genitale te jashtme dhe degen femorale (*r. femoralis*) qe shoqeron a. femorale dhe inervon lekuren ne regjionin femoral.

**N. kutan femoral lateral** (*n. cutaneus femoris lateralis*) kalon nen lig. inguinal prane spines iliake anteriore superiore dhe inervon lekuren ne pjesen laterale te kofshes.

**N. obturator** (*n. obturatorius*) kalon neper kanalin obturator dhe inervon muskujt mediale te kofshes dhe lekuren ne pjesen mediale te saj.

**N. femoral** (*n. femoralis*) eshte me i madhi nga deget e pleksit lumbar; ai pasi jep dege per muskujt e rrëthit pelvik, kalon ne lakunen muskullore. Pastaj jep dege muskulare per muskujt e perparshem te kofshes dhe kutane per lekuren ne pjesen e perparme te saj. Ne vazhdim n. femoral vazhdon me n. safen (*n. saphenus*), qe zbret ne kerci duke shoqeruar v. safena magna dhe jep dege kutane mediale (*rr. cutanei cruris mediales*).

■ **Pleksi sakral** (*plexus sacralis*) formohet nga deget anteriore te nervave L4-L5, qe formojne trunkun lumbosakral (*truncus lumbosacralis*) dhe te nervave S1-S3. Deget anteriore te n. S4-S5 bashke me n. koksigeal konsiderohen shpesh si pjese e ketij pleksi (dhe jo pleks i veçante).

Deget e pleksit sakral (perveç atyre muskulare per muskujt gluteale) jane n. gluteal superior, n. gluteal inferior, n. kutan femoral posterior e n. iskiadik. Dege te tij konsiderohen edhe n. pudend e n. koksigeal.

**N. gluteal superior** (*n. gluteus superior*) del nga pelvsi neper foramen suprapiriforme (mbi m. piriform) bashke me a. gluteale superiore, ndersa **n. gluteal inferior** (*n. gluteus inferior*) neper foramen infrapiriforme (nen m. piriform) bashke me a. gluteale inferiore; dy nervat inervojne muskujt gluteale.

**N. kutan femoral posterior** (*n. cutaneus femoris posterior*) inervon lekuren ne pjesen e pasme te kofshes.

**N. iskiadik** (*n. ischiadicus*) eshte nervi me i gjate i njeriut. Ai kalon neper foramen infrapiriforme, zbret prapa m. gluteal major e ne pjesen e pasme te kofshes dhe prapa artikulacionit te gjurit ndahet ne deget fundore, n. fibular komun dhe n. tibial.

**N. fibular komun** (*n. fibularis communis*) pasi jep n. kutan lateral per pulpen (*n. cutaneus surae lateralis*) del perpara ne kerci dhe ndahet ne n. fibular superficial dhe n. fibular profund. N. fibular superficial (*n. fibularis superficialis*) inervon muskujt laterale te kercirit, n. fibular profund (*n. fibularis profundus*) inervon muskujt anteriore te kercirit; ne kembe te dy nervat inervojne lekuren ne anen dorsale te saj.

**N. tibial** (*n. tibialis*) zbret prapa ne kerci dhe shoqeron a. tibiale posteriore. Ai jep n. kutan medial per pulpen (*n. cutaneus surae medialis*), dege per muskujt e pasem te kercirit, n. sural (*n. suralis*) per lekuren ne pjesen laterale te kembes si dhe n. plantar medial (*n. plantaris medialis*) e n. plantar lateral (*n. plantaris lateralis*) per lekuren ne shputen e kembes.

**N. pudendus** (*n. pudendus*) inervon lekuren e organeve genitale te jashtme dhe perineumin.

**N. koksigeal** (*n. coccygeus*) inervon lekuren ne zonen koksigeale.

## HARKU REFLEKTOR SOMATIK

Harku reflektor somatik realizohet me dy neurone: neuronin aferent dhe neuronin eferent.

Trupat e **neuroneve aferente** ndodhen ne ganglionet spinale, ne rrenjet posteriore te nervave spinale. Zgjatimet periferike sjellin impulset aferente somatike. Zgjatimet centrale hyjne ne bririn posterior dhe perfundojne ne bririn anterior.

Trupat e **neuroneve eferente** gjenden ne berthamat e bririt anterior, nga ku nisen aksonet perkates nepermjet rrjenjes anteriore, per te perfunduar ne organet perkatese (muskujt somatike).

## Fakte klinike

### Neuropatia

Neuropatia nenkupton nje semundje te nje nervi kranial ose periferik. Shkaqet e saj mund te jene trauma (nga vepimi direkt ose nga nje fragment i frakturuar kockor), toksina (alkoli, plumbi), infeksione, semundje te tjera (diabeti).

### Polineuropatia

Polineuropatia eshte prekja e njekohshme e disa nervave periferike. Zakonisht prekja eshte bilaterale simetrike.

### Neuriti

Neuriti eshte inflamacioni i nje nervi kranial ose periferik dhe shoqerohet me dhimbje, parestezi (ndjesi e nje ngacmimi kutan pa stimul) ose pareze (dobesi muskulare, jo paralize).

### Neuralgja

Neuralgja eshte dhimbja e forte ne trajektin e nervit ose territorin e inervimit te tij. te tilla mund te jene neuralgia trigeminale, neuralgia iskiatike etj.

### Neuralgia trigeminale

Neuralgja trigeminale karakterizohet nga atake te nje dhimbjeje shume te forte ne territorin e inrevimit te n. trigeminal, me teper te deges se tij n. maksilar. Dhimbja mund te filloje nga prekja e nje zone veçanerisht te ndjeshme te fytyres. Ne per gjithesë shkaku eshte i papercaktuar.

### Paraliza faciale

Praliza faciale shoqerohet me humbje te funksionit te nervave te mimikes te njerës ane, pa shenja te tjera shoqueruese. ajo mund te filloje menjehere, pas nje ekspozimi ne te ftohte dhe zakonisht zhduket pas disa javesh.

## SISTEMI NERVOR AUTONOM

### Sistemi nervor simpatik

### Sistemi nervor parasimpatik

### Harku reflektor autonom

### Sistemi nervor enterik

**Sistemi nervor autonom**, SNA, (*divisio autonomicus*) perfaqeson komponentin visceral te sistemit nervor, qe realizon kontrollin mbi mjedisin e brendshem te organizmit. Pavaresisht nga emertimi ky sistem nuk eshte "autonom", pasi funksionet e tij jane ngushtesishet te integruara me ato te sistemit nervor somatik. Ky integrum ndodhet ne katet e SNQ deri ne korteksin cerebral. SNA, ashtu si edhe ai somatik, ka rruget aferente dhe ato eferente.

**Rruget viscerale aferente** perfaqehen nga neuronet e vendosura ne ganglionet e irrenjeve posteriore te nervave spinale dhe ganglionet e nervave kraniale. Zgjatimet periferike te tyre kalojne neper ganglionet ose plekset autonome, ndersa zgjatimet qendrore (aksonet) shoqerojne fijet aferente somatike per te hyre ne SNQ.

**Rruget viscerale eferente**, ndryshe nga ato somatike, nuk formohen vetem nga nje neuron, por nga dy, per te arritur ne organet efektore. Neuroni i pare ose preganglionar, e ka trupin ne berthamat autonome te nervave kraniale ose bririn lateral te medules spinale. Aksonet e neuroneve preganglionare nepermjet

nervave kraniale ose spinale arrijne ne ganglionet periferike, ku bejne sinaps me neuronet e dyta postganglionare. Zakonisht nje neuron preganglionar ben sinaps me shume (deri 20) neurone postganglionare duke siguruar nje shperndarje te gjere te efekteve autonome.

SNA ka pjesen **parasimpatike**, pjesen **simpatike** dhe pjesen **enterike**. Keto pjesë ndryshojne ne organizim e strukture, por kane funksione te integruara. Sistemi nervor parasimpatik realizon “ruajtjen e energjise” se trupit dhe predomonon ne qetesë, ndersa sistemi nervor periferik aktivizohet gjate aksionit dhe predomonon ne gjendjet e stresit, duke qene nje “harxhues i energjise”. Ne nje organ veprimi i dy sistemeve te mesiperme eshte antagonist (psh. ne zemer simpatiku rrith frekencen, ndersa parasimpatiku e ul ate). Sistemi nervor enterik perfaqeshet nga nje rrjet neuronesh qe gjenden ne murin e traktit gastrointestinal.

## SISTEMI NERVOR PARASIMPATIK

**Sistemi nervor parasimpatik** (*pars parasympathica*) fillon me trupat e neuroneve te vendosur ne berthamat autonome te disa nervave kraniale ne trunkun e trurit dhe lenden gri te segmenteve S2-S4 ne medulen spinale. Fijet eferente preganglionare dalin nga SNQ nepermjet nervave perkates kraniale e spinale. Ato arrijne ne ganglionet parasimpatike qe gjenden ne periferi, ne distance nga SNQ. Prej tyre dalin fijet postganglionare, me te shkurtra se ato preganglionare, qe shkojnë ne organet efektore. Ne ganglionet parasimpatike kraniale mund te kalojne tranzit edhe fije simpatike ose sensore.

**N. okulomotor** ka fije parasimpatike preganglionare qe fillojne ne nc. mediale te tij (Westfal-Edinger) dhe perfundojne ne ganglionin ciliar. Prej tij dalin fijet postganglionare, qe ne perberje te nn. ciliare breve, futen ne bulb dhe inervojne m. ciliar e m. sfinkter te pupiles.

**N. facial**, ne fakt n. intermedius, ka fije parasimpatike preganglionare qe fillojne ne nc. salivator superior dhe vazhdojne ne n. petroz major dhe n. korda timpani. N. petroz major i dergon ne ganglionin pterygopalatin dhe ky nis fije postganglionare, qe nepermjet n. maksilar, n. zigomatik e n. lakrimal, perfundojne ne gjendren lakrimale. N. korda timpani i dergon ne ganglionin submandibular, qe nis fije postganglionare ne gjendren submandibulare e ate sublinguale.

**N. glosofaringeus** ka fije fije parasimpatike preganglionare qe fillojne ne nc. salivator inferior dhe vazhdojne ne n. timpanik, pleksin timpanik, n. petroz minor dhe perfundojne ne ganglionin otik. Ky nis fije postganglionare, qe nepermjet n. aurikulotemporal, arrijne ne gjendren parotide.

**N. vagus**, i cili eshte nervi kryesor parasimpatik, ka fije parasimpatike preganglionare qe fillojne ne nc. dorsal te tij dhe shperndahen me deget e shumta te nervit drejt organeve per te perfunduar ne ganglionet e tyre te vogla. Deget kardiak, qe formojne pleksin kardiak, perfundojne ne ganglionet qe gjenden ne dy atriumet. Efekti ne zemer eshte ulja e ritmit kardiak dhe ngushtimi i aa. koronare.

Deget pulmonare i perfundojne fijet preganglionare ne ganglionet e vendosura ne plekset pulmonare. Fijet postganglionare perfundojne ne muskulaturen e lemuar te bronkeve e bronkiolave, ku bejne bronkokonstriksion.

Deget e traktit digestiv (gastrike, intestinale) perfundojne ne ganglionet e paretit te tij. Fijet postganglionare iritin tonusin e m. sfinkter te pilorit dhe shtojne sekrecionet e mukozes.

Deget intestinale bejne inervim motor te muskulatures dhe inervim sekretor te gjendrave te mukozes.

**Nn. splanknike pelvike**, qe dalin nga medula spinale me rrenjen anteriore te nn. spinale sakrale, kane fije parasimpatike preganglionare me origjine nga nc. parasimpatike sakrale. Ato perfundojne ne ganglionet parasimpatike ne murin e organeve pelvike (*ganglia pelvica*). Fijet postganglionare jane motore per muskulaturen e rektumit e vezikes urinare dhe japin vazodilatacion ne penis e klitoris.

## SISTEMI NERVOR SIMPATIK

**Sistemi nervor simpatik** (*pars sympathica*) fillon me trupat e neuroneve te vendosur ne nc. intermediolateral, ne bririn lateral te lendes gri ne medulen spinale ne intervalin e segmenteve C8-L2. Aksonet e tyre kalojne ne rrenjet anteriore, pastaj ne nervat spinale dhe shpejt shkeputen prej tyre si dege komunikante te bardha (*ramus communicans albus*) qe perfundojne ose ne ganglionet paravertebrale ose ne ganglionet prevertebrale.

**Ganglionet paravertebrale**, te lidhur me njeri tjeterin, formojne ne secilen ane te kolones vertebrale nga nje trunk simpatik (*truncus sympathicus*). **Trunkuset simpatike** shtrihen nga baza e kafkes ne koksiks, ku bashkohen ne nje ganglion tek (*ganglion impar*). Kur fijet preganglionare arrijne ne nje ganglion te trunkusit simpatik, mund te sillen ne tre menyrat: ose te perfundojne ne te, ose mund te kalojne tranzit ne te e te perfundojne ne ganglione te tjere mbi ose nen te, ose mund te kalojne tranzit ne te dhe te perfundojne ne ganglionet prevertebrale (te plekseve autonome). Ganglionet prevertebrale gjenden para kolones vertebrale, ne linjen mediane dhe konsiderohen derivate te ganglioneve paravertebrale.

Ganglionet paravertebrale te trunkusit simpatik jane ganglione cervikale (qe fuzionohen ne tre ganglione: superior, i mesem, inferior), ganglione torakale (11-

12), ganglione lumbare (4) dhe ganglione sakrale (4-5). Fijet postganglionare prej tyre rikthehen ne nervat spinale si dege komunikante gri (*ramus communicans griseus*), proksimalisht atyre te bardha. Me pas ato shperndahen ne territorin e inervimit te nervave spinale.

**Ganglionet prevertebrale** vendosen ne **plekset autonome** (jane bashkime nervash e ganglionesh) te vendosur ne kavitetin torakal dhe kavitetin abdominopelvik. Ato jane pleksi kardiak (*plexus cardiacus*), pleksi pulmonar (*plexus pulmonalis*), pleksi celiak (*plexus coeliacus*), pleksi mezenterik superior (*plexus mesentericus superior*), pleksi mezenterik inferior (*plexus mesentericus inferior*), plekset renale (*plexus renalis*), pleksi iliak (*plexus iliacus*) etj. Fijet nga keto plekse vazhdojnë pergjate shumicës se degeve te eneve te medha që ndodhen pranë tyre, zakonisht emertohen sipas arterës me të cilën ato shperndahen dhe inervojnë zonen e vaskularizimit të arterës perkatese.

Efekti i inervimit simpatik eshte i kundert me atë parasimpatik.

## HARKU REFLEKTOR AUTONOM

**Harku reflektor autonom** realizohet me tre neurone: neuronin aferent, ate konektor dhe neuronin eferent.

Trupat e neuroneve aferente ndodhen ne ganglionet spinale, ne trenjet posteriore te nervave spinale, se bashku me ato te neuroneve sensore somatike. Zgjatimet periferike sjellin impulsset aferente autonome. Zgjatimet centrale hyjne ne bririn posterior dhe perfundojne ne bririn lateral.

Trupat e neuroneve konektore gjenden ne ncc. intermediolaterale të medullës spinale, nga ku nisen aksonet perkates nepermjet rrenjes anteriore, per te perfunduar si fije preganglionare ne ganglionet paravertebrale, prevertebrale ose parasimpatike.

Trupat e neuroneve efektore gjenden ne keto ganglione. Aksonet e tyre janë fijet postganglionare per ne organet perkates.

## SISTEMI NERVOR ENTERIK

**Sistemi nervor enterik** ne traktin gastrointestinal perfaqeson inervimin intrinsek te tyre. Ky inervim ekziston paralelisht me atë ekstrinsek (inervimi ekstrinsek eshte parasimpatik nga n. vagus e nn. splanknike pelvike dhe simpatik nga ganglioni celiak e ganglionet mesenterike).

Sistemi nervor enterik formohet nga neuronet sensore e neuronet motore dhe midis tyre plekset intrinseke te zorrës (*plexus entericus*), perkatesisht pleksi

subseroz (*plexus subserosus*), pleksi mienterik (*plexus myentericus*) dhe ai submukozal (*plexus submucosus*). Keto plekse janë të nderlidhur me njeri tjeterin. Neuronet motore e sensore të sistemit enterik kontrollojnë aktivitetin reflektor të sistemit gastrointestinal. Ato monitorojnë tensionin e paretit të zorrëve e permbajtjen e tyre dhe rregullojnë peristaltiken, sekrecionin dhe tonusin vaskular. Keto aktivitete mund të kryhen të pavarur nga truri e medulla spinale, pra edhe nëse lidhjet qendrore nderpriten, por gjithashtu edhe mund të modifikohen nga veprimi i sistemit simpatik e atij parasimpatik.

## ***13. ORGANET E SHQISAVE***

**Organi i te parit: Syri**

**Organi i degjimit dhe organi i ekuilibrit: Veshi**

**Organi i nuhatjes: Hunda**

**Organi i shijes: Gjuha**

**Organet e shqisave** (*organa sensuum*) perfshijnë syrin (organi i te parit) me strukturat ndihmese të tij, veshin (organi i te degjuarit dhe organi vestibular) si dhe organin olfaktor e organin gustator. Në këto organe merren ngacmimet e ndjeshmerise speciale, nëpermjet receptoreve perkates. Është e qarte që këto receptore gjenden në zona të caktuara, ndryshe nga receptoret e ndjeshmerise se per gjithshme (te prekjes, temperaturove, dhimbjes, presionit, vibracionit, proprioceptionit), që gjenden të shperndare në trupin e njeriut.

### **ORGANI I TE PARIT: SYRI**

**Syri** (*oculus*) është organi i te parit. Ai perbehet nga bulbi i syrit dhe strukturat ndihmese.

**Bulbi i syrit** (*bulbus oculi*) gjendet në hapësiren e orbitës, e cila jo vetem e mbrojnë nga demtimet, por edhe sherben si vend fiksimi për strukturat ndihmese të tij.

Ai formohet nga segmente të dy sferave me rrëze të ndryshme. Segmenti anterior (*segmentum anterius*), pjesë e sfères me të vogël, është prominent dhe kufizohet përpara nga kornea. Segmenti posterior (*segmentum posterius*), pjesë e sfères me të madhe, kufizohet anash e prapa nga sklera. Qendra e konveksitetit të kornës quhet poli anterior (*polus anterior*) dhe qendra e konveksitetit të sklerës quhet

poli posterior (*polus posterior*). Linja qe kalon neper dy polet eshte aksi optik (*axis opticus*). (Ne vijim te ketij aresyetimi) bulbi i syrit ka ekuatorin (*equator*) dhe meridianet (*meridiani*).

Bulbi i syrit rrrethohet nga **tre shtresa**, shtresa fibroze, shtresa vaskulare dhe shtresa e brendshme. Gjithashtu ai ka kristalinin (lenten) dhe dhomat e tij.

■ **Shtresa fibroze** e bulbit (*tunica fibrosa bulbi*) formohet ne segmentin posterior nga sklera dhe ne segmentin anterior nga kornea.

**Sklera** (*sclera*) ka ngjyre te bardhe; ne pjesen e perparme vishet nga konjunktiva qe vjen nga palpebrat, ndersa prapa pjesa e perforuar nga n. optik quhet lamina kriroze (*lamina cribrosae sclerae*). Sklera perpara vazhdon me kornene; ne kufirin midis tyre ne sklera gjendet sinusi venoz i saj (*sinus venosus sclerae*) me pamjen e nje kanali anular.

**Kornea** (*cornea*) eshte konvekse; kufiri i saj i pasem eshte limbusi i kornese (*limbus corneae*). Ajo eshte e tejdukshme, nuk ka vaza gjaku ose limfatike, por ka inervim te konsiderueshem. Kornea ka fuqi perthyese te drites me te madhe se kristalini (lentja).

■ **Shtresa vaskulare** e bulbit (*tunica vasculosa bulbi*) formohet nga koroidea, trupi ciliar dhe irisi, qe jane ne vazhdim te njeri tjetrit.

**Koroidea** (*choroidea*) ne vendin e daljes se n. optik (ku eshte e perforuar, si dhe sklera) eshte e ngjitur me skleren, ndersa ne pjesen tjeter midis tyre gjendet hapesira perikoroidale (*spatium perichoroideum*). Ne koroidea gjendet nje pleks kapilar i dendur dhe shume qeliza te pigmentuara, qe absorbojne dritten qe kalon retinen.

**Trupi ciliar** (*corpus ciliare*) eshte vazhdim i koroideas dhe shkon deri ne kufirin e skleres me kornene. Ai perbehet nga muskuli ciliar (*m. ciliaris*) qe ka fije radiale (*fibrae radiales*) e fije cirkulare (*fibrae circulares*) dhe proceset ciliare (*processus ciliares*), qe vazhdojne me fijet zonulare te kristalinit (lentes).

**Irisi** (*iris*) eshte vazhdimi i trupit ciliar dhe ka formen e nje diafragme me nje hapje qendrore, cirkulare, te ndryshueshme, qe quhet pupila (*pupilla*).

Irisi ka margon ciliare (*margo ciliaris*), margon pupilare (*margo pupillaris*), faqen anteriore (*facies anterior*) dhe faqen posteriore (*facies posterior*). Faqja anteriore e irisit eshte e pigmentuar dhe ngjyrat variojne nga e kalter (mungese e pigmentit) deri ne kafe e erret. Pigmentimi eshte i nevojshem per te kufizuar

kalimin e drites neper iris ne pjesen periferike te kristalinit (lentes), ku aberacionet optike jane me te medha.

Ne iris gjenden fije te muskulatures se lemuar qe formojne m. sfinkter pupile (*m. sphincter pupillae*), qe ngushton pupilen dhe m. dilatator pupile (*m. dilatator pupillae*), qe e zgjeron ate.

■ **Shtresa e brendshme** e bulbit (*tunica interna bulbi*) formohet nga retina (*retina*). Ajo eshte nje strukture nervore komplekse, e prejardhur nga truri, ku gjenden receptoret e drites (konet e shkopinjtë).

**Retina** mbeshtetet ne shtresen vaskulare te bulbit ne gjithe shtrirjen e saj, deri ne pupile. Pjesa e retines qe mbeshtetet ne koroidea ka receptore te drites dhe quhet **pjesa optike** e saj (*pars optica retinae*), ndersa pjesa tjeter qe mbeshtetet ne trupin ciliar e ne iris nuk ka receptore te tille dhe quhet **pjesa e verber** e retines (*pars caeca retinae*). Kufiri midis dy pjesave eshte ora serrata (*ora serrata*).

Ne pjesen e pasme, ne qender te retines, gjendet nje zone eliptike, 1-2 cm, me ngjyre te verdhe, **makula lutea** (*macula lutea*), qe ne qender ka **fovean centrale** (*fovea centralis*), ku rezolucioni optik eshte maksimal. Pak medialisht makules, gjendet vendi i formimit te nervit optik me pamjen e nje disku (*discus nervi optici*).

■ **Kristalini** ose lentja (*lens*) eshte strukture bikonvekse, e tejdukshme dhe vendoset prapa irisit. Ajo ka polin anterior (*polus anterior*), polin posterior (*polus posterior*), faqen anteriore (*facies anterior*), faqen posteriore (*facies posterior*) dhe ekuatorin (*equator*) ne kufirin midis dy faqeve. Nga ekuatori ne proceset ciliare gjendet zonula cilare (*zonula ciliaris*) me fijet zonulare (*fibrae zonulares*), qe sherbejne si ligamente suspensore te kristalinit. Gjate tkurries se m. ciliar fijet zonulare çtendosen dhe kristalini (elastik) behet me konveks; e kunderta ndodh gjate relaksimit te m. ciliar. Kjo siguron ndryshimin e fuqise perthyese te kristalinit dhe si rezultat akomodimin.

■ **Dhomat** e syrit (*camerae bulbi*) jane dhoma anteriore, dhoma posteriore dhe dhoma qelqore.

**Dhoma anteriore** (*camera anterior*) gjendet midis kornese dhe irisis. Midis tyre formohet kendi iridokorneal (*angulus iridocornealis*).

**Dhoma posteriore** (*camera posterior*) gjendet midis irisit dhe lentes e trupit ciliar. Dhoma anteriore e dhoma posteriore jane te mbushura me leng ujor.

**Dhoma qelqore** (*camera vitrea*) gjendet prapa lentes dhe eshte e mbushur me trupin qelqor.

**Lengu ujor** (*humor aquosus*) prodhohet ne dhomen posteriore ne proceset ciliare, kalon nepermjet pupiles ne dhomen anterieore dhe drenon ne kedin iridokomeal ne sinusin venoz te skleres.

Lengu ujor dhe trupi qelqor (*corpus vitreum*) jane struktura perthyese te drites.

**Strukturat ndihmese te syrit** (*structurae oculi accessoriae*) jane muskujt e jashtem te syrit, palpebrat dhe aparati lakrimale.

■ **Muskujt e jashtem te syrit** (*musculi externi bulbi oculi*) fillojne ne nje unaze tendinoze te perbashket (*anulus tendineus communis*) rrreh hapjes se kanalit optik dhe perfundojne ne ekuatorin e bulbit. Ata jane te drejte dhe oblike.

**M. rektus superior** (*m. rectus superior*) e rrotullon syrin lart, m. rektus inferior (*m. rectus inferior*) e rrotullon poshte, m. rektus medial (*m. rectus medialis*) e rrotullon medialisht dhe m. rektus lateral (*m. rectus lateralis*) e rrotullon lateralisht.

**M. oblik superior** (*m. obliquus superior*) e rrotullon syrin poshte e anash, ndersa m. oblik inferior (*m. obliquus inferior*) siper e anash.

**M. levator i palpebres superiore** (*m. levator palpebrae superioris*) shoqeron m. rektus superior, por perfundon ne palpebren superiore duke e ngritur ate gjate tkurrrjes.

■ **Palpebrat** (*palpebrae*) ose qepallat mbrojne nga perpara bulbin e syrit. Palpebra e siperme (*palpebra superior*) eshte me e madhe se palpebra e poshtme (*palpebra inferior*). Secila palpeber ka faqen anterieore (*facies anterior palpebrae*) dhe faqen posteriore (*facies posterior palpebrae*); ne kufirin midis tyre dalin qerpiket ose ciljet (*cilia*). Hapesira midis dy palpebrave quhet rima palpebrale (*rima palpebrarum*). Forma e palpebres (e perputhshme me formen e bulbit) sigurohet nga **tarset** (*tarsus superior, tarsus inferior*) qe luajne rolin e nje "skeleti kercor".

Faqja posteriore e palpebrave vishet me **konjunktive**, e cila pastaj vesh edhe nje pjese te skleres. Gjate kalimit nga palpebra ne sklere ajo formon fornixin superior (*fornix conjunctivae superior*) dhe fornixin inferior (*fornix conjunctivae inferior*).

Mbi palpebren superiore gjendet vetulla (*supercilium*).

■ **Aparati lakrimale** (*apparatus lacrimalis*) perbehet nga gjendra lakrimale dhe rruget lakrimale.

**Gjendra lakrimale** (*glandula lacrimalis*) vendoset ne fosen e saj ne murin superolateral te hapesires se orbites. Ajo e derdh lotin ne pjesen laterale te fornixit superior, nga ku ai zbret ne siperfaqen e bulbit te syrit

**Rruget lakrimale** perfshijne rruget ku kalon loti. Fillimisht ai mblidhet ne lumin lakrimale (*rivus lacrimalis*), qe formohet midis kornese dhe palpebrave, pastaj kalon ne kedin medial te syrit ne liqenin lakrimale (*lacus lacrimalis*), ne sakusin lakrimale (*saccus lacrimalis*) dhe nepermjet duktusit nazolakrimale (*ductus nasolacrimalis*) derdhet ne hapesiren nazale.

## ORGANI I DEGJIMIT E ORGANI I EKUILIBRIT: VESHI

**Veshi** (*auris*) eshte organ i degjimit dhe organ i ekuilibrit. Ai vendoset ne kocken temporale dhe perbehet nga veshi i jashtem, veshi i mesem dhe veshi i brendshem.

**Veshi i jashtem** (*auris externa*) perfshin aurikulen dhe meatusin akustik ekstern. Aurikula mbledh valet e zerit, ndersa meatusi akustik ekstern i dergon drejt membranes timpanike.

■ **Aurikula** (*auricula*) ose liapa e veshit ka siperfaqje ne forme konkave te çrrregullt. Ne buzen e jashtme te kesaj siperfaqje gjendet helixi (*helix*). Pjesa qendrore ne forme koni e aurikules, qe con ne meatusin akustik ekstern, eshte konka (*concha auriculae*). Perpara konkes gjendet tragusi (*tragus*). Ne pjesen e poshtme te aurikules gjendet lobulusi i saj (*lobulus auriculae*), qe nuk ka kerc, ndersa pjesa tjeter e aurikules ka skelet kercor.

■ **Meatusi akustik ekstern** (*meatus acusticus externus*) fillon me porusin akustik ekstern (*porus acusticus externus*) dhe perfundon tek membrana timpanike. Nje e treta laterale e tij eshte kartilaginoze dhe dy te tretat mediale kockore. Ai eshte i perkultur ne formen e shkronjes S.

■ **Membrana timpanike** (*membrana tympanica*) vendoset ne sulkusin timpanik ne fund te meatusit akustik ekstern. Ajo ka pjesen me te madhe te tendosur (*pars tensa*) dhe nje pjese te vogel jo te tendosur (*pars flaccida*). Membrana timpanike eshte konvekse nga jashte dhe pika me e dale quhet **umbo** (*umbo membranae tympanicae*).

**Veshi i mesem** (*auris media*) perfshin hapesiren timpanike dhe kockat e degjimit, te cilat gjenden ne te.

■ **Hapesira timpanike** (*cavitas tympani*) gjendet ne pjesen petroze te kockes temporale dhe ka formen e nje kubi te çrrregullt me gjashte faqe, ku ajo laterale quhet **faqja membranoze** (*paries membranaceus*) meqe ne te gjendet membrana timpanike, ndersa ajo mediale quhet **faqja labirintike** (*paries labyrinthicus*) meqe ka raport me labirintin. Ne qender te faqes mediale gjendet nje fryrje qe quhet promontorium (*promontorium*); mbi te gjendet **fenestra vestibulare** (*fenestra vestibuli*) ose ovale e nen te **fenestra kokleare** (*fenestra cochlae*) ose e rrumbullaket, qe mbyllt nga membrana timpanike sekondare (*membrana tympanica secundaria*).

Ne murin anterior te hapesires timpanike gjendet **ostium i tubit auditiv** (*ostium tympanicum tubae auditivae*) qe e lidh ate me nazofaringun. Ky komunikim siguron presion te njejtë te ajrit ne dy anet e membranes timpanike dhe amplitude optimale te dridhjeve te saj.

■ **Kockat e degjimit** (*ossicula auditus*) jane kocka te vogla qe artikulojnë me njera tjetren dhe lidhin murin lateral me murin medial te hapesires timpanike, duke transmetuar dridhjet e membranas timpanike. Ato jane maleusi, inkusi e stapesi.

**Maleusi** (*malleus*) ka formen e çekiçit; nga njera ane ai mbeshtetet ne membranen timpanike (duke formuar umbon) e nga ana tjeter artikulon me inkusin.

**Inkusi** (*incus*) ka formen e kudhres; lateralisht ai artikulon me çekiçin dhe medialisht me stapesin.

**Stapesi** (*stapes*) ka formen e yzengjise; lateralisht ai artikulon me inkusin, ndersa medialisht ka bazen (*basis stapedis*) qe vendoset ne fenestren e vestibulare ovale.

**Veshi i brendshem** (*auris interna*) perbehet nga labirinti kockor dhe labirinti membranoz.

■ **Labirinti kockor** (*labyrinthus osseus*) ka vestibulumin, kanalet semicirkulare dhe koklean.

**Vestibulumi** (*vestibulum*) eshte pjesa e mesme e labirintit dhe vendoset medialisht hapesires timpanike. Ne murin lateral ai ka fenestren vestibulare ku vendoset baza e stapesit, perpara komunikon me koklean, ndersa prapa me kanalet semicirkulare.

**Kanalet semicirkulare** (*canales semicirculares*) jane tre dhe vendosen ne plane perpendikulare me njeri tjetrin. Ata gjenden prapa vestibulumit dhe hapen ne te.

**Koklea** (*cochlea*) ka pamjen e nje kermilli me majen (*cupula cochleae*) dhe bazen (*basis cochleae*). Koklea formohet nga nje kanal spiral (*canalis spiralis*

*cochleae*), qe fillon nga vestibuli dhe mbeshtillet rreth pjeses qendrore qe quhet **modiolus** (*modiolus*). Nga modiolusi del nje flete kockore spirale (*lamina spiralis ossea*) qe shkon brenda kanalit spiral ne gjithe gjatesine e tij. Modiolusi ka kanale longitudinale (*canales longitudinales modioli*) perjate tij, ndersa ne bazen e lamines spirale gjendet kanali spiral i modiolusit (*canalis spiralis modioli*). Kanali spiral komunikon me kanalet longitudinale.

Nga buza e lire e **lamines spirale** drejt paretit te kanalit spiral shkojne dy membrana: **membrana vestibulare** dhe **membrana bazale**. Ne kete menyre brenda kanalit spiral formohen tre kanale me te vegjel. Ne qender eshte **duktusi koklear** (*ductus cochlearis*) ose skala media (*scala media*), pjesa e labirintit membranoz, qe mbyllt ne menyre te verber ne majen e kokleas; ne brendesi te saj, ne faqen e brendshme te membranes bazilare gjenden qelizat receptore te degjimit. Mbi duktusin koklear eshte **skala vestibulare** (*scala vestibuli*) dhe nen duktusin **skala tympanike** (*scala tympani*). Skala vestibulare dhe skala timpanike komunikojne me njera tjetren ne majen e kokleas. Ne ekstremin tjeter skala vestibulare perfundon ne fenestren vestibulare ovale, qe mbyllt nga baza e stapesit, ndersa skala tympanike perfundon ne fenestren kokleare te rrumbullaket qe mbyllt nga membrana timpanike sekondare.

■ **Labirinti membranoz** (*labyrinthus membranaceus*) gjendet brenda labirintit kockor. Ne hapesireni e ngushte midis tyre gjendet perilimfë (*perilympfa*), ndersa labirinti membranoz mbushet me endolimfë (*endolympha*).

Ne nivelin e vestibulumit, labirinti membranoz formon **utrikulusin** (*utricle*) e **sakulusin** (*saccule*), qe komunikojne midis tyre. Nga ana tjeter, utrikuli komunikon me kanalet (membranoze) semicirkulare, ndersa sakuli me duktusin (membranoz) koklear. Qelizat receptore ne utrikulus gjenden ne makulan e tij (*macula utriculi*), ne sakulus gjenden ne makulan e tij (*macula sacculi*), ndersa ne duktuset semicirkulare gjenden ne kristen e seclit prej tyre (*crista ampullaris*).

**Organi i degjimit** ose organi spiral gjendet ne membranen bazilare ne duktusin koklear te mbushur me endolimfe. Ne qelizat receptore te tij perfundojnë zgjatimet periferike te qelizave te ganglionit spiral te vendosur ne kanalin螺旋 te modiolusit. Zgjatimet qendrore te tyre, qe kalojne neper kanalet longitudinale te modiolusit, formojne **nervin koklear**. Nervi del ne bazen e modiolusit, bashkohet me nervin vestibular dhe futet ne meatusin akustik intern.

**Organi i ekuilibrit** ose organi vestibular ka qelizat receptore te vendosura ne makulat e sakulusit e utrikulusit dhe ne kristat e kanaleve semicirkulare. Ne to perfundojnë zgjatimet periferike te qelizave te ganglionit vestibular. Zgjatimet qendrore te tyre formojne **nervin vestibular**. Ai bashkohet me nervin koklear dhe futet ne meatusin akustik intern.

Ndonese njeriu nuk eshte i ndergjegjshem per komponentin vestibular te eksperencies se tij sensore, ky komponent eshte esencial per kordinimin e levizjeve motore.

## ORGANI I NUHATJES: HUNDA

**Organi i nuhatjes** ose organi olfaktori formohet nga qeliza te specializuara, olfaktore, te vendosura ne pjesen olfaktore te hapesires se hundes, ne tavanin e saj. Kjo pjese ka nje siperfaqe relativisht te vogel ( $5 \text{ cm}^2$ ) tek njeriu. Meqenese jane te ekspozuar ndaj “ambjentit te jashtem” qelizat receptore demtohen, keshtu ne edhe prodhohen te tjera vazhdimit. Megjithate me kalimin e moshes numri i tyre pakesohet dhe po keshtu aftesia nukatese. Ngacmimet olfaktore nga qelizat receptore i percillen n. olfaktori.

## ORGANI I SHIJES: GJUHA

**Organi i shiges** ose organi gustator (*organum gustatorium*) formohet nga qeliza te specializuara, gustatore, te grupuara ne formen e sytheve (*caliculus gustatorius*). Ato jane te vendosura kryesisht ne gjuhe, por gjithashtu edhe ne qjellzen e bute dhe epiglotis. Ne gjuhe ato gjenden ne papilat e saj, kryesisht ato valate, ndersa mungojne ne papilat filiforme. Ndjeshmeria gustatore percillet nga n. korda timpani (dy te tretat anteriore te gjuhes), n. glosofaringeal (nje e treta anteriore e gjuhes) dhe n. vag (epiglotisi).

### Fakte klinike

#### Ekzaminimi i syve

Ekzaminim i syve percakton aftesine shikuese, funksionin e muskujve te jashtem dhe demtimin e mundshem te syve nga semundje te tjera. Aparati qe mundeson vezigimin e strukturave te brendshme te bulbit quhet oftalmoskop.

#### Glaukoma

Rritja e presionit intraokular quhet glaukoma dhe ajo vjen kur prishet balanca midis prodhimit dhe absorbimit te lengut ujor. Glaukoma mund te çoje deri ne verberi nga kompresioni i retines dhe vazave te gjakut.

#### Katarakti

Me rritjen e moshes kristalini fillon e behet opak duke ulur keshtu progresivisht aftesine shikuese. Nderhyrja konsiston ne heqjen dhe zevendesimin e tij.

#### Miopia

Miopia (aferpamesia) eshte ajo gjendje ne te cilen objektet e aferta shihen qarte ndersa te largetat jo. Ne kete rast strukturat perthyese te drites e fokusojne imazhin jo ne retine, por perpara saj, ne trupin vitroz. Perdorimi i lenteve konkave pakeson perthyerjen e rrezeve dhe korigjon miopine.

#### Hipemetropia

Hipemetropia (largpamesia) eshte ajo gjendje ne te cilen objektet e aferta nuk shihen qarte, ndersa te largetat po. Ne kete rast strukturat perthyese te drites e fokusojne imazhin jo ne retine, por pertej saj. Perdorimi i lenteve konvekse pakeson perthyerjen e rrezeve dhe korigjon hipemetropine.

#### Presbiopia

Presbiopia eshte ajo gjendje ne te cilen, si pasoje e humbjes se elasticitetit te kristalinit dhe tonusit te n. ciliar, zvogelohet aftesa “fokusuese” e syve. Presbiopia fillon te shfaqet ne moshen rreth 45 vjeç me veshiresi ne leximin e shkronjave te vogla dhe perparon me kalimin e moshes. Ajo nuk konsiderohet semundje.

#### Strabizmi

Strabizmi eshte ajo gjendje ne te cilen, si pasoje e moskordinimit te muskujve te jashtem te syve, akset e dy bulbeve okulare nuk konvergojnë ne pikën qe vezhgohen. Strabizmi mund te jete unilateral ose bilateral si dhe konvergent ose divergent. Shaneset e suksesit te trajtimit Jane me te medha ne femijeri.

#### Ekzaminimi i veshit

Veshi i jashtem ekzaminohet lehtesish. Meatusi akustik ekstern dhe membrana timpanike ekzaminohen nepermjet nje aparati qe quhet otoskop.

Veshi i mesem dhe veshi i brendshem ekzaminohen nepermjet skanerit dje rezonances magnetike.

#### Perforacioni i membranes timpanike

Perforacioni (shpimi) i membranes timpanike vjen kryesisht nga trauma dje infekzioni. Infekzioni i veshit te mesem (otitis media) mund te çoje ne perforim te membranes timpanike dhe derdhje te sekrecioneve jashte (rrjedhja e veshit). Ne shumicen e rasteve sherimi i ruptures behet spontanisht.

## 14. MBULESA E TRUPIT

Lekura  
dhe derivatet e saj  
Indi i nenlekures  
Gjendrat e qumeshtit

**Mbulesa e trupit** ose **integumenti** (*integumentum commune*) perfshin lekuren e derivatet e saj (qimet, thonje, gjendrat), indin e nenlekures dhe gjendrat e qumeshtit.

Mbulesa e trupit e mbron ate nga demtimet fizike, kimike e termike; merr pjesë ne termoregullim dhe permban receptoret e ndjeshmerise. Ne kete menyre ajo eshte vendi i komunikimit te trupit me mjedisin e jashtem.

### LEKURA DHE DERIVATET E SAJ

**Lekura** (*cutis*) ndahet ne pjesen e saj me qime, qe eshte pjesa me e madhe dhe pjesen pa qime qe gjendet ne pellembet e duarve, shputat e kembeve dhe siperfaqen flektore te gishtave. Ne nivelin e palpebrave lekura modifikohet ne konjunkte ndersa ne nivelin e orificiumeve te trupit ajo vazhdon me mukoze. Lekura eshte elastike dhe perbehet nga **epiderma** (*epidermis*) dhe **derma** (*dermis*).

Ngyra e lekures varet nga sasia e pigmentit melanine, qe gjendet ne te; funksioni i tij eshte mbrojtja ndaj irrezatimit ultraviolet.

**Qimet** (*pili*) ndryshojne ne gjatesi, trashesi e ngjyre ne pjesë te ndryshme te trupit. Qimet e drejta jane per gjithesish me te forta se ato te perkulura. Qimet ne

koke quhen floke (*capilli*), ne palpebra quhen cilie (*cilia*), ne vetulla supercilie (*supercilia*) etj.

**Thonje** (*unguis*) jane derivat i epidermes ne te cilin drejtimi dhe kohezioni i shtresave perberese sigurojne fortisine. Thonje kane buzen e lire (*margo liber*), buzet laterale (*margo lateralis*), buzen e fshehur (*margo occultus*), trupin (*corpus unguis*) si dhe matriksin (*matrix unguis*) i cili eshte pjesa e padukshme e thoit.

**Gjendrat e lekures** (*glandulae cutis*) jane gjendra te djerves (*glandula sudorifera*) dhe gjendra dhjamore (*glandula sebacea*).

**Gjendrat e djerves** kane rol te rendesishem ne termorregullim; keshtu racat qe jetojne ne vende te nxehta i kane me te shumta ato.

**Gjendrat dhjamore** gjenden prane qimeve dhe jane me te medha ne ftyre, gjoks e shpatulla.

## INDI I NENLEKURES

**Indi i nenlekures** (*tela subcutanea*) ose **hipoderma** (*hypodermis*) eshte ind lidhor i shkrifet qe lejon mobiliteten dhe elasticitetin e lekures dhe eshte vendi ku kalojne vazat dhe nervat e nenlekures. Mbi muskujt ai shpesh eshte ind dhjamor (*panniculus adiposus*) i shperndare jo uniformisht ne pjese te ndryshme te trupit. Pergjithesish eshte me i shumte dhe me uniform tek femrat; gjithashtu eshte me i shumte tek banoret e zonave te ftohta.

## GJENDRAT E QUMESHTIT

**Gjendra e qumeshtit** (*glandula mammae*), qe gjendet ne gjirin e femres (*mamma*), eshte burim i ushqimit per te porsalidurin.

Midis gjirit te majte e gjirit te djathte gjendet sulkusi intermamar (*sulcus intermammarius*).

Secili gji ka ne qender areolen (*areola mammae*) dhe papilen (*papilla mammae*), ne te cilin hapen duktuset laktifere (*ductus lactiferi*).

Gjendrat e qumeshtit gjenden ne indin e nenlekures se gjinjeve dhe perbehen nga lobe (*lobi glandulae mammae*). Forma, madhesia dhe ndertimi i tyre ndryshojne gjate moshes, ciklit menstrual, gravidances e laktacionit.

Tek meshkujt gjendrat e qumeshtit jane rudimentare.

## Fakte klinike

### Kanceri i gjirit

Kanceri i gjirit eshte nga me te shpeshit e tumoreve malinje tek femrat. Ai zhvillohet ne gjendren e qumeshtit dhe mund te shoqerohet me limfadenopati kryesisht aksilare dhe metastaza ne organe te tjera. Pas percaktimit te statit te semundjes mund te behet kimioterapi, radioterapi ose kirurgji. Nderhyrja kirurgjikale konsiston ne heqjen e gjirit (mastektomi) dhe dhe limfonodulave te prekur aksilare.

Kanceri i gjirit mund te zhvillohet edhe tek meshkuji.